

# EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE  
ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

Viti LV nr. 137 / 2025

Boton: KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME E KOSOVËS

## EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE

ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

**www.edukataislame.net**

e-mail: [edukataislame@yahoo.com](mailto:edukataislame@yahoo.com)

Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182

**Tel & fax: 038 / 224-024**

*Redaksia:*

Ramadan Shkodra - kryeredaktor,

Dr. Ajni Sinani - redaktor

Dr. Sadik Mehmeti - redaktor

Dr. Sedat Islami - redaktor

Mr. Besnik Jaha - redaktor

*Redaktor gjuhësor:*

Besnik Jaha

*Redaktor teknik & ballina:*

Nuhi Simnica

*Shtypi:*

"Printing press" - Prishtinë

Tirazhi: 300

# EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE

ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

Viti LV nr. 137 / 2025

Prishtinë  
2025



## **I. EDITORIAL**



## **HARMONIA NDËRFETARE - VLERË IDENTIFIKUESE E POPULLIT SHQIPTARË**

Një nga tiparet dalluese të shoqërisë shqiptare është harmonia ndërfetare, e cila paraqet një vlerë që ka mbijetuar dhe lulëzuar përmes shekujve, pavarësisht rrethanave dhe sfidave historike, politike dhe shoqërore. Në një territor ku bashkëjetojnë myslimanë e të krishterë, shqiptarët kanë ndërtuar një model unik të tolerancës dhe të mirëkuptimit fetar. Kjo harmoni prej kohësh nuk është thjesht bashkëjetesë, por një bashkëveprim i bazuar në respektin, traditën dhe kulturën e përbashkët kombëtare. Që feja mos të jetë një faktor ndarës, ajo është kthyer në një element që pasuron identitetin shqiptar, duke dëshmuar se përkatësia fetare nuk e zbeh përkatësinë kombëtare, por e begaton dhe e forcon atë; ajo u bë një faktor përbashkues. Kjo bashkëjetesë paqësore është një dëshmi e pjekurisë së shoqërisë shqiptare dhe një shembull frymëzues dhe model për shumë vende, popuj e shoqëri të tjera.

Populli ynë ka qenë dhe mbetet i lidhur ngushtë me dy besimet më të mëdha monoteiste: Krishterimin dhe Islamin. Të dy besimet kanë pasur një rol të pazëvendësueshëm në krijimin e identitetit të popullit shqiptar përgjatë shekujve. Roli dhe misioni i feve, ashtu si në çdo shoqëri tjetër, është i shumanshëm dhe i thellë – nga aspekti shpirtëror, moral e social, deri tek ai kulturor, arsimor, ekonomik dhe historik.

Bashkëjetesa e dy besimeve më të mëdha monoteiste – e Islamit dhe e Krishterimit – ka bërë që toleranca dhe mirëkuptimi ndërfetar të jenë një domosdoshmëri historike për popullin shqiptar. Kjo bashkëjetesë ka shërbyer si një faktor kyç për ruajtjen e unitetit kombëtar dhe ekzistencën tonë si komb, duke na e dhënë një vlerë të rrallë: harmoninë ndërfetare – një pasuri që shumë vende të botës ende e kërkojnë. Madje, kjo harmoni ndërfetare ka kaluar edhe në përmasa ndërkulturore dhe ndëretnike.

Kjo sepse, që të dy këto besime abrahamike – Krishterimi dhe Islami, historikisht janë të organizuara në bashkësi dhe udhëhiqen prej prijësve fetarë që meritojnë një respekt të veçantë për kontributin e tyre në ndërtimin e themeleve të bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare. Pra, vlera e

harmonisë ndërfitare është ngritur dhe kultivuar prej udhëheqësve shpirtërorë të këtyre komuniteteve, të cilët me urtësi dhe përkushtim kanë lexuar, komentuar e interpretuar drejt mesazhet e shenjta të librave hyjnorë – Kuranit dhe Biblës – duke ndriçuar udhën e bashkëjetesës dhe të mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve të tyre në veçanti, dhe shoqërisë në përgjithësi.

Një thirrje e tillë madhore për njohje dhe afrimet gjendet në Kuranin fisnik, ku në mënyrë decisive, thuhet: ***“O njerëz! Ne ju kemi krijuar prej mashkulli e femre, dhe ju kemi bërë popuj e fise, që të njiheni me njëri-tjetrin.”*** (Kuran, Huxhurat, ajeti i 13-të)

Ndërsa, nga Bibla dërgohet ftesa për paqe dhe mirëkuptim të ndërsjellë: *“Nëse është e mundur, për aq sa varet prej jush, rroni në paqe me të gjithë njerëzit!”* (Bibla, Letra drejtuar Romakëve 12:18)

Prandaj, duke u mbështetur mbi këto parime, bashkëjetesa, mirëkuptimi, harmonia dhe respekti ndërfitar, janë bërë pjesë e traditës sonë dhe janë njohur e vlerësuar gjerësisht edhe prej të huajve. Këto vlera janë bërë një tipar dallues i popullit tonë, i cili vlerësohet si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim – nga Meka në Vatikan, e deri në Jerusalem. Madje, jo vetëm sot, por kështu ka qenë që në krye të herës. Dhe kjo, po e themi për të dytën herë, falë prijësve tanë fetarë, të cilët me urtësinë dhe vizionin e tyre, krijuan premiset për mirëkuptim dhe bashkëjetesë mes besimtarëve, duke promovuar ndjesinë e përkatësisë së përbashkët dhe të vëllazërisë hyjnore, si dhe, në periudhat historike, duke mbështetur idenë e shtetformimit dhe kombformimit. Ata e trajtuan fenë si një pasuri, dhe jo si burim ndarjeje apo përçarjeje.

Prijësit e shquar të komuniteteve fetare shqiptare ishin të vetëdijshëm se feja duhet shpjeguar dhe interpretuar në frymën e mësimave të Zotit të Madhëruar. Ata e kultivuan mesazhin se *“myslimanë e të krishterë kemi një Zot të vetëm”*, të Cilin e adhurojmë secili në formën dhe sipas doktrinës së vet, mirëpo jo duke u ndarë, por duke u bashkuar.

Me përgjegjësi të lartë, prijësit tanë fetarë prore kanë promovuar vlerat e përbashkëta të popullit tonë: etninë, gjakun, gjuhën, flamurin dhe atdheun. Ata i mbrojtën shqiptarët nga përpjekjet për t'i përçarë përmes fesë, duke e shndërruar fenë në një burim uniteti, sipas shembullit të Ha-

xhi Ymer Prizrenit, Haxhi Vehbi Dibrës, Dom Nikollë Kaçorrit, Gjergj Fishtës, Hafëz Ali Korçës, Fan Nolit, Mulla Idriz Gjilanit, Hafëz Sabri Koçit, At Zef Pllumbit dhe shumë e shumë të tjerëve, përmendja e të cilëve do të shkonte shumë gjatë. Këta burra të mëdhenj, këta intelektualë, fetarë e personalitete të shquara, duke përçuar me penë dhe me vepra mesazhe të bashkimit dhe të vëllazërisë, lanë pas vetes një trashëgimi shpirtërore dhe kombëtare që s'ka çmim për ta vlerësuar.

- *“Të gjithë shqiptarët janë vëllezër - qofshin myslimanë, të krishterë apo të tjerë - sepse gjaku dhe gjuha na bashkojnë”*, - thoshte Haxhi Vehbi Dibra kudo që shkonte e kahdo që ligjëronte.

Ndërsa, Dom Nikollë Kaçorri vazhdonte: *“Shqiptarët nuk i ndan feja, por i bashkon dashuria për atdheun.”*. Gjergj Fishta, shpjegonte se *“feja për ne shqiptarët është punë shpirti, por Atdheu është mbi të gjitha.”*. Kurse, Hafëz Ali Korça vërtetonte se: *“Feja s’duhet të na ndajë, por të na bashkojë në të mirën e kombit.”*.

Kjo qasje e thellë dhe e gjithanshme është dëshmi e ndërgjegjes sonë historike, ku feja ka shërbyer gjithmonë si një shtyllë e fortë e shpirtit, dhe asnjëherë nuk e ka ndarë popullin. Ajo që i ka bashkuar shqiptarët ka qenë dashuria për Atdheun dhe dëshira për t’i ruajtur vlerat e përbashkëta.

Kështu, me ndjenjën e respektit ndaj besimit të tjetrit qenë edukuar edhe besimtarët. Feja tjetër është parë si feja e vëllait, dhe objektet e kultit – xhami e kisha, – janë trajtuar si vende të shenjta.

Prijësit fetarë dhe institucionet arsimore kanë ditur ta ruajnë një ekuilibër të admirueshëm: kanë promovuar fenë e tyre dhe njëkohësisht e kanë respektuar fenë e tjetrit. Ky është një tipar që e bën popullin tonë të veçantë, ndërsa bashkësitë tona fetare një model për harmoninë dhe bashkëjetesën ndërfetare.

Këto vlera të bashkëjetesës dhe të harmonisë ndërfetare janë ruajtur me sukses edhe gjatë viteve të '90-ta, kur e përballuam okupimin serb. Atëherë dy bashkësitë tona fetare të Kosovës, Bashkësia Islame dhe Kisha Katolike, ishin në ballë të popullit dhe kontribuan për realizimin e ëndrrës për një Kosovë të lirë.

Harmonia ndërjetare, mirëkuptimi dhe bashkëjetesa janë vlera të rra-lla sot, po edhe shumë të nevojshme dhe tepër të rëndësishme për të gjithë popujt kudo nëpër botë. Kurse, për ne shqiptarët, meqë i kemi këto, është e rëndësishme që sikurse përgjatë historisë, edhe sot dhe për mot t'i ruajmë dhe t'i kultivojmë. Kjo është trashëgimi jona, dhe është detyrë jona njëkohësisht. Sepse, *“Feja, siç do të thoshte me të drejtë Hafiz Ali Korça, - nuk është për t'i ndarë njerëzit në fise, por për t'i bashkuar në dashurinë ndaj Zotit dhe Atdheut.”*

Sepse, një komb i bashkuar është një komb që ka arritur unitetin jo vetëm në aspektin politik, por mbi të gjitha edhe në nivel shpirtëror.

Prandaj, çdo nismë që synon të krijojë çfarëdo ndarjeje fetare apo sektare, prej kujt do qoftë, do të ishte një hap mbrapa për popullin tonë, dhe do t'i dëmtonte vlerat që kemi ndërtuar e kultivuar për shekuj.

Koha është për të qëndruar të bashkuar, duke e mbajtur besimin dhe kombin tonë si dy shtylla që na mbajnë të fortë dhe të qëndrueshëm. T'i mbrojmë dhe t'i kultivojmë këto dy vlera me përgjegjësi, me vetëdije dhe me dashuri – jo vetëm për ta nderuar të kaluarën tonë, por edhe për ta ndërtuar një të ardhme më të drejtë, më të qetë dhe më të bashkuar për brezat që vijnë! E tashmja dhe e ardhmja jonë është e sigurt kur ne jemi të bashkuar dhe kur jetojmë në paqe e harmoni me njërin-tjetrin. Në të kundërtën, të gjithë do të jemi humbës e të dënuar.

**Ramadan Shkodra**

## **II. ISLAMISTIKË**



Dr. Ass. Bahri HOXHA

## **XHENETI DHE XHEHENEMI NË BESIMIN ISLAM**

### **Abstrakt**

Shpjegimi fetar islam rreth realitetit të jetës në përgjithësi është i plotë dhe i arsyeshëm. Jeta sipas besimit islam nuk përfshin vetëm kohën e të jetuarit në këtë botë, por në kuptimin e përgjithshëm i tejkalon kufijtë e jetës në këtë botë, për të vazhduar në përjetësi. Jeta e përhershme personifikohet në marrjen e shpërblimit nga besimtarët e drejtë, të cilët veprojnë mirë, si dhe marrjen e dënimit nga jobesimtarët që kanë kryer vepra të liga në këtë botë. Në këtë kontekst, vijnë në shprehje emërtimet e këtyre dy vendpërfundimeve të përhershme. Përveç të tjerash, besimi në Xhenet dhe Xhehenem është shtytësi më praktik i fesë në mbjelljen e kujdesit ndaj krimeve, si dhe në nxitjen e vullnetit pozitiv për të anuar kah virtytet dhe e mira. Ky punim përmban disa rreshta mbi shpjegimin teorik islam lidhur me besimin në Xhenet dhe Xhehenem, si përgjigje ndaj disa pyetjeve që mund të parashtrohen në lidhje me shpjegimin teologjik islam mbi këto realitete, të cilat, sipas shumicës së besimeve, por edhe sipas Islamit, flasin për të ardhmen e njerëzimit.

**Fjalët kyçe:** *Xhenet, Xhehenem, Ahiret, shpërblim, dënim, përjetësi.*

## Nocioni Xhenet dhe Xhehenem

Fjala Xhenet rrjedh nga “xhenene”, e cila gjuhësisht e ka kuptimin e mbulimit, dendësisë, fshehjes etj. Dijetari Ragib El Asfehani thotë: “Xhenet quhet kopshti i dendur, dendësia e të cilit e mbulon Tokën.”<sup>1</sup>. Kurse, në terminologjinë islame përkufizohet si: “Vendshpërblimi për besimtarët në botën e Ahiretit.”<sup>2</sup>. Imam Ebu Hanife, në librin e tij “El Vesijeh”, kur flet për Xhenetin, thotë: “Zoti e ka krijuar si vend të shpërblimit.”<sup>3</sup>. Edhe Imam Es Savi Xhenetin e përkufizon: “Vendi ku merret shpërblimi final.”<sup>4</sup>.

Kurse, fjala “xhehenem” rrjedh nga persishtja, dhe e ka kuptimin e një grope të thellë (xhihinnam), kurse në terminologjinë islame është “Një nga emërtimet e zjarrit me të cilin Zoti i dënon, në botën tjetër, ata që e meritojnë dënimin e Tij.”<sup>5</sup> Imam Es Savi e definon Xhehenemin si shkalla më e lehtë e dënimit me zjarr, e cila është e përkohshme, sepse në të dënohen vetëm besimtarët mëkatarë. Kjo derexhe e zjarrit do të shuhet dhe do të shndërrohet në dhe, pas daljes së të gjithë besimtarëve mëkatarë nga aty.<sup>6</sup> Këtë e thonë shumica e dijetarëve të Ehli Sunetit, ani pse termi Xhehenem e ka marrë emërtimin e përgjithshëm të venddënimit me zjarr pas Ditës së Gjykimit, dhe në literaturën islame përdoret në kuptimin e tij të përgjithshëm, domethënë, të tërësisë së dënimit në Ahiret.<sup>7</sup>

<sup>1</sup> El Asfehani, Er Rragib, El Mufredat fi garibil Kuran, Darul kalem, Damask, 1992, f. 204.

<sup>2</sup> Definicion i nxjerrë nga një mori burimesh.

<sup>3</sup> El Babertij, Muhamed bin Muhamed, Sherh El Vesijeh li Ebi Hanifeh, Tahkik: Muhammed el Aidij dhe Hamza El Bekrij, Darul Fet’h, Aman, 2017, f. 53.

<sup>4</sup> Es Savi, Hashijetu Savi ala Xhveherit Tevhid, dar El kutub el ilmijeh, Bejrut, 2010, f. 194.

<sup>5</sup> El Mu'xhemul Vesit, Muxhemmeul lugatil arabijeti, Parathënie e Dr. Ibrahim Medkur, dar Imran, 1985, pj. 1-rë, f. 149.

<sup>6</sup> Shih: Es Savi, Hashijetu Savi ala Xhveherit Tevhid, f. 193!

<sup>7</sup> Shih: Po aty, f. 194!

### Argumentet për ekzistimin e Xhenetit dhe Xhehenemit

Xheneti dhe Xhehenemi janë krijesa që përfshihen në botën e gajbit - të fshehtës dhe argumenti për ekzistimin e tyre duhet të kërkohej unanimisht vetëm në tekstet fetare, qoftë nga Kurani, apo nga hadithet e Muhamedit, a.s. Tekstet fetare janë të shumta që e vërtetojnë ekzistimin e Xhenetit dhe Xhehenemit. Përveç kësaj, tekstet vërtetuese janë shumë të qarta dhe aluduese, dhe bëjnë pjesë në mesin e ajeteve muhkemat (të qarta). Përderisa gjendja është kështu, atëherë besimi në Xhenet dhe Xhehenem është i domosdoshëm, dhe nuk lejohet assesi të dyshohet në të. Nëse tekstet fetare vërtetojnë diçka nga bota e gajbit, aspekti racional ndërhyr vetëm në mundësinë e ekzistimit ose jo. Anë pse, kur është fjala për gajbin, kemi nevojë në mënyrë direkte për argumente tekstuale, lirisht mund të themi se edhe logjikisht pranohet mundësia e ekzistimit të Xhenetit dhe Xhehenemit pa kurrfarë mëdyshje. Ai që beson në Zotin dhe fuqinë e Tij, e vërteton lehtësisht, se ekzistimi i Xhenetit dhe i Xhehenemit është plotësisht në mundësinë e Zotit, xh.sh., dhe natyrshëm është logjike prezenca dhe ekzistenca e tyre. Imam El Kajrevani thekson: “Dije se nuk ka kurrfarë aspekti të pamundësisë së ekzistimit të Xhenetit dhe të Xhehenemit!”<sup>8</sup>. Edhe Imam Err Rrazi përqendrohet në të njëjtën pikë, kur është fjala për argumentimin logjik, dhe thotë: “Kriteri në gjithë çështjet e gajbit është se ato janë të mundshme logjikisht dhe janë të vërtetuara me tekst fetar, prandaj obligueshëm duhet të besohet në to.”<sup>9</sup> Madje, kur meditohej rreth drejtësisë së Allahut xh.sh. dhe gjendjes së njerëzve, sidomos në ndarjen e tyre në veprues të së mirës dhe kriminelë të vrazhdë, logjikisht duhet të konkludohet se domosdoshmërisht duhet të ketë vendshpërblim për të mirët dhe vendndëshkim për kriminelët.

<sup>8</sup> El Kajrevani, Abdullah bin Ebi Zejd, En Nuketul mufideh fi sherh el hutbeti vel aki-deh, El Mearif, Liban, 2008, f. 132.

<sup>9</sup> Er Rrazi, El Ishareh fi usulid dinë, 2007, f. 352.

## Rëndësia e besimit në Xhenet dhe Xhehenem

Besimi në Xhenet dhe Xhehenem është një nga bazat e besimit islam dhe, si i tillë, nëse dikush e mohon apo e vë në dyshim, nuk konsiderohet besimtar mysliman, sipas unanimitetit të dijetarëve myslimanë në të gjitha kohërat dhe periudhat. Kjo sepse Xheneti dhe Xhehenemi janë të vërtetuar me shumë tekste të prera fetare, saqë besimi në to përbën një nga bazat e besimit islam.

### A janë krijuar tashmë, apo krijohen në Ditën e Gjykimit?

Dijetarët e Ehli Sunetit unanimisht theksojnë faktin se Xheneti dhe Xhehenemi janë të krijuar dhe tani funksionojnë. Përballë këtij mendimi qëndron mendimi i mutezilinjeve, i xhehminjeve dhe i disa nënfraksioneve të havarixhëve, të cilët konstatojnë se Xheneti dhe Xhehenemi ende nuk janë krijuar, por se do të krijohen vetëm pas Ditës së Gjykimit. Imam En Nesefi thotë: “Disa xhehminj dhe mutezilinj thonë se Xheneti dhe Xhehenemi nuk janë të krijuara ende, por se do të krijohen në Ditën e Gjykimit..., kurse Ehli Suneti dhe Xhemati thonë se *Allahu i ka krijuar Xhenetin dhe Xhehenemin, dhe ata janë të përhershëm dhe nuk zhduken*”<sup>10</sup>. Edhe Imam Bagdadi thotë: “...kurse Dirarije<sup>11</sup>, mutëzillinj të dhe disa grupe të kaderinjve pretenduan se Xheneti dhe Xhehenemi nuk janë të krijuar.”<sup>12</sup>

<sup>10</sup> En Nesefi, Ebul Muin Muhamed bin Muhamed, Bahrul Kelam fi usulid dinë, El Mek-tebetul Ez herijeh, bot.1, Kajro, 2011, f. 315.

<sup>11</sup> Dirarije, janë pasues të Dirar bin Amr El Gatafani(v.190), prijës i një nënfraksioni mutezili. Ky i kundërshtoi mutezillinj të shumë mendime, derisa e larguan dhe e konsideruan jobesimtar. Pas Pejgamberit, a.s., nuk pranonte argument përveç ixhmait. Shih: Esh Shehristani, Muhamed bin Abdulkërim, El Mil el ven nihal, bot.1, mektebet Fejjad, Egjipt-2013, f. 105!

<sup>12</sup> El Bagdadi, Abdulkahir, El Ferku bejnel firek, f. 262. Shih: En Nuvejhi, Muhamed, halkul xheneti ve nar bejne ehli suneti vel mutezileti, punim i botuar në revistën El Mexheletul Urdunijeh fi dirasat islamijeh, vëll. 11, viti i 3-të, Amman, 2015, f. 149Q

### Argumentet se janë të krijuara

Argumenti se ato tashmë janë të krijuara gjendet në ajetet dhe hadithet që flasin për përgatitjen e Xhenetit për besimtarët. Kjo është treguar në Kuran përmes foljeve në kohën e shkuar, e që nuk ka arsye të interpretohen me ndonjë kuptim tjetër, prandaj domosdoshmërisht duhet të pranohet kuptimi që ato pohojnë. Kuptimi parësor i foljeve në kohën e shkuar konsiston në krijimin e Xhenetit dhe Xhehenemit, siç është rasti me fjalën e Allahut, xh.sh., në Kuran:

﴿أَعَدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ﴾

“(Xheneti) **Është përgatitur për të devotshmit**”. (Alu Imran: 133)

Dhe po ashtu, kur është fjala për Xhehenemin, thuhet:

﴿أَعَدَّتْ لِلْكَافِرِينَ﴾

“(Zjarri) **Është përgatitur për jobsimtarët**”. (El Bekareh: 24)

Këtij konstatimi, përveç ajeteve në Kuran, u shërbejnë edhe një gamë e gjerë hadithesh të Pejgamberit, a.s., e ne në vazhdim po i përmendim vetëm disa:

Imam Tirmidhiu transmeton prej Xhabirit, r.a., se Muhamedi, a.s., kishte thënë: “*Kush thotë: “Subhanallahu ve bihamdihi”, atij i mbillet një palmë nga palmat e Xhenetit.*”<sup>13</sup>

Pastaj, hadithet e Miraxhit, në të cilat Pejgamberi, a.s., tregon se e kishte parë Xhenetin dhe Zjarrin, dhe përveç kësaj kishte parë edhe disa forma shpërblimi dhe dënimi. Imam Muslimi transmeton prej Enesit, r.a., se Pejgamberi, a.s., kishte thënë: “*Pasha Atë që ma ka shpirtin në Dorë, sikur ta kishit parë atë që e kam parë unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë!*”. E pyeten: “*Çfarë ke parë, o i Dërguari i Zotit?*”. Tha: “*E pashë Xhenetin dhe Zjarrin.*”<sup>14</sup>

Përveç këtyre teksteve, Ehli Suneti i përdor si argumente valide dhe të qarta edhe ajetet kuranore dhe hadithet pejgamberike që e përmendin

<sup>13</sup> Tirmidhiu nr. 3464 dhe thotë se hadithi është i grades hasen.

<sup>14</sup> Muslimi, nr. 426.

Xhenetin në të cilin ishte Ademi, a.s., dhe ky është po i njëjti Xhenet në të cilin synohet kthimi.

**“Ne i thamë Ademit: “O Adem hyr ti dhe bashkëshortja jote në Xhenet!”.”** (El Bekareh: 35)

Imam Bezdeviu argumenton bukur, kur analizon ajetet kuranore në të cilat Allahu thotë:

**“Pastaj thamë: “O Adem, vërtet ky është armiku yt dhe i gruas sate, prandaj mos e lejoni t’ju nxjerrë nga Xheneti, se pastaj do të vuani në mjerim! Këtu nuk do të kesh uri e as zhveshje. Dhe nuk do të kesh as etje as vapë.”.** (Taha: 117-119)

Imam Bezdeviu sqaron se i tërë ky përshkrim i Xhenetit në këto ajete është tamam i përshtatshëm për Xhenetin e përjetësisë, sepse në Xhenet vërtet nuk ka uri dhe etje, si dhe dalja nga ai është vërtet mjerim, gjë që diçka e tillë nuk vlen domosdoshmërisht për kopshtet e kësaj bote.<sup>15</sup> Argumentet në këtë rend janë të shumëta, dhe ne nuk mund t’i sjellim këtu për shkak të tejzgjatjes.

### **Argumentet e mutezilinjeve se nuk janë të krijuara ende**

Dijetarët mutezilinj, xhehminj dhe disa nënfarksiione të havarixhëve, u përpoqën të argumentonin se Xheneti dhe Xhehenemi ende nuk janë krijuar, dhe se do të krijohen pas Ditës së Gjykimit. Jo të gjithë dijetarët mutezilinj ishin të këtij mendimi, sepse Ebu Alij El Xhubbajj, Ebul Husejn El Basërij dhe Bishr bin El Mu'temir mbajnë qëndrimin e njëjtë me të Ehli Sunetit, se Xheneti dhe Xhehenemi tashmë janë të krijuar.<sup>16</sup> Argumente të qarta për këtë konstatim mutezilinjtë nuk kishin, por, megjithatë e ndërtuan argumentimin e tyre përmes teksteve fetare dhe aspektit logjik.

<sup>15</sup> Shih: El Bezdevi, Ebul Jusr, Usulu Din, El Mektebetul ez herijeh li turath, Kajro, 2002, f. 170!

<sup>16</sup> Shih: El Ixhij, Adud ed Din, El Mevakif, Dar el Xhil, vëll. 3, Bejrut 1997, f. 485 dhe f. 487!

### Argumentimi mutezili nga tekstet fetare

Si argument morën fjalën e Allahut, xh.sh., në ajetin:

**“Gjithçka do të shkatërrohet”** (*Err Rrahman: 26*)

Dhe ajetin:

**“Gjithçka është e shkatërrueshme, përveç Tij”** (*El Kasas: 88*)

Sikur të ishin tashmë të krijuar, pra Xheneti dhe Xhehenemi, do të shkatërroheshin në Ditën e Gjykimit dhe, po të shkatërroheshin, do të binim në kundërshtim me fjalën e Allahut, xh.sh.:

**“Hija dhe ushqimet (e Xhenetit) do të jenë të përhershme.”** (*Err Rrad: 35*)

Pra, për ta mënjeluar kundërshtimin në mes teksteve, thonë se Xheneti dhe Xhehenemi ende nuk janë krijuar, por se do të krijohen në Ditën e Gjykimit, për të mbetur pastaj përgjithmonë.

### Argumentimi logjik i mutezilinjeve

Mutezilinjtë e shohin se prezenca e Xhenetit dhe Xhehenemit para kohës së shpërblimit dhe dënimit është punë koti, dhe si e tillë është e ndaluar t’i atribuohet Allahut, xh.sh. Në fakt, El Kadi Abdul Xhebari konstaton se ka mundësi që tani për tani të ketë xhenete të tjera në të cilët shpërblehen engjëjt dhe pejgamberët, mirëpo assesi Xheneti i përtjetësisë.<sup>17</sup>

### Demantimi i argumentimit mutezili

Ehli Suneti e demantuan këtë argumentim të mutezilinjeve, i cili nuk bazohet në një kuptim të mirëfilltë të teksteve kuranore. Sa i përket ajetit: **“Ushqimet e Xhenetit do të jenë të përhershme”** (*Err Rrad: 35*), kjo nuk guxon të kuptohet se ato nuk do të zhduken. Përkundrazi, ushqimet e Xhenetit do të përdoren prej banorëve të Xhenetit, vetëm se, sa herë që ato përdoren, do të zëvendësohen me ushqime të tjera, në vazhdimësi. Kështu duhet kuptuar ajeti kuranor, dhe jo të mendohet se vetë ushqimet qëndrojnë përherë, sepse ashtu ushqimet vetëm kur nuk shfrytëzohen

<sup>17</sup> Shih: Abdul Xhebar bin Ahmed, Et Tefsirul kebir, Dar el kutub el ilmijeh, Bejrut, 2009, f. 246!

mund të paramendohet se mbesin. Kurse, të mirat e Xhenetit janë për t'u shfrytëzuar, dhe jo për të qëndruar të paprekshme. Përveç kësaj, përhershmëria e ushqimeve të Xhenetit në ajet kuptohet pikërisht me rifurnizime të reja për banorët. Kur kështu kuptohet ajeti, dhe bie mundësia e argumentimit me të në këtë mesele, dhe kështu demantohet edhe keqargumentimi mutezili dhe keqkuptimi i tyre.<sup>18</sup>

Kurse, sa i përket ajetit tjetër: **“Gjithçka është e shkatërrueshme, përveç Tij”** (*El Kasas*: 88), tregon se gjithçka pranon shkatërrimin si ekzistencë, domethënë se çdo gjë e pranon shkatërrimin në vete, përveç Allahut, sepse çdo gjë është krijesë, kurse Allahu xh.sh. është Krijuesi. Po edhe se jo domosdoshmërisht çdo gjë do të shkatërrohet realisht në Ditën e Gjykimit. Imam El Lekvani, kur flet për këtë ajet, e përmend mendimin e Ibën Abbasit, se shtatë krijesa përjashtohen prej shkatërrimit të përgjithshëm në Ditën e Kiametit: Lapsi, Arshi, Levhi Mahfudhi, Kursija, shpirti, Xheneti dhe Xhehenemi.<sup>19</sup>

Ndërsa kundërpërgjigjja ndaj pretendimit se Xheneti dhe Xhehenemi, përderisa do të mbushen me banorë vetëm pas Ditës së Kiametit, është e paarsyeshme që ato të jenë krijuar më herët, ky është një konkluzion i çuditshëm dhe i pabazë. Kjo sepse veprimet e Allahut, sipas *ixhmait*, nuk i nënshtrohen arsyetimit dhe kufizimeve të kapacitetit njerëzor. Përkundrazi, Zoti, xh.sh., vepron si të dojë, dhe gjykon sipas vullnetit të Vet. Prandaj, fakti që *Mutezila* nuk janë në gjendje të kuptojnë arsyen e ekzistencës së Xhenetit dhe Xhehenemit para Ditës së Gjykimit, nuk nënkupton aspak se Allahut i mungon arsyeja dhe urtësia në krijimin e tyre. Ky realitet vërtetohet nga *ixhmaja* e dijetarëve islamë, nga e cila nuk ka devijuar askush, përveç mutezilitëve.

<sup>18</sup> Shih: Amidij, Ebkarul Efkar, vëll4, f. 331! Marrë nga: El Hamevij, Ahmed bin Muhammed, Talikul kalaid ala mendhumetil akaid, Darul Fet'h, Aman 2018, f. 504.

<sup>19</sup> Shih: En Nuvejhi, khalkul Xheneti ven nar, f. 143!

### A janë të përhershme, apo do të zhduken?

Dijetarët e Ehli Sunetit janë unanimë se Xheneti dhe Xhehenemi janë të përhershëm dhe nuk do të zhduken kurrë. Si rrjedhojë, shpërblimi i banorëve të tyre do të jetë i vazhdueshëm deri në pafundësi, po ashtu edhe dënimi i banorëve të zjarrit do të zgjasë pafundësisht. Përrjashtim bën vetëm dënimi i besimtarëve, i cili, sipas shumicës, quhet Xhehenem dhe përfaqëson shkallën më të lehtë të dënimit në Ahiret.

Sipas haditheve të shumta dhe të sakta, të gjithë besimtarët që ndëshkohen përkohësisht në këtë shkallë të zjarrit, më pas dalin prej andej dhe futen në Xhenet. Përndryshe, si Xhehenemi ashtu edhe Xheneti do të jenë të përjetshëm. Imam Tahaviu thekson: *“Besojmë se Xheneti dhe zjarri janë të krijuara, nuk zhduken dhe nuk mbarojnë kurrë.”* Këtë mendim nuk e ka kundërshtuar askush, përveç xhehminjve, disa mutezilitëve dhe disa rafidinjve. Imam Esh Shehristani thotë: *“Të gjitha grupet e umetit janë të pajtimit se Xheneti dhe mirësitë nuk kanë fund, dhe po ashtu edhe Zjarri me gjithë dënimin. Këtë e kundërshtoi Xhehm bin Safvani, Ebul Hudhejl El Al Lafi dhe disa grupe të rafidinjve.”*<sup>20</sup>

Prej të mëvonshmëve përjetësinë e dënimit të Xhehenemit e kundërshtuan Ibën Arabiu, i cili pohon se Xhehenemi për banorët e vet do të shndërrohet, pas një kohe, në kënaqësi dhe përjetim të lezetshëm, ide kjo e kundërshtuar ashpër prej dijetarëve suni. Edhe Ibën Tejmije<sup>21</sup> me nxënësin e tij, Ibën Kajim El Xhevzije, mendohet të kenë thënë se Xhehenemi pas një kohe shuhet dhe banorët e tij dalin në Xhenet. Këta të fundit i kundërshton bashkëkohësi, Imam Subkiu, në një shkresë që e shkroi për ta demantuar argumentimin në të cilin ishin mbështetur. Po ashtu edhe Sanwani shkroi një libërth për t'i demantuar pseudoargumentet që i për-

<sup>20</sup> Shih: Ebu Dekikah, Mahmud, El Kavlu es sedid fi ilmi Et Tevhid, bot. e 1-rë, pj. e 3-të, Ihjau turath, 1995, f. 184-185!

<sup>21</sup> Sa i përket mendimit të Ibën Tejmijes, ai nuk është shumë i qartë në këtë çështje, pasi në disa citate pohon se Xheneti dhe Xhehenemi janë të përhershme dhe nuk përfundojnë. Megjithatë, nxënësi i tij, Ibën Kajim El Xhevzije, në disa prej librave të tij mbron mendimin se Xhehenemi ka një përfundim dhe dënimi aty do të shuhet. Ky mendim, sipas tij, është edhe i Ibën Tejmijes. Kështu, mund të thuhet se ai nuk e kundërshton mësuesin e tij në çështjet e akides.

dorën Ibën Tejmijeh dhe Ibën Kajim El Xhevzijek.<sup>22</sup> Detajet e këtyre mendimeve dhe argumenteve nuk është vendi që t'i parashtrojmë këtu.

Argument se janë të përhershëm është pikërisht edhe fakti se Zoti në Kuran, në shumë ajete, ka përmendur se ata që do të hyjnë në Xhenet **“do të jenë aty përgjithmonë”**, si dhe ata që do të hyjnë në Zjarr **“do të jenë aty përgjithmonë”**<sup>23</sup>. Përveç ajeteve, edhe shumë hadithe të Muhamedit, a.s., tregojnë qartë se, pas ringjalljes nuk do të ketë më vdekje. Transmetimet e tilla janë shumë, e ne këtu po e përmendim vetëm hadithin që e transmeton Buhariu, Muslimi dhe të tjerë, se Pejgamberi, a.s., ka thënë: *“Kur banorët e Xhenetit të hyjnë në Xhenet, dhe banorët e Zjarrit të hyjnë në Zjarr, sillet vdekja në formë dashi, vendoset në mes të Xhenetit dhe Xhehenemit, dhe theret (vritet). Pastaj thërret një thirrës: “O banorë të Xhenetit, do të jeni në përjetësi dhe s’ka më vdekje për ju! O banorë të Zjarrit, do të jeni në përjetësi, dhe s’ka më vdekje për ju!”*<sup>24</sup>.

### Emrat e Xhenetit

Xheneti është përmendur me shumë emërtime në tekstet islame, e disa nga më të njohurit janë:

- **Dar Es Selam**, (Vendi i Shpëtimit); kështu përmendet në ajetin:

﴿هُم دَارُ السَّلَامِ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَهُوَ وَلِيُّهُمْ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ﴾

**“Atyre u takon vendi i shpëtimit (pages).” (El Enam: 127)**

- **El Husna** (Shpagesa e Mirë); kështu përmendet në ajetin:

﴿لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ﴾

**“Atyre që bëjnë vepra të mira u takon e mira (Xheneti) dhe më shumë (e shohin Allahun).” (Junus: 26)**

<sup>22</sup> Shih: Sanani, Muhamed bin Ismail, Ref’ul estar li ibtali edil-letil kailine bi fenain nar, ver. Nasirudin El Albani, bot. i parë, El Mekteb el Islami, Bejrut, 1984!

<sup>23</sup> Ajete të tilla janë të shumta në Kuranin famëlartë. Shih suren El Bejjineh!

<sup>24</sup> Buhariu, Muhamed bin Ismail, Sahih El Buhari, darus Selam, bot. i dytë, Riad, 2000, nr. 4730.

- **Darul Mukameh** (Vendi i Përhershëm); kështu përmendet në ajetin:

﴿الَّذِي أَحَلَّنَا دَارَ الْمَقَامَةِ مِنْ فَضْلِهِ﴾

**“I Cili me mirësinë e Tij na vendosi në Vending e Përjetshëm.”**

(*Fatir: 35*)

Ibën Abasi dhe një grup dijetarësh mendojnë se në Xhenet janë shtatë pozita: Firdeusi (më e larta), Xhenetul Meva, Xhenetul Khuld, Xhenetu Neim, Xhenetu Aden, Darus Selam dhe Darul Xhelal. Kurse, shumica e dijetarëve mendojnë se ato janë katër, siç përmenden në suren Rrahman, në ajetin e 46-të dhe në ajetin e 42-të.<sup>25</sup>

Xheneti ka dyer dhe pozita - grada në të cilat do të hyjnë besimtarët myslimanë. Këto pozita dhe thirrja përmes këtyre dyerve do të bëhet varësisht nga angazhimi, veprat e mira dhe devotshmëria e besimtarëve.<sup>26</sup>

### Emrat e Xhehenemit

Edhe Xhehenemi është përmendur me shumë emërtime në Kuran, siç janë:

Xhehenem, Ledha, El Hutameh, Es Seir, Es Sekar, El Xhehim, El Havijeh. Shumë dijetarë potencuan se secili nga këta emra paraqet një kategori dënimi në Xhehenem, dhe sipas renditjes sipër janë edhe kategoritë e dënimit nga më e lehta deri në më të rëndën.<sup>27</sup> E lusim Zotin e madh të na ruajë nga Xhehenemi dhe dënimi në të!

### Vendi i Xhenetit dhe i Xhehenemit

Disa dijetarë islamë shpjegojnë se nuk kemi tekste të qarta rreth vendit të Xhenetit dhe të Xhehenemit, dhe se dijen për këtë duhet lënë në kompetencën e Allahut, xh.sh. Mirëpo, pavarësisht kësaj shumica mendojnë

<sup>25</sup> Ajetet: (وَلَمَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ جَنَّاتٍ) dhe ajeti: (وَمَنْ دُونَهُمَا جَنَّاتٍ)

<sup>26</sup> Shih: Ternava, Naim, Besimi Islam, vëll. II, Europrint, Prishtinë, 2023, f. 275!

<sup>27</sup> Shih: Ed Derdir, Ahmed bin Muhamed El Adevij, Sherh el harideti behijeti fi ilmi Et Tevhid, bot. i 1-rë, Dar Ed Dekak, Damask, 2004, f. 138!

se Xheneti gjendet mbi qiellin e shtatë, dhe kulmi i tij është Arshi<sup>28</sup>. Kjo për shkak se disa tekste islame nga Kurani dhe hadithet e Muhamedit, a.s., japin shenjë në diçka të tillë. Zoti i Madhëruar në Kuran thotë:

﴿عِنْدَ سِدْرَةِ الْمُنْتَهَى. عِنْدَهَا جَنَّةُ الْمَأْوَى﴾

*“(E ka parë) te Sidretul Munteha. Që pranë saj është Xhenetul Meva.”. (En Nexhm: 15-16).*

Imam Kurtubiu, në komentin e tij për këtë ajet, thotë: “Ky është njoftim rreth vendit të Xhenetit Meva, i cili gjendet pranë Sidrutul Muntehasë, dhe e ka kuptimin “Xheneti i qëndrimit.”.<sup>29</sup>

Edhe Muhamedi, a.s., potencon në një hadith: “Kur kërkonit prej Allahut, kërkojeni Firdeusin, sepse ai është mesi i Xhenetit dhe më i larti! Sipër tij qëndron Arshi.”<sup>30</sup>

Sa i përket vendit të Xhehenemit, në Islam nuk kemi tekste të qarta mjaftueshëm që tregojnë për vendin e tij. Disa hadithe potencojnë se vendi i tij është poshtë, nën shtresën e shtatë të tokës. Kjo ndoshta ishte aludim se në bërthamën e tokës gjendet zjarr. Megjithatë, nga këto hadithe disa dijetarë nxiten të deklarohen se vendi i tij është nën tokën e shtatë. Kurse, shumica e Ehli Sunetit deklarojnë se kjo çështje është gajb – e fshehtë, dhe se vetëm Zoti Fuqiplotë e di vendin e Xhehenemit. Ajo që dihet sigurt është fakti se Ditën e Gjykimit do të sillet Xhehenemi i bartur përmes melekëve të fuqishëm. Zoti i Madhëruar thotë:

﴿وَجِيءَ يَوْمَئِذٍ بِجَهَنَّمَ﴾

*“E atë ditë sillet Xhehenemi.” El Fexhër: 23.*

Po ashtu, prej Imam Muslimit transmeton në Sahihun e tij, prej Ibën Mesudit, se Pejgamberi, a.s., ka thënë: “Xhehenemi sillet përmes shtatëdhjetëmijë frerëve, secilin fre e tërheqin shtatëdhjetëmijë melekë.”.<sup>31</sup>

<sup>28</sup> Teftazani, Mesud iben Omer, Sherhul Mekasid, vell. 3, Dar El Kutub el ilmijeh, Liban, 2011, f. 361.

<sup>29</sup> El Kurtubi, Tefsir ajatil ahkam.

<sup>30</sup> Transmetuar prej: Tirmidhiu, nr. 2530, Imam Ahmedi, Musned, nr. 22087, Ibën Ma-xheh nr. 4331 dhe Sujutiu, El Xhamiu Sagir, nr. 4306.

<sup>31</sup> Muslimi nr. 2842.

## Përfundim

Kjo është një paraqitje shumë e shkurtër rreth besimit islam në Xhenet dhe Xhehenem. Në të vërtetë, kjo temë është shumë e gjerë dhe nuk mund të përfshihet brenda strukturës së një punimi të shkurtër. Besimi në këto dy realitete është një nga shtyllat kryesore të Islamit. Zoti i ka përcaktuar si dy përfundimet e përjetshme për njerëzit, pa ndonjë alternativë tjetër. Besimtarët e sinqertë shijojnë ëmbëlsinë e besimit të drejtë dhe shpresojnë nga Zoti shijimin e Xhenetit, ndërsa ruhen me përkushtim nga e keqja dhe nga zjarri i Xhehenemit. Asgjë nuk e plotëson ambicien e njeriut përveç përjetësisë. Këtë përjetësi besimtarët shpresojnë ta arrijnë falë mëshirës së madhe të Allahut Fuqiplotë. Për ta merituar këtë dhuratë hyjnore, ata përgatisin veten me një besim të palëkundur dhe me një angazhim të vazhdueshëm në zhvillimin e vlerave humane.

### Referencat:

1. **Kurani**- përkthim i kuptimeve të tij, përkthim i H. Sherif Ahmetit.
2. **Abdul Xhebar** bin Ahmed, Et Tefsirul kebir, Dar el kutub el ilmijeh, Bejrut 2009.
3. **Amidij**, Alij bin Muhamed, Ebkarul Efkar fi usuli din, Dar el kutub el ilmijeh, bot i parë, Bejrut 2003.
4. **Ebu Dekikah**, Mahmud, El Kavlu es sedid fi ilmi Et Tevhid, bot. I, pj. III, Ihjau turath, 1995.
5. **Ed Derdir**, Ahmed bin Muhamed El Adevij, Sherh el kharideti behijeti fi ilmi Et Tevhid, bot. 1, Dar Ed Dekak, Damask-2004.
6. **El Asfehani**, Er Rragib, El Mufredat fi garibil Kuran, Darul kalem, Damask 1992.
7. **El Babertij**, Muhamed bin Muhamed, Sherh El Vesijeh li Ebi Hanifeh, Tahkik: Muhamed el Aidij dhe Hamza El Bekrij, Darul Fet-h, Aman - 2017.

8. **El Bagdadi**, Abdulkahir bin Tahir, El Ferku bejnel firek, dar Ibën Xhev-zij, bot i parë, Kajro 2014.
9. **El Bezdevi**, Ebul Jusr, Usulu Din, El Mektebetul ez-herijeh li turath, Kajro 2002.
10. **El Hamevij**, Ahmed bin Muhamed, Talikul kalaaid ala mendhumetil akaaid, Darul fet-h, Aman 2018. **El Ixhij**, Adud ed Din, El Mevakif, Dar el Xhil, vëll.3, Bejrut 1997.
11. **El Kajrevani**, Abdullah bin Ebi Zejd, En Nuketul mufideh fî sherh el hutbeti vel akideh, El Mearif, Liban 2008.
12. **El Kurtubi**, Muhamed bin Ahmed, El Xhamiu fî ahkamil Kuran, Dar el kutub el misrijeh, Kajro, 1964.
13. El Muxhemul Vesit, Muxhemmeul lugatil arabijeti, Parathënie e Dr. Ibrahim Medkur, dar Imran, 198.
14. **En Nesefi**, Ebul Muin muhamed bin Muhamed, Bahrul Kelam fî usulid dinë, El Mektebetul Ez-herijeh, bot.1, Kajro 2011.
15. **En Nuvejhi**, Muhamed, halkul xheneti ve nar bejne ehliis suneti vel mtezileti, punim i botuar në revistën El Mexheletul Urdunijeh fî dirasat islamijeh, vëll. XI, viti i 3-të, Amman 2015.
16. **Err Rrazi**, El Ishareh fî usulid dinë, Merkez Nurul Kuran, bot. i dytë, Aman 2007.
17. **Es Savi**, Hashijetu Savi ala Xhveherit Tevhid, Dar El kutub el ilmijeh, Bejrut 2010.
18. **Ibën Maxheh**, Muhamed bin Jezid, Sunen Ibën Maxheh, bot. i dytë, Dar es Selam, Rijad, 2000.
19. **Muslim**, Ibën El Haxhaxhaxh, Sahih Muslim, bot. i dytë, Dar es Selam, Rijad 2000.
20. **Sanani**, Muhamed ibën Ismail, Ref'ul estar li ibtali edil-letil kailine bi fenain nar, ver. Nasirudin El Albani, bot. i parë, El Mekteb el Islami, Bejrut, 1984.
21. **Teftazani**, Mesud bin Omer, Sherhul Mekasid, vell. 3, Dar El Kutub el ilmijeh, Liban, 2011.
22. **Tirmidhiu**, Muhamed bin Isa, Sunen Et Tirmidhij, bot. i dytë, Dar es Selam, Rijad, 2000.
23. Tërnavë, Naim, Besimi Islam, Europrint, Prishtinë 2023.

**Dr. Ass. Bahri HOXHA**

## **HEAVEN AND HELL IN ISLAM**

### **Abstract**

The Islamic religious explanation, about the reality of life in general, is complete and reasonable. Life according to Islamic belief does not only include the time of living in this world, but in its general sense it exceeds the limits of life in this world, to continue in eternity. Eternal life is personified in receiving reward from the righteous who do good, as well as receiving punishment from the unbelievers who committed evil deeds in this world. In this context, the names of both of these permanent destinations come to the fore. Among other things, the belief in Heaven and Hell is the most practical driver of religion in sowing caution from crimes, as well as the positive will to lean towards virtues and goodness. This paper contains some lines in the Islamic theoretical explanation about the belief in Heaven and Hell, as an answer to some questions that may be asked regarding the Islamic theological explanation to these realities that according to most faiths, but also Islam, deal with the future of humanity.

**Keywords:** *Heaven, Hell, Ahiret, reward, punishment, eternity.*



Prof. Ass. Dr. Valmire BATATINA KRASNIQI

## KONCEPTI DHE RËNDËSIA E AGJËRIMIT GJATË MUAJIT RAMAZAN

### **Abstrakt**

Muaji Ramazan është një periudhë agjërimi, meditimi, përkushtimi, bujarie, sakrifice dhe disipline, e cila praktikohet nga myslimanët në mbarë botën. Nëse mësimet e marra gjatë Ramazanit, veçanërisht ato që lidhen me mënyrën e ngrënies dhe devotshmërinë, kuptohen dhe zbatohen siç duhet, ato mund të jenë të dobishme për jetën e individit. Si të gjitha detyrimet dhe ritet fetare, edhe agjërimi ka një logjikë të fuqishme, e cila synon të sjellë përfitime të shumta shpirtërore dhe materiale për besimtarët. Përveçse është një obligim i dashur dhe i çmuar për Allahun e Plotfuqishëm, agjërimi ka përfitime të shumëfishta, si për individin ashtu edhe për shoqërinë. Përveç ndikimeve psikologjike, shpirtërore, ekonomike dhe sociale të përmendura në Kuran dhe hadithet e Pejgamberit, a.s., studimet moderne shkencore dhe mjekësore kanë zbuluar gjithashtu përfitime të mahnitshme të tij. Në këtë studim do të trajtojmë konceptin e agjëritit në Islam, rëndësinë dhe ndikimin e tij tek individit dhe shoqëria.

**Fjalët Kyçe:** *Ramazan, agjërim, Kuran, obligim, rëndësia, ndikimi.*

## HYRJE

Kurani e përshkruan Ramazanin në mënyrën më të përsosur. Ai tërheq vëmendjen në një mënyrë të veçantë kur flet për të. Çdo krijesë, qoftë materiale apo shpirtërore, ka karakteristika që e bëjnë të dallohet nga të tjerat. Prandaj, kur dëshirojmë ta përshkruajmë atë në një kuptim të përgjithshëm, ne zgjedhim tiparin më të veçantë ose më fisnik që e karakterizon atë. Nisur nga kjo, Ramazani është muaji i nëntë i vitit hënor. Besimtarët islamë e konsiderojnë këtë muaj si një kohë të shenjtë, dhe kjo për disa arsye:

1. Agjërimi, një nga obligimet kryesore për myslimanët, praktikohet gjatë këtij muaji;
2. Të gjitha rregullat që lidhen me agjërimin janë shpallur dhe përfunduar gjatë këtij muaji;
3. Dyert e Allahut të Lartë hapen plotësisht për ata që kërkojnë ndihmë, dhe veprat e tyre të mira pranohen veçanërisht gjatë këtij muaji, si dhe;
4. Muhamedi, a.s., e ka dedikuar veten më shumë në adhurim gjatë këtij muaji, si dhe i ka këshilluar besimtarët ta bëjnë të njëjtën gjë. Më e rëndësishmja është që Allahu i Lartë, kur e përmend muajin Ramazan, e identifikon atë në formën më të përsosur duke thënë: *“Muaji Ramazan është muaji në të cilin ka zbritur Kurani...”*<sup>1</sup> Nuk ndodh që një besimtar të kalojë pranë një reference të tillë kurane pa e vënë re dhe pa u lidhur me të. Kurani lexohet edhe gjatë muajve të tjerë, por në Ramazan ai merr një rëndësi dhe vlerë të veçantë. Kjo ndodh sepse është muaji në të cilin u shpall vetë Kurani, dhe Allahu e nderoi Ramazanin pikërisht për këtë arsye.

Muaji i nëntë i kalendarit hënor është i caktuar për agjërim, që nënkupton largimin nga çdo lloj ushqimi e pije, si dhe nga marrëdhëniet intime, brenda harkut kohor nga agimi deri në perëndimin e diellit, për një periudhë kohore njëmuajore. Kjo është një sakrificë që besimtari e kryen me qëllimin e vetëm për të arritur kënaqësinë e Allahut të Lartë, nënshtri-

<sup>1</sup> Kuran, El Bekareh, 185.

min e plotë ndaj Tij dhe, mbi të gjitha, shpërblimin e pakufishëm për këtë adhurim të veçantë.

Për t'u arritur e gjithë kjo, është e nevojshme të posedohet vetëdije më e madhe mbi kontrollin e mendimeve, fjalëve dhe veprimeve. Kështu, muaji Ramazan është një shkollë edukimi e veçantë në lidhje me menaxhimin dhe frenimin e epsheve. Ai ofron mundësinë që të pasurit të mësojnë përmbajtjen dhe të ushtrojnë kënaqësinë e thjeshtësisë, duke ofruar ndihmën për ata që kanë nevojë, ndërsa për ata që jetojnë në varfëri, Ramazani mëson durimin ndaj pasurisë së të pasurve, mbajtjen e një qëndrimi të dinjitetshëm dhe një përkushtimi të plotë ndaj Krijuesit të Lartë.

### Kuptimi i agjërimit

Agjërimi, në Kuranin fënisht, në mënyrë koncize, me shprehje dhe formë të ndryshme si "saum" dhe "sijam", përmendet në disa kapitla<sup>2</sup>, e të cilat janë shpallur në intervale të ndryshme kohore. Ndërsa, si një adhurim i detyrueshëm për besimtarët zë vend në kapitlin El Bekare.<sup>3</sup> Në leksik, fjalët "saum" dhe "sijam" kanë kuptimin: të përmbahesh, të heshtësh, të qëndrosh i palëvizur, të frenosh diçka, të ndalosh vetveten, të përmbahesh nga të bërit diçka dhe mos të flasësh".<sup>4</sup> Kurse, në kuptimin terminologjik agjërimi është një adhurim me të cilin obligohet çdo mysliman i moshës së përgjegjësisë (madhore), me qëllim adhurimi, duke i ndërprerë ushqyerjen dhe marrëdhëniet intime nga agimi i vërtetë (fexhri sadik) gjer në perëndimin e diellit.<sup>5</sup> Ibën Kajjim El Xhevzi, në lidhje me agjërimin përmend se, meqë agjërimi është mënjanim i urisë dhe i etjes, ai e menaxhon forcën e nefsit, duke ia kujtuar njeriut gjendjen e uritur dhe të mundimshme të të varfërve. Po ashtu, ai thekson se me t'u pakësuar koha dhe mënyra e të ushqyerit të njeriut, rrugët e djallit për të hyrë në zemrat

<sup>2</sup> Kuran El Bekareh, 2/184, 196, 187; En Nisa, 4/92; El Maide, 5/89,95; Merjem, 19/26; El Muxhadele, 58/4.

<sup>3</sup> Kuran, El Bekareh 2/183-186.

<sup>4</sup> Kasani (1986), *Kitabu Bedai' us-Sana' i fi Tertibi'sh-Shera' i*, v. II, Bejrut: Daru Kutubu'l-Ilmijje, 75.

<sup>5</sup> Er Razi, Fahrudin (1862), *Mefatihul-Gajb*, v. V, Kajro: El Matbaa Misrijje, 75.

e tyre bëhen më të ngushta.<sup>6</sup> Kurse, sipas disa dijetarëve, agjërimi është një nga masat parësore mbrojtëse në luftën e shpirtit për të mos qenë në varësi të vetvetes.<sup>7</sup> Me fjalë të tjera, agjërimi është një metodë e kontrollit të shpirtit, fjalëve, sjelljeve të këqija, të cilat janë karakteristika të nefs-i emmare-s.<sup>8</sup>

### Synimi i agjëritit

Agjërimi është një periudhë intensive edukimi për një zhvillim të thellë shpirtëror. Gjatë këtij akti adhurimi, agjëruesi i afrohet më shumë Zotit përmes lutjeve dhe kërkesave të tij dhe, siç tregohet në Kuran, nuk ka nevojë për ndërmjetësues. Po ashtu, ndalimi nga ushqimi, pijet dhe marrëdhëniet intime në periudha të caktuara është një mësim i vlefshëm për durimin dhe këmbënguljen.

Gjatë agjëritit, njeriu mbështetet në durimin si një virtyt për të arritur kënaqësinë e Allahut. Ky akt adhurimi gjithashtu kërkon lavdërimin e Zotit për të mirat që Ai i ka dhuruar njeriut. Procesi i agjëritit nënvizon se filozofia e tij kryesore është përmirësimi i gjendjes shpirtërore të individit. Një person që ka ushqime dhe pije me bollëk mund të hasë më shumë vështirësi kur ato mungojnë, ndërsa agjëruesi është si një bimë që rritet në shkretëtirë: ai qëndron i fortë, i durueshëm dhe i palëkundur përballë mungesës dhe vështirësive. Agjërimi është një shkollë për shpirtin, e cila, duke e përballur individin me kufizime të përkohshme, i jep atij durim, forcë vullneti dhe aftësinë për të qëndruar i fortë ndaj privimeve, duke mbajtur zemrën të pastër dhe instinktet nën kontroll. Gazali thekson se, nëse individi e kupton thelbin e agjëritit, e koncepton vendin e tij në zemër dhe vlerën që ai ka për udhëtimin e përjetshëm në botën tjetër, nuk do ta ketë të vështirë të gjejë paqen dhe qetësinë në shpirtin e tij. Nuk është e nevojshme që agjërimi të zgjasë dymbëdhjetë muaj. Sepse edhe Pejgamberi, a.s., agjëronte deri sa të krijohej përshtypja se ai nuk kishte

<sup>6</sup> Ibën Kajjim El Xhevziye (2008), *Zadu'l-Mead*, v. II, Bejrut: Muessesetu'l-Rejjan, 621.

<sup>7</sup> Ibën Kethir (1999), *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, v. I, Bejrut: Daru Tajjibe, 497.

<sup>8</sup> Gjendja që nxit përherë në vepra të këqija.

ngrënë kurrë, dhe, gjithashtu hante në mënyrë që të dukej sikur nuk agjëronte kurrë.<sup>9</sup> Allahu i Lartë fillimisht thotë: “*Muaji Ramazan...*”, e pastaj e identifikon atë duke thënë: “*...që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtër).*”<sup>10</sup> Në të vërtetë, muaji Ramazan është muaji i agjëritimit dhe i Kuranit.

Pas një agjërimi të pastër, besimi merr një ngjyrë të re. Ngase, njeriu fillimisht e nis një adhurim që e afron te Zoti i tij, pastaj duke i bërë lutje Atij ai përfiton një edukim shpirtëror, dhe kështu vendoset një lidhje në të cilën ai ndihet afër Zotit të tij, me besim të sinqertë. Pra, kjo është një rrugë që fillon me një besim të thjeshtë, dhe rezulton me një rend më të lartë bindjeje. Në lidhje me këtë, në Kuran thuhet: “*O ju që besuat, agjërimi ju është bërë obligim... ashtu që të bëheni të devotshëm!*”<sup>11</sup>. Agjërimi është një akt adhurimi që devotshmërinë e shndërron në një mburojë të pathyeshme. Agjëruesi, me përmbajtjen e tij nga veprat e këqija, kalitet në drejtim të kënaqësisë hyjnore, duke arritur lumturinë në të dy botët. Në këtë kontekst, në hadith të Pejgamberit, a.s., thuhet: “*Kush e agjëron Ramazanin me besim të sinqertë për shpërblimin e tij (vetëm prej Allahut), atij i falen mëkatet e kaluara.*”<sup>12</sup>. Prandaj, në dritën e këtyre argumenteve, agjërimi vlerësohet si një rrugë, fundi i së cilës kurorëzohet me piedestalin më të lartë të devotshmërisë. Në lidhje me këtë, Raziu thekson se agjërimi është një akt që thyen kërkesat dhe dëshirat njerëzore, si ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime. Sa më e madhe të jetë dëshira e njeriut për diçka, aq më i vështirë është mosplotësimi i saj. Pikërisht për shkak të natyrës së tij si krijesë, ngrënia, pirja dhe nevojat e tjera fizike zënë një vend kryesor mes kërkesave dhe dëshirave të njeriut, ndërsa përmbajtja ndaj tyre është e mundur vetëm përmes agjëritimit. Personi që, me anë të agjëritimit, mëson ta përmbajë veten nga këto shprehje e dëshira, do

<sup>9</sup> Gazali, Ebu Hamid Muhammed (1979), *Ihjau Ulumi'd-Din*, “Kitabu Esrari's-Saum”, Lahor: 49.

<sup>10</sup> El Bekareh, 185.

<sup>11</sup> El Bekareh 2/183.

<sup>12</sup> Buhari, “Iman”, 28.

ta këtë edhe më të lehtë të vërë nën kontroll kërkesat dhe dëshirat e tjera.<sup>13</sup>

Ramazani, që me urtësinë e Zotit të Madhërishëm përsëritet çdo vit, është i rëndësishëm për t'u kuptuar dhe rikuptuar. Në lidhje me këtë, Pejgamberi, a.s., ka thënë: "Kur të vijë Ramazani, dyert e Xhenetit hapen, dyert e Xhehenemit mbyllen, dhe shejtanët prangosen."<sup>14</sup> Ky hadith është një njoftim për besimtarët, që ky është një muaj i veçantë, një mundësi për t'u afruar më shumë me Allahun dhe për t'u pastruar shpirtërisht. Po ashtu, Pejgamberi, a.s., thotë se dyert e mëshirës janë të hapura gjatë Ramazanit, duke ofruar mundësinë që individët të kërkojnë falje dhe mëshirë te Zoti i Madhëruar. Për individin ky hadith duhet të kuptohet si një thirrje për reflektim dhe përkushtim. Në këtë muaj jepet mundësia për të pastruar shpirtin dhe për të forcuar lidhjen me Allahun përmes lutjeve, agjërimit dhe adhurimeve të tjera. Çdo individ duhet ta shfrytëzojë këtë periudhë për të reflektuar brenda vetes, duke kërkuar falje për mëkatet dhe duke u përpjekur të përmirësojë jetën e tij shpirtërore. Në këtë mënyrë, besimtarët mund të gjejnë paqe dhe harmoni, ndërsa dyert e Xhenetit mbeten të hapura dhe mundësia për shpërblime të mëdha është e pranishme.

### **Përfitimet shpirtërore**

Ramazani është një periudhë agjërimi, reflektimi, përkushtimi, bujari, sakrifice dhe edukim për vetveten, e që respektohet prej myslimanëve në mbarë botën. Përderisa festat e mëdha të besimeve të tjera shpeshherë janë komercializuar, Ramazani vazhdon ta ruajë thellësinë e tij shpirtërore. Sipas Islamit, agjërimi është, para së gjithash, një formë e edukimit shpirtëror. Në këtë kontekst, në Kuran është shpallur: *"(Të Xhenetit janë) Edhe ata që pendohen, ata që sinjerisht adhurojnë, ata që falënderojnë,*

<sup>13</sup> Err Rrazi, *Mefatihul-Gajb*, v. II, 77.

<sup>14</sup> Buhari "Iman", 34.

*ata që agjërojnë...*<sup>15</sup> Ata që agjërojnë përmenden si një termin “saihun”, e që vjen nga rrënja “saha”, dhe nënkupton udhëtarin, ose në një kuptim më të gjerë: udhëtarin në rrugën shpirtërore. Sipas Raziut, janë dy shkaqe që agjëruesi quhet “sâih”. E para, ai që udhëton nëpër tokë për përkushtim fetar dhe nuk merr me vete furnizime, dhe mbetet pa ngrënë, ashtu siç bën edhe agjëruesi. Kjo ngjashmëri e bën të përshtatshëm përdorimin e këtij termi për agjëruesin. E dyta, fjala “sihaha” nënkupton vazhdimësinë e një veprimi, si uji që rrjedh pa ndalur. Në të njëjtën mënyrë, agjëruesi vazhdon ta kryejë adhurimin, duke qëndruar larg ushqimit, pijes dhe marrëdhënieve intime.<sup>16</sup> Rrjedhimisht, nëse një person, përveçse heq dorë nga ngrënia dhe pirja, largohet edhe nga çdo e keqe dhe mëkat, atëherë ai konsiderohet një “saiih” – një udhëtar i përkushtuar në rrugën e shpirtërores. Në përgjithësi, udhëtimi shpirtëror ka një ndikim të madh në edukimin moral, pasi ai që udhëton përballet me sfida dhe vështirësi, të cilat ia mësojnë durimin. Shpesh, ai mund të mbetet pa furnizime dhe, në këto momente, mbështetet te Allahu i Lartë. Gjatë udhëtimit, ai takon njerëz të urtë e të ditur dhe përfiton prej tyre. Gjithashtu, mund të takohet me njerëz të mëdhenj dhe të kuptojë modestinë e vet. Për më tepër, ai sheh ndryshimet në mënyrën e jetesës së popujve të ndryshëm dhe, kështu, zgjeron horizontin e tij. Udhëtimi shpirtëror ka një ndikim të fuqishëm në besim dhe në formimin shpirtëror.

Agjërimi përmendet në Kuran si një mundësi për afrim tek Allahu, dhe si një shpërblim shpirtëror. Allahu i Lartë thotë: *“E kush prej jush e përjeton këtë muaj, le të agjërojë!”*<sup>17</sup>.

Dyert e Xhenetit hapen për atë që agjëron gjatë Ramazanit. Ky muaj është veçanërisht i përshtatshëm për përmirësimin shpirtëror dhe afrimin me Allahun e Madhërishëm. Në lidhje me këtë, Kurani thotë: *“E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër: i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet; pra, për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen*

<sup>15</sup> Et Teube, 112.

<sup>16</sup> Razi, *Mefatihul-Gajb*, VIII/4.

<sup>17</sup> El Bekareh, 185.

*Mua, dhe le të më besojnë Mua!*”<sup>18</sup>. Këtu theksohet se rrugët për t’u afruar me Allahun e Lartë hapen veçanërisht gjatë muajit Ramazan, dhe se kjo duhet të kërkohej përmes namazit, lutjeve dhe përkushtimit. Pejgamberi, a.s., i ka këshilluar besimtarët që mos të flenë gjatë natës në këtë muaj, por të angazhohen në adhurim.<sup>19</sup> Po ashtu, në një hadith tjetër thuhet: *“Atij që agjëron Ramazanin, duke besuar dhe llogaritur shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e së kaluarës.”*<sup>20</sup>. Ky hadith potencon dobinë shpirtërore të agjërimit në Ramazan, sepse agjërimi nuk është vetëm një akt fizik, por një rezultat i besimit të sinqertë dhe kërkim i shpërblimit prej Krijuesit Fuqiplotë. Falja e mëkateve të së kaluarës është një mëshirë e madhe e Tij, dhe kjo vlen vetëm për ata që agjërojnë me qëllimin e duhur.

Nuk ka asgjë më tërheqëse dhe më të begatë sesa frenimi nga ushqimi kur ka ushqim dhe pije me bollëk. Ky frenim nuk ndodh vetëm një apo dy herë, por çdo ditë, gjatë gjithë muajit, me një qëllim të caktuar: afimin me Zotin e Lartë dhe bindjen se ky është urdhri i Tij. Edhe kur është i vetëm dhe askush nuk e shikon, mund ta shuante etjen me një gllënjikë ujë, por nuk e bën, sepse ndjenja e afërsisë me Zotin është aq e fortë, sa nuk do të lejonte as një pikë ujë të kalonte në buzët e tij. Sa herë që përballlet me një tundim të ri, ai e tejkalon këtë sfidë duke kujtuar veten se *“Agjërimi është vetëm e vetëm për Zotin tim.”* Asnjë formë tjetër përkushtimi nuk mund ta zhvillojë këtë ndjenjë të thellë afërsie me Zotin e Madhërishëm dhe vetëdijen për praninë e Tij, siç e bën agjërimi i përditshëm gjatë një muaji të tërë.

Për agjëruenin, ekzistenca hyjnore nuk është thjesht një çështje besimi, por një realitet i prekshëm, i përjetuar përmes disiplinës shpirtërore të agjërimit. Nëpërmjet kësaj lidhjeje të shtuar me Krijuesin, ai kupton se çdo gjë që ka në jetë është një dhuratë nga Zoti. Ai zhvillon një vetëdije të re për një ekzistencë që shkon përtej nevojave të përditshme të ushqimit dhe pijes – një vetëdije për jetën shpirtërore.

<sup>18</sup> El Bekareh, 186.

<sup>19</sup> Buhari, “Saum”, nr: 27.

<sup>20</sup> Buhari, “Saum”, nr: 38.

### Rëndësia sociale-shoqërore e Ramazanit

Ramazani, përveç rëndësisë së tij shpirtërore, ka edhe një ndikim të madh social-shoqëror. Gjatë këtij muaji, agjërimi zgjon ndërgjegjen e shoqërisë së pasur, duke i ndihmuar njerëzit të kuptojnë vështirësitë me të cilat përballen të varfrit. Ai u ofron atyre një përvojë të drejtpërdrejtë të urisë dhe etjes, duke krijuar një ndjenjë solidariteti dhe dhembshurie. Mungesa nuk shihet më si diçka e largët, por bëhet një përvojë e përbashkët për të gjithë, duke i shtyrë njerëzit të ndajnë me bujari begatitë që Zoti i Lartë u ka dhënë me ata që kanë nevojë. Megjithatë, për të arritur qëllimin e vërtetë të muajit Ramazan, besimtarët duhet të ndjekin një disiplinë të rreptë shpirtërore dhe praktike. Disa njerëz mund të mendojnë se shpëtimi arrihet vetëm duke i mundësuar një të varfëri të hajë pas agjërimit. Kjo është, pa dyshim, një pjesë e rëndësishme e praktikës, por nuk është i vetmi synim që duhet përmbushur gjatë këtij muaji të bekuar. Në lidhje me këtë, transmetohet se Pejgamberi, a.s., ka thënë: *“O njerëz! Hëna e një muaji të shenjtë ka rënë mbi ne. Ky muaj ka një natë që është më e vlefshme se një mijë muaj. Allahu e ka bërë agjërimin e këtij muaji një obligim, ndërsa namazin e natës e ka bërë vullnetar. Kush kërkon ta afrojë veten me Allahun përmes një namazi nafie, shpërblimi i tij do të jetë si ai i dikujt që kryen detyrat e farzit gjatë ditës. Ky është muaji i durimit, dhe shpërblimi i durimit është Xheneti. Ky është muaji i solidaritetit dhe ndihmës së njëri-tjetrit. Ai që ushqen një agjëruer për iftar, Allahu do t’ia rritë furnizimin atij, dhe kjo do të sjellë faljen e mëkateve dhe shpëtimin nga zjarri i Xhehenemit. Shpërblimi i atij që agjëron nuk do të zvogëlohet asgjë.”*<sup>21</sup>. T’i ndihmosh skamnorët dhe ta ushqesh agjëruesin, pa marrë parasysh nëse ai është në nevojë apo jo, është një simbol i përkushtimit dhe largimit nga mendjemadhësia dhe vetëpëlqimi. Allahu e shpërblen individët e këtillë duke i dhënë mundësinë të bëjë më shumë vepra të mira dhe duke i falur mëkatet e tyre. Pejgamberi, a.s., përherë ishte bujar në dhënien e sadakasë, por sadakaja që ai jepte gjatë Ramazanit ishte më e bujshme se në çdo muaj tjetër. Ibën Abasi, r.a., transmeton: *“Pejgamberi,*

<sup>21</sup> Tirmidhi, nr: 807.

*a.s., ishte më i bujari i njerëzve. Ai ishte më bujar kur takonte Xhibrilin gjatë muajit Ramazan. Xhibrili e vizitonte çdo natë, dhe ia recitonte Kur-anin. Gjatë këtij muaji, bujaria e Pejgamberit, a.s., kalonte çdo erë që sillte shi.*"<sup>22</sup>. Në një kohë kur shumë njerëz janë të angazhuar me punë dhe aktivitete të përditshme shpesh të ndërlikuara, ky hadith thekson rëndësinë e bujarisë dhe mirësisë si virtyte që mund të zhvillohen dhe kultivohen në jetën e përditshme. Pejgamberi, a.s., ishte një model i përkushtimit ndaj të tjerëve, veçanërisht gjatë muajit Ramazan, kur ai i ndihmonte dhe shpërndante të mirat tek ata që kishin nevojë. Ky hadith është një thirrje për t'u angazhuar më shumë në ndihmën ndaj të tjerëve, për të kultivuar sjellje bujare dhe për të ruajtur një shpirt të pastër e të dëlirë përballë sfidave të jetës moderne. Prandaj, besimtari pritet të afrohet me Allahun e Madhërisëm përmes mënyrave të ndryshme të bamirësisë dhe të përfitojë sa më shumë nga muaji Ramazan. Elementi kyç në këtë proces është sinqeriteti, duke orientuar çdo veprim dhe shpenzim vetëm për kënaqësinë e Zotit të Lartë. Pas përmbushjes së nevojave të tij, njeriu duhet të ushtrojë ndjeshmëri ndaj mjedisit shoqëror, duke u kujdesur për të afërmit, fqinjët dhe individët në nevojë, si dhe duke kontribuar në lehtësimin e vuajtjeve të tyre.

Agjërimi shërben si një mekanizëm edukues që forcon ndjenjën e nderisë mes individëve brenda shoqërisë. Përmes tij, ata që kanë më shumë mundësi ekonomike përjetojnë drejtpërdrejt sfidat e të varfërve, duke zhvilluar një kuptim më të thellë të realitetit të varfërisë dhe duke u angazhuar në ndihmën ndaj tyre përmes mjeteve të disponueshme. Ky proces nxit ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë sociale, veçanërisht te shtresat e pasura të shoqërisë. Megjithatë, një përvetësim i tillë i realitetit shoqëror është më i thellë dhe më i efektshëm kur buron nga përvoja personale dhe reflektimi individual. Në këtë kontekst, agjërimi në Ramazan nuk është thjesht një praktikë fetare, por edhe një mjet për të ofruar një perspektivë përjetuese dhe praktike mbi çështje të rëndësishme shoqërore.

Ramazani nuk duhet të perceptohet thjesht si një akt privimi nga ushqimi, por si një periudhë shpirtërore dhe sociale me vlera të thella huma-

<sup>22</sup> Buhari, "Kitabu'l-Zekat", 605; Muslim, "Kitabu'l Zekat", nr. 2308.

ne. Pejgamberi, a.s., përfaqëson modelin më të lartë të përjetimit të këtij muaji, duke e mishëruar atë përmes adhurimit, devotshmërisë dhe veprave të bamirësisë.

Pa dimensionin e solidaritetit dhe bujarisë, Ramazani do të reduktohej në një praktikë formale, duke humbur esencën e tij të vërtetë. Dhënia e sadakasë nuk është vetëm një akt individual i dobishëm, por një mekanizëm që forcon kohezionin social dhe ndihmon në adresimin e nevojave të shtresave të marginalizuara. Kjo praktikë e shndërron bamirësinë në një detyrim etik dhe shpirtëror, duke e ngritur atë në një nivel të domosdoshëm për zhvillimin e jetës fetare dhe shoqërore.

Një tjetër aspekt thelbësor që lidhet me agjërimin në muajin Ramazan është dhe hadithi i transmetuar prej Ebu Hurejres, në të cilin Pejgamberi, a.s., ka thënë: *“Kush nuk heq dorë nga gënjeshtria dhe veprimet e rreme, Allahu nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijet e tij.”*<sup>23</sup> (Buhariu). Ky hadith thekson se nëse një individ vazhdon të gënjejë dhe të veprojë në mënyrë të pandershme, agjërimi i tij humbet vlerën shpirtërore dhe nuk shpërblehet tek Allahu i Madhërishëm. Agjërimi nuk është thjesht një privim fizik nga ushqimi dhe pija, por një proces që synon përmirësimin moral dhe shpirtëror. Një person që bie në mendjemadhësi, në të vërtetë, e bën të kotë agjërimin e tij. Paradoksi i madh qëndron në faktin se njerëzit heqin dorë nga gjërat e lejuara për hir të agjërit, por nuk tregojnë të njëjtin përkushtim për t’u larguar nga veprimet e ndaluara. Ata ruhen nga mëkatet e mëdha, por shpesh bien pre e mëkateve të vogla.

## Përfundim

Gjatë historisë agjërimi është zhvilluar si një metodë shpirtërore për forcimin e besimit dhe të adhurimit. Ai është konceptuar jo vetëm si një detyrim fetar, por edhe si një akt vetëdisipline, orientim drejt një jete më të shëndetshme dhe një lidhjeje më të fortë shpirtërore. Përfitimet e tij janë shumëdimensionale, si në aspektin shpirtëror, intelektual, emocional dhe fizik, duke kontribuar në mirëqenien e përgjithshme të individit.

<sup>23</sup> Buhari, “Saum”, nr: 1903.

Agjërimi sjell një transformim që rigjallëron dhe rifreskon shpirtin e njeriut. Një person mund të ndiejë se ka jetuar një jetë egoiste, të pakuptimtë, të mbushur me lakmi dhe papërmbytshmëri, pa ndonjë vlerë të vërtetë. Ky zgjim i ri shpirtëror dhe ndjenja e mëshirës e shtynë individin të heqë dorë nga etja për luks dhe ambiciet vetjake, duke menduar më shumë për të tjerët. Ai fillon të shohë bukurinë e jetës në sakrificën për të mirën e të tjerëve, duke kontribuar për të zbutur varfërinë dhe vështirësitë e tyre.

Koncepti i kënaqësisë ndryshon plotësisht; lumturia nuk gjendet më në përfitim personal, por në ndihmën ndaj atyre që janë në nevojë, të trishtuar dhe të lodhur nga jeta. Ky ndryshim e shndërron një individ që dikur mund të ishte lakmitar dhe i pakujdesshëm në një anëtar produktiv të shoqërisë.

Agjërimi i dhuron njerëzimit përfitime të panumërta, disa prej të cilave i kuptojmë, ndërsa të tjerat mbeten përtej perceptimit tonë. Siç thotë Allahu në Kuran:

**“Mirëpo, po që se e dini, agjërimi është më i mirë për Ju.”** (Bekare, 184).

### **Literatura:**

- El Kasani, Alauddin Ebu Bekr b. Mes‘ud b. Ahmed (1986), *Kitabu Be-dai ‘us-Sana’ i fi Tertibi ‘sh-Shera’ i*, Bejrut: Daru Kutubu’l-Ilmijje.
- Er-Razi, Fahrudin (1862), *Mefatihu ‘l-Gajb*, Kajro: el-Matbaa Misrijje.
- Ibën Kajjim El Xhevzijje (2008), *Zadu ‘l-Mead*, v. II, Bejrut: Muessesetu’l-Rejjan.
- Ibën Kethir (1999), *Tefsiru ‘l-Kurani ‘l-Adhim*, Bejrut: Daru Tajjibe.
- Gazali, Ebu Hamid Muhammed (1979), *Ihjau Ulumi ‘d-Din*, “Kitabu Esra-ri’s-Saum”, Lahor.
- Buhari, Muhammed bin Ismail (1997), *Sahihu ‘l-Buhari*, Rijad: Darusselam.
- Tirmidhi, Muhammed bin Isa (2007), *Suneu ‘t-Tirmidhi*, Rijad: Darusselam.
- Muslim, Husejn Muslim Ibën Haxhxhaxh (2007), *Sahihu Muslim*, Rijad: Darusselam.

**Prof. Ass. Dr. Valmire BATATINA KRASNIQI**

## **THE CONCEPT AND IMPORTANCE OF FASTING DURING THE MONTH OF RAMADAN**

### **Abstract**

The month of Ramadan is a period of fasting, meditation, devotion, generosity, sacrifice and discipline, which is practiced by Muslims all over the world. If the lessons learned during the month of Ramadan, especially those related to eating habits and devotion, are understood and applied properly, they can be beneficial to the individual. Like all religious obligations and rituals, fasting too has a strong logic behind it, which aims to bring numerous spiritual and material benefits to the believers. Apart from being a beloved and precious obligation towards Allah, the Almighty, fasting has multiple benefits, both for the individual and society. In addition to the psychological, spiritual, economic and social impacts mentioned in the Qur'an and the hadiths of the Prophet, peace be upon him, modern scientific and medical studies have also revealed its amazing benefits. In this study, we will address the concept of fasting in Islam, its importance and impact on the individual and society.

**Keywords:** *Ramadan, fasting, Qur'an, obligation, importance, impact.*



Myftiu Naim TËRNAVA

## FILOZOFË E MENDIMTARË ARGUMENTOJNË BESIMIN NË ZOT (2)

### Abstrakt

Nevoja e njeriut për fe është e lindur me vet njeriun dhe se ajo është pjesë e pandashme e tij. Historikisht kështu ka qenë që nga krijimi i njeriut të parë - Ademit, a.s. dhe se ajo e ka përcjellë njerëzimin përgjatë gjithë fazave të tij. Dhe pavarësisht intelektit që zotëron njeriu si krijesa më e përsosur e Allahut xh.sh. në këtë gjithësi, dhe pavarësisht të arriturave të tij përgjatë shekujve e kohëve, feja nuk e humbi rëndësinë e saj, përkundrazi. Kjo sepse mësimet fetare erdhën nga Zoti, xh.sh., përmes të dërguarve të Tij, në përputhje me natyrën dhe nevojat e njeriut. Për këtë arsye, mësimet fetare, meqë kanë bazë hyjnore, ato prore ua japin shpjegim çështjeve të cilave mendja e njerit s'mund t'u gjej zgjidhje.

**Fjalët çelës:** *njeriu, feja, pejgamberwt, shpallja*

Më se e vërtetë është se natyra e njeriut gjithherë anon kah ajo që ta ruajë veten nga çdo gjë që shkon në dëm të tij, të shëndetit të tij, të natyrës së tij në të qenët njeri. Njeriu nga natyra e tij nuk është në gjendje të jetojë pa fe, pa besim në Zot, të cilin e madhëron, e shenjtëron, dhe me këtë adhurim e shenjtërim ai fiton qetësi, si dhe kënaq shpirtin, mendjen e zemrën. Duhet pasur gjithherë parasysh se feja apo besimi është pjesë e natyrës njerëzore, dhe njeriu nuk mund të jetojë pa të, qoftë ajo fe e shpallur prej Zotit, xh.sh., siç është Islami, apo fe që konsiderohet e shpallur, apo fe që është shpikur prej njeriut. Zoti, xh.sh., me dëshirën e Vet nuk e la njeriun të varur vetëm nga mendja e dija që ia dhuroi, por e bëri atë të

marrë nga drita e Tij (Shpallja). Ai, xh.sh., i fali njeriut liri të plotë në zgjedhjen e fjalëve dhe veprave, në mënyrë që të jetë përgjegjës për tërë atë që angazhohet, flet e vepron, dhe në mënyrë që ta arsyetojë qëllimin përse ekziston.

Për nevojën e besimit në Zot kanë folur edhe mendimtarë, dijetarë e filozofë, të besimit islam dhe joislam, të cilët kanë arritur në përfundim se pa besimin në Zot njeriu është absolutisht i humbur. Në vazhdim po i përmendim disa mendime të tyre:

- 1) Dekarti (Renë Descartes 1596-1650), thotë: “Unë bashkë me ndjesinë e një vete të mangët në të njëjtën kohë e ndiej se ekziston një Qenie e Plotë, dhe e gjej veten të detyruar të besoj se këtë ndjenjë e ka ngulitur në veten time ajo Qenie e Plotë që i ka të gjitha cilësitë e plota, dhe Ai është Zoti.”
- 2) Filozofi francez Bergson (Henry Bergson 1859-1941) thotë: “Në të kaluarën dhe në të sotmen do të gjenden shoqëri njerëzore që nuk kanë as shkencë, as art, as filozofi, por nuk ka pasur kurrë shoqëri pa fe.”
- 3) Dr. Alvin Carl Plantinga, filozof amerikan dhe anëtar i Akademisë dhe Shkencave Amerikane, si dhe profesor i filozofisë në universitetin Notre Dame, që është marrë me mësimet e filozofisë rreth feve, me origjinën e njohurive dhe të fshehtësive, thotë se “besimi në ekzistencën e një Perëndie është një ndjenjë e lindur, një intuitë që nuk ka nevojë për prova.”
- 4) Ralph Matthev Mcinerny, filozof amerikan, autor i një libri mbi krishterimin dhe teologjinë e krishterë, si dhe i disa tregimeve fetare, duke folur për këtë temë, thotë: “Rregullsia dhe mrekullitë e shumta në strukturën e ekzistencës, si dhe pandryshueshmëria e ligjeve natyrore, dëshmojnë se ekziston një Krijues (një aksiomë logjike), dhe kushdo që e mohon atë duhet të sigurojë prova.”
- 5) Dijetari dhe filozofi i famshëm anglez David Conway, i lindur më 1947, profesor i filozofisë në universitetin Middlesex në Londër, i interesuar për filozofinë e feve, filozofinë klasike si dhe atë moderne, autor i librit të njohur “Kthimi te urtësia”, u pajtua me një numër të madh dijetarësh rreth cilësive apo attributeve të Zotit, që

filozofi Aristotel arriti t'i identifikonte 25 shekuj më parë, të cilat ai i përcaktoi duke thënë: “Zoti ka atributet e mëposhtme: Zoti është një; ai është i paprekshëm; nuk është materie; gjithëfuqia, gjithëdituria, uniteti apo pandashmëria, mirësia e përsosur dhe ekzistenca e domosdoshme janë cilësi të Tij.”

6) Dr. Omer Sherif, profesor i kirurgjisë së përgjithshme, i cili shkroi librin me titull “Një udhëtim mendjeje” thotë se shkenca e çon ateistin më të egër drejt besimit dhe thekson se “Duhet të pranohet që bindja ime, e Conway-t apo e Aristotelit, për ekzistencën e Zotit dhe për atributet apo cilësitë e Tij, u arrit përmes arsyes, pa nevojën e ndonjë ndërhyrjeje që do t'i shkelte ligjet e natyrës, pra, shpalljes apo mrekullive.” Ky po ashtu shton se “Kuptimi për ekzistencën e Zotit dhe disa prej veçorive të Tij ishte përmes një udhëtimi mendor, jo një udhëtimi besimi.”

7) Dr. Vandwick Muhamed El Hadi thotë: “Unë e kuptova vërtet veten kur isha duke lexuar Kuran. Në çdo ajet që lexoja kam gjetur ide (mendime) të integruara (të plota), të cilat nuk i përmbahen thënies njerëzore. Kjo është arsyeja pse unë ia bëra vetes sime obligim të përditshëm që të lexoja nga një ajet për çdo ditë dhe të meditoja për të.”

Pra, besimi është diçka që e ka shoqëruar njeriun gjatë gjithë historisë së tij dhe ndërmjet tij ai ka gjetur rrugëdalje nga çdo problem. Duke pranuar fenë, njeriu e refuzon egon, të keqen dhe ndërgjegjësohet se çdo gjë është nën pushtetin e Zotit, gjë që i jep kurajë dhe forcë, e bën të pavarur prej njerëzve, ia ngre vlerën dhe e bën krenar. Besimi është shëndet për mendjen, shpirtin dhe trupin. Duke pranuar se çdo gjë udhëhiqet prej Zotit, xh.sh., ne e shkarkojmë veten nga barra që ndiejmë për disa gjëra, barrë e cila rëndon shumë në shoqërinë ku mungon besimi.

Duke e njohur Allahun, xh.sh., e duam më shumë Atë dhe, rrjedhimisht, i kryejmë të gjitha detyrimet që burojnë nga besimi. Kështu, feja shndërrohet në dashuri, në gëzim, në lumturi.

1. Monoteizmi si nevojë shpirtërore
2. Islami i jep kuptim jetës

Më lart konfirmuam se besimi është nevojë shpirtërore, mirëpo duhet të shpjegojmë se jo çdo besim e mbush boshllëkun shpirtëror. Vetëm besimi i vërtetë dhe i pastër në Zotin Një të jep kënaqësi të vërtetë shpirtërore, iu jep përgjigje pyetjeve që na mundojnë, e mbush boshllëkun shpirtëror dhe i jep kuptim jetës. Nisur nga kjo, Allahu dërgoi shumë peygamberë, me porosinë kryesore bazë: të besohet Allahu Një dhe mos t'i përshkruhet ortakëri e as të mos përngjasohet asgjë me Të. Në fakt, besimi është më shumë sesa nevojë. Ai është natyrshmëri me të cilën lind njeriu. Për këtë shkak, thirrja në këtë parim, pra në besimin e pastër, ka qenë, siç shpjeguam edhe në hyrje, misioni i të gjithë peygamberëve. Të gjithë peygamberët pas Ademit, a.s.: Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai, Muhamedi, a.s., i thirrën popujt e tyre në monoteizëm, në Njëshmërinë e Zotit. Kjo thirrje, në esencë, e parqet Islamin në shtrirjen vertikale, si fe e të gjithë peygamberëve. Allahu, xh.sh., thotë: ***“Feja e pranueshme tek Allahu vërtet është Islami...”*** (Ali Imran, 9)

Pra, në thelb feja e vetme e shpallur prej Zotit, xh.sh., është Islami, fe e cila në vazhdimësi thirri për besim në Zotin Një, ndërsa çështjet e tjera dytësore, siç janë ligjet, u shpallën sipas kohës, rrethanave dhe natyrës së misionit të peygamberit përkatës. Thirrja për ta besuar dhe adhuruar vetëm Allahun, xh.sh., është pika kyçe dhe e përbashkët e gjithë peygamberëve, është boshti rreth të cilit sillet i tërë misioni i tyre. Duke na e kujtuar këtë, Allahu, xh.sh., na thotë në Kuran:

***“Ne edhe ty (Muhamedi) ta zbritëm Librin e vërtetë (Kuranin), që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre. Pra, gjyko mes tyre me atë që Allahu e zbriti, dhe mos pëlqe epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi! Për secilin prej jush Ne caktoam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte Allahu do t’ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t’ju sprovtojë në atë që jua dha juve. Prandaj, ju (besimtarë) përpiquini për punë të mira! Kthimi i të gjithë juve është tek Allahu, e Ai do t’ju njoftojë me atë që kundërshtoheshit.”*** (Maide, 48)

Kurani është vërtetues i shpalljes apo i librave hyjnorë të zbritur më herët te peygamberët e mëparshëm. Kurani është shpjegues i tyre dhe përmbledhës i çështjeve kyçe: besimi në Zotin Një, besimi në Ditën e Fundit

etj. Kurani gjithashtu vë në dukje ndërhyrjen që njerëzit kanë bërë te librat e mëhershëm, devijimin e këtyre librave nga origjinali, dhe na bën me dije se përfundimisht është marrë përsipër të ruhet prej vetë Zotit, xh.sh., nga çdo tentativë për devijim nga origjinali.

Zoti, xh.sh., e urdhëroi Muhamedin, a.s., që të gjykojë mes njerëzve sipas mësimave dhe dispozitave të zbritura në Kuran, dhe t'i këshillojë ata që epihet e tyre të mos i devijojnë nga e vërteta. Popujt ku u dërguan librat e shenjtë: Tevrati, Inxhili, Zeburi, apo fletushkat (broshurat), kishin ligjet e tyre në bazë të të cilave e organizonin jetën e tyre, si në aspektin fetar ashtu edhe në jetën e përditshme. Krejt kjo ishte e vlefshme para se të vinte Kurani, i cili i anuloi të gjitha shpalljet e mëhershme, pasi librat e mëhershëm kishin pësuar ndryshime, rrjedhimisht nuk vlenin më.

Njerëz të shtyrë edhe nga motive të ulëta, për interesa personale dhe favore të ndryshme, i ndryshuan tekstet nga origjinali i zbritjes, duke futur mendime personale në mesin e asaj çka kishte zbritur prej Allahut, xh.sh., dhe kështu ligjet e tilla të mëhershme, tani me zbritjen e Kuranit, kanë pushuar të funksionojnë e të kenë vlerë.

Sikur Allahu, xh.sh., të dëshironte, Ai do të na bënte të gjithëve një popull me një besim, mirëpo Ai nuk e bëri këtë, por na bëri popuj e fise të shumta e të ndryshëm, si në ngjyrë, në të folur etj., me qëllim që të njihemi e të bashkëpunojmë mes vete. Allahu, xh.sh., ia la njeriut edhe mundësinë që ai të zgjedhë për besim në Zotin Një, ta besojë Atë apo ta mohojë, e la të lirë, duke ia tërhequr vërejtjen dhe duke e thirrur në vazhdimësi për besim të drejtë në Zotin Një, përmes peygamberëve që Ai i dërgoi vazhdimisht. Pra, Zoti, xh.sh., i dha njeriut edhe mundësinë e pranimi ose jo të besimit.

Nga vetë natyra e njeriut shihet se ai ka nevojë për fe, dhe se feja gjithherë duhet të jetë e pranishme te njeriu. Sikur të mos ishte feja, a thua kush do t'i përgjigjej pyetjeve të njeriut, siç janë:

- 1) Kush e krijoi këtë gjithësi?
- 2) Prej çfarë u krijua dhe çfarë do të bëhet me të?
- 3) Kush jam unë? Nga kam ardhur? Pse kjo jetë nuk është e përherëshme? Çka do të bëhet me mua pas vdekjes? A do të ketë ringjallje? A do t'i vijë fundi kësaj gjithësie etj.

Nga e gjithë kjo shihet se feja është e domosdoshme për individin dhe shoqërinë. Siç kemi përmendur edhe më herët, njeriu dallon nga krijesat e tjera me intelektin dhe arsyen, aftësinë për të menduar e logjikuar. Pra, njeriu është e vetmja krijesë e vetëdijshme në mesin e qindra miliona krijesave që jetojnë në këtë planet. Njeriu nuk ka njohuri vetëm për veten e tij, por edhe për gjërat që ndodhin përreth tij.

Nisur nga kjo, kureshtja e njeriut për të njohur sa më shumë nuk shuhet kurrë. Kjo e provokon mendjen të meditojë edhe rreth gjërave të paqena, se si do të ishin po të ishin, dhe këtë jo për tjetër, por vetëm e vetëm që t'i ofrojë vetes kënaqësi shpirtërore. Mirëpo, duke qenë se bëhet fjalë për kënaqësi të shpirtit, atëherë as ky meditim dhe as kjo përsiatje, nëse nuk rezultojnë me besimin e pastër, nuk mund t'i dhurojnë kënaqësi. Zoti ka caktuar që kënaqësia të realizohet vetëm përmes besimit. Në Kur'an Zoti, xh.sh., na mëson se kënaqësia e vërtetë shpirtërore arrihet vetëm nëpërmjet përkujtimit dhe përmendjes së Tij. Zoti, xh.sh., thotë: ***“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve qetësohen kur përmendet Allahu. Zemrat vërtet qetësohen me përmendjen e Allahut!”*** (Rrad, 28)

### **Shfaqja e besimeve të gabuara në mungesë të Shpalljes hyjnore**

Historikisht njeriu, pavarësisht kohës dhe hapësirës ku u gjend, u provokua nga natyrshmëria për besim. Dëshmi për nevojën e tij për Zotin kemi natyrën e tij, e cila në vazhdimësi ka nevojë të mbështetet në diçka përtej vetes. Njeriu e gjeti veten të vogël dhe të pafuqishëm karshi asaj që e rrethon, prandaj rrjedhimisht edhe shfaqja e nevojës për ndihmë nga jashtë, prej dikujt që është më i madh se kjo botë ku jeton dhe që i zgjidh këto sfida e probleme me të cilat ballafaqohet. Pra, kështu njeriu vetëm nëpërmjet besimit arriti ta mbushë boshllëkun që ndiente në zemër.

Dihet mirëfilli se çdo gjë e krijuar argumenton për Krijuesin, gjithë çfarë ka në qiej e në Tokë. Preciziteti dhe harmonia që mbretëron në këtë ekzistencë argumenton se ekziston vërtet vetëm një Zot, dhe se Ai është Sunduesi i vetëm që meriton të adhurohet. Ai është Fuqiploti e i Lartësuar! Ai është më i Larti, i Madhërishmi, si dhe është i Gjithëdijshmi e Gjykatësi Suprem. E gjithë kjo na dërgon te qëllimi pse është krijuar kjo ekzistencë, e kjo e shtyn njeriun në dashurinë dhe falënderimin e vazh-

dueshëm, veprim i cili buron nga thellësia e zemrës. E, me këtë veprim njeriu arrin pozitë të lartë të besnikërisë të Zotit, xh.sh. Zoti, xh.sh., thotë: **“Po edhe në veten tuaj. A nuk jeni kah e shihni?!”** (Dhariat, 21).

Së këndejmi, kjo nevojë e shtyri njeriun të hulumtojë për Zotin të Cilit, në shpërputhje me mësimet e pastra fetare, i dha formë ashtu siç e imagjinoi ose perceptoi. Për pasojë lindën forma të gabuara të besimit. Në mungesë të besimit të drejtë, në mungesë të shpalljes hyjnore, të pejgamberëve, njerëzit besuan në lisa e gurë të gdhendur e të pagdhendur, në yje e planetë, në gjallesa e kafshë. Natyrisht, për ne si ithtarë të Islamit, fesë sonë monoteiste, trajtimi i këtij devijimi nga një anë tjetër, megjithë-këtë duke iu përmbajtur kontekstit, themi se e rëndësishme të ky evidencim i këtyre formave të besimit është natyrshmëria dhe nevoja e njeriut për të besuar. Nga zbulimet arkeologjike, gjegjësisht statujat e monumentet e tjera me motive besimi të gjetura kudo në botë, mund të konstatojmë se besimi është dukuri që e përcjell shoqërinë njerëzore gjatë gjithë ekzistimit të saj. Më qartë, forma të këtyre besimit hasim edhe në shoqëri të lashta, si në shoqërinë e Egjiptit të vjetër, Kinës, Persisë etj., gjë kjo që provon këtë prani të besimit tek njeriu (instinktiv, megjithëqë të gabuar).

Këto besime të gabuara e shtynë njeriun që t'i hyjë aventurave, siç janë, për shembull, ato në Egjiptin e lashtë, ku në emër të besimit njeriu, duke e personifikuar vetën si zot, bëri veprime të çuditshme, siç ishte, ta zëmë balsamimi i trupave, ndërtimi i piramidave, e që edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të jenë tema diskutimi në qarqe studiuesish e arkeologësh. Nga historia mësojmë se popuj të ndryshëm besonin edhe në besime të ndryshe, besonin në zotin e dritës, errësirës, fuqisë, dashurisë, erës, shiut, si dhe në shumë zota të tjerë. Këto besime ishin të pranishme me mijëra vjet para ardhjes së Muhamedit, a.s.

Në Greqinë e vjetër gjejmë zanafilla të shkencave të shumta, e edhe dijetarë e filozofë të shumtë, të cilët në mungesë të shpalljes, mirëpo të shtyrë nga nevoja e natyrshme, bënë orvatje të vazhdueshme për konceptin e besimit, si dhe dhanë mendimet e tyre, e që nga kjo perspektivë duhen vlerësuar sidomos nëse kihet parasysh periudha e shkëputjes së dërgimit të pejgamberëve. Fjala është për periudhën gjashtëshekullore,

duke u nisur që prej Isait, a.s., e deri te pejgamberi i fundit, Muhamedi, a.s., 571 e.r.

Thalesi (624-552 p.e.r.) dhe Herakliti (540-480 p.e.r.), mendimtarë materialistë, pretendonin se çdo gjë u krijua nga materia. Pa dashur të thellohem në këtë problematikë, megjithatë e shohim se materia nuk mund të jetë shpikëse e kësaj ekzistence, ngase ajo nuk posedon veçori e cilësi të cilat do t'ia kishin mundësuar një gjë të tillë. Gjithashtu, gjatë shtjellimit të kësaj teme ky diskutim nuk është fokus yni, ngase ne na intereson ta dimë çështjen se njeriu, pavarësisht se ku dhe kur jetoi e veproi, prej vetë natyrës së krijimit, kishte nevojë për fe (besim) në Zot. Pak më vonë, në Greqinë e vjetër kemi paraqitjen edhe të dijetarëve apo filozofëve idealistë, siç qenë: Sokrati (470-399 p.e.r.), Platoni (427-347 p.e.r.), Aristoteli (384-322 p.e.r.) etj., të cilët e kundërshtonin teorinë se materia është krijuese e kësaj gjithësie, dhe mbronin mendimin se kjo gjithësi është e krijuar prej një fuqie Supreme (Zotit), dhe jo nga hiçi, apo nga materia. Pra, sipas këtyre, kjo gjithësi e ka fillimin dhe mbarimin e saj, dhe atë e krijoi një fuqi metafizike, e cila vazhdimisht është e pranishme në gjithësi, dhe ajo e mban dhe e udhëheq gjithësinë.

### **Feja pas dërgimit të Muhamedit, a.s.**

Nëse në të kaluarën, në mungesë të pejgamberëve, mund të jenë falur format e gabuara të besimit, me ardhjen e Muhamedit, a.s., nuk ka kurrfarë arsytimi tek ata që ka arritur shpallja. E sot, me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë, për një moment mund të informohet bota mbarë. Sepse Muhamedi, a.s., është i dërguar për mbarë njerëzimin, dhe Kurani është libër dedikuar mbarë njerëzimit, pa kurrfarë dallimi mes tyre. Prandaj edhe e kemi detyrë përhapjen dhe kumtimin e shpalljes në gjithë botën. Askush nuk mund të thotë nesër para Allahut, xh.sh., se nuk e ka ditur mënyrën e besimit, kur ai veçse ka dëgjuar për Islamin, apo se nuk ka pasur shpallje apo pejgamber, kur veçse ka dëgjuar për Kuranin dhe Muhamedin, a.s. Të gjithë duhet ta dinë se të Allahut, xh.sh., janë ç'ka në qiej e në Tokë, se vetëm Ai sundon Tokë e qiej, dhe se vetëm Atij i takon sundimi. Askush prej nesh nuk e posedon mundësinë e udhëheqjes me qiej e Tokë. Kjo është kompetencë e të Madhit Zot, xh.sh., si qiejt, Toka, ash-

tu edhe yjet, Dielli, satelitët si Hëna, të gjitha udhëhiqen prej Atij. Njeriu, edhe nëse dëshiron që sadopak të marrë pjesë në këtë, ai nuk mund të bëjë asgjë, sepse është gjë e pamundshme. Çdo gjë, si në krijim, udhëheqje, harmoni etj., në këtë univers, i takon vetëm Allahut, xh.sh., dhe njeriu ka nevojë ta dijë dhe ta besojë këtë, sepse në këtë e thërret edhe Kurani fisionik. Allahu, xh.sh., thotë:

***“A nuk e di për Allahun se Atij i nënshtrohet (i bën sexhde) kush është në qiej dhe kush është në Tokë, edhe Dielli, edhe Hëna, edhe kodrat, edhe bimët, edhe shtazët, e edhe shumë njerëz, po shumë janë që dënimin është meritë e tyre. Atë që e poshtëron Allahu, nuk ka kush që mund ta bëjë të ndershëm. Allahu punon atë që dëshiron.” (Haxh, 18)***

Nga ky ajet mësojmë se Allahu, xh.sh., nuk e la njeriun të vetëm, dhe nuk ia ngarkoi atij barrën që ta gjejë formën se si të besojë. Allahu e udhëzoi njeriun nëpërmjet pejgamberëve për mënyrën e saktë të besimit dhe të adhurimit, pra nga një çështje që fillimisht është instinktive e emocionale, besimi, nëpërmjet pejgamberëve kaloi në çështje të normuar e rregulluar sipas shpalljes hyjnore. Më saktësisht, Allahu, xh.sh., e udhëzoi njeriun në formën e drejtë dhe të vërtetë, të vetmen të pranuar, të quajtur me emrin Islam, duke e përgatitur për natyrshmërinë e tij karshi Islamit dhe pamundësinë që kjo të zëvendësohet me diçka tjetër.

Adhurimi, në kuptim të pranimit të Zotit, xh.sh., dhe nënshtimit ndaj Tij, paraqet të vërtetën që e kanë kuptuar të gjitha krijesat, dhe i janë nënshtuar vullnetarisht, përveç një pjese të njerëzve dhe xhindeve. Ne besojmë se engjëjt, apo melekët, e adhurojnë Allahun, sikurse e adhuron edhe çdo gjë tjetër e krijuar: Toka, qiejt dhe krejt çfarë ka ndërmjet tyre, me përjashtim të njeriut. Sepse vetëm njeriu e ka mundësinë edhe të refuzimit. Dhe po sipas kësaj, devijimi nuk është thjesht humbje nga rruga e drejtë, por edhe deformim në vullnet e bindje.

Njeriu, siç po shihet, ka nevojë ta besojë Zotin Një, të Vetëm, dhe të largohet nga besimet e kota, nga besimet në gurë e dru, në yje, Diell e Hënë, apo nga besimet në shumë zota. Njeriu duhet të besojë në Zotin Një, të Cilit i nënshtrohet çdo gjë dhe tek i Cili do të kthehemi për llogaridhënie.

## Studimi për gjithësinë e forcon besimin në Zotin Një

Ky konstatim vjen duke u nisur nga parimi se raporti i njeriut me Krijuesin duhet të jetë i ndërtuar mbi bindjen dhe sinqeritetin. Islami është fe e vetme e shpallur prej Zotit, xh.sh., dhe e shpjeguar me argumente të qarta, e që nuk bien ndesh me natyrën dhe mendjen e njeriut. Po ashtu, Islami mbetet i pandryshuar, e rrjedhimisht edhe i pazëvendësueshëm. Pra, fakti se Islami është fe e vërtetë, nuk është diçka alternative, por diçka që duhet pranuar, kështu që nevoja për të mësuar më shumë për fenë dhe për t'u njohur sa më thellësisht me parimet e fesë është e pranishme gjithnjë. Prandaj, njeriu ka nevojë të përhershme të dijë sa më shumë për këtë besim, i cili nuk pranon as të shtohet e as të pakohet, as të zëvendësohet e as të devijohet, pavarësisht rrethanave nëpër të cilat kalon shoqëria njerëzore. Kjo ndodh ngase kjo fe nuk është produkti i tubimeve të mëdha të njerëzve të mëdhenj, të ditur apo të pasur, apo të ushtrive të mëdha, por është ligj dhe sistem jete i shpallur prej Zotit, xh.sh.

Ky koncept për nevojën për besim ka rëndësinë e vet, pasi ai nuk ngel thjesht në diçka teorike, në diçka që e mësove apo jo, si dhe nuk paraqet ndonjë dallim, por diçka që nga njohuria dhe informacioni merr trajtë dashurie e respektimi. Sa më shumë ta njohim Allahun, xh.sh., aq më shumë edhe e duam. Këtu mbase qëndron sekreti pse Zoti, xh.sh., në Kuran dhe Muhamedi, a.s., në hadithe na kërkojnë të mendojmë për ekzistencën, gjithësinë, të vështrojmë fakte dhe dëshmi që na flasin për Zotin, xh.sh., sepse e tërë gjithësia është një argument që dëshmon për Krijuesin.

Për t'u bindur në këtë Allahu, xh.sh., i drejtohet njeriut, mendjes e arsyes së tij edhe me këto kërkesa. Allahu, xh.sh., thotë:

***“Thuaj: Vështroni me vëmendje ç’ka (nga argumentet) në qiej e në Tokë...!” (Junus, 101)***

Thuaji ti, o Muhamed, popullit tënd, shikoni, vështroni në kuptim të studimit dhe të bindjes, se çfarë ka në qiej dhe në Tokë! Thjesht, ju nuk jeni të urdhëruar të besoni në mënyrë të verbër, pa e ditur pse besoni, si të besoni dhe në çka të besoni. Për t'u bindur në këtë, në Zotin Një, Krijuesin e çdo gjëje, shikoni se çfarë ka në qiej e Tokë, në mënyrë që të kuptoni e bindeni se çdo gjë që shohim argumenton e flet për Madhërinë e Allahut, xh.sh. Nëse e vështrojmë me syrin e mendjes ndërrimin e natës

dhe të ditës, pastaj bereqetet e shumta që prodhon toka, nëse e shikojmë edhe vetë përbërjen dhe përgjegjësinë që ka njeriu, si dhe shumë e shumë argumente të tjera, do të bindemi se nuk ka asgjë të rastësishme, por të gjitha këto i ka krijuar Ai që po na urdhëron të mësojmë e studiojmë për gjithçka, aq sa kemi mundësi për ta bërë, ngase studimi i thellë në çdo gjë të krijuar na afron dhe na bën ta besojmë Zotin Një. Allahu, xh.sh., thotë në Kuran:

***“Dhe a nuk menduan ata me veten e tyre se Allahu nuk krijoi qiejt dhe Tokën dhe çdo gjë që gjendet ndërmjet tyre pa ndonjë qëllim të caktuar dhe për një kohë të kufizuar?! Mirëpo një pjesë e njerëzve janë mohues të takimit me Zotin e tyre (në momentin e ringjalljes pas vdekjes).” (Rum, 8)***

Edhe ky ajet na mëson se Allahu, xh.sh., ia tërheq vërejtjen njeriut që ai të shikojë, të analizojë e ta studiojë krijimin e të gjitha botëve, jetën dhe rolin e të gjitha krijesave në këtë univers, llojllojshmërinë e tyre, si në krijim ashtu edhe në formë, obligim, ngjyrë, aromë e shije. Pastaj t’i shikojë dhe t’i vështrojë në mënyrë studimore edhe qiejt dhe Tokën, për t’u bindur se asgjë nuk është e krijuar rastësisht dhe pa qëllim të caktuar, por çdo gjë e ka qëllimin dhe rolin përse është krijuar.

Përkundër ekzistimit të argumenteve të shumta, një pjesë e njerëzve nuk e besojnë Allahun, xh.sh., se Ai është Krijues i çdo gjëje dhe se tek Ai do të rikthehemi, për ta dhënë llogarinë për angazhimin tonë gjatë jetës në këtë botë. Ata që nuk besojnë janë mohues në besim dhe takim me Zotin, xh.sh., dhe nuk besojnë në ringjallje dhe dhënie të llogarisë para Allahut, xh.sh. Zoti, xh.sh., thotë:

***“A nuk vështruan ata me vëmendje pushtetin e madh në qiej e në Tokë dhe atë që e krijoi Allahu?!” (Arafë, 185).***

Pastaj ajeti:

***“Edhe në Tokë ka argumente për ata të bindurit. Po edhe në veten tuaj. A nuk jeni kah e shihni?!” (Dharijat, 20-21)***

Allahu, xh.sh., i kërkoi njeriut që, për t’u bindur në Madhërinë e Tij, për ta (mirë)pranuar nevojën e vazhdueshme për besim, për ta parë edhe praktikisht se si funksionon ky univers i krijuar prej Tij, sipas një ligji preciz dhe të saktë, pra i kërkoi ta kthejë shikimin e syve dhe të mendjes

nga qiejt e Toka, e edhe nga vetja e tij, për t'u bindur se Zoti, xh.sh., ekziston, se Ai ka krijuar çdo gjë dhe se ky univers është një libër i hapur që flet për madhësinë e Krijuesit.

Prandaj, o ti njeri që në vazhdimësi ke nevojë për fenë, vështro me kujdes e vëmendje në këtë gjithësi, dhe bindu se vetëm Zoti, xh.sh., është Ai që e mban këtë gjithësi, se vetëm Atij i takon madhështia, se vetëm Ai meriton të besohet e të adhurohet! Sigurisht, nëse njeriu shikon gjithësinë me këtë qëllim, ai edhe do ta fitojë bindjen se ajo dhe çfarë ka në të nuk u krijuan pa ndonjë qëllim apo funksion të caktuar, se ajo nuk mund të jetë krijuar rastësisht, e aq më pak të funksionojë rastësisht e në formë kaq të përsosur. Kështu edhe do ta kuptojë se gjithçka është e udhëhequr vetëm prej Zotit, xh.sh.

Mos të na habitë fakti se përkundër këtyre argumenteve shumica e njerëzve nuk e besojnë Zotin Një e të Vetëm! Njësoj nuk e besuan edhe në të kaluarën, dhe njësoj ka që nuk e besojnë as tash, si dhe që nuk do ta besojnë edhe në të ardhmen, deri në shenjat paralajmëruese të Kiametit. Mirëpo, atëherë do të jetë shumë vonë, sepse besimi i tyre nuk do të ketë dobi.

Nëse madhështia e mrekullia e krijimit të qiejve nuk na mjafton për t'u bindur në Madhërinë e Allahut, xh.sh., atëherë Allahu, xh.sh., na thotë ta kthejmë shikimin edhe në Tokën, po edhe në veten tonë, për ta parë në vazhdimësi sistemin e përkryer të krijimtarisë së Allahut, xh.sh., se si funksionon gjithçka, ngase gjithçka në këtë Tokë, dhe, dete e lumenj, në këto gjallesa të panumërta, po edhe në vetë njeriun, në vazhdimësi argumenton për nevojën e njeriut për fenë, për besimin në Allahun Një. Allahu, xh.sh., thotë:

***“Allahu është Një, e nuk ka të adhuruar përveç Tij. Ai është i Përgjetshmi, Mbikëqyrësi. Ai ta zbret ty (Muhamed) Librin me argumente, që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin, udhërrëfim për njerëz; e zbriti edhe Furkanin (dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtria). S'ka dyshim se ata që mohojnë argumentet e Allahut i pret ndëshkimi i rreptë. Allahu është Ngadhënjyes, Shpagues!”*** (Ali Imran, 2-4)

Këto ajete na mësojnë se Zoti, xh.sh., është Një, dhe se vetëm Ai meriton të adhurohet e të besohet. Gjithashtu na mëson se Allahu, xh.sh., është pa fillim dhe pa mbarim, se Ai është Krijuesi i këtij universi, të cilin e krijoi nga asgjëja, dhe se Atij i takon kompetenca e plotë në gjithësi. Allahu është Ai që zbriti libra të shenjtë dhe që dërgoi peygamberë, që përmes tyre njeriu të mësojë se si duhet besuar dhe si duhet adhuruar Zotin, xh.sh.

Siç po e shohim nga kjo që përmendëm më lart, lidhja mes peygamberit dhe shpalljes është një lidhje e fortë, e pashkëputshme dhe me porosi të vazhdueshme. Pra, të gjithë peygamberët thirrën se Zoti, xh.sh., është Një. Kjo shpallje prej Zotit, xh.sh., e cila iu dërgua njerëzimit, bart në vete përmbajtje të njëjtë të të gjithë peygamberët që e kumtonin shpalljen të popujt ku u dërguan; të gjithë ata e ndiqnin Islamin për fe, dhe e kishin për detyrë që këtë fe t'ua mësonin edhe popujve ku u dërguan. Këto porosi përmes shpalljes kishin edhe qëllimin e çrrënjësjes së të gjitha formave të idhujtarisë, të çfarëdo përuljeje apo çfarëdo adhurimi përveç Zotit, xh.sh., e edhe të adhurimit të vetë njeriut si zot, politeizmit në përgjithësi. Qëllimi ishte vendosja e një besimi që thërret për ta besuar Zotin Një e të Vetëm. Zoti, xh.sh., thotë:

***“Adhurojeni Allahun, e mos i shoqëroni Atij asnjë send...!”*** (Nisa, 36)

Islami ndryshoi themelet e konceptit të besimit, të moralit e shpirtërores ndaj besëtytnive, traditave e zakoneve të besimeve antropomorfe, duke ia bërë me dije njeriut se parafytyrimet për Qenien e Zotit janë të pakuptimta dhe, njëkohësisht duke ia shpjeguar se të menduarit dhe përpjekja për njohjen e cilësive apo të attributeve të Zotit është obligim. Gjithashtu Islami ia bëri me dije njeriut se asgjë nuk është si Ai, dhe, sido që të parafytyrohet Zoti, nga kushdo qoftë, Ai nuk është ashtu siç është parafytyruar. Prandaj, shpallja ia bën me dije njeriut vlerën e tij të vërtetë dhe pozitën e tij në këtë jetë; se njeriu nuk është një krijesë që meriton të adhurohet prej të tjerëve, por se njeriu duhet ta adhurojë Zotin, xh.sh., dhe të përkushtohet përmes devotshmërisë, e cila gjithmonë lind si rezultat i besimit dhe i adhurimit.

Ai është që e zbriti edhe Kuranin librin e fundit dedikuar njerëzimit mbarë, dhe në këtë nuk ka kurrfarë dyshimi dhe kurrfarë dileme. Ky libër, Kurani, është edhe vërtetues i librave të mëhershëm të shpallur te pejgamberët e tjerë para Muhamedit, a.s., dhe këtë e vërteton vetë Kurani, pa kurrfarë dyshimi. Po, ky është Zoti, xh.sh., i Cili e zbriti më parë Tevratin te Musai, a.s., Zeburin te Davudi, a.s., Inxhilin tek Isai, a.s., biri i Merjemes.

Allahu, xh.sh., e zbriti edhe Furkanin (Kuranin), dalluesin i së mirës nga e keqja (gënjeshtër), i cili e qartësoi të drejtën dhe të vërtetën nga devijimi dhe gënjeshtër. Nuk ka dyshim se ata që e përgënjeshtroan atë që Allahu, xh.sh., zbriti, që e mohuan dhe e luftuan atë, të tillët i pret dënim i pamëshirshëm në botën tjetër, në Ditën e Gjykimit, kur të gjithë do të japin llogari për punët dhe angazhimet e bëra gjatë jetës në këtë botë.

Së këndejmi, është e drejtë e pamohueshme, madje edhe detyrë, që me urtësi e maturi secili të kërkojë nga shoqëritë e mbarë botës që t'i kthehen besimit në Zotin Një, ashtu siç urdhëron Kurani, nëse dëshirojmë ta kemi kënaqësinë e Zotit dhe të shpërblehemi me të mirat e Tij. Pra, Kurani është gjithëpërfshirës i njohurive, i rregullave dhe i ligjeve që sollën librat e mëparshëm të zbritur prej Zotit të Madhëruar.

Në asnjë civilizim apo kulturë botërore, te asnjë shoqëri, vlera morale e fesë nuk është e ndërlidhur me njeriun më shumë sesa në Islam. Kjo ngase asgjë nuk mund ta edukojë njeriun sikurse feja, apo ta mësojë njeriun se si ta përvetësojë edukimin dhe sjelljet morale, se si ta respektojë Zotin, prindërit, të moshuarit, fëmijët, të varfrit, se si të ruhet shenjtëria e jetës njerëzore, nderi dhe dinjiteti njerëzor.

Feja e edukon me sukses njeriun në mposhtjen e egos së tepruar dhe të mendjemadhësisë, dhe se si të sakrifikohet për fitoren e së mirës ndaj së ligës (së keqes), e kjo arrihet përmes përmendjes së vazhdueshme të Zotit prej njeriut.

---

**Literatura:**

- Bejheki, Ahmed bin Husejn, *Delail en-nubuvveh*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijje: 1405 h.).
- Ebu Hanife, Nu'man bin Thabit, *El-fikhu el-ekber*, (Liban: 1979).
- El-Mejdani, Abdurrahman Xhentik, *El-akidetu el-islamijje ve ususuha*, (Damask: 1994).
- El-Xhezairi, Ebu Bekr Xhabir, *Akidetu el-mu'min*, (Kajro: 1977).
- Gavoçi, Vehbi Sulejman, *Ebu Hanife en-Nu'man*, (Damask: 1993).
- Gazali, Muhammed, *Besimi i myslimanit*, (Shkup: 2001).
- Grup autorësh, Bazat e Imanit në dritën e Kuranit dhe Synetit, (Shkup: 2011).
- Grup dijetarësh, *Bazat e Imanit*, (Shkup: 2011).
- Isa, Muhamed Enver Hamid, *Nedharat Fi el-akideti el-islamije*, (Kajro: 2000).
- Misri, Mahmud, *Rihletun ila dari el-ahireh*, (Kajro: 2005).
- Savi, Salah, Akideja e Tahaviut - Parimet e besimit islam, (Shkup:)
- Xhevheri, Muhammed Rebi Muhammed, *Akidetuna*, (Kajro: 2000).

**Mufti Naim ef. TËRNAVA**

## **MAN'S NEED FOR RELIGION (II)**

### **Abstract**

Man's need for religion is inborn and it is an inseparable part of him. Historically, this has been the case since the creation of the first man - Adam, and it has accompanied mankind throughout the ages. Despite the intellect that man possesses as the most perfect creature of Allah in this universe, and despite his achievements throughout centuries, religion did not lose its importance. On the contrary. This is because religious teachings came from God, the Almighty, through His messengers, in harmony with man's nature and needs. Due to this, religious teachings, since they have a divine origin, have always given an explanation to the issues that the human mind cannot find a solution to.

**Keywords:** *man, religion, prophets, revelation*

Dr. Sedat ISLAMI

## KURANI SIPAS HADITHEVE PEJGAMBERIKE

### Abstrakt

Ky punim në fokus ka hadithet që flasin për Kuranin nga perspektiva të ndryshme. Qëllimi i tij është që të hedh dritë mbi këto hadithe dhe mësimet që përfitohen nga ato. Punimi mëton t'i zbërthejë këto hadithe, për ta dokumentuar lidhjen që Kurani dhe Suneti kanë ndërmjet vete si dy burime hyjnore. Edhe Suneti, siç dihet, është *vahj*, sepse pejgamberi Muhamed, a.s., nuk ka folur nga hamendja, por nga ajo që i është shpallur prej Zotit të Madhëruar. Rëndësia e punimit qëndron në ofrimin e këtij materiali në një formë më përmbledhëse dhe sipas praktikave në Shkencën e Hadithit Tematik. Punimi ka karakter përshkrues. Për shkak të natyrës së tij, tekstet e haditheve i kemi ofruar edhe në origjinal, duke dokumentuar me këtë rast jo vetëm burimin, por edhe rangun e tyre. Apriori kemi shmangur çdo hadith saktësia e të cilit nuk është konfirmuar. Ndërsa, jemi mjaftuar vetëm me një sërë hadithesh që shërbejnë për qëllimin e punimit tonë, dhe nuk kemi synuar përfshirjen e çdo hadithi që e ka me këtë tematikë. Rezultatet e punimit kanë konfirmuar rëndësinë e hadithit në trajtesat fetare, në përgjithësi, e në përshkrimin e Kuranit dhe të çështjeve që kanë të bëjnë me të, në veçanti. Punimi u rekomandon hulumtuesve që hadithit tematik t'i kushtohet rëndësi dhe hapësirë më e madhe, për shkak të përmbajtjes gjithëpërfshirëse dhe detajeve të tij.

**Fjalët kyçe:** *Kurani, Suneti, hadithi, vahji, pejgamberi Muhamed, feja.*

## Hyrje

Kurani “...është shpallje prej një të Urtit që i meriton të gjitha lavdet.”<sup>1</sup> Ai dallon për vlerat dhe tiparet. Ai është “...Libri në të cilin nuk ka dyshim...”<sup>2</sup>, prandaj është “...udhërrëfyes për të devotshmit.”<sup>3</sup> Ai është libri që Allahu ia shpalli njerëzimit, si referencë të parë dhe absolutisht më të rëndësishmen për çdo gjë, për faktin se përfshin çdo gjë që u duhet.<sup>4</sup> Nga kjo perspektivë, Kurani është mirësi e mëshirë e Allahut me njerëzimin. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي الصُّدُورِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ﴾ ﴿٥٧﴾ قُلْ بِفَضْلِ اللَّهِ وَبِرَحْمَتِهِ فَبِذَلِكَ فَلْيَفْرَحُوا هُوَ خَيْرٌ مِّمَّا يَجْمَعُونَ ﴿٥٨﴾

**“O njerëz, ju ju ka ardhur këshillë (Kurani) prej Zotit tuaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët. Thuaj: “Me dhuntinë e Allahut dhe mëshirën e Tij – vetëm me këto le të gëzohen! Kjo është më e mirë se ajo që grumbullojnë.” (Junus: 57-58)**

Në këto ajete kuranore, Allahu i Madhëruar ua përkujton njerëzve mirësinë e Tij ndaj tyre, duke ua shpallur këtë Kuran, që i largon nga punët e urryera dhe që ua shëron shpirtrat, duke ua flakur dyshimet dhe paqartësitë.<sup>5</sup> Dhuntia e përmendur në ajetin e 58-të ka për qëllim Kuranin, ndërsa mëshira fenë dhe besimin.<sup>6</sup>

Kjo ka bërë që Kurani të ketë pozitë të veçantë në zemrat e besimtarëve. Ai është libri që nuk i gjendet zëvendësues, është libri që lexohet për adhurim e udhëzim, është libri i jetës. Kjo për faktin se është fjalë e

<sup>1</sup> Fussilet: 42.

<sup>2</sup> Bekare: 2.

<sup>3</sup> Bekare: 2.

<sup>4</sup> Nahël: 89; En’amë: 38.

<sup>5</sup> Shih: Ibën Kethir, *Tefsiru el Kur’ani el adhim*, red. shkenc. Hikmet bin Beshir bin Jasir, (Saudi: Dar Ibën El Xhevzi, 1431 h.), 4/405!

<sup>6</sup> Abdurrahman bin Nasir Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman fi tefsiri kelami el Menan*, red. shkenc. Abdurrahman bin Muala El Luvejhak, (Bejrut: Muessesetu Err Rrisale, 2000), f. 366.

Zotit, prandaj nuk krahasohet me asgjë. Pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

إِنَّ فَضْلَ كَلَامِ اللَّهِ عَلَى سَائِرِ الْكَلَامِ كَفَضْلِ اللَّهِ عَلَى خَلْقِهِ

***“Vlera e Fjalës së Allahut ndaj fjalëve tjera vërtet është sikur vlera e Allahut ndaj krijesave të Tij.”<sup>7</sup>***

Rrjedhimisht, Kurani është libri që ka shërbyer edhe shkencërisht më shumë se çdo libër tjetër. Duke filluar nga brezat e parë, vazhdimisht janë shkruar dhe shkruhen libra e punime për Kuranin, e që e trajtojnë atë nga aspekte e perspektiva të ndryshme. Pra, janë shkruar e përkthyer punime edhe në shqip, prej autorëve të dëshmuar e me nam. Nga ajo që kemi parë e shfletuar, nuk është bërë ndonjë trajtesë që në mënyrë ekskluzive i është kushtuar vetëm haditheve që e trajtojnë Kuranin. Kjo na ka shtyrë që t’i qasemi këtij punimi temë e të cilit do të jenë hadithet që flasin për Kuranin. Përanash kësaj, ky punim mëton të hedhë dritë mbi këto hadithe, si dhe mënyrat dhe aspektet se si e kanë trajtuar ato Kuranin.

Kjo mënyrë e trajtimit të kësaj teme bën pjesë në kuadër të Shkencës së Hadithit Tematik, e cila, edhe pse ka ekzistuar si përmbajtje qysh moti, si shkencë më vete, është relativisht e re<sup>8</sup>, prandaj edhe mund të kenë munguar trajtesat e këtilla për Kuranin. Së këndejmi, ky punim mund të jetë ndër trajtesat e para të kësaj natyre, dhe këtu fshihet edhe rëndësia e tij.

<sup>7</sup> Hadithin e shënojnë Tirmidhiu, nr. 2926 dhe të tjerë. Albani dhe të tjerë e kanë klasifikuar si hadith të dobët, ndërsa Ebu Is’hak Huvejni në recensimin e librit të Ibën Kethirit, *Fedail El Kuran*, f. 274, thotë se hadithi, me dëshmitë që ekzistojnë, ngrihet në gradën hasen. Pavarësisht faktit se dijetarët kanë folur për këtë hadith nga aspekti i senedit – vargut të tij të transmetuesve, kuptimi i tij është i saktë. Dëshmi për këtë mund të merret emërtimin që Buhariu ia ka bërë një kapitulli; Kapitulli: Vlera e Kuranit ndaj gjithë librave (باب فضل القرآن على سائر الكلام). Ibën Haxheri, Bedruddin Ajni dhe të tjerë, kur e shpjegojnë këtë kapitull, shprehen se kuptimisht ky titull është përvetësuar nga hadithi që e kemi shënuar ne. Shih: Mahmud bin Ahmed Bedrudin El Ajni, *Umdetu el karij sherhu Sahihi El Buhari*, (Bejrut: Dar ihjai et turath el arabij - Dar El Fikër), 20/37; Ibën Haxher El Askalani, *Fet’hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, (Egjipt: El mektebetu es selefije, 1390 h.), 9/66; Ahmed bin Muhamed Kastalani, *Irshadu es sari li sherhi Sahihi El Buhari*, (Rijad: Dar Ataati El Ilm, 2021), 15/605!

<sup>8</sup> Shih: Letifat Rashid, *El hadith el meuduij: el menhexh ve et te’sil ve et temthil*, (Mekke: Dar Tajjibe El Hadra, 2021), f. 18!

Punimi ka karakter përshkrues dhe shtrihet, megjithëse në formë të përmbledhur, në disa kapituj. Fillimisht trajtohet pozita referenciale e Kuranit, pastaj raporti i tij me Sunetin, rregullat dhe etika e leximit, zbatimi i tij në praktikë dhe, së fundi, ngritja e tij në përfundim të kësaj bote. Ky punim nuk synon t'i përfshijë të gjitha hadithet, pasi një gjë e tillë është e pamundur brenda këtij formati. Megjithatë, ai përzgjedh hadithe përkatëse nga fusha të ndryshme, duke pasur si kriter kryesor përfshirjen vetëm të haditheve të sakta.

Punimi ka dokumentuar rëndësinë e trajtimit tematik të çështjeve që kanë të bëjnë me Kuranin, në veçanti, si dhe temat fetare në përgjithësi, nga perspektiva e Hadithit, për shkak të përmbajtjes së tij detajuese dhe konkretizuese. Për shkak se, siç thamë, trajtesat e këtij formati janë relativisht të reja, punimi ua rekomandon hulumtuesve që Hadithin ta trajtojnë nga kjo perspektivë më shumë, në mënyrë që konceptet fetare të shtjellohen dhe të thjeshtësohen më shumë.

## 1. Koncepti për Kuranin

Kurani është libër që Zoti ia shpalli njerëzimit. Ky (shtë libër që duhet të trajtohet ndryshe, si nga aspekti i kredos, si nga ai i normave, rregullave dhe etikës. Këtë e gjejmë të aluduar në hadithin që na përcillet prej sahabiut i nderuar, Temim Ed Dari, r.a., në të cilin qëndron se Pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

الدِّينُ النَّصِيحَةُ. قُلْنَا: لِمَنْ؟ قَالَ: لِلَّهِ وَلِكِتَابِهِ وَلِرَسُولِهِ وَلِأَيِّمَّةِ الْمُسْلِمِينَ وَعَاقِبَتِهِمْ

*“Feja është këshillë!”*. - *“Për kë?”*, - e pyetëm. *“Tha: “Për Zotin, për librin e Tij, për të Dërguarin e Tij, për prijësit e myslimanëve dhe masën e gjerë të tyre.”*<sup>9</sup>

Shprehja “këshillë” nënkupton përkushtimin e sinqertë dhe korrekt, dhe përmbledhja e tërë fesë në “këshillë” është bërë për shkak të rëndësisë dhe pozitës që ka, mu ashtu siç është thënë për qëndrimin në Arafat, se i tërë haxhi është Arafat, ani pse ka edhe detyrime tjetra në të.

<sup>9</sup> Hadithin e shënon Muslimi, nr. 55.

Përkitazi me singjeritetin karshi Kuranit, dijetarët myslimanë kanë shpjeguar se bëhet fjalë për:

- besimin në të: besimin se është fjalë e Zotit dhe se është shpallur prej Tij, se asgjë nga të folurit e krijesave nuk përngjet me të, se askush prej krijesave nuk ka mundësi të sjell( diç të ngjashme me të;
- vërtetimin e tij dhe bindjen në mësimet e tij;
- leximin ashtu siç e meriton të lexohet, me nder e madhërim, me rregulla, zbukurim zëri, përlulje e meditim;
- veprimin sipas tij dhe largimin nga gjërat që i ka ndaluar ai;
- mbrojtjen e tij nga interpretimet e gabuara dhe tendencioze;
- besimin se dispozitat dhe ligjet e tij janë më të mirat, absolutisht;
- thirrjen e njerëzve në përqafimin e mësimave të tij; etj.<sup>10</sup>
- Pra, siç mund të vërehet, me *këshillën për Kuranin* përfshihet i tërë besimi ynë karshi tij dhe mënyra se si duhet ta trajtojmë në përditshmërinë tonë, si libër që i referohemi për çdo gjë. Detaje të këtij koncepti do t'i gjejmë të shtjelluara në pjesët në vazhdim.

## 2. Kurani, mrekullia kryesore që i është shpallur pejgamberit Muhamed, a.s.

Në hadithet e pejgamberit Muhamed, a.s., mësojmë për Kuranin si mrekulli kryesore që i është dhënë atij. Siç dihet, pejgamberët përkrahen me mrekulli që të provon dhe dëshmon misionin e tyre. Disa pejgamberë kanë pasur mrekulli lëndore, sikurse ishin: Musai, a.s., Isa, a.s., etj., ndër- sa Muhamedi, a.s., krahas atyre lëndore, ka pasur edhe mrekullinë e mrekullive, Kuranin fisnik.

<sup>10</sup> Shih: Jahja bin Sheref En Nevevi, *El minhaxh sherhu Sahihi Muslimi bin el Haxhaxh*, (Bejrut: Dar ihjai et turath el arabij, ed. 2, 1392 h.), 2/37-38; Bedrudin El Ajni, *Umde- tu el karij sherhu Sahihi El Buhari*, vep. cit., 1/322; Ibën Dekik El Idî, *Sherhu el erbei- ne En Nevevije*, (Muessesetu Err Rrejjan, ed. 6, 2003), f. 50-51; Halil Ahmed Saharenfuri, *Bedhlu el mexhud fi hali Suneni Ebi Davud*, (Indi: Qendra Hoxha Ebu El Hasen En Nedvi për Hulumtime dhe Studime Islame, 2006), 13/346; Muhamed bin Salih El Uthejmin, *Sherhu el erbeine En Nevevije*, (Dar Thurejija), f. 116-117!

مَا مِنَ الْأَنْبِيَاءِ نَبِيٍّ إِلَّا أُعْطِيَ مَا مِثْلُهُ آمَنَ عَلَيْهِ الْبَشَرُ، وَإِنَّمَا كَانَ الَّذِي أُوتِيتُ وَحْيًا  
أَوْحَاهُ اللَّهُ إِلَيَّ، فَأَرْجُو أَنْ أَكُونَ أَكْثَرَهُمْ تَابِعًا يَوْمَ الْقِيَامَةِ

*“Nuk ka pejgamber që nuk i janë dhënë mrekulli (mjaftueshëm), që njerëzit ta besojnë. Kjo që më është dhënë mua është shpallje (Kuran) që Allahu ma ka shpallur, kështu që kam shpresë se në Ditën e Llogarisë do të jam pejgamberi me më së shumti pasues.”<sup>11</sup>*

Ajo që e bën Kuranin të dallojë nga mrekullitë e tjera, nga ato lëndore më saktë, qëndron fakti se “mrekullitë e mëhershme ishin lëndore dhe shiheshin me sy, siç ishin, për shembull: deveja e pejgamberit Salih, a.s., shkopi i pejgamberit Musa, a.s., ndërsa mrekullia e Kuranit shihet me syrin e argumentit dhe dëshmisë (ar. *el besireh*). Kështu që, ata që e pasojnë, po për këtë arsye janë më shumë, sepse ajo që shihet me syrin e kokës mbaron me mbarimin e shikimit, ndërsa ajo që shihet me syrin e mendjes mbetet dhe shihet vazhdimisht prej të gjithë atyre që vijnë pas shikimit.”<sup>12</sup>

Se Kurani është mrekulli e jashtëzakonshme flet edhe fakti se ai nuk është mrekullia e vetme që i është dhënë pejgamberit Muhamed, a.s., por se është mrekullia më madhështore me të cilën ai është veçuar prej të tjerëve. Përndryshe, pejgamberi Muhamed, a.s., ka pasur edhe shumë mrekulli të tjera.<sup>13</sup>

### 3. Pozita e sunetit në raport me Kuranin

Kurani dhe Suneti kanë një lidhje të pashkëputur ndërmjet tyre. Në Kuranin famëmadh aludohet për këtë lidhje. Për shembull, në kaptinën Nisa, Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَأَنْزَلَ اللَّهُ عَلَيْكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَعَلَّمَكَ مَا لَمْ تَكُنْ تَعْلَمُ﴾

*“...Allahu ta shpalli ty Librin (Kuranin) dhe Urtësinë e plotë, si dhe ta mësoi atë që nuk e ke ditur....” (Nisa: 113)*

<sup>11</sup> Buhariu, nr. 4981; Muslimi, nr. 152.

<sup>12</sup> Ibën Haxher El Askalani, *Fet'hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari*, vep. cit., 9/7.

<sup>13</sup> Po aty, 9/6.

Abdurrahman bin Nasir Es Sadi citon brezat e parë, të cilët kanë thënë se, me fjalën “urtësi” synohet Suneti që i shpallet sikurse Kurani.<sup>14</sup> Kjo lloj shpalljeje mund të jetë drejtpërdrejt prej Allahut të madhëruar, po mund të jetë edhe si rezultat i ixhtihadit të Pejgamberit, a.s., të cilin Zoti nuk e lë të gabojë kurrë.<sup>15</sup>

Prandaj, çdo përpjekje për ta shmangur njërin prej këtyre burimeve është gabim i madh. Pejgamberi, a.s., ka thënë:

أَلَا هَلْ عَسَىٰ رَجُلٌ يَلْعَنُ الْحَدِيثَ عَنِّي وَهُوَ مُتَكَيِّ عَلَىٰ أُرِيكَتِهِ ، فَيَقُولُ: بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ كِتَابُ اللَّهِ، فَمَا وَجَدْنَا فِيهِ حَلَالًا اسْتَخْلَلْنَاهُ، وَمَا وَجَدْنَا فِيهِ حَرَامًا حَرَّمْنَاهُ، وَإِنَّ مَا حَرَّمَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ كَمَا حَرَّمَ اللَّهُ

*“Nuk është larg koha kur njeriut do t’i përcillet hadithi prej meje, ndërsa ai, duke qenë i shtrirë në divanin a shilten e tij, do të thotë: ndërmjet nesh dhe jush është libri i Zotit; atë që e gjejmë hallall në të, e konsiderojmë hallall, e atë që e gjejmë haram, e konsiderojmë haram. Vini re, atë që e ndalon i Dërguari i Allahut, ajo është sikur ta ndalojë Vetë Allahu!”*<sup>16</sup>

Se Suneti ka këtë pozitë mësojmë edhe nga një version tjetër i këtij hadithi, në të cilin figuron dhe kjo shtesë:

أَلَا إِلَيَّ أُوتِيَتْ الْكِتَابُ وَمِثْلُهُ مَعَهُ

*“Shihni, mua më është dhënë Libri dhe i ngjashmi me të!...”*<sup>17</sup>

Me “Libër” synohet Kurani, ndërsa me “i ngjashmi” me Kuranin synohet të jetë hadithi apo Suneti.<sup>18</sup>

<sup>14</sup> Abdurrahman bin Nasir Es Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman fi tefsiri kelamu El Mennan*, vep. cit., f. 200. Shih këtë aludim edhe në ajetin e 164-të nga kaptina Ali Imran; në ajetin e 2-të nga kaptina Xhumuah; në ajetin e 7-të nga kaptina Hashër dhe në ajetin e 157-të nga kaptina Arafë!

<sup>15</sup> Shih: Abdulmehdi bin Abdulkadir Abdulhadi, *Es Sunetu en nebevijeh: mekanetuha, avamilu bekaiha, tedvinuha*, (Kajro: Dar El Itisam, 1989), f. 24; 58!

<sup>16</sup> Hadith i saktë. Shih: *Sahihu Et Tirmidhij*, nr. 2664!

<sup>17</sup> Hadith i saktë. Shih: *Sahihu Ebi Davud*, nr. 4604!

<sup>18</sup> Halil Ahmed Saharenfuri, *Bedhlu el mexhud fi hali Suneni Ebi Davud*, vep. cit., 13/14.

Për Kuranin dhe pozitën e tij referenciale në fe, si dhe raportin e tij me Sunetin, mësojmë dhe nga hadithi në vazhdim. Hudhejfe bin Jemani, r.a., përcjell se pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

أَنَّ الْأَمَانَةَ نَزَلَتْ مِنَ السَّمَاءِ فِي جَذْرِ قُلُوبِ الرِّجَالِ ، وَنَزَلَ الْقُرْآنُ فَفَرَّوْهُ الْقُرْآنَ ، وَعَلِمُوا مِنَ السُّنَّةِ

*“Amaneti ka zbritur nga qielli fillimisht në rrënjët e zemrave të burrave (besimtarëve). Më pas zbriti Kurani dhe njerëzit e lexuan atë (mësuan prej tij për detyrimin e këtij amaneti) dhe mësuan gjithashtu nga Suneti (detajet e tij).”<sup>19</sup>*

Sipas shpjegimeve të dijetarëve, me *amanet* është për qëllim amaneti i ngarkimit me përgjegjësinë e organizimit të jetës dhe rendit në Tokë, siç qëndron në Kuran:

﴿إِنَّا عَرَضْنَا الْأَمَانَةَ عَلَى السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَالْجِبَالِ فَأَبَيْنَ أَنْ يَحْمِلْنَهَا وَأَشْفَقْنَ مِنْهَا وَحَمَلَهَا الْإِنْسَانُ﴾

***“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi...”*** (Ahzabë: 72)

Amaneti nënkupton fenë, Sheriatin, detyrimet fetare. Ky amanet fillimisht ka qenë i vendosur në zemrat e njerëzve, pra ka qenë natyrshmëri, sepse zemrat janë krijuar me këtë tiparin e bartjes së kësaj përgjegjësie, e pastaj nga Kurani dhe Suneti besimtarët e kanë mësuar obligimin dhe detyrimin për ta çuar në vend këtë përgjegjësi. Nga Kurani e kanë mësuar detyrimin, ndërsa nga Suneti detajet dhe mënyrën e zbatimit dhe të përmbushjes së këtij detyrimi.<sup>20</sup>

<sup>19</sup> Buhariu, nr. 7276; Muslimi, nr. 143.

<sup>20</sup> Shih: Muhamed El Emin El Hererij, *El Keukeb el vehhaxh ve err rreudu el behhaxh fi sherhi Sahihi Muslimi bin El Haxhaxh*, (Xhidde: Dar El Minhaxh – Dar Tuk En Nexhat, 2009), 4/27; Abdulaziz bin Abdullah Err Rraxhihi, *Teufiku Err Rrabbi el Mun'im bi sherhi Sahihi Muslim*, (Rijad: Merkez Abdulaziz bin Abdullah Err Rraxhihi, 2018), 1/262; Muhamed bin Jusuf Shemsudin Kermani, *El Keukeb ed derari fi sherhi Sahihi El Buhari*, (Bejrut: Dar Ihjai Et Turath El Arabij, ed. 2, 1981), 25/32; Muhamed El

Për ne, në kontekstin e trajtesës që po ia bëjmë Kuranit, rëndësi ka ky raporti që ekziston ndërmjet Kuranit, si burim i parë dhe kryesor, dhe Sunetit, si burim shpjegues dhe detajues.

#### 4. Vlera e Kuranit dhe vlera e leximit dhe e studimit të tij

Në hadithe vlera e Kuranit dhe vlera e leximit dhe e studimit të tij trajtohet nga aspekte të ndryshme.

##### 4.1. Vlera dhe pozita e Kuranit

Përkitazi me vlerën e Kuranit dhe pozitën e pakrahasueshme të tij, pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

إِنَّ فَضْلَ كَلَامِ اللَّهِ عَلَى سَائِرِ الْكَلَامِ كَفَضْلِ اللَّهِ عَلَى خَلْقِهِ

“Vlera e Fjalës së Allahut ndaj fjalëve tjera vërtet se është sikur vlera e Allahut ndaj krijesave të Tij.”<sup>21</sup> Pra, ashtu siç nuk mund të krahasohet askush me Zotin, nuk mund të krahasohet po kështu as të folurit e askujt me të Folurit e Tij – Kuranin.

##### 4.2. Vlera dhe shpërblimi për leximin e Kuranit

Duke lexuar Kuranin, besimtari fiton shpërblime të mëdha. Këtë shpërblim e ka konkretizuar pejgamberi Muhamed, a.s., në një nga hadithet e tij, në të cilin ka thënë:

مَنْ قَرَأَ حَرْفًا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ فَلَهُ بِهِ حَسَنَةٌ وَالحَسَنَةُ بِعَشْرِ أَمْثَالِهَا لَا أَقُولُ: (الْم)  
حَرْفٌ وَلَكِنْ أَلِفٌ حَرْفٌ وَلَا مٌ حَرْفٌ وَمِمْ حَرْفٌ

*“Kush e lexon një germë nga Libri i Allahut, për të e ka një të mirë, dhe një e mirë shpërblehet me dhjetë sosh. Nuk po them Elif,*

---

Emin El Hererij, *Sherhu Sunen Ibën Maxheh*, (Xhidde: Dar El Minhaxh, 2018), 24/291!

<sup>21</sup> Shih ekstraktin e hadithit dhe vlerësimin përkatës në Hyrje!

*Lam, Mim është një germë, por Elif germë, Lam germë dhe Mim germë.*<sup>22</sup>

Ky shpërblim vlerësohet dyfish kur lexuesi gjen vështirësi. Pra, kur ka vështirësi në lexim por megjithatë nuk heq dorë. Pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

وَالَّذِي يَقْرَأُ الْقُرْآنَ وَيَتَتَعْتَعُ فِيهِ، وَهُوَ عَلَيْهِ شَاقٌّ، لَهُ أَجْرَانِ

*“...e ai që e lexon Kuranin duke belbëzuar dhe duke i ardhur vështirë, i ka dy shpërblime.”*<sup>23</sup>

Imam Neveviu duke e shpjeguar këtë hadith, thotë se ky është njeriu që nuk e ka zotëruar hifzin apo memorizimin e Kuranit, dhe që nuk di të lexojë mirë. Pra, i tilli i ka dy shpërblime: të parin për leximin, dhe të dytin për vështirësinë që gjen gjatë leximit.<sup>24</sup>

### 4.3. Vlera dhe rëndësia e studimit të Kuranit (Ngjitja në majat e fetarisë dhe vlerave nëpërmjet Kuranit)

E nëse puna është kështu, atëherë nuk duhet të çuditemi pse mësimi të Kuranit i kushtohet rëndësi e madhe. Pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

خَيْرُكُمْ مَنْ تَعَلَّمَ الْقُرْآنَ وَعَلَّمَهُ

*“Më i miri ndër ju është ai që e mëson Kuranin për vete dhe atë ua mëson të tjerëve.”*<sup>25</sup>

Pra, besimtari më i mirë na qenkësh ai që e mëson Kuranin për vete, dhe pastaj atë ua mëson të tjerëve. E, arsyeja pse është kështu qëndron në llojin e veprës që paraqet mësimi fillimisht, e pastaj mësimi i vetë Kuranit, që është vepër e dalluar. Mësimi është vepër me shpërblim rrjedhës, e

<sup>22</sup> Tirmidhiu, nr. 2910. Hadith i saktë. Shih: *Sahih El Xhami*, nr. 6469.

<sup>23</sup> Buhariu, nr. 4937; Muslimi, nr. 798.

<sup>24</sup> Neveviu, *El Minhaxh sherhu Sahihi Muslimi bin El Haxhaxh*, vep. cit., 6/85.

<sup>25</sup> Buhariu, nr. 5027.

mësimi i Kuranit është mësimi i dijes së dobishme nga e cila pa dyshim se përfitohet në ahiret.<sup>26</sup>

Për vlerën dhe rëndësinë e studimit të Kuranit mësojmë edhe në një hadith tjetër. Në fakt, mësojmë një detaj të rëndësishëm që ka të bëjë me reflektimin shpirtëror dhe psikik të mësimi të Kuranit. Pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

وَمَا اجْتَمَعَ قَوْمٌ فِي بَيْتٍ مِنْ بُيُوتِ اللَّهِ، يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ، وَيَتَدَارَسُونَهُ بَيْنَهُمْ؛  
إِلَّا نَزَلَتْ عَلَيْهِمُ السَّكِينَةُ، وَغَشِيَتْهُمْ الرَّحْمَةُ، وَحَفَّتْهُمُ الْمَلَائِكَةُ، وَذَكَرَهُمُ اللَّهُ  
فِي مَنْ عِنْدَهُ

**“...dhe nuk ndodh të tubohet një grup (besimtarësh) në ndonjë xhami për ta lexuar Kuranin dhe për ta studiuar bashkërisht, e që mos t’u zbresë sekineja, mos t’i mbulojë mëshira, mos të rrethohen prej engjëjve dhe mos t’i përmend Zoti tek ata (engjëjt) që janë tek Ai...”**<sup>27</sup>

Në hadith përmendet “sekineja”, që sipas interpretimeve kuptimin bazë dhe parësor e ka qetësinë shpirtërore, rehatinë dhe prehjen shpirtërore, pastërtinë dhe dëlirësinë shpirtërore, ndriçimin shpirtëror,<sup>28</sup> pra, të kundrën e stresit, frikës, ankthit, ngarkesës shpirtërore që orienton njerëzit.

Për shkak të kësaj vlere të jashtëzakonshme, në hadithe mësojmë se lejohet zilia ndaj atyre që Zoti i ka begatuar me këtë mirësi, dhe kjo është

<sup>26</sup> Pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë: “Kur vdes njeriu, i ndërpritet shpërblimi nga punët që ka bërë, përveç në tre raste: ...dituria nga e cila kihet dobi...”. Muslimi, nr. 1631. Shih po kështu hadithin: “Luteni Allahun për dije të dobishme!...” Hadith hasen. *Sahihu Suneni Ibën Maxheh*, nr. 3114.

<sup>27</sup> Muslimi, nr. 2699.

<sup>28</sup> Shih: Muhamed bin Ismail bin Salah Es San’ani, *Et Tenviru sherhu El Xhami Es Sagir*, red. shkenc. Muhammed Is’hak Muhammed Ibrahim, (Rijad: Mektebetu Dari Es Selam, 2011), 9/326; Ahmed bin Omer El Kurtubi, *El Muhfim lima ushkile min telhisi kitabi Muslim*, (Damask – Bejrut: Dar Ibën Kethir; Damask – Bejrut: Dar El Kelim Et Tajjib, 1996), 6/587; Fadlullah bin Hasen Turibishti, *El mujesser fi sherhi Mesabihi Es Sunneh*, red. shkenc. Dr. Abdulhamid Hindavi, (Mektebetu Nezzar Mustafa El Baz, ed. 2, 2008), 1/100; Abdulhak Dihlevi, *Lemeatu et tenkih fi sherhi Mishkati el mesa-bih*, red. shkenc. Prof. Dr. Tekijudin Nedvi, (Damask: Dar En Nevadir, 2014), 1/533.

njëra nga dy format kur ndalesa për zilinë bën përjashtim. Në hadith qëndron:

لَا حَسَدَ إِلَّا فِي اثْنَتَيْنِ رَجُلٌ آتَاهُ اللَّهُ الْقُرْآنَ فَهُوَ يَتْلُوهُ آتَاءَ اللَّيْلِ وَآتَاءَ النَّهَارِ  
وَرَجُلٌ آتَاهُ اللَّهُ مَالًا فَهُوَ يُنْفِقُهُ آتَاءَ اللَّيْلِ وَآتَاءَ النَّهَارِ

**“Zilia lejohet vetëm në dy raste: ndaj njeriut që Zoti ia ka dhënë Kuranin, të cilin ai e lexon gjatë (orëve të) ditës e gjatë (orëve të) natës, dhe njeriut që Zoti i ka dhënë pasuri, ndërsa ai e shpenzon atë për hir të Tij gjatë (orëve të) ditës e gjatë (orëve të) natës.”<sup>29</sup>**

#### 4.4. Mirësitë e Kuranit në botën tjetër

Kurani ndërmjetëson për lexuesin e vet. Ebu Uname, r.a., transmeton ta ketë dëgjuar Pejgamberin, a.s., duke thënë:

اَقْرَأُوا الْقُرْآنَ؛ فَإِنَّهُ يَأْتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ شَفِيعًا لِأَصْحَابِهِ

**“Lexojeni Kuranin, sepse në Ditën e Kiametit ai vjen ndërmjetësues për lexuesit e vet!”<sup>30</sup>**

Kurani, si në kuptim të dijes që shkëmbehet dhe bartet nga brezi në brez, si në kuptim të librit (mus’hafit) që lihet trashëgimi, është vepër me shpërblim rrjedhës edhe pas vdekjes.<sup>31</sup> Këtu mbase qëndron arseja pse në hadithe llogaritet vepër që na ruhet e deponohet në botën tjetër.

عَلَيْكَ بِتِلَاوَةِ الْقُرْآنِ، فَإِنَّهُ نَوْرٌ لَكَ فِي الْأَرْضِ، وَذُخْرٌ لَكَ فِي السَّمَاءِ

**“Lexoje Kuranin, sepse është dritë në Tokë dhe zahire në qiell!”<sup>32</sup>**

Kurani e nderon lexuesin dhe hafëzin edhe në Xhenet. Hafëzit do t’i thuhet që të lexojë Kuran dhe të ngjitet në pozita. Ai do të ndalet në këtë gradim vetëm atëherë kur të ndalet nga leximi, pra në ajetin e fundit që e lexon.<sup>33</sup>

<sup>29</sup> Buhariu, nr. 7091; Muslimi, nr. 815!

<sup>30</sup> Muslimi, nr. 804.

<sup>31</sup> Shih: *Sahihu Ibën Maxheh*, nr. 200. Hadithi është hasen!

<sup>32</sup> Hadith hasen. Shih: *Sahihu Et Tergib*, 1422!

<sup>33</sup> Hadith hasen sahih. Shih: *Sahihu Ebi Davud*, nr. 1300!

## 5. Përkujdesja për memorizimin e kuranit

Memorizimi i Kuranit është, krahas mirësisë, edhe sfidë më vete. Ebu Musa Eshariu transmeton se Pejgamberi, a.s., ka thënë:

تَعَاهَدُوا هَذَا الْقُرْآنَ، فَوَالَّذِي نَفْسُ مُحَمَّدٍ بِيَدِهِ هُوَ أَشَدُّ تَفَلُّتًا مِنَ الْإِبْلِ فِي عُمْلِهَا

*“Përkushtojuni Kuranit (lexojeni dhe përsëriteni atë vazhdimisht) se, për Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, më shpejt ikën ai se deveja që ikën nga litari lidhës i saj!”<sup>34</sup>*

Pra, atë që e kemi memorizuar, duhet ta përsërisim, veçmas në namaz nate, në mënyrë që mos ta harrojmë. Përndryshe, harrimi i pjesëve kur-anore është fatkeqësi. Selefi kanë diskutuar për çështjen e atij që e harron Kuranin. Disa kanë thënë se është mëkat i madh. Dahhak bin Muzahimi ka thënë se nuk ka njeri që e ka mësuar Kuranin dhe e ka harruar më pas atë, e që këtë mos ta ketë bërë për shkak të ndonjë mëkati që ka bërë, sepse Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَمَا أَصَابَكُمْ مِّنْ مُّصِيبَةٍ فِيمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ﴾

*“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë...” (Shura, 30)*

Ibën Haxheri thotë: “Harrimi i Kuranit është nga fatkeqësitë më të mëdha.”<sup>35</sup>

Dijetarët myslimanë kanë diskutuar rreth çështjes së harrimit të Kuranit. Disa kanë thënë se nëse harrimi është si shkak i shpërfilljes dhe mosinteresimit për Kuranin, është mëkat i madh, ndërsa të tjerë kanë thënë se kur harresa ndodh për shkaqe të tjera, e konsiderojnë mëkat. E disa, sikur Ima-mi Ibën Haxheri, Allahu i mëshiroftë të gjithë, thonë se është fatkeqësi.<sup>36</sup>

<sup>34</sup> Buhariu, nr. 5033; Muslimi, nr. 791.

<sup>35</sup> Ibën Haxher El Askalani, *Fet’h El Bari bi sherhi El Buhari*, vep. cit., 9/86.

<sup>36</sup> Për më shumë shih: <https://islamqa.info/ar/answers/127485!>

## 6. Vlera e lexuesit, e mësuesit dhe e hafizit të Kuranit

Në tekstet pejgamberike gjejmë vlerësime të çmuara për ata që angazhohen për Kuranin, qoftë në kuptim të mësimit për vetveten, qoftë për t'ua mësuar të tjerëve. Ne pamë më parë se si duke e mësuar Kuranin për vete dhe duke ua mësuar të tjerëve arrhet në gradën e besimtarëve më të mirë. Në hadithe të tjera na tregohet se ky angazhim e lartëson edhe më shumë besimtarin. E lartëson në shoqëri të engjëjve. Pejgamberi, a.s., ka thënë:

مَثَلُ الَّذِي يَتْلُو الْقُرْآنَ وَهُوَ حَافِظٌ لَهُ، مَعَ السَّفَرَةِ الْكِرَامِ الْبَرَّةِ

*“Ai që e lexon Kuranin duke qenë hafëz i tij, do të jetë me engjëjt shkruar, të ndershëm dhe të drejtë.”<sup>37</sup>*

Kjo tregon për pozitën e lartë që ka ky besimtar, dhe se ai do të jetë me këta engjëj. Ai do të përmendët tek engjëjt e dalluar të Zotit. Në versionin tjetër të hadithit, të shënuar në Sahihun e Muslimit, qëndron:

الْمَاهِرُ بِالْقُرْآنِ مَعَ السَّفَرَةِ الْكِرَامِ الْبَرَّةِ

*“Lexuesi i shkathtë i Kuranit do të jetë me engjëjt shkruar, të ndershëm dhe të drejtë...”*

Pra, ai që e zotëron mjeshtërisht leximin, do të ketë këtë shpërblim dhe këtë gradë të lartë.

Për pozitën dhe gradën e lartë të lexuesit dhe hifzit të Kuranit aludohet edhe në këtë hadith:

لَوْ كَانَ الْقُرْآنُ فِي إِهَابٍ مَا أَكَلَتْهُ النَّارُ

*“Po të ishte Kurani në një lëkurë, nuk do ta digjte zjarri.”<sup>38</sup>* *Ihab* është lëkura e paregjur, e cila është nënvizuar në këtë hadith, për shkak të mundësisë së djegies shpejtë. Pra, edhe po të ishte Kurani në këtë lloj lëkure, nuk do të digjej. Siç kanë përmendur disa shpjegues, për qëllim është besimtari që e ka mësuar Kuranin, që e ka brenda vetes së tij. Kështu, lëkura është përmendur në mënyrë figurative, ndërsa për qëllim është besimtari.<sup>39</sup> Imam Ahmedi, duke iu referuar këtij hadithi, ka thënë: “Ka

<sup>37</sup> Buhariu, nr. 4937; Muslimi, nr. 798.

<sup>38</sup> Hadith hasen. Shih: *Sahih El Xhami*, nr. 5282!

<sup>39</sup> Shih: San'ani, *Et tenviru sherhu El Xhami Es Sagir*, vep. cit., 9/162.

shpresë se atë që ka Kuran brenda zemrës, nuk do ta djegë zjarri i Xhehenemit.”<sup>40</sup>.

Te këta besimtarë kjo mjafton si vlerësim, veçmas për hafëzin e Kuranit, që respektimi i tij është konsideruar madhërim për Allahun. Pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

إِنَّ مِنْ إِجْلَالِ اللَّهِ إِكْرَامَ ذِي الشَّيْبَةِ الْمُسْلِمِ، وَحَامِلِ الْقُرْآنِ غَيْرِ الْغَالِي فِيهِ وَالْجَائِي عَنْهُ، وَإِكْرَامَ ذِي السُّلْطَانِ الْمَقْسُوطِ

*“Madhërim për Allahun konsiderohet nderimi i myslimanit të thinjur (moshuar), hafëzit të Kuranit që nuk i tejkalon kufijtë me të, por as nuk e shpërfill atë (Kuranin<sup>41</sup>), dhe nderimi i prijësit të drejtë.”<sup>42</sup>*

Si mos ta kenë këtë pozitë, kur janë evlija të Zotit?! Pejgamberi Muhamed, a.s., ka thënë:

أَهْلُ الْقُرْآنِ هُمْ أَهْلُ اللَّهِ وَخَاصَّتُهُ

*“Ithtarët e Kuranit janë evlijatë e Zotit, të dashurit dhe të veçuarit e Tij!”<sup>43</sup>*

Me “ithtarë të Kuranit” për qëllim janë hafëzët, ata që e lexojnë gjatë ditës dhe natës, dhe që veprojnë sipas tij.

<sup>40</sup> Muhamed bin Muflih, *El adab esh sher'ijeh ve el mineh el mer'ijeh*. (Bejrut: Alem El Kutub, p.v.b.), 2/33.

<sup>41</sup> Pra, i ikën ekstremeve dhe e ndjek rrugën mesatare.

<sup>42</sup> Hadith hasen. Shih: *Sahihu Ebi Davud*, nr. 4843!

<sup>43</sup> Hadith i saktë. Shih: *Sahihu Et Tergib*, nr. 1432!

## 7. Rregullat dhe etika e leximit

Derisa i shfletojmë hadithet për Kuranin, gjejmë mësimë që vërtet kanë vlerë të veçantë.

### 7.1. Mësimi i Kuranit prej mësuesve kompetentë

Pejgamberi, a.s., ka thënë:

حُلُّوا الْقُرْآنَ مِنْ أَرْبَعَةٍ مِنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ، وَسَلَامٍ، وَمُعَاذِ بْنِ جَبَلٍ، وَأُبَيِّ بْنِ كَعْبٍ

*“Merreni (mësojeni) Kuranin prej katër personave: Abdullah bin Mesudit, Salimit, Muadh bin Xhebelit dhe Ubej bin Kabit!”<sup>44</sup>*

Ky mësim ka të bëjë me leximin, po edhe kuptimet e tij. Pra, detyrë jona mbetet që mësimin e Kuranit ta marrim prej njerëzve kompetentë, të dëshmuar e me kualifikime përkatëse. Se duhet pasur mësues, si dëshmi mund ta marrim edhe fatin se ai, a.s., çdo vit e studionte atë me engjëllin Xhibril, në Ramazan.

### 7.2. Zbukurimi i zërit gjatë leximit

Kur lexohet Kurani, është etikë që të zbukurohet zëri. Ebu Lubabe Beshir bin Abdul Mundhiri, r.a., përcjell se Pejgamberi, a.s., ka thënë:

لَيْسَ مِنَّا مَنْ لَمْ يَتَعَنَّ بِالْقُرْآنِ

*“Nuk është prej nesh ai që nuk e zbukuron zërin gjatë këndimit të Kuranit.”<sup>45</sup>*

Po kështu ka thënë:

زَيِّنُوا الْقُرْآنَ بِأَصْوَاتِكُمْ؛ فَإِنَّ الصَّوْتَ الْحَسَنَ يَزِيدُ الْقُرْآنَ حُسْنًا

*“Zbukurojeni Kuranin me zërat tuaj, sepse zëri i bukur Kuranit ia shton hijeshinë!”<sup>46</sup>*

Mirëpo, ky zbukurim nuk nënkupton daljen jashtë rregullave, dhe veçmas leximin që nuk i shërben qëllimit. Më qartë, Ibën Omeri, r.a., tra-

<sup>44</sup> Buhariu, nr. 4999; Muslimi, nr. 2464.

<sup>45</sup> Buhariu, nr. 7527.

<sup>46</sup> Hadith i saktë. Shih: *Sahih El Xhami*, nr. 2202!

nsmeton se Pejgamberi, a.s., qe pyetur se kush është njeriu që e lexon Kuranin me zërin më melodik, dhe ai kishte thënë:

مَنْ إِذَا سَمِعْتَ قِرَاءَتَهُ رَأَيْتَ أَنَّهُ يَخْشَى اللَّهَ عَزَّ وَجَلَّ

*“Është ai që kur ta dëgjosh leximin e tij, e sheh se ia ka frikën Allahut të lartmadhëruar.”<sup>47</sup>*

Pra, qëllimi i leximit është këshillimi, e nëse zbukurimi i zërit nuk i shërben këtij qëllimi, atëherë ai nuk preferohet.

### 7.3. Meditimi i Kuranit

Ky është leximi i vërtetë i Kuranit, leximi i duhur, leximi produktiv. Përndryshe, leximi i shpejtë, nga i cili nuk përfitohet, nuk është leximi që ne e duam. Madje, Pejgamberi ynë, a.s., ka paralajmëruar për këtë lloj leximi, duke ofruar një shembull ilustrues interesant. Ai, a.s., thënë:

سَيُخْرِجُ أَقْوَامٌ مِنْ أُمَّتِي يَشْرُونَ الْقُرْآنَ كَشُرْبِهِمُ اللَّبَنَ

*“Në umetin tim do të dalë (vijë) një grup që do ta pinë Kuranin siç e pinë qumështin.”<sup>48</sup>*

Qëllimi me fjalët “do ta pinë Kuranin” është: do ta lexojnë pa i mediatuar kuptimet e tij dhe pa i shqyrtuar e analizuar normat e tij. Shprehjet kuranore do të rrëshqasin në gjuhët e tyre siç rrjedh qumështi i pirë. Kjo “rrjedhshmëri” është në kontekst përbuzjeje për ta.

Leximi me studim e meditim preferohet edhe në Ramazan, edhe pse dijetarët, duke marrë parasysh natyrën e këtij muaji, e kanë lejuar leximin e shumtë dhe të shpejtë të Kuranit, siç do të përmendim në pikën në vazhdim. Ajo që na intereson këtu është që, duke marrë shkas praktikën e Xhibrilit me Pejgamberin tonë, paqja qoftë mbi të dy, që në Ramazan, respektivisht në çdo natë të tij ta lexonin (nga memoria) bashkë atë që i qe shpallur nga Kurani,<sup>49</sup> pra, gjatë këtij muaji të lexohet sa më shumë Kuran.

<sup>47</sup> Hadith i saktë. Shih: *Sahih El Xhami*, nr. 3581!

<sup>48</sup> Hadith hasen. *Sahih El Xhami*, nr. 3653.

<sup>49</sup> Buhariu, nr. 3220; Muslimi, nr. 2308.

#### 7.4. Leximi jo i shpejtë i Kuranit

Kurani lexohet për të marrë mësimë e këshilla prej tij. Kjo natyrshëm parasheh që leximi mos të bëhet shpejt. Shpërblimi i përmendur për leximin e Kuranit nuk duhet ta shtyjë besimtarin që të provojë të lexojë sa më shumë, e pastaj t'i ikën qëllimi i vërtetë nga leximi – kuptimi i Kuranit. Pejgamberi, a.s., siç përcillet prej Ummu Selemes, r.a., e lexonte Kuranin ngadalë, duke e ndarë në ajete. Pra, lexonte një ajet, dhe ndalej, për të vazhduar më pas me tjetrin.<sup>50</sup> Abdullah bin Amri, r.a., ishte këshilluar prej Pejgamberit, a.s., që Kuranin ta bënte hatme brenda një muaji. Ai kishte kërkuar edhe më shumë, pra të shkurtohej koha, ta lexonte në një periudhë më të shkurtër. Pejgamberi, a.s., i kishte thënë:

فَافْرَأْهُ فِي سَبْعٍ وَلَا تَزِدْ عَلَى ذَلِكَ

*“Lexoje brenda shtatë ditëve, dhe mos kërko më shkurt se kaq!”<sup>51</sup>*

Kjo është periudha që pëlqehet, përndryshe janë përmendur edhe periudha të tjera. Periudha prej tre ditësh është përmendur si limiti kohor i fundit që duhet zbatuar në rrethana normale. Pejgamberi, a.s., ka thënë:

لَا يَفْقَهُ مَنْ قَرَأَ الْقُرْآنَ فِي أَقَلِّ مِنْ ثَلَاثٍ

*“Nuk e kupton Kuranin ai që e lexon atë në më pak se tri ditë.”<sup>52</sup>*

Kështu kanë vepruar sahabët.<sup>53</sup> Abdullah bin Mesudi, r.a., ka thënë: “Lexojeni Kuranin të tërin brenda shtatë ditëve, e (nëse dëshironi më shpejt, atëherë) mos e lexoni në më pak se tri ditë!”<sup>54</sup>

Kjo sa i përket ditëve të rëndomta, përndryshe, në kohë dhe vende me vlerë të shtuar, sikurse, për shembull, në Ramazan, në Mekë, lejohet edhe në më pak se tri ditë. Ibën Rexhebi ka thënë: “Ndalesa për ta lexuar Kuranin në më pak se tri ditë është kur bëhet praktikë e rutinë, përndryshe, në kohë të vlerësuar, sikurse muaji Ramazan, e veçmas në netët në të cilat

<sup>50</sup> Shih: *Sahihu Ebi Davud*, nr. 4001.

<sup>51</sup> Buhariu, nr. 1978; Muslimi, 1159.

<sup>52</sup> Hadith i saktë. Shih: *Sahihu Ebi Davud*, nr. 1394.

<sup>53</sup> Shih: Ebu Amër Ed Dani, *El Bejan fi addi aji El Kuran*, (Kuvajt: Merkez el mahtutat ve et turath, 1994), f. 322.

<sup>54</sup> Ibën Haxheri, *Fet'h El Bari*, vep. cit., 9/78.

kërkohet Nata e Kadrit, apo në vende të çmuara, si Meka, ai që e viziton dhe nuk është prej banorëve të saj, në këto kohë dhe vende preferohet të lexohet sa më shumë Kuran, për ta shfrytëzuar kohën dhe vendin. Ky është mendimi i Ahmedit, Is'hakut dhe i imamëve tjerë. Për këtë dëshmon edhe praktika e dijetarëve të tjerë, siç u përmend më parë.”<sup>55</sup>

### 7.5. Leximi për hir të Zotit, jo për qëllime materiale

Kurani është libër misioni i të cilit është udhëzues dhe orientues. Ai nuk mund zbret në nivele të tjera, formale e degraduese, siç është, për shembull, përfitim material nëpërmjet tij. Për këtë arsye Pejgamberi, a.s., na këshillon:

تَعَلَّمُوا الْقُرْآنَ، فَإِذَا عَلِمْتُمُوهُ فَلَا تَعْلَمُوا فِيهِ، وَلَا تَحْفُوا عَنْهُ، وَلَا تَأْكُلُوا بِهِ، وَلَا تَسْتَكْبِرُوا بِهِ

*“Mësojeni Kuranin, e kur ta mësoni, mos i tejkaloni kufijtë me të, por as mos e shpërfillni! Mos hani prej tij, dhe as mos e shumoni pasurinë nëpërmjet tij!”<sup>56</sup>*

Kuptimi i kësaj këshille pejgamberike është që leximin e Kuranit ta mësojmë fillimisht për vete, e pastaj të kujdesemi për të që të interpretohet në përputhje me rregullat përkatëse, që Kuranit, si në kuptim të leksimit, si në atë të zbatimit të porosive të tij në jetë, mos ia kthejmë shpinën dhe që mos ta përrulim e nënvlerësojmë, duke e shndërruar në mjet për përfitim material.<sup>57</sup> Ibrahim Nah'iu ka thënë se e kanë urreyer që mësuesi i Kuranit të kompensohet materialisht për mësimin e fëmijëve në mejtep.<sup>58</sup>

<sup>55</sup> Ibën Rexheb Hanbeliu, *Letaif el mearif fima li-mevasimi el ami min el vedhaif*, red. shkenc. Tarik bin Ivedullah, (Bejrut: El Mekteb El Islamij, 2007), f. 306.

<sup>56</sup> Hadithin e shënon Ahmedi në Musned, nr. 15666, ndërsa Shuajb Arnauti konsideron se hadithi ka sened të saktë sipas kushteve të Muslimit.

<sup>57</sup> Shih: Munavi, *Fejdu El Kadir sherhu El Xhami'i Es Sagir*, (Egjypt: El mektebetu et tixharijetu el kubra, 1356 h.), 2/64!

<sup>58</sup> Ibën Mulekkini, *Et Teudih li sherhi El Xhami'i Es Sahih*, (Damask: Dar Nevadir, 2008), 15/80.

### 7.6. Etika në shprehje

Pjesë e etikës me Kuranin është që, në rastet kur harron ndonjë pjesë të tij, mos të thuash: “E kam harruar”, por: “Më është fshirë nga memoria”<sup>59</sup>. Kjo për faktin se Kurani është më i madh dhe më i rëndësishëm sesa të shpërfilllet e harrohet.

### 8. Vlera dhe shpërblimi i dëgjimit të Kuranit

Përkitazi me vlerën dhe shpërblimin e dëgjimit të Kuranit, është thënë se për dëgjim është shpërblimi sikur për leximin. Pra, ai që e dëgjon me vëmendje, ka shpërblim sikur ai që e lexon, veçmas nëse bëhet me qëllim studimi e meditimi. Pejgamberi, a.s., kërkoi prej Abdullah bin Mesudi, r.a., që t’ia lexonte Kuranin. Abdullahu, r.a., i tha: “Unë të ta lexoj ty, ndërsa ty të është shpallur?!”. “Po”, - i tha ai, a.s., dhe shtoi:

فَلَيْتَ أَحَبُّ أَنْ أَسْمَعُهُ مِنْ غَيْرِي

*“Sepse unë kam dëshirë ta dëgjoj prej të tjerëve...!”*<sup>60</sup>

Nga ky hadith është kuptuar se vlera e dëgjimit të Kuranit është sikur vlera e leximit. Madjem thuhet - në mënyrë figurative - se *lexuesi është mjelësi, ndërsa dëgjuesi pirësi i qumështit*.<sup>61</sup>

### 9. Vlera e disa ajeteve dhe kaptinave të Kuranit

Në hadithe është folur për vlerën e disa ajeteve dhe kaptinave kurane. Pra, është folur për:

- kaptinën Fatiha, si kaptina më e madhe në Kuran;<sup>62</sup>
- kaptinat Bekare dhe Ali Imran, që do të ndërmjetësojnë fuqishëm për lexuesin e tyre;<sup>63</sup>

<sup>59</sup> Shih: Buhariu, nr. 5032; Muslimi, nr. 790!

<sup>60</sup> Buhariu, nr. 4582; Muslimi, nr. 800.

<sup>61</sup> Musa Shahin Lashin, *El Menhel el hadith fi sherhi el hadith*, (Dar el medar el islamij, 2002), 3/314.

<sup>62</sup> Buhariu nr. 5006.

<sup>63</sup> Muslimi, nr. 804.

- Ajetul Kursinë, si ajeti më i madh në Kuran;<sup>64</sup>
- vlerën e memorizimit të dhjetë ajeteve të para të kaptinës Kehf, të cilat e mbrojnë besimtarin nga Dexhalli;<sup>65</sup>
- kaptinat Ihlas, Felek dhe Nas, si të veçanta. Më saktë, Pejgamberi, a.s., një ditë u kishte thënë shokëve:

احْشُدُوا؛ فَإِنِّي سَافِرٌ عَلَيْكُمْ ثُلُثَ الْقُرْآنِ، فَحَشَدَ مَنْ حَشَدَ، ثُمَّ حَرَجَ نَبِيُّ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَرَأَ: {قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ}، ثُمَّ دَخَلَ، فَقَالَ بَعْضُنَا لِبَعْضٍ: إِنِّي أَرَى هَذَا خَبَرٌ جَاءَهُ مِنَ السَّمَاءِ، فَذَلِكَ الَّذِي أَدْخَلَهُ، ثُمَّ حَرَجَ نَبِيُّ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ، فَقَالَ: إِنِّي قُلْتُ لَكُمْ سَافِرٌ عَلَيْكُمْ ثُلُثَ الْقُرْآنِ، أَلَا إِنَّمَا تَعْدِلُ ثُلُثَ الْقُرْآنِ

*“Tubohuni, se do t’jua lexoj 1/3 e Kuranit!”*. U tubua kush u tubua, e pastaj erdhi Pejgamberi i Allahut dhe e lexoi kaptinën **Kul huvAllahu ehad**. Pasi e lexoi, u kthye brenda në dhomë. Dikush i tha dikujt: *“Më duket po i shpallet diç nga qielli, prandaj edhe u kthye brenda në dhomë.”*. Pastaj doli Pejgamberi, a.s., dhe tha: *“Ju thashë se do t’jua lexoj 1/3 e Kuranit? Pikërisht ajo kaptinë vlen sa 1/3 e Kuranit.”*<sup>66</sup>.

Për kaptinat Felek dhe Nas ka thënë:

أَنْزَلَ، أَوْ أَنْزَلْتُ عَلَيَّ آيَاتٌ لَمْ يُرَ مِثْلُهُنَّ قَطُّ، الْمَعْوَدَتَيْنِ

*“Më janë zbritur disa ajete të paparë më parë: dy mbrojtëset (Felek dhe Nas).”*<sup>67</sup>.

<sup>64</sup> Muslimi, nr. 810;

<sup>65</sup> Muslimi, nr. 809.

<sup>66</sup> Muslimi, nr. 812.

<sup>67</sup> Muslimi, nr. 814.

## 10. Mbajtja për Kuranit dhe veprimi sipas tij

Qëllimi kryesor i shpalljes së Kuranit është që të veprohet sipas tij. Allahu i Madhëruar e shpalli libër udhëzues për njerëzimin mbarë, të cilit, nëse i përmbahen, gjejnë shpëtimin në këtë dhe botën tjetër. Pejgamberi Muhamed, a.s., këtë e ka lënë edhe si porosi që, edhe kur mos të jetë më fizikisht në mesin e besimtarëve, ata do të mbesin në të vërtetën përdërisa i mbahen atij. Ka thënë:

تركتُ فيكم شيئين، لن تضلوا بعدهما: كتاب الله، و سنتي

*“Në mesin tuaj i kam lënë dy gjëra, të cilave nëse u mbaheni, nuk do të lajthitni: Librin e Allahut dhe Sunetin tim!”<sup>68</sup>.*

Në hadithe të tjera na ofron detaje dhe përshkrime figurative, që lidhjes sonë me Kuranin dhe rëndësisë së tij t’i japim kuptim më të qartë.

فإنَّ هذا القرآنَ سببُ طرْفِهِ بيدِ اللهِ وطَرْفُهُ بأيديكم فتمسَّكوا به فإنَّكم لن تضلُّوا  
ولن تهلكوا بعده أبداً

*“...sepse ky Kuran është litar, një pjesë e të cilit është në Dorën e Zotit, e pjesa tjetër në duart tuaja; prandaj, mbahuni për të, se kurrë nuk do të lajthitni e të shkatërroheni pas tij!”<sup>69</sup>.*

Mbajtja për Kuran është dritë që ta ndriçon rrugën,<sup>70</sup> është mënyrë se si i ngjysim shkallët e krenarisë. Pejgamberi, a.s., ka thënë:

إن الله يرفعُ بهذا الكتابِ أقواماً ويضعُ به آخرينَ

*“Allahu vërtet disa njerëz i ngre me këtë Kuran, dhe disa të tjerë i ulë.”<sup>71</sup>.*

Ky hadith, në fakt, ka një rrëfim. Amir bin Vathile Ebu Tufejl transmeton prej Nafi bin Abdul Harithit, i cili e kishte takuar Omer bin Hattabin në Usfan. Nafiu, në fakt, ishte emëruar vali i Mekës prej Umerit, r.a. Ky i fundit, kur e pa në Usfan, i tha: “Kë e ke lënë zëvendës për banorët e luginës (Mekës)?”. “E kam lënë Ibën Ebzanë”, - u përgjigj. “E kush është

<sup>68</sup> Hadith i saktë. *Sahih El Xhami*, nr. 2937.

<sup>69</sup> Hadith hasen. Shih: *Tahrixhu Sahihi Ibën Hiban*, nr. 122!

<sup>70</sup> Shih: *Sahihu Et Tergib*, n. 1422! Hadithi është hasen li-gajrihi.

<sup>71</sup> Muslimi, nr. 817.

Ibën Ebzaja?”, - e pyeti Omeri. “Ai është një nga robërit tanë të liruar?”, - u përgjigj Nafiu. “Si, një rob të liruar e ke caktuar zëvendës për banorët e Mekës?”, - e pyeti me habi Omeri. “Po, por është lexues (dijetar) i Librit të Zotit (dhe vepron sipas tij), ka dituri për feraidet (rregullat e trashëgimisë), dhe për gjykimin me drejtësi.” Omeri tha: “Shihni! Pejgamberi juaj ka thënë: “Allahu do t’i ngre me këtë Libër disa njerëz, dhe do t’i ulë disa të tjerë.”.

Të vepruarit sipas Kuranit ndikon në zbukurimin dhe ndreqjen e imazhit fetar të besimtarit. Në mënyrë figurative, Pejgamberi, a.s., atë që e lexon Kuranin dhe vepron sipas tij e ka përshkruar si qitron.

المُؤْمِنُ الَّذِي يَقْرَأُ الْقُرْآنَ وَيَعْمَلُ بِهِ: كَالْأُتْرَاجَةِ، طَعْمُهَا طَيِّبٌ وَرِيحُهَا طَيِّبٌ

*“Shembulli i besimtarit që e lexon Kuranin është sikur shembulli i qitros, shija dhe era e së cilës janë të mira...”<sup>72</sup>*

Të vepruarit sipas Kuranit nuk është çështje vullnetare, por obligim. Për këtë arsye Kurani në Ditën e Llogarisë do të vijë si dëshmitar për dhe kundër. Pejgamberi, a.s., ka thënë:

وَالْقُرْآنُ حُجَّةٌ لَّكَ، أَوْ عَلَيْكَ

*“...Kurani, o është argument për ty, o kundër teje...”<sup>73</sup>*

## 11. Shpërfillja e Kuranit dhe rreziku nga shpërfillja e tij në këtë dhe botën tjetër

Shpërfillja e Kuranit merr trajta të ndryshme. Ndonjëherë Kurani shpërfilllet edhe duke e lexuar, por jo për hir të Zotit. Kjo është ajo që Pejgamberi Muhamed, a.s., ka aluduar kur ka thënë:

مَنْ قَرَأَ الْقُرْآنَ فَلَيْسَ بِاللَّهِ بِهِ، فَإِنَّهُ سَيَجِيءُ أَقْوَامٌ يَقْرَءُونَ الْقُرْآنَ، يَسْأَلُونَ بِهِ النَّاسَ

*“Kush e lexon Kuranin, le ta lutë Zotin me të, sepse do të vijë njerëz që do ta lexojnë Kuranin e do t’i lutin njerëzit me të!”<sup>74</sup>*

<sup>72</sup> Buhairu, nr. 5059; Muslimi, nr. 797.

<sup>73</sup> Muslimi, nr. 223.

<sup>74</sup> Hadithin e shënon Tirmidhiu në *Sunen*, nr. 2917. Hadithi është hasen. Shih: *Sahih El Xhami*, nr. 6467!

Këtë formë të gabuar të trajtimit të Kuranit e gjejmë të shtjelluar edhe në hadithin e Xhabir bin Abdullahut, r.a., në të cilin qëndron:

خَرَجَ عَلَيْنَا رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَنَحْنُ نَقْرَأُ الْقُرْآنَ وَفِينَا الْأَعْرَابِيُّ  
وَالْأَعْجَمِيُّ، فَقَالَ: اقْرَءُوا فَكُلُّ حَسَنٌ وَسَيَجِيءُ أَقْوَامٌ يَقِيمُونَهُ كَمَا يَقَامُ الْقَدْحُ  
يَتَعَجَّلُونَهُ وَلَا يَتَأَجَّلُونَهُ

*“Derisa ishim duke lexuar Kuran dhe në mesin tonë kishte beduinë e axhemijë (joarabë), erdhi i Dërguari i Allahut a.s., dhe tha: “Lexoni, sepse leximi i secilit prej jush është i mirë! Pas jush do të vijnë njerëz që do ta perfeksionojnë leximin mu ashtu siç drejtohet shigjeta,”<sup>75</sup> dhe me të do ta kërkojnë dynjanë, dhe jo ahiretin.”<sup>76</sup>*

Mesazhi dhe porosia që këto dy hadithe japin është: Kush e lexon Kuranin, le ta kërkojë shpërblimin e leximit të Zotit i vet, sepse do të vijnë gjenerata që do ta shndërrojnë atë në mjet për përfitim material, e Kurani nuk është shpallur për këtë qëllim.<sup>77</sup>

Siç mund të vërejmë, veçmas në hadithin e dytë, Pejgamberi, a.s., e miratoi leximin edhe të bedunit dhe joarabit, të cilët mund të mos i shqiptojnë gërmat siç duhet, por që janë të sinqertë, ndërsa e refuzoi leximin e atyre që u përmbahen strikt rregullave dhe i shqiptojnë gërmat në mënyrë perfekte, mirëpo që ndërmjet tyre dhe sinqeritetit ka një hendek të patejkalueshëm. Ata nuk e synojnë Allahun dhe kënaqësinë e Tij me këtë lexim, por dynjanë. Prandaj, të parët tanë e urrenin këtë mënyrë të trajtimit të Kuranit, sikurse porosisnin që njerëzve që e përdhosin Kuranin kështu t’u mbyllet dera. Abdullah bin Mesudi, r.a., ka thënë: “Njerëzve do t’u vijë një kohë kur do të lypet me Kuran. E, kur t’ju lypin me Kuran, mos u jepni asgjë!”<sup>78</sup>. Pra, do të ketë njerëz që nëpërmjet Kuranit duan t’i arrijnë

<sup>75</sup> Do ta lexojnë rrjedhshëm Kuranin dhe drejt, pa gabime gjuhësore.

<sup>76</sup> Hadith i saktë. Shih: *Sahihu Ebi Davud*, nr. 830.

<sup>77</sup> Shih: San’ani, *Et Tenviru sherhu El Xhami Es Sagir*, vep. cit., 10/362.

<sup>78</sup> Hasan bin Ali El Fejumi, *Fet’hu El Karibi El Muxhib ala et tergibi ve et terhib*, red. shkenc. Prof. Dr. Muhamed Is’hak Muhamed Al Ibrahim, (Autori - Rijad: Mektebetu Dari Es Selam, 2018), 7/63.

të mirat materiale, e ju kur t'i shihni e takoni të këtillët, refuzojini! Mejmun bin Mihrani ka thënë: “Mos e shndërroni Kuranin në mjet për ta kërkuar fitimin në dynja! Jo, dynjanë kërkojeni me dynja, e ahiretin me ahiret!”<sup>79</sup> Prandaj, “Hafëzi i Kuranit nuk duhet ta lutë me Kuran askënd tjetër përveç Allahut të Madhëruar.”<sup>80</sup> Këtu qëndron arsyeja pse të parët, kur bënë hatme Kuranin, kishin lutje që nuk kishte të bënte me aspektin material. Kurtubiu ka thënë: “Nga brezat e parë kishte besimtar që kur e mbaronte Kuranin, lutej kështu: “O Allah, m'i fal mëkatet me Kuran! O Allah, më mëshiro me Kuran! O Allah, më udhëzo me Kuran! O Allah, më jep shëndet me Kuran!”<sup>81</sup> .

Shpërfillja e Kuranit ka pasojat e veta në dynja dhe ahiret. Siç patëm rastin të mësojmë praj sahabiut të nderuar, Abdullah bin Mesudi, r.a., ata që e shfrytëzojnë Kuranin për qëllime materiale, duhen refuzuar. Të tillët, edhe në ahiret do të jenë të refuzuar, pavarësisht se sipërfaqësisht kanë bërë veprë të mirë. Ebu Hurejra, r.a., përcjell hadithin në të cilin flitet për gjykimin në Ditën e Gjykimit, e ku qëndron:

فَأُولَ مَنْ يَدْعُو بِهِ : رَجُلٌ جَمَعَ الْقُرْآنَ، وَرَجُلٌ يُقَاتِلُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ، وَرَجُلٌ كَثُرَ الْمَالُ.  
 فيقولُ اللهُ تبارَكَ وتعالى لِلْقَارِي : أَلَمْ أُعَلِّمْكَ مَا أَنْزَلْتُ عَلَى رَسُولِي صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ  
 وَسَلَّمَ ؟ ! قال : بلى يا رَبِّ ! قال : فَمَاذَا عَمِلْتَ فيما عَلِمْتَ ؟ قال : كُنْتُ  
 أَقْوَمُ بِهِ آتَاءَ اللَّيْلِ وَآتَاءَ النَّهَارِ، فيقولُ اللهُ تبارَكَ وتعالى لَهُ : كَذَبْتَ ! وتقولُ لَهُ  
 الملائكةُ : كَذَبْتَ ! ويقولُ اللهُ : بَلْ أَرَدْتَ أَنْ يَقَالَ : فُلَانٌ قَارِيٌّ، وقد قيلَ ذَلِكَ

“...I pari që thirret për llogaridhënie është lexuesi i Kuranit, dëshmori dhe pasaniku. Allahu i Madhëruar i thotë lexuesit të Kuranit: “A nuk ta kam mësuar atë që ia kam shpallur të Dërguarit Tim, paqja qoftë mbi të?!”. Lexuesi përgjigjet: “Po, gjithsesi Zoti im!”. “E çfarë ke vepruar me atë që e ke mësuar?”, - e pyet Zoti. “Jam falur me të natën, dhe e kam i kam zbatuar mësimet e tij ditën”, – përgjigjet lexues. “Po gënjen!”, – i thotë Zoti. Edhe engjë-

<sup>79</sup> Po aty.

<sup>80</sup> Po aty, 7/64.

<sup>81</sup> Po aty.

*jt i thonë: “Po gënjen!”.* Allahu thotë: “Ti ke dashur që të thonë për ty “Filani është lexues”, dhe ashtu kanë thënë...”<sup>82</sup>.

Kjo edhe për faktin se Kurani, siç përmendëm edhe më parë, o do të jetë argument për ne, nëse kemi vepruar sipas tij, o kundër nesh, nëse e kemi shpërfillur atë.

## 12. Ngritja e Kuranit në *Ahiri zeman*

Hudhejfe bin Jemani, r.a., transmeton se Pejgamberi, a.s., ka thënë: يُدْرُسُ الْإِسْلَامُ ، كَمَا يُدْرَسُ وَشْيُ الثَّوْبِ ، حَتَّى لَا يُدْرَى مَا صِيَامٌ ؟ وَلَا صَلَاةٌ وَلَا نُسُكٌ وَلَا صَدَقَةٌ ، وَيُسْرَى عَلَى كِتَابِ اللَّهِ فِي لَيْلَةٍ ، فَلَا يَبْقَى فِي الْأَرْضِ مِنْهُ آيَةٌ ، وَتَبْقَى طَوَائِفُ مِنَ النَّاسِ الشَّيْخُ الْكَبِيرُ وَالْعَجُوزُ يَقُولُونَ : أَدْرَكْنَا آبَاءَنَا عَلَى هَذِهِ الْكَلِمَةِ ، يَقُولُونَ : لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ ، فَنَحْنُ نَقُولُهَا

*“Islami do të zbardhet (shlyhet) siç zbardhet (shlyhet) mbishkrimi në rroba, derisa mos të dihet më se çfarë janë agjërimi, namazi, riti (haxhillëk) dhe as sadakaja. Libri i Allahut do të ngrihet brenda një nate, duke mos mbetur në Tokë asnjë ajet. Do të mbesin grupe njerëzish, pleq e plaka, të cilët do të thonë: “I kemi zënë prindërit tanë në këtë fjalë, që thoshin: “La ilahe il-la Allah”, dhe edhe ne po e themi.”*<sup>83</sup>.

Ngritja do të ndodhë e Kuranit, në kohën e fundit, atëherë asgjë më nuk do të mbetet, përveç dëshmisë La ilahe il-la Allah. Në mesin e njerëzve do të përhapet injoranca aq shumë, saqë nuk do të dihet më as për shtyllat kryesore të fesë.

Në këtë hadith fshihen, përveç të tjerash, dy kuptime të mëdha:

1. Ngritja e Kuranit paralajmëron ndodhjen e shpejtë të Kiametit, dhe;
2. Rolin dhe rëndësinë e Kuranit në ruajtjen e fesë së myslimanëve. Për aq kohë sa ai ekziston, ekzistojnë namazi, zekati, agjërimi, e kur ai të ngrihet, më nuk dihet rreth këtyre shtyllave kryesore të fesë.<sup>84</sup>

<sup>82</sup> Hadith i saktë. Shih: *Sahihu Et Tirmidhij*, nr. 2382 & *Sahihu El Mevarid*, nr. 2119.

<sup>83</sup> Ibën Maxheh. Albani në *Sahih Ibën Maxheh*, nr. 3289, e ka saktësuar.

<sup>84</sup> Shih: Muhamed El Emin El Hererij, *Sherhu Suneni Ibën Maxheh*, vep. cit., 24/279!

### **Përfundim**

Në përfundim të këtij punimi, si rezultate më të rëndësishme të tij do t'i veçonim:

1. Hadithet pejgamberike kanë konfirmuar pozitën burimore të Kuranit;
2. Ato kanë dokumentuar rolin e tyre shpjegues dhe detajues të Kuranit;
3. Hadithet kanë ripërsëritur rëndësinë e mbajtjes për Kuranin si rrugë shpëtimi në këtë dhe botën tjetër;
4. Ato kanë bërë thirrje për lexim të vërtetë të Kuranit, lexim që nuk përmbledhet thjesht në artikullimin dhe shqiptimin e germave, por që depërton thellë në kuptimet dhe mesazhet e Kuranit
5. Hadithet kanë bërë thirrje po kështu edhe për etikë me Kuranin, sikur që kanë tërhequr vërejtjen për të mos e shpërfillur atë.

Ndërsa, si rekomandim kryesor të punimit do të veçonim thirrjen e hulumtuesve që hadithit tematik t'i kushtohet rëndësi në të gjitha temat fetare, për shkak të shpjegimeve të shumta dhe të hollësishme që do t'i gjejmë në thëniet e pejgamberit tonë, Muhamedit, a.s.

### **Literatura:**

- Abdulhadi, Abdulmehdi bin Abdulkadir, Es Sunetu en-nebevijjeh: mek-netuha, avamilu bekaiha, tedvinuha, (Kajro: Dar el i'tisam, 1989).
- Abdulhak Dihlevi, Lemeatu et tenkih fi sherhi Mishkati el mesabih, red. shkenc. Prof. dr. Tekijudin Nedvi, (Damask: Dar en-nevadir, 2014).
- Bedrudin El Ajni, Mahmud bin Ahmed, Umdetu el karij sherhu Sahihi El Buhari, (Bejrut: Dar ihjai et turath el arabij - Dar el fikr).
- Ebu Amër ed-Dani, El bejan fi addi aji El Kuran, (Kuvajt: Merkez el mah-tutat ve et turath, 1994).
- Hasan bin Ali El Fejumi, Fet'hu El Karibi El Muxhib ala et tergibi ve et terhib, red. shkenc. Prof. Dr. Muhamed Is'hak Muhamed Al Ibrahim, (Autori - Rijad: Mektebetu Dari Es Selam, 2018).
- Ibën Dekik El Idi, Sherhu el erbeine En Nevevije, (Muessesetu err-Rrejjan, ed. 6, 2003).
- Ibën Haxher El Askalani, Fet'hu El Bari sherhu Sahihi El Buhari, (Egjipt: El Mektebetu Es Selefije, 1390 h.).
- Ibën Kethir, Tefsiru El Kurani el adhim, red. shkenc. Hikmet bin Beshir bin Jasir, (Saudi: Dar Ibën El Xheuzi, 1431 h.).
- Ibën Muflih, Muhamed, El Adab esh-sher'ijeh ve el mineh el mer'ijeh. (Bejrut: Alem el kutub, p.v.b.).
- Ibën Mulekkini, Et Teudih li sherhi El Xhami'i es sahih, (Damask: Dar Nevadir, 2008).
- Ibën Rexheb Hanbeliu, Letaif El Mearif fima li mevasimi el ami min el vedhaif, red. shkenc. Tarik bin Ivedullah, (Bejrut: El Mekteb El Islamij, 2007).
- Kastalani, Ahmed bin Muhamed, Irshadu es sari li sherhi Sahihi El Buhari, (Rijad: Dar Ataaf El Ilm, 2021).
- Kurtubi Ahmed bin Omer, El muhfim lima ushkile min telhisi kitabi Muslim, (Damask – Bejrut: Dar Ibën Kethir; Damask – Bejrut: Dar el kelim et tajjib, 1996).
- Muhamed El Emin El Hererij, El keukeb el vehhaxh ve err rreudu el beh-haxh fi sherhi Sahihi Muslimi bin El Haxhaxh, (Xhidde: Dar el minhaxh – Dar Tuk en-nexhat, 2009).

- Muhamed El Emin El Hererij, Sherhu Sunen Ibni Maxheh, (Xhidde: Dar el minhaxh, 2018).
- Munavi, Fejdu El Kadir sherhu El Xhami Es Sagir, (Egjipt: El mektebetu et tixharijetu el kubra, 1356 h.).
- Musa Shahin Lashin, El menhel el hadith fi sherhi el hadith, (Dar el medar el islamij, 2002).
- Nevevi, Jahja bin Sheref, El minhaxh sherhu Sahihi Muslimi bin El Haxhaxh, (Bejrut: Dar ihjai et turath el arabij, ed. 2, 1392 h.).
- Rashid, Letifa, El hadith el meuduij: el menhexh ve et te'sil ve et temthil, (Mekke: Dar Tajiibe el hadra, 2021).
- Rraxhihi, Abdulaziz bin Abdullah, Teufiku Err Rrabbi El Mun'im bi sherhi Sahihi Muslim, (Rijad: Merkez Abdulaziz bin Abdullah Err Rraxhihi, 2018).
- Sadi, Abdurrahman bin Nasir, Tejsiru El Kerimi Err Rrahman fi tefsiri kelami El Mennan, red. shkenc. Abdurrahman bin Muala el Luvejhak, (Bejrut: Muessesetu Err Risale, 2000).
- Saharenfuri, Halil Ahmed, Bedhlu el mexhud fi hali Suneni Ebi Davud, (Indi: Qendra Hoxha Ebu el Hasen en-Nedvi për Hulumtime dhe Studime Islame, 2006).
- San'ani, Muhamed bin Ismail bin Salah, Et tenviru sherhu El xhami es-sagir, red. shkenc. Muhammed Is'hak Muhammed Ibrahim, (Rijad: Mek-tebetu Dari Es Selam, 2011).
- Shemsudin Kermani, Muhamed bin Jusuf, El keukeb ed-derari fi sherhi Sahihi el Buhari, (Bejrut: Dar ihjai etturath el arabij, ed. 2, 1981).
- Turibishti, Fadlullah bin Hasen, El mujesser fi sherhi Mesabihi es-Sunneh, red. shkenc. Dr. Abdulhamid Hindavi, (Mektebetu Nezzar Mustafa El Baz, ed. 2, 2008).
- Utthejmin, Muhamed bin Salih, Sherhu el erbeine En Nevevije, (Dar Thu-rejjja).

**Dr. Sedat ISLAMI**

## **THE QUR'AN ACCORDING TO PROPHETIC HADITHS**

### **Abstract**

This paper focuses on hadiths that speak about the Qur'an from different perspectives. Its purpose is to shed light on these hadiths and the lessons that are gained from them. The paper aims to analyze these hadiths, to document the connection between the Qur'an and the Sunnah as two divine sources. The Sunnah too, as is known, is a *revelation*, because the Prophet Muhammad, peace be upon him, did not speak from conjecture, but from what was revealed to him by God Almighty. The importance of the paper lies in providing this material in a more concise form and according to practice in the Science of Thematic Hadith. The paper has a descriptive character. Due to its nature, we have also provided the texts of the hadiths in the original, documenting in this case not only the source, but also their rank. A priori we have avoided any hadith whose accuracy has not been confirmed. We have limited ourselves to a series of hadiths that serve the purpose of our paper, and have not aimed to include every hadith that has to do with this topic. The results of the paper have confirmed the importance of the hadith in religious treatises, in general, and in the description of the Qur'an and the issues related to it, in particular. The paper recommends to researchers that the thematic hadith be given greater importance and space due to its comprehensive content and details.

**Keywords:** *Qur'an, Sunnah, hadith, revelation, prophet Muhammad, religion.*

Dr. Ajni SINANI

## SHERIATI DHE FIKHU (2)

### **Abstrakt**

*Sheriati* është shpallje prej Allahut, që ia ka zbritur Pejgamberit, a.s., dhe e ka urdhëruar që t'ia komunikojë njerëzimit. Shpallja ndahet në dy pjesë: Kurani famëlartë, i zbritur me fjalë dhe kup-tim prej Allahut, xh.sh., dhe njerëzit nuk kanë mundësi të bëjnë të ngjashëm si ai dhe Suneti. Suneti i Pejgamberit, a.s., përbëhet nga thëniet, veprat dhe pëlqimet e tij.

Për rrjedhojë, dispozitat direkte të Kuranit dhe të Sunetit përbëjnë *sheriatin*; ato janë të pandryshueshme, të përhershme, nuk përfundojnë, janë mbrojtur edhe pas ndërprerjes së Shpalljes hyjnore dhe përfundimit të saj, nuk mund të ndryshohen dhe nuk mund të vjetrohen.

*Fikhu* është sistemi juridik i Islamit, i ndërtuar nga përpjekjet intelektuale të juristëve që synojnë interpretimin dhe përkthimin në realitet të urdhrave të Ligjit islam. Orvatja njerëzore e shpjegimit të Ligjit islam dhe përpjekja që nga dispozitat dhe parimet e tij të përgjithshme të nxirren dispozitat individuale dhe të hollësishme përgjithësisht quhet ixhtihad apo fikh i disa juristëve.

Fikhu burimin e ka në burimet e Islamit dhe në përpjekjet intelektuale e fetare të dijetarëve myslimanë (ixhtihad), dhe nga aspekti i përfshirjes, dedikimit dhe llojllojshmërisë është unik, dhe nuk mund t'i gjendet ngjashmëria tek asnjë popull tjetër dhe në asnjë fe të ardhur prej ndonjë pejgamberi tjetër.

Pavarësisht se fikhu është rezultat i veprës dhe i formulimit njerëzor, nuk duhet harruar se ixhtihadi i muxhtehidëve, pra, mendimet

dhe qëndrimet e tyre, janë nxjerrë nga Kurani dhe Suneti, prandaj janë dispozita të fesë së Allahut, xh.sh., ligjit të Tij fetar me të cilin Ai na ka obliguar të punojmë.

**Fjalët çelës:** *Islam, Kuran, Sunet, sheriat, Fikh, ibadet, muamelat, ixhma, ixhtihad, kijas, muxhtehid, er reëju, maslaha, adet.*

### Ndarja e së drejtës islame

Muxhtehidët, si dhe dijetarët që kanë ardhur pas tyre, janë përpjekur që t'i sqarojnë dispozitat e Sheriatit të Allahut dhe t'i nxjerrin nga Kurani fënik dhe Suneti i të Dërguarit, a.s. Rezultati që e arritën përbën arritjet më të vlershme që mund ta mbërrijë umeti në njohjen e dispozitave të fesë.<sup>1</sup>

Dijetari Mustafa Ez Zerka pohon se fikhu islam paraqet të drejtën më të madhe dhe më gjithëpërfshirëse ligjore në historinë e jurisprudencës që është e njohur deri tani.<sup>2</sup>

Në parim, e Drejta Islame (jurisprudenca e Sheriatit) përbëhet nga dy fusha kryesore:

1. Fusha e *ibadetit* (e adhurimit), e cila i rregullon marrëdhëniet njerëzore me Zotin, dhe;
2. Fusha e *muamelatit*, e cila i rregullon marrëdhëniet juridike dhe ekonomike të individëve dhe të shoqërisë, si dhe marrëdhëniet e tyre reciproke.

Në fushën e ibadetit bëjnë pjesë rregullat e pastërtisë, të namazit, të zekatit, të agjërit, të haxhit dhe të kurbanit. Të gjitha rregullat e fushës së ibadetit kanë për qëllim drejtimin e mirëfilltë njerëzor drejt Allahut, xh.sh.<sup>3</sup>

Fusha e muamelatit përfshin këto degë të drejtësisë:

<sup>1</sup> Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, Fikhu haneft vëll. 1, Gjilan 2006, f. 20.

<sup>2</sup> Po aty, f. 20.

<sup>3</sup> Semir Imamović, *Izvori šerijatskog prava*, shih: <http://oazatuzla.org/index.php/projekti/ramazanski-preporod-2014/izvori-serijatskog-prava>

1. E Drejta Qytetare, me të cilën rregullohen raportet pronësore-juridike;
2. E Drejta Familjare (*fikhul usre*) ose e Drejta e Martesës (*fikhul mu-nakehat*) me të cilën rregullon marrëdhëniet martesore midis bashkëshortëve;
3. E Drejta e Trashëgimisë, me të cilën rregullohet mbartja e trashëgimisë nga i ndjeri tek pasardhësit e tij (feraid);
4. E Drejta Gjyqësore, e cila përfshin rregullat dhe normat e procesit para gjykatës, të dëshmisë, të pranimi, të betimet etj.
5. E Drejta Ndëshkimore-Penale, që ka të bëjë me deliktet juridike, dhe përmban rregulla qëllimi i të cilave është mbrojtja e jetës, e nderit dhe e pronës;
6. Normat Kushtetuese që kanë të bëjnë me sundimin dhe korrelacionet midis sundimtarëve dhe nënshtetasve (*es sijasetush sher'ijje*);
7. E Drejta Ndërkombëtare, e cila trajton marrëdhëniet e shtetit islam me shtetet e tjera në paqe dhe luftë, pozitën e jomyslimanëve në shtetin islam. Në praktikë, termi *muamelat* shpesh përdoret për marrëdhëniet ekonomike e ndërpersonale.<sup>4</sup>

Dijetarët myslimanë konsiderojnë se nga mbi 6000 ajete kuranore, gjithsej 200 ajete kanë të bëjnë me normat juridike. Disa juristë të tjerë myslimanë mendojnë se numri i ajeteve që kanë të bëjnë me të drejtën (*ajatul ahkam*), drejtpërdrejt ose tërthorazi është rreth 500, ose deri në 600, apo 1/13 e Kuranit.<sup>5</sup>

Autori egjiptian, Abdulvehab Halaf, pohon se të Drejtës Familjare i përkasin 70 ajete, të Drejtës Civile 70, të Drejtës Penale 30, gjyqësisë dhe procedurave gjyqësore 13, të Drejtës Kushtetuese 10, marrëdhënieve ndërkombëtare 25 dhe ekonomisë e financave 10 ajete.<sup>6</sup>

Në Kuran, nga ajetet mbi çështjet e së drejtës, të njohura si *ajatul ahkam*, pothuajse 140 kanë të bëjnë me dogmën dhe devotshmërinë, duke

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Ahmed Emîni, Fexhrul islam botimi XIII, Kajro 1982, f. 228, shih parathënien e shkruar nga Nexhat Ibrahimî në librin: Seid Ramadan, *E Drejta Islame, burimi dhe zhvillimi*, Logos-A Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2007, f. 12-13.

<sup>6</sup> Fikret Karçiç, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 32.

përfshirë obligimet e tilla praktike fetare si: namazi, zekati dhe dhëniet e tjera vullnetare, agjërimi, haxhi etj. Shtatëdhjetë ajete janë dedikuar për martesën, divorcin, atësinë, kujdestarinë për fëmijët, trashëgiminë dhe lë-nien në trashëgimi; 30 ajete për të Drejtën Penale; 25 ajete për marrëdhë-nie ndërkombëtare etj.<sup>7</sup>

### Burimet e së Drejtës Islame

E Drejta Islame (Sheriati) bazohet në burime të pandryshueshme feta-re: Në Kuran dhe Sunet.<sup>8</sup>

Sipas mësimave islame, e drejta është norma në të cilën është shpre-hur vullneti i Zotit, që përmblihet në dy burime kryesore: në Librin e Shpallur-Kuran, dhe në fjalët dhe veprat e të Dërguarit, Muhamedit, a.s.,-Sunet. Roli parësor i tekstit të Kuranit dhe i Sunetit është të udhëzojnë në fenë e vërtetë dhe në mënyrën e drejtë të jetesës, prandaj në to, përveç paraqitjeve të natyrës teologjike, qëndrojnë normat morale dhe të drejtë-sisë. Kështu, e Drejta Islame nuk është dhënë në formën e kryer, por është e nevojshme që në bazë të burimeve të njohura të formohet në më-nyrë krijuese.<sup>9</sup>

Prandaj, ekzistojnë burime të Sheriatit që janë shpallje, dhe ato që nuk janë. Vetëm dy burime janë shpallje: I pari është Kurani, dhe i dyti është mësimi dhe sjellja (Sunet) i të dërguarit Muhamed, a.s., duke për-fshirë thëniet e tij, veprimet dhe miratimin e heshtur, ose abstenimin nga gjykimi i sjelljes së sahabëve të tij dhe disa zakoneve në shoqërinë ara-be.<sup>10</sup>

<sup>7</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo, Uporedna religijska prava*, hrestomati, përgatiti: Fikret Karciq, Sarajevo 2005, f. 82.

<sup>8</sup> Sayed Hassan Amin, *Pravni sistemi Srednjeg istoka*, Sarajevo, 1998, f. 5.

<sup>9</sup> Bernard Weiss, *Interpretation in Islamic Law: the Theory of Ijtihad*, "The American Jo-urnal of Comparative Law" XXVI (1978), f. 199. i dalje, sipas: Fikret Karčić, *Šerijats-ko pravo-reformizam i izazovi modernosti, hrestomatija tekstova i eseja*, shih: <https://bosnamuslimmedia.files.wordpress.com/2009/08/06-dr-fikret-karcic.pdf>, f. 9.

<sup>10</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo, Uporedna religijska prava*, op. cit., f. 81.

Raporti i teksteve ndërlidhëse të Kuranit dhe të Sunetit (*nass*), si dhe interpretimi i tyre, në Islam shprehet si relacion i mendjes dhe autoritetit, të shenjtës dhe njerëzores, të përhershmes dhe të së ndryshuarës. Karakteristikë për këto raporte është mbizotërimi parimor i autoritetit ndaj mendjes (“nuk ka vend për ixhtihad nëse ekziston teksti i detyrueshëm), por edhe roli autonom praktik i mendjes, pasi me aktivitet njerëzor përcaktohet domethënia, qëllimi, masa e vlefshmërisë dhe mënyra e aplikimit të tekstit të shenjtë. Në këtë mënyrë, tërësia e së drejtës pozitive islame shprehet në formën e mendimit të juristëve, dhe paraqet shembull të theksuar “të së drejtës së juristëve” (juristenrecht).<sup>11</sup>

Burimet kryesore të Sheriatit janë të përhershme dhe të pandryshuara. Ato nuk i prek as koha, as vendi, as rrethanat dhe as kushtet. Mirëpo, realiteti shoqëror në të cilën jetojnë myslimanët ndryshon vazhdimisht. Realiteti shoqëror, për dallim nga ajeti dhe hadithi, nuk ka karakter të shenjtë, vlerë të padiskutueshme dhe qëndrueshmëri, prandaj realiteti shoqëror duhet të vlerësohet dhe të klasifikohet përmes analizave adekuate. Po, në lidhje me këtë nuk është fjala për tekstet e pandryshueshme, por për rrethanat e ndryshuara për të cilat duhet të jepet gjykim adekuat.<sup>12</sup>

Kurani, Suneti, Ixhmaja (konsensusi) dhe Kijasi (analogjia) njihen si katër “rrënjët” zyrtare ose burimet e shkencës së drejtësisë, si parime metodologjike nga të cilat ligjërisht mund të nxirren rregullat e së drejtës.<sup>13</sup>

<sup>11</sup> Fikret Karčić, *Šerijatsko pravo-reformizam i izazovi modernosti, hrestomatija tekstova i eseja*, op. cit., f. 10.

<sup>12</sup> Shih: Propozim në formën e shkruar, të cilën ia ka dërguar gjykatësi i sheriatit në Trebinje, Abdulah Škaljić, Kuvendit vjetor të Shoqatës së gjykatësve të sheriatit (15.08.1937.), sipas: Mustafa Hasani, *Tumačenje i primjena šerijatskog prava o mješovitim brakovima u Bosni i Hercegovini u periodu od 1930. do 1940. godine*, El Kalem, Sarajevë, 2014, f. 251.

<sup>13</sup> Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, Svjetlost, Sarajevo, 1990, f. 187.

## Kurani

Kurani është libër i shenjtë, fjala e pakrijuar e Allahut xh.sh., nga urtësia dhe dija e Tij e pafund.<sup>14</sup> Ai është fjalë e drejtpërdrejtë e shpallur e Allahut xh.sh., është burimi i parë i mendimit dhe i jurisprudencës islame. Ai është në arabisht, i ndarë në 114 sure (kaptina), që përfshin më tepër se gjashtë mijë ajete.<sup>15</sup>

Në kohën e Pejgamberit sahabët e kanë shkruar Kuranin te disa mjete rrethanore që gjendeshin atëherë, siç janë kockat, gurët e hollë, lëvoret e pemëve, e të tjera, e të cilat i vendosnin te shtëpia e Pejgamberit, a.s. Këtë gjë ata e bënë me qëllim që të kishin një pikë referimi për ta përsëritur atë që kishin mësuar përmendsh.<sup>16</sup>

Në të thuhet qartë: **“Shoku juaj (Muhamedi që ju e njihni), as nuk është njeri që ka humbur, as që ka devijuar (nga e vërteta).”** (En Nexhm, 2).

Kurani është shpallur pjesë-pjesë, nëpërmjet melekut Xhebrail, gjatë misionit peygamberik të Muhamedit, a.s., i cili mision ka zgjatur njëzet e tre vjet.<sup>17</sup> Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe (ta shpallëm) Kuranin, që Ne e ndamë pjesë – pjesë, për t’ua lexuar njerëzve dalëngadalë, dhe ashtu e shpallëm atë një pas një.”** (El Isra, 106). Kurani nuk është libër i Muhamedit, por është libër i zbritur dhe fjalë që Zoti ia kishte shpallur për të mirën e njerëzimit. Ai historikisht ia komunikoi bashkëkohësve të tij.<sup>18</sup> Prandaj, Muhamedi, a.s., nuk është autor, por mjet komunikimi i asaj porositë hyjnore.<sup>19</sup>

<sup>14</sup> Mohsen Haredy, Abeceda islamskog prava, shih:

<http://www.islambosna.ba/forum/islambosna-vijesti-i-tekstovi-81/abeceda-islamskog-prava>.

<sup>15</sup> Abdulhamid A. Ebu Sulejman, *Drejt një teorie islame për marrëdhëniet ndërkombëtare*, Logos-A Shkup, 1419/1998, f. 75.

<sup>16</sup> Muhamed Ali Es Sajis, *Historia e legjislativit dhe jurisprudencës islame*, Logos-A Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2013, f. 49.

<sup>17</sup> Seid Ramadan, *E Drejta Islame, burimi dhe zhvillimi*, Logos-A Shkup Prishtinë Tiranë, 2007, f. 36.

<sup>18</sup> Malik bin Nebi, Fenomeni Kuranor, Prishtinë 1419/1998, f. 5.; Malik bin Nebi, *Kuranski fenomen*, Zagreb, (pa vit botimi) f. 11.

<sup>19</sup> Muhammed Hamidullah, Muhamedi, alejhi selam, vepra II, op. cit., f. 37.

Për myslimanët Kurani i shpallur në një periudhë 23 vjeçare, midis viteve 610-632, është fjalë e Zotit e dhuruar nga lart, përmes melekut Xhibril, a.s. Në këtë kuptim, natyrisht, Kurani paraqet një botë të absolute, ngase është shpallur prej Krijuesit të qiejve dhe të Tokës, hapësirës dhe kohës.<sup>20</sup>

Zoti, xh.sh., përmes melekut Xibril, ia transmetoi Kuranin në arabisht peygamberit Muhamed: **“Atë e solli Shpirti Besnik (Xhibrili), (e solli) në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (peygamber), me gjuhë të kulluar arabe.”** (Esh Shuara, 193-195).

**Prandaj, Kurani është burimi i parë dhe kryesor i Islamit. Asgjë nuk mund ta kundërshtojë atë, madje as Suneti, i cili konsiderohet burim i dytë.**<sup>21</sup> **Allahu i Madhëruar premtoi ta ruajë dhe ta mbrojë Kuranin: “Ne e shpallëm Kuranin, dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”** (El Hixhër, 9).

Islami është e vetmja fe, burimet e së cilës janë të shkruara që nga fillimi. Kurani ka pasur një privilegj të veçantë, duke u përcjellë i pandryshuar për katërmëdhjetë shekuj, pa pësuar asnjë lloj ndryshimi dhe pa njohur asnjë tekst apokrif.<sup>22</sup>

E pamundur të flitet për ndonjë karakter sheriatik të një norme (dispozite, hukm) nëse ajo nuk lidhet drejtpërdrejt ose indirekt me tekstin e Kuranit, nëse nuk buron nga kuptimet e tij universale dhe nuk përcaktohet nga qëllimet e tij sublime (mekasid). Meqë Allahu i Madhëruar është Ligjvënësi i vetëm dhe vullneti i Tij shprehet përmes shpalljes së Kuranit, është plotësisht logjike që të gjitha ligjet, në një kuptim të përgjithshëm, të kenë burimin e tyre në Kuran.<sup>23</sup>

Dispozitat e të drejtës islame, të përfshira në Kuran dhe në fjalët e veprat e Pejgamberit Muhamed a.s. (sunet), fillimisht quheshin *sheri’at*

<sup>20</sup> Tarik Ramdan, Të jesh mysliman evropian, Logos-A Shkup Prishtinë Tiranë, f. 91.

<sup>21</sup> Ibrahim Džananović, *Fikh u vrijeme Muhammeda alejhi selam*, Islamska misao, viti VII, nr. 84, Decembar, 1985, Rebiul-evvel – Rebiul-ahir, 1406, Sarajevo, f. 4.

<sup>22</sup> Malik bin Nebi, Fenomeni Kuranor, Prishtinë 1419/1998, f. 47.

<sup>23</sup> Semir Imamović, *Izvori šerijatskog prava*, shih:

<http://oazatuzla.org/index.php/projekti/ramazanski-preporod-2014/izvori-serijatskog-prava>

(shariat). Sipas mësimi islam, sheriatit njihet në thelb përmes shpalljes hyjnore. Burimi kryesor i përmbajtjes së normave të sheriatit është ajo që autoritativisht është e “dhënë”.<sup>24</sup>

### Suneti

*Suneti*, fjalë për fjalë, do të thotë "rrugë e qartë". Ai i referohet gjithçkaje që Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë, ka bërë, e ka miratuar ose e ka ndaluar. Suneti është burimi i dytë i sheriatit, menjëherë pas Kuranit, dhe përbën një burim tjetër legjislativ në të Drejtën Islame. Të gjithë sahabët ishin unanimes se duhej vepruar sipas asaj që konfirmohet si *Sunet* i të Dërguarit të Allahut dhe se ai ka të njëjtën forcë argumentimi si Kurani.<sup>25</sup>

Suneti përmban tërë atë që transmetohet nga i Dërguari i Zotit: veprat e tij (fiël), thëniet (kavl) dhe çfarëdo që Pejgamberi, a.s., e ka aprovuara me heshtje (takrir). Hadith janë fjalët e Pejgamberit të Zotit, veprat e tij dhe pëlqimi e miratimi i veprimeve të bashkëkohësve të tij që e kanë besuar. Hadithi quhet edhe Sunet. Nuk duhet harruar se kur Pejgamberi i Zotit nuk ka ndërhyrë në aspektin e ndonjë tradite të shokëve të tij, ajo traditë është pjesë e fikhut, pasi ajo futet në tërësinë e Sunetit nën emrin “miratimi” i të Dërguarit të Zotit.<sup>26</sup>

Ulemaja e hadithit (muhadithun) konsideron se elementi i katërt në përkufizimin e Sunetit është përshkrimi (*vasf*) i tipareve fizike, i karakterit dhe i biografisë së Muhamedit, a.s.<sup>27</sup> Prandaj, nuk ka kundërshtime se personaliteti i të Dërguarit të Zotit është themeli i burimit të së Drejtës

<sup>24</sup> Senko Rašljanin, Šerijatski sudovi u Kraljevini Jugoslaviji, shih:

<http://www.bosnjaci.rs/tekst/74/serijatski-sudovi-u-kraljevini-jugoslaviji.html>

<sup>25</sup> *Tarihut tešri*, përgatiti, Muhammed Jusri Ibrahim, Xhida, 1425/2005, f. 147.

<sup>26</sup> Muhammed Hamidullah, Ndikimi i të drejtës romake mbi fikun, sipas: Fikret Karciq, Studime për të drejtën e sheriatit dhe institucionet, Logos-A, Shkup Prishtinë Tiranë, f. 347.

<sup>27</sup> Mustafa Hasani, *Sunet Božijeg Poslanika a.s. u metodologiji islamske jurisprudencije*, shih: *Usuli fikh*, përgatiti Enes Ljevaković, Fakultet islamskih nauka u Sarajevu, Sarajevo, 2005, f. 116.

Islame.<sup>28</sup> Pra, Suneti përfshin tërë jetën, punën dhe mësimet e Muhamedit, a.s., pa marrë parasysh se në çfarë forme është manifestuar aktiviteti i tij.<sup>29</sup> Roli i Muhamedit, a.s., ishte që të përcillte shpalljen e Kuranit ashtu siç e pranonte, ta interpretonte dhe ta praktikonte atë në mënyrë të përpiktë. Interpretimet dhe praktikimet e tij i dhanë të ashtuquajturat tradita të Muhamedit, a.s. (Suneti i tij).<sup>30</sup>

Sunet do të thotë zakon, metodë, ligj, shprehi, traditë. Ky term ishte i njohur edhe për arabët para-islamikë në kuptimin e traditës që ata e trashëguan nga paraardhësit e tyre dhe që formonte të drejtën e tyre zakonore. Arabët e lashtë e konsideronin virtut nëse ndiqej suneti i etërve (suneti është, në fakt, rruga së cilës shkohet zakonisht, d.m.th. mënyra e zakonshme e veprimit, zakon i vjetër). Por në Islam, Suneti nuk mund të konsistonte më në ndjekjen e zakoneve dhe shprehive të mëhershme pagane të etërve. Komuniteti mysliman duhej të respektonte sunetin e ri. Secili besimtar tani duhej të merrte në konsideratë sjelljen e Pejgamberit, a.s., dhe shokëve të tij në të gjitha rrethanat e jetës dhe të përpiqej të fitonte njohuri për të.<sup>31</sup>

Ibën Mendhuri, në fjalorin e tij të famshëm *Lisanul Arab*, thotë se Suneti nuk tregon mënyrën e jetës sensuale, të ndjeshme që praktikon një person, por ajo tregon rrugën ideologjike dhe shpirtërore.<sup>32</sup>

Suneti “e dëfton rrugën” me shembullin e vet konkret, prandaj veprimi i tij është identik me veprimin e atyre që ndjekin atë rrugë duke përveçësuar shembullin. Suneti mund të pohojë rregullat që gjenden në Kuran. Së dyti, Suneti mund të bëjë shpjegime ose interpretime të ajeteve të Kur-

<sup>28</sup> Muhammed Hamidullah, Ndikimi i të drejtës romake mbi fikun, sipas: Fikret Karcic, Studime për të drejtën e sheriatit dhe institucionet, Logos-A, Shkup Prishtinë Tiranë, f. 351.

<sup>29</sup> Ibrahim Džananović, *Fikh u vrijeme Muhammeda alejhi selam*, Islamska misao, godina VII, nr. 84, Decembar, 1985, Rebiul-evvel – Rebiul-ahir, 1406, Sarajevo, op. cit., f. 5.

<sup>30</sup> Hamudeh AbdulAti, *Islami në fokus*, Shkup, 1413/1992, f. 23.

<sup>31</sup> Smailagić, Nerkez, *Leksikon Islama*, op. cit., f. 220.

<sup>32</sup> Mustafa Hasani, *Sunet Božijeg Poslanika a.s. u metodologiji islamske jurisprudencije*, shih: *Usuli fikh*, pergatit Enes Ljevaković, op. cit., f. 115.

anit. Së treti, Suneti mund të trajtojë çështje për të cilat Kurani nuk ka folur.<sup>33</sup>

Suneti është shkruar në librat e Hadithit (thëniet ose traditat). Vërtetësia e Sunetit, si burim i Sheriatit, tregohet në vetë Kuranin. Mbrojtja e Kuranit përfshin edhe mbrojtjen e Sunetit, siç e ka shpjeguar Imam Esh Shatibi në veprën e tij *El Muvafekat*, meqë Suneti është interpretim i Kuranit.<sup>34</sup> Prandaj, Allahu, xh.sh., thotë: **“... Ty ta zbritëm Kuranin, që t’ua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kuranin).”** (*En Nahël*, 44).

Suneti, pra, ka një status normativ. Ulematë janë unanimitë në qëndrimin se mësimi normativ (Suneti) i Pejgamberit, a.s., është një nga burimet e Sheriatit dhe se vendimet e Pejgamberit, a.s., për atë që është e ligjshme dhe çfarë nuk është (halal ve haram) kanë vërtetësinë e Kuranit. Siç thuhet në Kuran, fjalët e Pejgamberit, a.s., janë shprehje e frymëzimit hyjnor: **“Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kurani) nuk është tjetër veçse shpallje që i shpallet.”** (*En Nexhm*, 3-4).

Detyrë e çdo myslimani është që t’u bindet atyre: **“Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur Allahut, e kush e refuzon, Ne nuk të dërguam ty roje kundër tyre.”** (*En Nisa*, 80); **“... Çka t’ju japë Pejgamberi, atë merreni, e çka t’ju ndalojë, përmbajuni, dhe kini frikë Allahun, se Allahu është Ndëshkues i ashpër.”** (*El Hashër*, 7). Kjo do të thotë që fjalët e Pejgamberit, a.s., kanë forcën e ligjit.<sup>35</sup>

Shembulli i të Dërguarit të Zotit, Muhamedit, a.s., është modeli që i parashtrohet një myslimani për ta praktikuar. Në jetën e Pejgamberit, a.s., mund të gjendet një direktivë për çdo aspekt të jetës njerëzore, që nga ai specifikisht personal e deri tek ai shoqëror, si bir, si bashkëshort, baba, predikues, mësues, veprues ekonomik, negociator i paqes, gjykatës dhe udhëheqës shteti.<sup>36</sup>

<sup>33</sup> Taha Džabir Al Aluani, *Etika neslaganja u islamu*, Sarajevo, 1996/1417, f. 148.

<sup>34</sup> Jusuf El Kardavi, *Sheriati Islam*, aktualiteti gjithëkohor dhe gjithëhapësinori i tij, Logos-A Shkup Prishtinë Tiranë, 2013, f. 20.

<sup>35</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo, Uporedna religijska prava*, op. cit., f. 82.

<sup>36</sup> Khurshid Ahmed, *Familja dhe islami*, Tiranë 2000, f. 11.

Besimtarët janë të detyruar, në përputhje me tekstin e qartë kuranor, t'i përmbahen sunetit, d.m.th. të pranojnë gjithçka që i Dërguari i Zotit tha, bëri dhe vendosi. Kjo është arsyeja pse suneti, si burim i dytë ligjor, është më gjithëpërfshirës se burimi i parë – Kurani, nga i cili rrjedh.<sup>37</sup>

Hadithi është transmetim, traditë. Fjala *hadith* (a. *hadith*) do të thotë, para së gjithash, një thënie ose transmetim në përgjithësi, qoftë i llojit laik ose fetar, dhe pastaj, në veçanti, një njoftim për veprimet ose thëniet e Pejgamberit, a.s., dhe shokëve të tij. Në këtë kuptim të fundit, e gjithë tradita e shenjtë islame quhet Hadith, dhe shkenca për të quhet “ilmul hadith”.<sup>38</sup> Pohimet e Pejgamberit, a.s., quhen hadithe. Hadithet përmbajnë udhëzime për të gjitha aspektet e jetës, dhe pasqyrojnë jetën e plotë dhe të virtytshme të vetë Pejgamberit, a.s.<sup>39</sup>

Muhamed Hamidullahi, sikurse edhe të gjithë dijetarët e umetit, theksojnë faktin se shënimi i thënieve të Pejgamberit, a.s., me shkrim ka filluar qysh kur Muhamedi, a.s., ishte gjallë, sepse shumë prej atyre që e vizitonin Pejgamberin, a.s., i shënonin bisedat që zhvillonin me të, si dhe atë që vërenin tek ai. Përmbledhja e hadithit, burim i dytë i ligjit dhe fesë islame, zë një vend më të ulët se Kurani. Arsyeja qëndron në faktin se Kurani ka qenë i shënuar në formë të shkruar nën mbikëqyrjen e vetë Pejgamberit, a.s., ndërsa hadithet u transmetuan nga persona privatë dhe këto përmbledhje nuk kontrolloheshin prej njerëzve kompetentë. Pra, Hadithi paraqet një përpjekje private, dhe çdo përmbledhje ka të drejtë t'i besohet vetëm në masën e cilësive dhe aftësive individuale të transmetuesve dhe të përshkruesve të tij.<sup>40</sup>

Sipas Islamit, njeriu nuk ka autorizim që të lejojë atë që e ka ndaluar Kurani ose Hadithi, dhe për këtë arsye nuk ka ndonjë autoritet njerëzor që

<sup>37</sup> *Dijalog islamskih i evropskih učenjaka*, Sarajevo, 1979, f. 63.

<sup>38</sup> Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, op. cit., f. 220.

<sup>39</sup> Abdul Wahid Hamid, *Islamizmi rruga e natyrshme*, Istanbul, 1992, f. 44.

<sup>40</sup> Muhamed Hamidullah, Muhamedi, alejhi selam, vepra II, op. cit. f. 44.

mund t'ia ndalojë myslimanëve atë që e ka lejuar Kurani ose Suneti i Pejgamberit të Zotit.<sup>41</sup>

Besimi se këto ishin themele të pandryshueshme të mësimit islam kishte për pasojë logjike që, si një mënyrë për konkretizimin e parimeve të përgjithshme dhe dispozitave, të pranohet interpretimi, kurse si metodë themelore ajo dogmatike.

Meqenëse Islami hodhi poshtë çdo koncept të klerit, si një kategori e veçantë, dhe të kishës si një organizatë fetare, interpretimi i teksteve themelore hyri nën juridiksionin e ulemave - ekspertëve në shkencat islamiqe, të gjuhës arabe dhe të gjuhësisë islame në tërësi. Ata i kushtuan vëmendje të veçantë pjesëve të Kuranit dhe të Sunetit që përmbajnë dispozita (*ahkam*).<sup>42</sup>

Përveç Kuranit dhe Sunetit, ekzistojnë edhe disa burime dytësore të ligjit islam, siç janë Ixhmai, Ixhtihadi (konkluzione personale), Kijasi, Adati dhe Masleha (interesi publik).<sup>43</sup>

### Ixhmai

Burimi i tretë i të Drejtës Islame është el ixhmai, unanimiteti, d.m.th. një qëndrim i pranuar unanimisht nga juristët myslimanë, që korrespondon me parimet e përgjithshme të Kuranit dhe Sunetit dhe i referohet ndonjë problemi dhe të shtjelluarit të tij më të detajuar. Nëse lind një çështje për zgjidhjen e së cilës nuk ka tekst të detajuar në Kuran dhe Sunet, myslimanët e njohin ixhmain si burimin e tretë së Drejtës Islame.<sup>44</sup>

Ixhmai (a. *ixhma*), bukalisht pajtueshmëri e mirëfilltë për diçka, është një nga katër bazat (usul), dhe definohet si pëlqim i muxhtehidëve (d.m.th., ekspertëve që kanë të drejtë, duke u mbështetur në njohuritë e

<sup>41</sup> Muhammed Hamidullah, Ndikimi i së Drejtës Romake mbi Fikun, sipas: Fikret Karciq, Studime për të Drejtën e Sheriatit dhe institucionet, Logos-A, Shkup Prishtinë Tiranë, f. 345.

<sup>42</sup> Senko Rašljanin, *Šerijatski sudovi u Kraljevini Jugoslaviji*, shih: <http://www.bosnjaci.rs/tekst/74/serijatski-sudovi-u-kraljevini-jugoslaviji.html>

<sup>43</sup> Mohsen Haredy, *Abeceda islamskog prava*, op. cit.

<sup>44</sup> *Dijalog islamskih i evropskih učenjaka*, op. cit., f. 64.

veta, të sjellin gjykimet e tyre), pas vdekjes së Muhamedit, a.s., në të gjitha kohët, për të gjitha çështjet.<sup>45</sup>

Ixhmai emëron konsensusin e shumicës së muxhtehidëve (ixhmaul ektherije). Është një lloj konsensusi që nuk e lejon një mysliman të dalë përtej kornizës së tij, as të shprehë mospajtim, duke pasur parasysh se është shumica dërrmuese e studiuesve, mendimtarëve dhe ekspertëve më të mirë të Islamit.<sup>46</sup> Konsensusi, thonë shumica e dijetarëve, duhet të jetë i mbështetur në argumente nga Kurani ose Suneti, përkatësisht dijetarët e asaj periudhe do të bashkohen në mendimin se një ajet i caktuar ose hadith e ka vetëm një kuptim, dhe se nuk ka mundësi të komentohet në mënyra të ndryshme.<sup>47</sup>

Ixhmai është një konsensus i mendimit, ose një marrëveshje unanime e muxhtehidëve të cilësdo periudhë pas vdekjes së Pejgamberit, a.s., për çfarëdo çështje. Si i tillë, ai përshkruhet si një ixhtihad kolektiv.<sup>48</sup>

Allahu i Lartë thotë: **“Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që e ka zgjedhur (në dynja), dhe e fusim në Xhehenem. Përfundim i keq është ai.”** (En Nisa, 115). Kurani kërkon që të mos shkohet pas qëndrimeve joislame dhe hadithi thekson faktin se umeti mysliman nuk mund të jetë në humbje. Pejgamberi, a.s., thotë: “Umeti im nuk do të pajtohet në gabim.” (transmetuar prej Tirmidhiut)

Burimet e Sheriatit që nuk janë objekt i Shpalljes zakonisht bazohen në gjykimin ligjor (ixhtihad). Ky gjykim ndodh në disa forma, përfshirë analogjinë juridike (kijas), preferencën ligjore (istihsan), çështje me interes publik (istislah) dhe madje edhe konsensusin e ekspertëve (ixhma), i cili, në thelb, bazohet në ixhtihad dhe mundëson veprimin përmes të cilit

<sup>45</sup> Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, op. cit., f. 262.

<sup>46</sup> Kutb Mustafa Sano, *Parimet e bashkëpunimit ndërmjet medhhebeve islame*, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2014, str. 75.

<sup>47</sup> Hayreddin Karaman, *Historia e së Drejtës Islame, nga fillimi deri në kohën tonë*, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2014, f. 68.

<sup>48</sup> Taha Džabir Al Aluani, *Etika neslaganja u islamu*, op. cit., f. 146.

një gjykim të dhënë në bazë të një interpretimi ligjor mund t'i jepet forcë detyruese e ligjit.<sup>49</sup>

Orientalisti Goldziher është mrekulluar me institucionin e ixhmas si një nga bazat e ligjit islamik, për të thënë: “Së shpejti do të konfirmohet se ky burim i ixhmailt është një burim i forcës që Islami të lëvizë dhe të zhvillohet lirshëm, sepse ofron një korrigjim të favorshëm të të shkronjave të vdekura dhe një autoritet të brendshëm personal”. Ai konstaton se ixhmai përfaqëson “një mendje të mrekullueshme për zhvillimin e të drejtës së Sheriatit dhe prosperitetin e tij dhe një ilaç efektiv kundër sterilitetit të tij dhe ngrirjes së ideve të tij”.<sup>50</sup>

### Ixhtihadi

Burimi i katërt i të Drejtës Islame është ixhtihadi, respektivisht, mendimi individual, në një vend apo periudhë kohe, me kusht që Kurani, Suneti ose Ixhmai mos të ketë ndërhyrë në atë çështje, ose që ata mos të kenë një pozicion mjaft të qartë.<sup>51</sup>

Ixhtihadi është derivat nga folja arabe ixhtehe, e që tekstualisht do të thotë “të përpjekurit”, “të munduarit”, “të orvaturit”.<sup>52</sup> Fjala ixhtihad është infinitiv i llojit të tetë të foljes nga rrënja *xhuhd*, që do të thotë: investim i përpjekjes maksimale për të arritur qëllimin e dëshiruar, ndërsa në kuptimin terminologjik definohet me fjalët: “Procesi i nxjerrjes së dispozitave juridike-sheriatike nga argumentet (burimet) e tyre të veçanta në Sheriat.”<sup>53</sup>

<sup>49</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo, Uporedna religijska prava*, op. cit. f. 81.

<sup>50</sup> *Dijalog islamskih i evropskih učenjaka*, op. cit., f. 65.

<sup>51</sup> *Dijalog islamskih i evropskih učenjaka*, op. cit., f. 65.

<sup>52</sup> Seid Ramadan, *E Drejta Islame*, Logos-A Shkup Prishtinë Tiranë, 2007, f. 76; *Munteka kadaja el vakfi el fekhije eth thani*, Kuvajt, 1426/2005, f. 11.

<sup>53</sup> Abdulkahir Muhammed Ahmed Kamer, *Idžtiħad i fetva u međunarondoĝ akademiji islamskog prava: mehanizmi i preporuke*, shih: *Ustanova fetve u globaliziranom svijetu (Al iftau fil alem meftuh)*, Međunarodni centar za srednji islamski put u Kuvajtu, Sarajevo, El Kalem, 1453/2013, f. 149.

Ai, fjalë për fjalë, do të thotë: përpjekje ose orvatje maksimale; rezonim i pavarur, të menduarit analitik. Ixhtihadi mund të përfshijë interpretimin e materialeve burimore, nxjerrjen e rregullave prej tyre, ose dhënien e një zgjidhjeje ligjore ose vendimi për ndonjë çështje për të cilën nuk ka udhëzim specifik në Kuran dhe Sunet..<sup>54</sup>

Sipas fjalëve të Hashim Kamalit, “Ixhtihadi definohet si investim i përpjekjeve maksimale nga juristët për të nxjerrë, me një shkallë të probabilitetit, rregullat e Sheriatit nga argumentet e hollësishme që gjenden në burime. Konkluzionet juridike/ligjore janë burimi bazë dhe mjet i përshtatjes së ligjit me realitetin e ndryshimeve shoqërore.”<sup>55</sup>

Disa dijetarë ixhtihadin e kanë përkufizuar si përdorim të të gjitha aftësive të juristit, qoftë për të nxjerrë rregullat e Sheriatit nga burimet e tyre, qoftë për t’i implementuar këto rregulla dhe për t’i përdorur ato në çështje të veçanta. Qenësisht, ixhtihadi përbëhet nga nxjerrje-konkluzione (istinbat) që arrin një probabilitet (dhann), duke përjashtuar me këtë rast nxjerrjen e rregullave nga teksti i qartë.<sup>56</sup>

Kur mendimi juridik arrihet përmes ixhtihadit, i mbështetur nga konsensusi i përgjithshëm i juristëve (fukaha), ai konsiderohej i padiskutueshëm dhe kështu i detyrueshëm për të gjithë bashkësinë. Opinionet juridike të dijetarëve individualë (ixhtihad) dhe konsensusi i tyre (ixhma) u bënë, pas vdekjes së të Dërguarit të Zotit, një burim shtesë i Sheriatit dhe metoda të reja të definimit të drejtës hyjnore.<sup>57</sup>

Ixhtihadi afërsisht korrespondon me atë që quhet interpretimi i ligjit në shkencën evropiane. Bernard Vajs (Bernard Weiss), një studiues bashkëkohor i të drejtës islame, vëren se ixhtihadi ndryshon nga interpretimi i ligjit për atë, ngase është një interpretim i burimeve të ligjit, dhe jo i rregullave ligjore. Ligji si një sistem normash në Islam është fundi i pro-

<sup>54</sup> Taha Džabir Al Aluani, *Etika neslaganja u islamu*, op. cit. f. 146.

<sup>55</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo*, op. cit. f. 84.

<sup>56</sup> Tarik Ramadan, *Të jesh mysliman evropian*, op. cit. f. 132,133.

<sup>57</sup> Louay M. Safi, *Islamsko pravo i društvo*, op. cit., f. 118.

cesit të interpretimit, jo fillimi i tij. Kjo është arsyeja pse ixhtihadi është edhe interpretimi, edhe formulimi i të drejtave.<sup>58</sup>

Muxhtehidi është ekspert për çështjet e fikhut, i cili nxjerr/konstituon norma sheriatike bazuar në burimet e së Drejtës së Sheriatit, që do të thotë se ai nuk ndjek askënd dhe është i pavarur në ixhtihadin e tij.<sup>59</sup>

Pra, muxhtehidi është ai që bën ixhtihad. Prandaj, muxhtehidi zbulon dhe formulon në mënyrë autoritative ligjin e Zotit, ligj që, sipas bindjes islame, ekziston objektivisht jashtë dhe mbi këtë botë. Nuk duhet harruar se kjo është vetëm një përpjekje njerëzore për të arritur përmbajtjen e së drejtës së Zotit dhe se rezultatet e kësaj përpjekje janë pak ose shumë të besueshme, por jo absolutisht të sigurta.<sup>60</sup>

Megjithatë, ekziston një mënyrë për të vendosur për qëllime praktike një shkallë të lartë të sigurisë së interpretimeve subjektive të burimeve të ligjit. Ky do të jetë rasti kur disa juristë/fakih në mënyrë të pavarur arrijnë të njëjtin rezultat. Një mekanizëm i tillë verifikimi quhet ixhma, ose “unanimiteti i umetit islam” ose “unanimiteti i dijetarëve myslimanë.” Në themel të konceptit të ixhmasë është kuptimi se vullneti i Zotit do të parandalojë që umeti mysliman të bëjë një gabim kolektiv dhe se njerëzit në jetën e përditshme mund të mbështeten në atë që, me të drejtë, konsiderohet shprehje e së drejtës së Zotit.<sup>61</sup>

Në rastet kur i Dërguari i Zotit nuk ishte mes tyre, sahabët bënë përpjekje për të zgjidhur një problem. Ata shprehën mendimet e tyre që buronin nga kuptimi i tyre i dispozitave fetare. I Dërguari i Zotit i inkurajoi shokët e tij në ixhtihad.<sup>62</sup>

<sup>58</sup> Bernard Weiss, *Interpretation in Islamic Law: the Theory of Ijtihad*, The American Journal of Comparative Law XXVI (1978), str. 200, prema: Fikret Karčić, *Šerijatsko pravo-reformizam i izazovi modernosti, hrestomatija tekstova i eseja*, op. cit. f. 9.

<sup>59</sup> Vehbe Mustafa Ez Zuhajli, *Kompetencije za izdavanje fetvi*, vidi: *Ustanova fetve u globaliziranom svijetu (Al iftau fil alem meftuh)*, op. cit., f. 14.

<sup>60</sup> Fikret Karčić, *Šerijatsko pravo-reformizam i izazovi modernosti, hrestomatija tekstova i eseja*, op. cit., f. 10.

<sup>61</sup> Po aty, f. 10.

<sup>62</sup> Omer Sulejman El Eshkar, *Historia e fikhut*, Shkup, 1426/2005., f. 75.

### Analógjia ligjore (Kijas)

Kijasi është deduksion analogjik ose rezonim. Një analogji bëhet vetëm nëse një zgjidhje për një rast të ri nuk mund të gjendet në Kuran ose Sunet. Analógjia ka të bëjë me shtrirjen e parimit (asl), i cili deduktohet dhe nxirret nga Kurani dhe Suneti në rastin gjegjë. Deduktimi analogjik nuk mund të funksionojë i pavarur nga nususet (tekstet).<sup>63</sup>

Fjala kijas është paskajore e foljeve kase dhe kajese. Në arabisht, fjala kijas do të thotë matje (et takdir), dhe meqenëse kjo kërkon dy gjëra që i shtohen/bashkëngjiten njëra-tjetrës me njëjtësim dhe krahasim (bil musavati), kjo fjalë përdoret gjithashtu për të kuptuar përqasjen. Sipas Imam Maturidiut, kijas në terminologjinë e Sheriatit do të thotë: “Nxjerrja e një norme të ngjashme me atë që është në njërën nga dy rastet e përmendura, në bazë të së njëjtës arsye ligjore në rastin tjetër.”<sup>64</sup>

Pra, nëse dihet cilësia ose shkaku i një vendimi që është në Kuran dhe Sunet, ose nxirret nëpërmjet një përpjekjeje shtesë intelektuale fetare islame (tahrixhul menat), dhe është në një vepër tjetër që ka cilësinë, shkaku dhe nevojën e njëjtë, atëherë i jepet i njëjti përfundim, dhe kështu realizohet veprimi i kijasit (analógjia).<sup>65</sup> Analógjia ligjore (kijas) ishte më e zakonshmja dhe, sipas Imam Shafiut, forma e vetme e vlefshme e ixhtihadit. Si një formë themelore e ixhtihadit, analógjia siguroi përputhshmërinë e mendimeve juridike me dispozitat e përfshira në tekstin e Kuranit dhe Sunetit, të cilat mundohen t’i zbatojnë për raste të ngjashme.<sup>66</sup>

Gjykimi analogjik në teorinë klasike kërkonte që shkaku veprues (i’l-le) i një urdhri hyjnor të përcaktohej, në mënyrë që zbatimi i urdhrit të mund të shtrihej në objektet e tjera që ndajnë të njëjtin motiv.<sup>67</sup> Për shembull, Kurani: **“Edhe ata që bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk**

<sup>63</sup> Al Aluani, Taha Džabir, *Etika neslaganja u islamu*, op. cit., f. 148.

<sup>64</sup> Enes Ljevaković, *Analógjia (qijas) kao izvor prava*, shih: *Usuli fikh*, përg: Enes Ljevaković, op. cit., f. 133.

<sup>65</sup> Hayreddin Karaman, *Historia e së Drejtës Islame, nga fillimi deri në kohën tonë*, op. cit., f. 69.

<sup>66</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo*, op. cit., f. 85.

<sup>67</sup> Louay M. Safi, *Islamsko pravo i društvo*, op. cit., f. 119.

*sjellin katër dëshmitarë, t'i rrihni ata me nga tetëdhjetë të rëna...*” (En Nur, 4), kërkon që kushdo që akuzon me shpifje një grua të virtytshme për tradhti bashkëshortore, të dënohet me tetëdhjetë goditje.

Ky dënim u zbatua më pas me analogji për personat që akuzuan burra të pafajshëm për të njëjtën gjë, sepse ekzistonte një lidhje konkrete, mbrojtja e nderit të një personi të pafajshëm, pra, midis rastit fillestar (grave) dhe rastit të ri (burrave).<sup>68</sup>

Kijas janë dispozita të reja të krijuara me analogji nga gjykatës dhe zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit. Kijasi përfaqëson, në fakt, një precedent gjyqësor, një term pothuajse identik me precedentin gjyqësor në të drejtën evropiane.<sup>69</sup> Disa juristë konsiderojnë se vetëm përmes analogjisë mund të plotësohen zbrazëtirat në sistemin juridik, ndërsa të tjerë lejojnë që kjo të bëhet përmes krijimit të lirë (er’rej) dhe zakoneve popullore (urf-adet).<sup>70</sup>

## Er re'ju

Ka juristë që mbajnë qëndrimin se një çështje konkrete mund të zgjidhet sipas gjykimit të lirë, nëse për të nuk ka zgjidhje nga burimet ekzistuese. Ata e konsiderojnë er-re’jin si një variant të analogjisë juridike dhe e justifikojnë zbatimin e tij duke iu referuar një hadithi autentik nga Muadh bin Xhebeli, të cilin Muhamedi, a.s., e kishte emëruar gjyqtar në Jemen.<sup>71</sup> Para se të shkonte Muadhi për në Jemen, Pejgamberi, a.s., e kishte pyetur: “Me çka do të gjykoshe?” Ai kishte përgjigjur: “Sipas Librit të Zotit.” E nëse aty nuk gjen gjë? “Sipas syneve të Pejgamberit të Zotit.” E nëse aty nuk gjen gjë? “Atëherë do të përpiqem të formoj gjykimin tim

<sup>68</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo*, op. cit., f. 85.

<sup>69</sup> Kandić Vajs: *Opšta istorija države i prava, feudalni period, savremena administracija*, Beograd, 1996, f. 34, sipas: Milan Andrić, *Osnovi šerijatskog prava (s posebnim osvrtom na odnose između polova prema bračnim pravilima šerijatskog prava)*, shih:

[http://www.ceir.co.rs/images/stories/rit\\_06/rit\\_6\\_osnovi\\_serijatskog\\_prava.pdf](http://www.ceir.co.rs/images/stories/rit_06/rit_6_osnovi_serijatskog_prava.pdf).

<sup>70</sup> Dr. Mehmed Begović, *E drejta martesore shariatike, me një hyrje të shkurtër në studimin e së drejtës shariatike*, Tiranë, 2020, f. 23.

<sup>71</sup> Po aty, f. 22.

vetjak (exhte hidu reji vela alu).” Pejgamberi, a.s., pas kësaj kishte thënë: “I Lavdëruar qoftë Allahu që e drejtoi emisarin e Pejgamberit të Tij drejt asaj me çka është i kënaqur Pejgamberi i Tij.”<sup>72</sup>

I Dërguari i Zotit e miratoi deklaratën e Muadhit për të formuar gjykimin e tij në rastet kur ai nuk mund të gjejë një tekst të zbatueshëm në Kuran dhe Sunet. Kjo përpjekje nga alimat (juristët) për të kuptuar burimin, për të nxjerrë rregullat, ose, në mungesë të indikacioneve të qarta tekstuale, për të formuluar gjykimet e tyre, quhet ixhtihad.

Er re’ju – (ixhtihad, konkluzion personal) është një zgjidhje që e sjell një gjykatës në bazë të bindjes së tij të lirë gjyqësore.<sup>73</sup>

### Adeti

Shkolla henefite dhe malitike i njohin zakonet juridike popullore si burim dytësor i së Drejtës. Mirëpo, me kusht që ai zakon mos të binte ndesh me Kuranin dhe Sunetin.<sup>74</sup> Adet (a. adat, zakon, shprehje) është një term juridik që tregon të drejtën zakonore, e cila në vendet islamike ekzistonte paralel dhe e pavarur nga e drejta fetare (sheriati); zbatohet për ato mosmarrëveshje juridike që nuk ishin të lidhura ngushtë me rregullat fetare. Në literaturë, termi adet nganjëherë zëvendësohet me termat urf ose kanun.<sup>75</sup>

Adet, një zakon, një praktikë, një zakon lokal, i cili nuk është në kundërshtim me Kuranin ose Sunetin, njihet si pjesë e ligjit islam.<sup>76</sup> Adeti përfaqëson të drejtën zakonore që formohet nga përsëritja afatgjate e një sjelljeje të caktuar në një situatë, pa kundërshtuar burimet e përmendura më parë.<sup>77</sup>

<sup>72</sup> Seid Ramadan, *E Drejta Islame*, op. cit., f. 76.

<sup>73</sup> Milan Andrić, *Osnovi šerijatskog prava (s posebnim osvrtom na odnose između polova prema bračnim pravilima šerijatskog prava)*, op. cit.

<sup>74</sup> Dr. Mehmed Begović, op. cit., E drejta martesore shariatike, op. cit., f. 21.

<sup>75</sup> Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, op. cit., f. 12.

<sup>76</sup> Al Aluani, Taha Džabir, *Etika neslaganja u islamu*, op. cit., f. 141.

<sup>77</sup> Milan Andrić, *Osnovi šerijatskog prava (s posebnim osvrtom na odnose između polova prema bračnim pravilima šerijatskog prava)*, op. cit.

## **Maslaha (Marrja në konsideratë e interesit publik)**

Qëllimet e Sheriatit dhe të gjitha dispozitave të tij janë arritja e *el maslahas* ose mirëqenies së njerëzve. Imam Ebu Hamid El Gazaliu (v. 1111), në veprën e tij *El Mustesfa min Ilmi'l Usul*, thekson qartësisht: *"Esencialisht, el maslaha është një shprehje që shënon kërkimin e diçkaje të dobishme (menfa'a) ose mënjanimin e diçkaje të dëmshme (medarra). Mirëpo nuk është kjo ajo që synojmë të themi, sepse ta kërkosh të dobishmen dhe ta mënjanosësh të dëmshmen janë qëllime (mekasid) të cilat njerëzit duan të arrijnë, kurse mirësia (salah) e krijimit të njerëzimit qëndron në realizimin e qëllimeve (mekasid). Ajo që nënkuptojmë me maslahan është ruajtja e qëllimit (maksad) të Ligjit (Sheriatit), i cili përbëhet nga pesë sende: ruajtja e fesë, e jetës, e arsyes (mendjes), e pasardhësve dhe e pasurisë. Ajo që siguron ruajtjen e këtyre pesë parimeve (usul) është maslaha, ndërsa ajo që dështon ta ruajë këtë është mefsede, mënjanimi i së cilës është maslaha."*<sup>78</sup>

Maslaha është shqyrtimi i interesit publik që përputhet me qëllimet e Ligjvënësit. Kjo siguron një përfitim ose e parandalon dëmin, ndërsa Sheriati nuk jep një tregues të vlerës së kësaj ose të së kundërtës.<sup>79</sup>

## **Sheriati dhe fikhu**

Sheriati është shpallja nga Allahu, e zbritur Pejgamberit, a.s., të cilin Ai e ka urdhëruar ta komunikojë njerëzimit. Shpallja ndahet në dy pjesë: Kurani Famëlartë, i zbritur me fjalë dhe kuptim nga Allahu, xh.sh., të cilit njerëzit nuk mund t'i bëjnë të ngjashëm, dhe Suneti.

Suneti i Pejgamberit, a.s., përbëhet nga thëniet, veprat dhe pëlqimet e tij. Kuptimi i Sunetit është nga Allahu xh.sh., ndërsa fjalët janë të Pejga-

<sup>78</sup> Ebu Hamid El Gazali, *El Mustesfa min Ilmi'l-usul* (Muthanna, Bagdad, 1970), sipas: Tarik Ramadan, *Të jesh mysliman evropian*, Logos A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2011, f. 122-123.

<sup>79</sup> Për shembull, sahabët vendosën të lëshojnë monedha, të ngrenë burgje dhe të paguajnë taksa mbi tokën bujqësore, pavarësisht se nuk ka tekste për këto masa. Shih: Al Aluani, Taha Džabir, *Etika neslaganja u islamu*, op. cit., f. 147!

mberit a.s., me qëllim që të sqarojnë Kuranin: “...*Ty ta zbritëm Kuranin, që t'u shpjegosh njerëzve atë që iu është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kuranin).*” (*En Nahl, 44*).

Në këtë ajet, Allahu ka sqaruar detyrën e Sunetit të Pejgamberit, a.s. Për rrjedhojë, dispozitat direkte të Kuranit dhe Sunetit përbëjnë Sheriatin; ato janë të pandryshueshme, të përhershme, nuk përfundojnë, janë mbrojtur edhe pas ndërprerjes së shpalljes dhe përfundimit të saj, nuk mund të ndryshohen dhe nuk mund të vjetrohen.<sup>80</sup>

Allahu, xh.sh., në Kuranin fisnik thotë: “*Ne e shpallëm Kuranin, dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.*” (*El Hixhër, 9*)

Nga kjo rrjedh se ekziston një dallim midis Sheriatit dhe Fikhut. Fikhu është produkt i mendimit dhe shtjellimit njerëzor; më saktësisht, ai përfaqëson një gjendje të të menduarit ligjor të arritur nga studiuesit myslimanë në një kohë dhe kontekst të caktuar, në dritën e studimit të tyre mbi Sheriatin.

Fikhu është kryesisht një produkt i arsyes njerëzore, i cili lidhet me të kuptuarit dhe njohjen njerëzore. Përmes arsyes, njeriu zbulon Sheriatin dhe udhëhiqet nga udhëzimet e tij themelore në kërkim të zgjidhjeve për çështje të veçanta ose të reja. Ai është një shprehje e përpjekjes racionale dhe, si produkt i gjykimit njerëzor, autoriteti i tij është më i vogël se ai i Sheriatit.<sup>81</sup>

Shkenca juridike bazohet kryesisht në rregulla dhe parime të zhvilluara nga gjykimi njerëzor (*ixhtihad*). *Fikhu*, pra, mund të ndryshojë nga një jurist te tjetri dhe nga një medhheb te tjetri.<sup>82</sup>

**Fikhu**, fjalë për fjalë, do të thotë kuptim. Vetë termi *el-fikh*, i cili emëron veprat e juristëve myslimanë, zbulon shtysën origjinale për shfaqjen e tij. Folja *fekihe/jefkahu* do të thotë të kuptosh, të marrësh vesh, të arsyetosh, prandaj forma e saj emërore *fikh* do të thotë kuptim dhe gjithashtu mund të nënkuptojë edhe shkencë.

<sup>80</sup> Hayreddin Karaman, *Historia e së Drejtës Islame, nga fillimi deri në kohën tonë*, op. cit., f. 355.

<sup>81</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo, Uporedna religijska prava*, op. cit., f. 74.

<sup>82</sup> Al Aluani, Taha Džabir, *Etika neslaganja u islamu*, op. cit., f. 144.

Në këtë kuptim, fjala *fikh* është përdorur edhe në Kuran: “...Ç’është me këtë popull që nuk kupton gati asnjë send?” (*En-Nisa*, 78); “Ata thanë: ‘O Shuajb, ne nuk po e kuptojmë shumicën e asaj që thua, dhe ne të konsiderojmë ty të dobët në mesin tonë, dhe sikur të mos ishte ai grupi yt, ne do të të gurëzonim, sepse ti nuk je i çmuar ndër ne’.” (*Hud*, 91).

Ky term shfaqet në Kuran në njëzet vende, veçanërisht në ajetet që përshkruajnë gjendjen e mosbesimtarëve dhe marrëdhëniet e tyre me Shpalljen, duke theksuar moskuptimin e saj. Megjithatë, vetëm në një vend në Kuran, termi *fikh*, në formën foljore *tefe’aale*, është përdorur në kuptimin e shkencës fetare: “Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ata, në mënyrë që ata të kuptojnë.” (*Et-Tevbe*, 122).

Fikhu (a. *Fikh*), një fjalë që fillimisht do të thoshte kuptim, njohuri dhe marr vesh, dhe që zbatohet në të gjitha degët e dijes (p.sh. *fikh el luga* - leksikografi), u bë një term teknik i përdorur për të treguar shkencën juridike, shkencën e së Drejtës Fetare Islame. Termi *fikh* përdoret në shfrytëzimin e pavarur të inteligjencës, për vendimet e çështje ligjore me gjykim personal, në mungesë ose në rast të mosnjohjes së rregullit tradicional për rastin e dhënë, për çështje të caktuara.<sup>83</sup>

Terminologjikisht, fikhu është shkenca e dispozitave praktike të shariatit, e të cilat derivojnë nga provat e tij të pjesshme dhe të hollësishme.<sup>84</sup> Fikhu e ka burimin në shpalljen hyjnore dhe në përpjekjet intelektuale fetare të dijetarëve myslimanë (*ixhtihad*). Nga aspekti i përfshirjes, dedikimit dhe llojllojshmërisë, ai është unik dhe nuk mund t’i gjendet ngjashmëri të asnjë popull tjetër dhe në asnjë fe të ardhur nga ndonjë pejgamber tjetër.<sup>85</sup>

<sup>83</sup> Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, op. cit., f. 186.

<sup>84</sup> *Kitabut-ta’rifat*, str. 216, sipas: Šukrija Ramić, *Temeljni principi idžtihada u islamskom pravu (fikh) i značaj njihove primjene u savremenom dobu*, shih: [http://ipf.unze.ba/fileadmin/user\\_upload/TEKSTOVI/ZBORNİK\\_6\\_2\\_.pdf](http://ipf.unze.ba/fileadmin/user_upload/TEKSTOVI/ZBORNİK_6_2_.pdf)

<sup>85</sup> Hayreddin Karaman, *Historia e së Drejtës Islame, nga fillimi deri në kohën tonë*, op. cit., f. 25.

Fikhu fillon me rregullimin e raporteve midis Allahut Fuqiplotë dhe robit, duke vazhduar me namazin, agjërimin, zeqatin, haxhxin, si dhe pastrimin nga papastërtitë e dukshme dhe të padukshme (*papastërtia fetare – xhunubllëku dhe papastërtia për adhurim – të qenët pa abdes*), syneimin, veshjen etj. Politeistët e Mekës ishin habitur me gjithpërfshirjen e tij, prandaj njëri prej tyre kishte thënë: “Njeriu juaj (*Pejgamberi, a.s.*) ua mëson çdo gjë juve, madje edhe si të shkoni në nevojtores?” Selman El Farisiu, r.a., i ishte përgjigjur: “Po, është e vërtetë. Ai na ka ndaluar që dikush të pastrohet pas nevojës së madhe me dorën e djathtë, të kthehet nga Kibla gjatë kryerjes së nevojës dhe ka urdhëruar që të pastrohemi pas saj...”<sup>86</sup>

Fikhu është, pra, sistemi juridik i Islamit, i ndërtuar nga përpjekjet intelektuale të juristëve që synojnë interpretimin dhe përkthimin në realitet të urdhrave të Ligjit Islam (*shariatit*). Orvatja njerëzore për të shpjeguar Ligjin Islam dhe përpjekja për të nxjerrë nga dispozitat dhe parimet e përgjithshme të Kuranit dhe Sunetit rregullat individuale dhe të hollësishme, përgjithësisht quhet ixhtihad apo fikh, sipas disa juristëve.<sup>87</sup>

Fikhu përfaqëson shumën e interpretimeve, deduktimeve dhe mendimeve juridike të dijetarëve myslimanë (*ulema*), veçanërisht atyre të rangut më të lartë – muxhtehidëve, të cilët kanë treguar kompetencë dhe pavarësi të mjaftueshme në mendim.<sup>88</sup>

Nëpërmjet popullit mysliman dhe teksteve të tyre të shenjta- Kuranit dhe Hadithit- zuri vend një oqean i tërë i *fikh*-ut, në të cilin vetëm ulemaja ishte kompetente dhe e aftë për të “lundruar”.<sup>89</sup>

Sheriati sikurse u theksua, ka burimin në shpalljen e Zotit, të shprehur me fjalë dhe kuptim (Kurani), ose thjesht kuptim (Suneti), dhe përbën pjesën e përhershme të sistemit ligjor Islam. Kështu, ai si një rrugë e shpa-

<sup>86</sup> Po aty, f. 25.

<sup>87</sup> Fikret Karciq, Studime për të drejtën e sheriatit dhe institucionet, op. cit., f. 34.

<sup>88</sup> Abdulhamid A. Ebu Sufjan, *Drejt një teorie islame për marrëdhëniet ndërkombëtare*, Logos A, Shkup, 1419/1998, f. 8.

<sup>89</sup> Ziauddin Sardar, *Përtej dogmës, Islami në kohët postmoderne*, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2010, f. 39.

llur dhe e pandryshueshme, është krejt ndryshe nga fikhu, i cili, për t'i mbetur besnik funksionit të vet, duhet të jetë dinamik, në zhvillim të vazhdueshëm, ngase zhvillimi është karakteristikë e botës sonë.<sup>90</sup>

Sheriati nuk përkufizohet vetëm me kodin penal, ai është një element, një pjesë e rrugës së përgjithshme, e metodologjisë dhe e filozofisë së jetës.<sup>91</sup>

Ibën Kajjimi për Sheriatin thotë se është “Drejtësia e Allahut dhe mëshirë mes krijesave, hija e Tij në Tokë dhe urtësia që udhëzon tek Ai.”<sup>92</sup>

Fikhu paraqet produktin e mendimit dhe shqyrtimit njerëzor; ai është një gjendje e reflektimit juridik të arritur nga dijetarët myslimanë në një kohë dhe kontekst të caktuar, në dritën e studimit që ata i kanë bërë shariatit.<sup>93</sup>

Fikhu gjithashtu nënkupton se rregullat e tij, të nxjerra nga Kurani dhe Suneti nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me argumentet origjinale, domosdoshmërisht përmbajnë një masë të caktuar të gjykimit të lirë dhe përpjekjes intelektuale (ixhtihad).<sup>94</sup>

Fikhu në fillim nuk ishte emërtim i ndonjë disipline të veçantë apo sistemi objektiv, por thjesht emërtim i procesit ose i veprimtarisë së të kuptuarit. Ai është diçka subjektive, sepse shpreh të kuptuarit personal të ndonjë dijetari.<sup>95</sup>

Me restaurimin e metodologjisë islame (d.m.th., të lidhjes së ndërsjellë të sunetit, ixhtihadit dhe ixhmait), fikhu nga një veprimtari individuale u shndërrua në disiplinë të strukturuar, rezultat i së cilës ishte sistemi i dijeve. Ai është standardizuar dhe konstituuar si sistem objektiv. Fikhu u bë ilm/shkencë,<sup>96</sup> për t'i kuptuar burimet themelore të fesë: Kuranin dhe

<sup>90</sup> Tarik Ramadan, Të jesh mysliman evropian, op. cit., f. 97.

<sup>91</sup> Po aty, f. 96.

<sup>92</sup> Ibrahim Džananović, *Fikh u vrijeme Muhammeda alejhi selam*, Islamska misao, viti VII, nr. 84, Decembar, 1985, Sarajevo, f. 10.

<sup>93</sup> Tarik Ramadan, Të jesh mysliman evropian, op. cit., f. 97.

<sup>94</sup> Mohammad Hashim Kamali, *Zakon i društvo, Uporedna religijska prava*, op. cit., f. 74.

<sup>95</sup> Fazlur Rahman, Islami, op. cit., f. 226.

<sup>96</sup> Po aty, f. 229.

Sunetin E Pejgamberit, a.s., dhe në nxjerrjen e normave dhe të dispozitave shariatike prej tyre.

Ligji islam nuk është i dhënë në një formë të gatshme, por duhet të ndërtohet në mënyrë krijuese dhe në bazë të burimeve të njohura.<sup>97</sup> Kjo detyrë bie mbi dijetarët (ulemanë), d.m.th., njohësit e fikhut (fukahanë).

Fikhu përfshin njohjen e dispozitave të Zotit në lidhje me veprimet e detyruesve të atyre normave (*mukelef*), sikurse janë: urdhëresat, ndalesat, veprat e lavdërueshme dhe të qortueshme, pastaj lejimet, të gjitha të nxjerrra nga Kurani dhe Suneti, në bazë të argumenteve të vlefshme. Këto dispozita që përfitoen nga prova të tilla quhen fikh.<sup>98</sup>

Në këtë shkencë shqyrtohen të gjitha veprimet e të rriturve nga pikëpamja e shariatit dhe përcaktohet nëse një veprim duhet ose nuk duhet të bëhet sipas rregullave fetare, nëse i lejohet ose jo, nëse është i lirë ta bëjë atë, ose nëse është një veprim i lavdërueshëm apo i shëmtuar për t'u kryer.<sup>99</sup>

Në përvojën historike të Islamit, funksionet e interpretimit dhe formulimit të ligjit, si dhe zbatimi i tij, janë ndarë. E para u krye nga individë të ditur jashtë strukturave shtetërore dhe shpesh në konflikt me to, ndërsa funksioni i dytë – zbatimi i ligjit – i përkiste vetë qeverisë.<sup>100</sup>

Madje, konsiderohej se ligji i paraprin shtetit dhe shoqërisë dhe se funksioni themelor i shtetit ishte të zbatojë ligjin e formuluar nga studiuesit,

<sup>97</sup> Bernard Weiss, *Interpretation in Islamic Law: the Theory of Ijtihad*, "The American Journal of Comparative Law" XXVI (1978), str. 199, sipas: Fikret Karčić, *Šerijatsko pravo-reformizam i izazovi modernosti, hrestomatija tekstova i eseja*, <https://bosnamuslimmedia.files.wordpress.com/2009/08/06-dr-fikret-karcic.pdf>, op. cit. f. 9.

<sup>98</sup> Abd El Al Salim Mukrim, *Islamska misao između razuma i Objave u oblasti zakonodavstva*, Islamska misao, godina VI, broj 68, Avgust, 1984, Zul-ka'de – Zul-hidždže, 1404, Sarajevo, f. 18.

<sup>99</sup> Muhamed Serdarević, *Fikhul ibadat*, Sarajevo, 1968, f. 10.

<sup>100</sup> Fikret Karčić, *Šerijatsko pravo-reformizam i izazovi modernosti, hrestomatija tekstova i eseja*, op. cit. f. 9.

të cilin besimtarët janë të detyruar ta respektojnë, pavarësisht nga ekzistenca e autoritetit përgjegjës për zbatimin e tij.<sup>101</sup>

Sipas përkufizimit terminologjik, fekih është një person që e ka zotëruar këtë shkencë. "Ai është një dijetar (alim)", siç thotë Kalaxhi, "i cili i njeh rregullat praktike të sheriatit të hallallit dhe haramit, të saktës dhe të pasaktës."<sup>102</sup>

Fukahatë (juristët) e komunitetit mysliman jo vetëm që duhet t'u japin bashkëbesimtarëve përgjigje adekuate që përputhen me rrethanat e vendit dhe të kohës, por gjithashtu duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të formuar qëndrime individuale ose të përbashkëta, në mënyrë që të ruajnë lidhjen thelbësore midis anës absolute të burimit dhe relativitetit të historisë dhe gjeografisë.

Fikhu filloi të zhvillohej menjëherë pas vdekjes së Muhamedit, a.s. Para kalifit dhe njerëzve më të përgjegjshëm në shtetin e ri, të sapoformuar islam, u shtruan probleme të mëdha që duheshin zgjidhur. Dëshira ishte të zbatohet plotësisht mësimi islam dhe kjo nuk mund të bëhej pa u përmbushur zbrazëtirat juridike. Kurani jep parime të përgjithshme, kurse Muhamedi, a.s., me interpretimin e tij të këtyre parimeve të përgjithshme, sqaroi dhe detajoi shumë gjëra.<sup>103</sup>

Në kohën e hulefai-rashidinit, pyetje themelore kanë qenë ato të natyrës praktike, si të harmonizohet jeta me vullnetin e Zotit. Në fushën e interesimit të muxhtehidëve të kësaj periudhe, në masën më të madhe ishin çështjet me karakter moral, fetar-obligues dhe juridik. Kjo hapi rrugën për një ngushtim të mëvonshëm të kuptimit të fikhut.<sup>104</sup>

Ebu Hanifeh e përkufizon fikhun si "njohuri për të drejtat dhe detyrat e njeriut" (*ma'rifetun nefsi me leha ve ma alajha*).<sup>105</sup>

<sup>101</sup> Majid Khadduri, *From Religious to National Law*, u: Middle East: Eorl Center, ed. Ruth Nanda Anshen, Neë York, 1956, page. 221, sipas: Fikret Karčić, *Šerijatsko pravo-reformizam i izazovi modernosti, hrestomatija tekstova i eseja*, op. cit. f. 10.

<sup>102</sup> Mu'džemu lugatil-fukaha, f. 349, sipas: Šukrija Ramić, *Temeljni principi idžtihada u islamskom pravu (fikh) i značaj njihove primjene u savremenom dobu*, op. cit.

<sup>103</sup> Ibrahim Džananović, *Idžtiħad u prva četiri stoljeća islama*, Sarajevo, 1986, f. 11.

<sup>104</sup> Fikret Karcic, *Historia e së drejtës së sheriatit*, Prizren 1994, f. 42.

<sup>105</sup> *Tariħut tešri'*, përgatiti: Ibrahim, Muhammed Jusri, op. cit., f. 11.

Fikhu është një fjalë polisemike që ka kuptime të shumëfishta në arabisht. Fejruzabadi e përcaktoi atë si njohuri për diçka, kuptim për diçka dhe depërtim, dhe në fund ai deklaroi se kuptimi i kësaj fjale mbizotëronte për shkencën e fesë, për shkak të respektit që ajo gëzon.<sup>106</sup>

Fikhu ka bazat dhe rregullat e veta, të cilat rregullojnë argumentet e tij të përgjithshme, mënyrën e ixhtihadit dhe nxjerrjen e normave juridike prej tyre, si dhe kushtet në lidhje me ata që mund të marrin pjesë në këtë proces.<sup>107</sup>

Që besimtarët ta arrijnë shpëtimin dhe ta fitojnë kënaqësinë e Allahut, duhet t'i zbatojnë urdhrat dhe parimet etike dhe juridike islame.<sup>108</sup>

Me sheriat nënkuptojmë dispozitat e Allahut për të gjitha sferat e jetës. Kjo është bërthama. Kurse, ajo që juristët myslimanë, duke i hulumtuar dhe kuptuar këto dispozita kanë shpjeguar dhe shkruar, quhet fikh (fjalë për fjalë kuptimi diakronik i sheriatit dhe sjellja sinkrone e mendimeve juridike në një kohë), pra, është mbështjellësi i asaj bërthame. Bërthama është e përjetshme, e pandryshueshme, universale, kurse mbështjellësi dhe paketimi përcaktohet nga fuqitë dhe rrethanat njerëzore, gjithmonë në lidhje me bërthamën, që i nënshtrohet ndryshimit dhe përshtatjes. Në këtë fakt qëndron fuqia dhe universaliteti i Islamit, si një fe e përhershme që jeton dhe ripërtërihet.<sup>109</sup>

Pavarësisht nga besimi të myslimanëve për prejardhjen hyjnore të Sheriatit, e drejta pozitive<sup>110</sup> islame është rezultat i veprës dhe i formulit-

<sup>106</sup> *El Kamus El muhit*, f. 1126, sipas: Šukrija Ramić, *Temeljni principi idžtihada u islamskom pravu (fikh) i značaj njihove primjene u savremenom dobu*, op. cit.

<sup>107</sup> Sejfuđdin Abdulfetah Ismail, *Fetve o općim pitanjima ummeta i osnove civilizacijskog fikha*, shih: *Ustanova fetve u globaliziranom svijetu (Al iftau fil alem meftuh)*, op. cit., f. 33.

<sup>108</sup> Ekrem Sarikçioğlu, *Historia e feve prej fillimit deri me sot*, Logos-A Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2007, f. 641.

<sup>109</sup> Džemalutin Latić dhe Seid Smajkić, *Šerijat i njegov današnji značaj za Bošnjake*, Glasnik Rijaseta Islamske zajednice u Bosni i Hercegovini, nr. 1-2, Januar-Februar, 1997, Sarajevo, ibid, f. 51.

<sup>110</sup> E drejta pozitive është e drejta që krijon njeriu, d.m.th. ajo e drejtë që e sjell dhe e sanksion autoriteti përkatës përmes institucioneve të veta. Në aspektin etimologjik, termi “ligji pozitiv” e ka origjinën nga latinishtja “iuspositum”, që do të thotë “e drejtë e

mit njerëzor.<sup>111</sup> Mirëpo, nuk duhet harruar se ixhtihadi i muxhtehidëve, pra mendimet dhe qëndrimet e tyre, janë nxjerrë nga Kurani dhe Suneti, prandaj janë dispozita të fesë së Allahut, xh.sh., ligjit të Tij fetar me të cilin na ka obliguar<sup>112</sup>, ngase Allahu, xh.sh., ka thënë: **“... e përse nga çdo grumbull i tyre mos të shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ata, që ata të kuptojnë?!”** (Et Tevbe, 122).

E drejta kuptohet ndryshe nga shkencëtarët evropianë. Për shumicën prej tyre, fikhu – për shkak se nuk ka një term të barasvlershëm në gjuhët dhe sistemet evropiane – përkufizohet si një ligj fetar që rregullon marrëdhëniet e myslimanëve me Zotin, veten dhe të tjerët. Nga një këndvështrim, ky përkufizim përfshin pjesën më të madhe të asaj që perëndimorët e quajnë e drejtë, ndërsa nga një aspekt tjetër, vetëm një pjesë të saj.

Në fikh trajtohen aktet e adhurimit, çështjet e familjes, statusi personal, trashëgimia, të drejtat e pronës (përfshirë vakëfet), cilësitë e gjykatësve dhe procedurat gjyqësore, dënimet, si dhe sijeri (rregullat ndërkombëtare mbi paqen dhe luftën). Ai përfshin gjithashtu çështje që perëndimorët i konsiderojnë fetare, si besimi dhe zotimet, therja e kafshëve për konsum dhe flijim, rregullat mbi ushqimin dhe pijet e lejuara e të ndaluara, gjuetinë në tokë dhe ujë, si dhe normat mbi veshjen dhe zbukurimin.

Nga ana tjetër, në fikh nuk përfshihen çështje të rëndësishme të së Drejtës Publike dhe disa çështje të së Drejtës Private, sepse burimet e sheriatit (Kurani dhe Suneti) nuk kanë sjellë dispozita për to, sikurse është teoria e hilafetit dhe sulltanatit - dhe çështje të shumta në fushën e së Drejtës Administrative (e cila quhet *sijase sher’ijje*, që do të thotë ad-

vendosur”. Ligji pozitiv, ligji i vlefshëm; tërësi rregullash ligjore (norma) që janë në fuqi në një moment të caktuar.

<sup>111</sup> Kjo është e drejta e nevojshme, që të bëhet ndarja e qartë mes atij që në Islam konsiderohet si ligj i Zotit (Sheriat) dhe kuptimit njerëzor të atij Ligji (Fikhu). Ky është dallimi i përafërt që i përgjigjet dallimit *ius divinum* dhe *ius humanum* në ligjin kanunor, Fikret Karčić, *Šerijatskopravo-reformizam i izazovi modernosti, hrestomatija tekstova i eseja*, op. cit., f. 11.

<sup>112</sup> Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, Fikhu hanefi vëll. 1, f. 20.

ministrim i gjërave të përgjithshme, sipas rezultateve të ixhtihadit, me kusht që kjo mos të jetë në kundërshtim me Sheriatin).<sup>113</sup>

Me vendosjen e metodologjisë islame (d.m.th., të lidhjes së ndërsjellë të Sunetit, ixhtihadit dhe ixhmait) ndodhi një ndryshim radikal në karakterin e fikhut, i cili deri atëherë ishte veprimtari personale, kurse u shndërrua në disiplinë të strukturuar, rezultati i së cilës ishte sistem i dijeve. Ky sistem i dijeve, kështu standardizohet dhe konstituohet si sistem objektiv. Fikhu u bë ilm.<sup>114</sup>

---

<sup>113</sup> C. A. Nallino, Përsiatje për lidhjet e fikhut me të Drejtën Romake, shih: Fikret Karciq, Studime për të drejtën e sheriatit dhe institucionet, op. cit., f. 328.

<sup>114</sup> Fazlur Rrahman, Islami, op. cit., f. 229.

**Dr. Ajni SINANI**

## **SHARIA AND FIQH (2)**

### **Abstract**

Sharia is a revelation from Allah, which was received by the Prophet, who was ordered to communicate it to mankind. The revelation is divided into two parts: the Glorious Qur'an, which was revealed in words and meaning by Allah, and it is impossible for any human being to duplicate it, and the Sunnah. The Sunnah of the Prophet consists of his sayings, actions, and tacit approvals.

Consequently, the direct provisions of the Qur'an and Sunnah constitute the Sharia; they are immutable, permanent, never-ending, preserved even after the cessation of the divine revelation and its completion, cannot be changed, and cannot become obsolete.

Fiqh is the legal system of Islam, built on the intellectual efforts of jurists who aim to interpret and translate into reality the injunctions of Islamic Law. The human attempts to explain Islamic Law and the attempt to derive individual and detailed provisions from its general provisions and principles is generally called *ijtihad* or *fiqh* by some jurists.

Fiqh has its source in the sources of Islam and in the intellectual and religious efforts of Muslim scholars (*ijtihad*), and in terms of its comprehensiveness and diversity, it is unique, and nothing similar can be found among other peoples and other religions.

Despite the fact that *fiqh* is the result of human work and formulation, it should not be forgotten that the *ijtihad* of the *mujtahids*, that is, their thoughts and positions, are derived from the Qur'an and the Sunnah, and therefore are provisions of the religion of Allah, His religious law we are obliged to follow.

**Keywords:** *Islam, Qur'an, Sunnah, Sharia, Fiqh, worship, transactions, ijma, ijtihad, qiyas, mujtahid, maslaha, adat.*

### **III. KULTURË / TRASHËGIMI**



Hafëz Sabit ef. ZAIMI

Myderriz i Vushtrrisë

## ME SHKAS (HASBIHAL)\*

*Të nderuar vëllezër dhe motra myslimane,*

E shoh të arsyeshme t'i them disa fjalë rreth paraqitjes së femrës me fytyrë të shpluar dhe me mantel (pardesy). Meqenëse nga mungesa e njerëzve të ditur unë radhitem si i ditur, atëherë do t'i them disa fjalë rreth reformave të kësaj kohe:

Të gjitha fetë qiellore, njerëzit i kanë ftuar të besojnë në besimin në një Zot (tevhîd) dhe në qytetërim (medenijjet). Këtë urdhër ata kanë vazhduar t'ua lënë amanet popujve pasues të tyre deri në Ditën e Kiametit. Në të vërtetë, në fillim (kur u krijua njeriu i parë-shën. yni) nuk kishte mosmarrëveshje dhe kundërshtime në fe, sepse në prizmin e Islamit të gjithë njerëzit janë të barabartë. Në fakt, Islami ka ardhur të ndërtojë dhe krijojë barazi, dhe kjo nuk do të ndryshojë deri në Ditën e Kiametit, sepse ky është Ligj Hyjnor. Filozofët botërorë, Zotërinë tonë, Muhamedin, a.s., e kanë radhitur dhe e kanë cilësuar edhe si “filozofi më i madh”, prandaj nuk dua të vijoj më tutje për pa i cituar këto fjalë të Muhamedit, a.s.:

يا عباد الله كونواخوانا

*“O ju robër të Allahu, bëhuni vëllezër!”<sup>1</sup>.*

---

\* Titulli i këtij punimi në origjinal është “*Hasbihâl*”, që, në të vërtetë, domethënë fjalim i domosdoshëm në rast nevojë, përkatësisht zhvillimi i një fjalimi sipas paraqitjes së rrethave kohore (shih: Dr. Hüseyin Remzî Altınbilek, *Lugat-i Remzî*, Stamboll 1305/1887, bot. Matbaâ Hüseyin Remzî, f. 440), mirëpo, ne e pamë më të drejtë që ta përkthenim “*Me shkas*”.

<sup>1</sup> Transmeton Muslimi.

Falënderimi i takon Zotit që ne u deklaruar dhe thamë se jemi myslimanë, por *për se* dhe *nga se* përbëhet myslimanllëku, këtë nuk u përpoqëm që ta mësonim; kaluam ditët tona, shkuam në gjumë dhe u zgjuam, por asnjëherë nuk e kuptuam sa veta kemi në mesin tonë që, për hir të Allahut, e njohin plotësisht fenë? A ka gjë më të lehtë sesa ta dëshmosh dhe të deklarosh se je mysliman, dhe këtë duke e thënë vetëm me fjalë (gojë), po edhe duke marrë abdes, duke falur namazin etj. Natyrisht, nuk ka gjë më të lehtë se kjo! Por paraardhësit tanë nuk ishin kështu. Ata e dinin se njerëzve që punojnë, u ndihmon Zoti, dhe kjo ishte edhe forma e besimit të tyre në Zot. Trashëgimia vakëfnore, në përgjithësi, duke filluar nga xhamitë, medresetë dhe teqetë, a nuk janë gjurmë të tyre? Prandaj, ata nuk u mjaftuan vetëm me të shprehurit dhe deklaruarit vetëm me gojë se ishin myslimanë, por njëkohësisht vazhduan duke na lënë gjurmë të dobishme dhe një trashëgimi të begatë që edhe sot ekziston.

Ata ishin të shpërblyer dhe të laureuar nga urtia dhe sekreti i fjalëve të shenjta pejgamberiane, të haditheve, të cilëve ata u besuan duke i vërtetuar njëkohësisht edhe me veprat e tyre. Në mesin e këtyre haditheve bëjnë pjesë edhe hadithi:

المؤمنون لا يموتون

*“Besimtarët nuk vdesin!”*

Dhe hadithi:

خير الناس من ينفع الناس

*“Më i miri ndër njerëz është ai që është më i dobishmi për ta!”<sup>2</sup>*

Paraardhësit tanë ishin vetë kujtesa dhe shembulli i kohës së lumtur, transmetues të kohës së Pejgamberit, a.s. Trupat e tyre u varrosen dhe u bënë dhe e pluhur. Ata asnjëherë nuk ecën dhe nuk menduan vetëm me zemër njeriu, po ashtu kurrë nuk u orientuan sipas kundërshtarit dhe të panjohurit. Prandaj, ai që për fenë e tij vepron krahas për të dyja botët, pra për dobi të kësaj dynjaje dhe për hir të ahiretit, ai është një udhëzues i denjë dhe i drejtë, ndërsa ai që jepet e kapet vetëm për njërën prej tyre, atëherë ai është injorant, nuk e kupton të vërtetën e fesë, nuk e do dhe e

<sup>2</sup> Transmeton Taberaniu.

fsheh atë. Për t'i vërtetuar këto që i thamë, duhet t'i dëgjojmë dhe t'i analizojmë edhe disa nga ajetet e Kuranit fisnik, si:

و ان ليس للانسان الا ما سعى

**“Dhe se njeriut nuk i takon tjetër, përveç asaj që ka punuar!”<sup>3</sup>**

يحسب الانسان ان يترك سدى

**“A mos mendon njeriu se do të lihet duke mos zënë asgjë (pa kurrfarë përgjegjësie).”<sup>4</sup>**

هو الذي جعل لكم ما في الأرض جميعاً

**“Ai (Allahu) është që për ju krijoi gjithë ç’ka në Tokë”<sup>5</sup>**

Dhe ajeti:

ألم تروا ان الله سخر لكم ما في السماوات و ما في الارض

**“A nuk e dini ju se Allahu nënshtroi për të mirën tuaj ç’ka në qiej dhe ç’ka në Tokë”<sup>6</sup>**

Me një fjalë, njerëzit janë dëshmitarë të shumë ajeteve, haditheve dhe ngjarjeve të ndryshme ku mund të kërkojnë dhe të nxjerrin të vërtetën.

“اطلب العلم من المهد الى الحد”

**“Kërkoni diturinë nga djepi deri në varr!”**

Sheriati i Muhamedit, a.s., urdhëron kërkimin e diturisë nga djepi deri në varr. Ky ligj urdhërohet i përgjithësuar, duke mos i veçuar gratë.

أنتم اعلم بأمر دينكم

**“Ju jeni më të ditur për çështje të kësaj bote (dynjallëk)!”<sup>7</sup>**

Këto hadithe peygamberiane janë të thëna për rregullimin dhe sistematizimin e çështjeve të përgjithshme, si dhe për reformat e çështjeve aktuale të kësaj bote, pra duke mos i lënë hapësirë stopimi dhe përdhosjeje

<sup>3</sup> Kuran, En Nexhm, ajeti 39.

<sup>4</sup> Kuran, El Kijame, 36.

<sup>5</sup> Kuran, El Bekare, 29.

<sup>6</sup> Kuran, Llukman, 20.

<sup>7</sup> Transmeton Muslimi.

nga asnjë çështje tjetër të çastit ose ndërhyrje e mendimit të kotë. Kjo është forma më e përshtatshme dhe më e sigurt për depërtimin e lirë të reformave të shumta përparimtare, të cilat burojnë nga qytetërimet. Si shembull për këtë që themi, mund ta marrim Zejd bin Selemen, i cili ndërsa mbillte një pemë në kopshtin e tij, atë e pa Hazreti Ymeri, r.a., dhe i tha:

“Aferim, të lumtë, jeni më i shkathëti nga mesi i njerëzve, për të cilët më vonë ka për të dëshmuar feja jote! Mirëpo, dije gjithashtu se edhe ndër njerëz do të jesh i nderuar!”.

Të përvetësojmë diturinë dhe shkencat, sepse dituria dhe shkencat nuk janë pronë e askujt. Përvetësimi i këtyre dy cilësive nuk paraqet ndonjë ndalesë fetare.

الحكمة ضالة المؤمن يأخذها من سمعها ولا يبالي من أى وعاء خرخت

*“Urtësia është (pasuri) e humbur e besimtarit, të cilën duhet ta marrë kudo që ta dëgjojë dhe pa i interesuar se nga cila enë rrjedh ajo.”<sup>8</sup>*

Dhe hadithi tjetër:

خذوا الحكمة ولو من أفواه المشركين

*“Merreni urtësinë, po qoftë edhe nga goja e jobesimtarëve!”*

Shkrimtari dhe filozofi francez Çarls Mismër (Charles Mismër (1832-1904) - shënim ynë) ka thënë se: “Feja islame i bëri dobi botës, për këtë shkak, Evropa fenë islame e mori dhe e radhiti në kuadër të feve të mbrojtura (me ligj)”. Këtë e vlerësojnë dhe kështu mendojnë edhe disa në mesin tonë, e në mesin e atyre që e vlerësojnë fenë, sikurse filozofi francez, me modesti e them se jam edhe unë personalisht.

*Vëllezër dhe motra,*

Duhet të mendojmë se tanimë jetojmë në qytetërimin e shekullit XX. Edhe nëse nuk do të punosh ti, shteti nuk të lë ty të veprosh kokë më vetë, thjesht nuk të lejon të vendosësh ti vetë për veten tënde, si p.sh. të thuash: “unë nuk shkoj në shkollë”, “unë nuk mund ta zbuloj fytyrën”, “unë nuk mund të vesh mantel (pardesy)”, sepse veprimi i këtyre gjërave vet-

<sup>8</sup> Transmeton Tirmidhiu.

vetiu krijon dhe ndjell gjak në myslimanllëk (islam). E di që do të më thuash: “I dashur, Kiameti është afër, prandaj çfarë më duhet mua kjo dynja?!”. Për fat të keq, njerëzit me një mendësi të tillë në mesin tonë, na fusin në injorancë dhe në kotësi! Në këtë mënyrë vetëm na helmojnë me ndjen dhe mendimet (idetë) tona. Lexojini ajetet në vijim, të cilët dëshmojnë se nuk ka asnjë kufizim kur flitet për përparimin e njeriut.

قل من حرم زينة الله التي اخرج لعباده والطيبات

**“Thuaj: “Kush i ndaloj bukuritë dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robërit e vet?!”<sup>9</sup>**

Duhet t’i lexosh, sepse këto janë ajete që dëshmojnë se nuk ka asnjë kufizim kur flitet për përparimin e njeriut.

Ka kaluar shumë kohë deri sot nga kur u zbulua Amerika, telegrafi, telefoni, makina me avull, të cilat, që të gjitha, në fillim nga masa janë pranuar si çmenduri dhe me shumë akuza. Sepse njerëzit kur dëgjuan për herë të parë këto zbulime thanë se këto janë zbulime të ndaluara. Në Islam nuk ka asnjë gjë që i dëmton të drejtat dhe liritë e njeriut. Të gjitha ligjet dhe rregulloret e tija janë të përputhura sipas nevojës, pra, ato janë të përputhura në plotni sipas kërkesave të kësaj bote dhe në pajtim me lirinë. Nga kjo që u tha më sipër, nënkuptohet se lumturia nuk po ik nga ne, porse ne po ikim nga ajo.

Sipas Sheriatit (ligjit) të shenjtë të Muhamedit, a.s., në rrethana të ndryshme kohore janë pranuar dhe praktikuar reforma të ndryshme, bile edhe dispozitat (ahkâm) kanë pësuar ndryshime dhe zëvendësime sipas nevojës, për këtë mund të gjejmë me qindra shembuj. Fjala vjen, te “Paqja e Hudejbisë”, kur Pejgamberi, a.s., u detyrua t’i pranonte kushtet e rënda! A nuk ishte ky një rezultat politik? Si argument për këtë e kemi edhe ajetin kuranor:

فعلم ما لم تعلموا

**“Pra, Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit.”<sup>10</sup>**

<sup>9</sup> Kuran, A’raf, 32.

<sup>10</sup> Kuran, El Fet’h, 27.

Gjithashtu këtë që po themi e gjejmë edhe tek praktika e Pejgamberit, a.s., siç ishte rasti i asaj gruas që vodhi në luftë dhe të cilës nuk iu pre dora, edhe pse ky akt ishte i sanksionuar me normativa të qarta hyjnore.

Edhe pas Pejgamberit, a.s., saktësisht janë të vërtetuara veprimet e sahabëve gjatë rasteve dhe ndërmarrjeve të reja në përputhje me kohën, si p.sh:

- Hazreti Ymeri nuk ua preu dorën vjedhësve në kohët me varfëri të rëndë dhe me kushte të rënduara ekonomike;
- tubimi i Kuranit në kohën e hazreti Osmanit, r.a.;
- ndryshimi (zëvendësimi) i shkrimit të Kuranit nga lloji i shkrimit “kûfî” në llojin “nes’h”;
- ndërtimi i minareve;
- ndryshimi i rregullores mbi pagesën për punët dhe detyrat që kishin të bënin me fushat dhe aktivitetet fetare, si pagesa për detyrën e imamit, mualimit dhe detyrat e tjera të cilat kryheshin nëpër medrese dhe institucione të tjera fetare, të cilat gjeneratat e para në fillim i kryenin pa shpërblime, ndërsa po këto detyra nga ulemaja e mëvonshme u lejuan që të kryheshin me shpërblim të caktuar;
- transformimi i “shtatë kiraeteve” në llojin “mutevâtir”;
- shfaqja e katër medhhebeve (shkollave-drejtimeve juridike islame):
- ndarja nëpër shumë tarikate (drejtime);
- lejimi i shkurtimeve të namazit në dy reqate gjatë udhëtimit;
- në rastet e mos gjetjes së ujit, lejimi i zëvendësimit të ujit me dhe, respektivisht pastrimi me tejemum;
- lejimi i mosfaljes së namazit për gratë gjatë ditëve të tyre;
- fetvaja e Meshihatit Islam mbi lejin e marrjes dhe dhënies së parave me kredi për myslimanët që jetojnë në shtete të huaja, etj...

Në fenë tonë nuk ka shekull, por ka gjithmonë lehtësi, këtë e dëshmon ajeti kuranor:

بِكُمُ الْيُسْرَةَ يُرِيدُ اللَّهُ

*“Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju.”<sup>11</sup>*

<sup>11</sup> Kuran, El Bekare, 185.

Gjithashtu edhe në kushtet e Islamit, të cilat janë pesë dhe ato të imanit, të cilat janë gjashtë, çështja (meseleja) e mbulesës nuk bën pjesë tek asnjëra nga këto, dhe në përputhje me këto rrethana, themi se mbulesa nuk është pjesë e imanit. Sipas pajtimit të juristëve (fakihëve) të shkollës juridike hanefite është dhënë dispozita se për gruan myslimane, pjesët e trupit si fytyra, duart dhe këmbët nuk janë pjesë të turpshme (avret), pra lejohet të shihen. Ndërsa kur është fjala te mbulimi me çarçaf, të veshësh mantel (pardesy) në zëvendësim të çarçafit, nuk ka asnjë ndalesë ose pengesë sipas ligjit të Sheriatit.

Ne myslimanët duhet që të mos i vendosim fytyrës së burrave apo të grave perde (mbulesë), porse këto perde duhet t'ia vendosim syrit të tyre, sepse perdia e vërtetë është pikërisht kjo.

Para tri dekadash, diku në një gazetë të Egjiptit, kam lexuar të shkruhej:

“Sot në xhematin islam janë dy gjëra të vërteta dhe të prera, e ato janë:

**E para**, qytetërimi i sotëm, për sa u përket të gjitha feve, nuk dëshiron një shkatërrim të tërësishëm të tyre, sepse botërisht pranohet se disa nga fetë janë shkas dhe sebeb në përhapjen e qytetërimit.

**E dyta**, qytetërimi modern nuk mund ta përballojë rrugën e përparimit të feve. Bazuar nga kjo që thamë, atëherë fetë duhet të veprojnë dhe të paraqiten qetë dhe të bëhen anë përfaqësuese dhe përkrahëse të përparimit dhe të së mirës. Përndryshe, shkatërrimi i jetës së besimtarëve dhe humbja e tyre do të ndodhë patjetër”.

Kjo rrjedh sipas mendimit dhe ideve të njerëzve më të mëdhenj, të cilët u bazuan në hadithin:

ما يزع الله بالسلطان أكثر مما يزع بالقرآن

*“Zoti e largon më shumë pushtetin sesa e largon përmes Kuranit”.*

Marrë nga: “Glasnik”, nr. 4-6, Sarajevë 1951, f. 156-158.

Shqipëroi nga gjuha osmane:

**Hatixhe AHMEDI**

### ﴿ حېچال ﴾

مسلمان قرداش و قیز قرداش: مسلمان قادينڭ آچيڭ يوزله و ماخلو ايله چيڭمه لري  
چتنده بر قاچ سوز سوله مکه زوم كوريبوروم. مادامكه ادم قيتلندن علما صنفندن كوريبوروز.  
بتون اديان ساويه انسانلري توحيد و مديته ديهوت ايتشيلرد. و بر امري قيامت دكين  
امتارينه وصيت ايدوب كيتشيدلر. اساساً اصل دينده اولدن اختلاف يوق ایدی. اسلاميت  
نقطه نظرندن بتون انسانلر مساويدير.

اساساً مسلمانلق تاسيس مساوات ايچون وضع اولغش الى قيام الساعة لا يتغير بر  
قانون اللهدير. جهان فيلسوفلري بيوك حكيم ديه تقدير ايتدكارى (حضرت محمد) صلعم  
افنديزك شو سوزلريني سوله مدن كچه ميه چكم (يا عباد الله كونوا اخواناً) اى الهك قوللري  
قرداش اولكز. ياللكز مسلمانم الحمد لله دينڭ اما: مسلمانلق نه دن عبارت اولديغنى  
او كز نكچه چاليشماق. ياتدق. اويودق. الله ايچون آره مزده تماماً ديني بيلان قاچ داننه. ز  
وار؟ مسلمانم ديمكله. آبدست آلمق. ناز قيلمق. مسلمانلق اولايدي اوندن ده قولاى  
برش اولامازدى. ده ده لوز. بويه دكلوردى. چالیشان كيمنه لره الهك ياردم ايتديكيني بيلير  
و اوييله ايتان ايدلوردى. جوامع، مدارس، تكيابا، بالعموم اوقاف هپ اونلرك آتارى  
دكلى؟ ياللكز مسلمانم ديمكله قالاديلر، خيلى آثار وجوده كتورديلر. (المؤمنون لا يموتون)  
سرينه مظهر و (خير الناس من ينفع الناس) حديث شريفنه ما صدق اولديلر. زهى سعادت،  
اوت واقعا كنديلري اولدى. حيات چمانه لري دفين تراب اولدى. و فقط بشرينك  
قابندن، اخلافك يادندن هيچ بر زمان كيتمز اولديلر. شوالده (دين) نفع دينوي، و نفع  
اخروي بي جامع بر دستور العملدر ياللكز بريسته حصر جهلدر. و دينك حقيقتى اكلامامق  
وكم ايتكدر. ذاتاً دين بتون ترقياتك أس الاساسيدر. قيل قدر مانع ترقى دكلدر. بر  
دعواني اثبات ايچون شو بر قاچ آيت جليله في دخي ديكله ييلم. (وان ليس للانسان الا ما  
سمى، ايحسب الانسان ان يترك سدى. هو الذى جعل لكم ما فى الارض جميعاً، الم تروا  
ان الله سخر لكم ما فى السموات و ما فى الارض) آيات كوريله لريني دوشوندلم. بر آيات  
جليله ده كى (كم) ضميرينك مخاطبي اكر انسانلر ايسه بر عموميتله « بر انسان دكلير »

ديککمز لازم کليز. چونکي بز ږده و کوکده کي شيلري تسخير ايدو مدک بالعکس هرشي بزى تسخير الشهدر. خلاصه انسانلري طريق سيعه سوق ايدن بر جوق آيات و احاديث و شواهد موجوددر.

(اطلبو العلم من الهدى الى النور) بشيکدن لځده قدر تحصيل علومى امر ايدن شريعت محمدية قادينلري دغى بر امر دن استاثنه البته مشدر. (انتم اعلم بامور دنياکم) کي احاديث نبويه انتظام امور عامه و مصالح دينويه ايچون باينلمسى ايجاب ايدن هيج بر امر معقولدن کير و طور ميه رق هر دورلو اصلاحات و ترقيات مدينه تايمينه سريست بر اقمده در. از جمله (زيد ابن سلمه في) تارلاسنده آغاچ ديککرن کورن حضرت عمر رضى الله عنها (آقرين، خلقن مستغنى اوله که دينک مستحکم اولور. ککندکده بين الناس مکرم اولوروسک) ديشدى. علوم و فنيونى آله لم، چونکي علوم و فنون کيمه زک مالى دکل. بونلري آفده بر محذور دينى يوقدر. (الحکمة ضالة المؤمن ياخذها من سمعها ولا يبالي من اى و عاء خرجت) ديکک (خذوا الحکمة ولو من افواه المشركين).

فرانسز فلاسفه ادباسندن موسيوسموسر دين اسلام جهانى مستفيد قيلدى. اونک ايچون بتون اروپا مسلمانلنى محافظه مدينه در. ديشدر. تقدير ايديدورده، بزمر اده مزده بعضر افرانسز قدردنه دينى تقدير دن عاجز بولنيوروز. دوشونلى بز قدراش، و قيز قدراش، بوکون کرمجى عصر مدينه شده ياشيوروز. سن ايشله مزسه ک بيله حکومت براقاز، چونکي حکومت ملت باباسيدر. سنى خود بخود براقاز، بن مکتبه کيده مم، بن يوزمى آچهمم، بن مانظلو کيمم، ديه مسلمانلقدن دم اوروز. آجانم قيامت يقين بکا دنيا نه لازم، بوفکرلى انسانلر اده مزده مع التاسف عوام ناسى جهالته، عطالته سوق ايدر. سنک عقلسى، فکرى تسميم ايددر. (قل من حرم زينة الله التي اخرج لعباده والطيبات) آيتنى اوقو سکا، انسانک ترقياتى ايچون برحد يوقدر.

زمان اولش انديکه آمر يقانک کاشنى، تلفرافک، تلفونک، بخار ماکنه سنک موجودى، جنون ايله اتهام ايدلشاردى. چونکي ناس بو سوزلري يکى دويونجه مهال عدايدنيوردى. اسلاميتده حقوق بشريه به مضر برش يوقدر. بتون احکامى مزاجه موافق، عدالته مقارن حريته مطابق، شوحاله بزدن سعادت قاچميور، بز سعادتدن قاچيوروز.

شریعت جلیله احمد یدده احوال زمان و عواملک اختلافیه احکامک دخی تحول و تبدله اوغرا دیتنه یوزلرله مثال بولق ممکتدر. از جمله حدیثیه مصالحه سی کبی آغیر شرطلرله طرف رسالتینا هیدن قبول بیورلش! بر سیاست نتیجه سی دکلی؟ (فعلما ما لم تعلموا). غزاده حدود الهیه دن اولان سارقک الی کسله دیکی فعل رسول ایله ثابت، کذا حضرت عمر رضی الله عنه قحط و غلاسنه لرنده سارقک الی کسله دیکی فعل و قضایله ثابت، حضرت عثمان رضی الله عنه زماننده قرآنک جمعی، قرآنک خط کوفیدن خط نسخه تبدلی مناره لک ایجادی، سلف حضراتنک امام، معلم، مدرس و هرکوتا وغاننک یاره سر ایفا ایدلکده ایکن علما. متأخرینک هپسنک اجرتله جوازی، قرأت سبعة نك متواترا نقلی، مذاهب اربعه نك ظهوری، طرق علیه نك متعدد یولره انقاسی، نازک حال سفوده ایکی به رخصتی، صوبولنا دینی وقت صویه بسدل طوپراق ایله تیسیمک جوازی، قادینلرک عادت زماننده نمازک هیدن عفو، اجنبی تحت اداره سنده یشایان مسلمانلرک فاضله پاره آلویپ ویره بیلرله دانه مشیخت اسلامیه نك فتوا سی.

دینورده عسریق، دانا یسرا (یرید الله)، شرائط اسلام که (۵) و شرائط ایمانکه (۶) تستر مسئله سی بونلرک هپج برنده داخل دکل بنا. علیه (تستر) ایمان دن دکلدرد. فقها. خنیه نك اتفاقیه مسلمان قادینک یوز، ال و ایاملری عورت اولدیتنه حکم ویرمشلردرد. چارشافه کتبیجه: چارشافک یرینه ماغلور کیلمسندده هپج بر محذور شرعی یوقدرد.

بز مسلمانلر: لرکک و قادین یوزه دکل، کوزه پرده ووره لم که حقیقی پرده ایشته بودرد. بوندن اوتوز سنه اول مصر غزته لرینک برنده اوقومشدم. بوکون جماعت اسلامیه د. ثابت اولان ایکی شی واردرد. برنجیسی شودرکه: مدینت حاضره ادیانی کلیا محوایتمک ایسته مز، زیرا اونلرک مدینته وسیله اولسی ده قابلدرد. ایکنجیسی شودرکه: مدینت ادیانک سیل ترقیسنده حائل اولسنه تحمل ایدم مز. بناء علیه ادیان ملایم داورانقالی و صلح طرافداری اولالیدرد. یوقسه موقی محققدر.

یوکلرک نظرلرینه حدیث (ما یزع الله بالسلطان اکثر مما یزع بالقران) جناب حق قران واسطه سیله دفع ایله دیکی منکراتدن، دها زیاده سلطان صولتیه دفع ایتسکده در.

ووچیتدن مدرسی

حافظ ثابت

Vehbi Sylejman GAVOÇI - Albani

## **PËRKTHIM I KUPTIMEVE TË KAPTINËS “EL ASËR”**

*Autori i këtij punimi është Vehbi Sylejman Gavoçi, i njohur edhe si Vehbi Sylajman El Albani. Ka lindur më 17 maj 1923, në lagjen Parrucë të Shkodrës. Në qershor të vitit 1937, ai së bashku me të atin e tij, Sylejman Gavoçin, si dhe vëllanë e tij Muhamedin, bashkë me familjet e tyre, mërguan në Damask-Siri. Në moshën trembëdhjetë vjeçare shkoi në Kajro të Egjiptit, ku studioi në universitetin e famshëm “Al Az’har”. Me t’u kthyer në Siri, në vitin 1949, nisi punën si mësues në shkollat e vajzave të qytetit të Halepit, ku shërbeu deri në vitin 1951. Më pas shkoi në Damask, ku punoi deri në vitin 1965, si mësues në shkolla të ndryshme, si pedagog i Institutit që përgatiste mësues, si dhe në Universitetin e Damaskut. Pas vdekjes së të atit, në vitin 1958, Vehbiu e zëvendësoi atë duke dhënë ligjërata në xhaminë “Arnaut”, ndërtuar prej të atit. Për tre vjet në këtë xhami Vehbiu ishte imam dhe vaiz, e pastaj ligjëroi në xhamitë “Esh Shemsije”, “Ravda” dhe “Lalabasha”. Në vitin 1966, nga Siria shkon në vende të tjera arabe. Në këtë vit u emërua pedagog në Universitetin e Riadit dhe të Medinës, në Arabinë Saudite, ku shërbeu deri në vitin 1971. Më pas kthehet në Siri, ku shërbeu si mësues deri në vitin 1980. Më pas ai mori rrugën për në Arabinë Saudite, ku shërbeu si studiues në Universitetin Islamik të Medinës, pastaj nga Arabia Saudite shkoi në Jordani, ku dha kontributin e tij në punë studimore të ndryshme dhe në botime librash. Në vitin 1986 u emërua pedagog në Fakultetin Fetar dhe Gjuhësor në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe, ku edhe vdiq, më 19 shkurt 2013. Në përgjithësi ka botuar*

*mbi 20 vepra origjinale në gjuhën arabe, si dhe 30 vepra në gjuhën shqipe. Ky punim i Vehbi Sylejman Gavoçit është botuar në revistën “Glasnik”, nr. 9-12, në Sarajevë, në vitin 1958, organ i Kryesisë Supreme të Bashkësisë Islame të ish-Jugosllavisë. Punimi është botuar në gjuhën arabe, dhe krahas tij edhe në gjuhën boshnjake, në përkthim të dijetarit të shquar boshnjak, Hysein Xhozo. Për shkak të vlerave përmbajtjesore dhe historike, ky shkrim, i përkthyer në gjuhën shqipe prej profesor Resul ef. Rexhepit (bashkëpunëtor ndër të parët dhe njëherësh ish-kryeredaktor i revistës “Edukata Islame”), po botohet edhe në këtë numër të revistës “Edukata Islame”.*

Allahu, xh.sh., ka thënë:

﴿وَالْعَصْرِ ۝١﴾ إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ ﴿٢﴾ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ ﴿٣﴾

**“Betohem në shekullin, njeriut vërtet i kanoset shkatërrimi, përveç atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe njeri-tjetrit ia rekomandojnë të vërtetën dhe durimin!”** (Kuran, El Asër, 1-3)

Surja e Kuranit “El Asër”, ndonëse është e shkurtë për nga teksti dhe fjalët, dhe është edhe e thjeshtë dhe e kuptueshme, në vete përmban mësim të mëdha, udhëzime dhe fakte, dhe dëshmon se me të vërtetë është e shpallur prej Zotit, xh.sh., drejtuar njerëzve. Kjo sure përmban jetën e brendshme të njeriut dhe besimin në Zot, jetën praktike, edukimin, përkushtimin, besnikërinë dhe veprat e mira, jetën morale, ndihmën reciproke, këshillimin dhe lidhshmërinë ndërmjet vete.

Në fillim të sures, Allahu, xh.sh., betohet në shekullin në të cilin ka vepruar pejgamberi i fundit i Zotit, Muhamedi, a.s., sepse ai është shekulli më i rëndësishëm. Muhamedi, a.s., ka thënë:

خير القرون قرني ثم الذين يلونهم ثم الذين يلونهم

**“Ndër të gjithë shekujt, shekulli më i rëndësishëm është shekulli im, pastaj ai që pason, dhe tjetri me radhë...”**

I ka hije, prandaj shekullit në të cili u shfaq pejgamberi i fundit, Muhamedi, a.s., që Zoti të betohet në të, sepse në të e shpëtoi njerëzimin, duke e liruar nga dhuna, errësira, anarkia, injoranca, përçarja, armiqësia,

prapambeturia dhe primitivizmi. Ai është shekulli në të cilin njeriut iu kthye dinjiteti njerëzor, u ndalua derdhja e gjakut të pafajshëm të gjinisë njerëzore, u shpall paprekshmëria e pasurisë dhe e nderit, iu dha vlera e vërtetë njeriut dhe punës së tij. Po ashtu u kthye edhe dinjiteti i gruas; ajo ka ekzistuar, sipas vetë natyrës së saj, nënë dhe motër e njeriut. Janë mbrojtur të drejtat e saj, fjala e saj dëgjohet, kërkesat e saj plotësohen, roli dhe vendi i saj në shoqëri është vlerësuar, sepse ia ka caktuar Krijuesi i botës, në interes të përgjithshëm të jetës dhe të përparimit.

### 1. إلا الدين آمنوا...

**“...përveç atyre që besojnë...”**

I Gjithëfuqishmi e vërteton me betim, se çdo njeri që ecën në errësirë pa dritë dhe pa udhëzues, është i ekspozuar në jetën e tij të brendshme ndaj konflikteve të tmerrshme, pasionit dhe lakmisë, përplasjeve të mendimeve dhe parimeve, me anën e kundërt të ndjenjave dhe të instinkteve të ndryshme; beteja midis forcave të së mirës dhe të së keqes. Në të tilla raste shpesh ndodh që, për shkak të dobisë vetanake, e injoron të vërtetën, e çon në pasion, e braktis parimin dhe e zgjedh atë që është e dëmshme, kurse e lë atë që është e dobishme, apo më shumë e vlerëson paditurinë sesa diturinë, e shet të përgjithshmen për kalimtarin, qëndron mirë me djallin, duke i shërbyer me besnikëri atij. Duke shkuar rrugës së tillë, njeriu nxiton në shkatërrim të pashmangshëm. **“Është shoqëria e shejtanit, dhe për të tillët shkatërrimi është i pashmangshëm”** (Kurani: Muxhadele, 19). Ndërkaq, ata që besojnë në Zot, e pasojnë ligjin e Tij, kështu që, pikërisht për këtë llogariten prej të gjallëve që e shfrytëzojnë dritën e Tij, prandaj dhe janë gjendur në rrugë të drejtë, dhe definitivisht ata që e konsiderojnë Kuranin ligj të tyrin, kështu që edhe bëhen mësues: **“Ata, pra, janë pasuesit e partisë së Zotit, e pasuesit e partisë së Zotit janë të shpëtuarit.”** (Kurani: Muxhadele, 22).

Zoti ka thënë: **“Dhe po kështu Ne, me urdhrin tonë, ta shpallëm (frymëzuar) ty Kuranin. Ti nuk e dije se ç’është Libri dhe as ç’është besimi, por Ne e kemi bërë atë (Kuranin) dritë, që Ne ta udhëzojmë me anë të tij atë që Ne duam nga robërit Tanë. Pa dyshim që ti (Muhamedi) sigurisht që po e udhëheq njerëzimin në Udhën e Drejtë (në fenë e Allahut, në Islam).”** (Kurani: Shura, 52). Besimi në Krijuesin është gjë e lindur te njeriu. Ai

është instinkt, është veti, është natyra e njeriut. Nuk mund të mohohet krijuesi i një pune të thjeshtë, krejtësisht të panjohur. Pra, si mund të mohohet Drejtuesi i botës dhe Organizatori i saj?! **“...Ju nuk mund të shihni ndonjë të metë në krijimin e të Gjithëmëshirshmit. Ktheje, pra, shikimin përsëri: A mund të shohësh ndonjë plasaritje!”** (Kurani: Mulk, 3). Mendja dhe ndjenjat nuk mund ta injorojnë gjithë atë që nuk mund të shihet me sy. Ne nuk e shohim mendjen, shpirtin, vetitë e ndryshme njerëzore dhe cilësitë morale. Ne nuk i shohim, gjithashtu, as këto erëra, të cilat asnjë fuqi nuk mund t’i ndalë kur vijnë, e as t’i rikthejë pasi të kalojnë. Asnjë i mençur nuk mund ta mohojë ekzistimin e tyre. Njeriu beson në shumë e shumë gjëra dhe ngjarje, ndonëse nuk i ka parë e as që i ka ndjerë ato; ai beson në to nëpërmjet arsyes (mendjes) dhe njohurive të vërteta njerëzore. E, çfarë thoni për dijen e Zotit?! **“E kush është në fjalë më i vërtetë se Allahu?!”** (Kurani: Nisa, 122). Ekzistimi i Zotit është aq i qartë, sa nuk ka nevojë të vërtetohet në veçanti siç nuk ka nevojë të dëshmohen disa krijesa të Tij që duken si në pikë të ditës. Pse duhet të dëshmohet nata, për sa kohë që të gjithë e shohim ditën?! **“Në fakt, nuk janë sytë që verbohen, por janë verbuar zemrat që i kanë në kraharrorë.”** (Kurani: Haxhxh, 46). Sepse, zemra shumë herë kthehet kah pasionet, në anën e kundërt të kërkesave themelore të moralit dhe etikës.

## 2...و عملوا الصالحات

### “...bëjnë vepra të mira...”

Bërja e veprave të mira është vetia e dytë e atyre që kursehen nga shkatërrimi. E para, siç e pamë, ishte besimi në Zot. Besimi në Zot e nxit njeriun në aktivitete të dobishme, në përkushtim të sinqertë, në sjellje humane, në këmbëngulësi të vazhdueshme për bamirësi. Besimi në Zot, nga i cili rezultojnë veprat e mira, të cilat edhe e lëvizin njeriun kah aktiviteti i dobishëm, është besimi i vërtetë. Ajo që është në zemër, në vetëdije, në shpirtin tonë, tregohet dhe manifestohet me anë të organeve tona, me anë të gjuhës etj. Apo, siç thotë një poet: “Fjalimi është në zemër. Gjuha tregon vetëm zemrën.”. Ai që do dhe i beson Zotit, që e ndjek rrugën e Tij, duhet të jetë besnik ndaj Tij, i nënshtruar dhe i gatshëm t’u përmbahet

rregullave të Tij. Një poet thotë: "Kur në zemër depërton udhëzimi i vërtetë, organet aktivizohen në ibadet, lutje e adhurim."

### 3. ... و تواسوا بالحق

#### "...njëri-tjetrit ia rekomandojnë të vërtetën..."

Ashtu siç njeriu e harron kontrollin e Zotit, jo rrallëherë ai u nënshtrohet pasioneve që e privojnë nga gjykimi dhe vigjilenca e shëndoshë. Dhe, meqë ndjenja e tij shumë herë e kapërcen besimin, kështu edhe bën vepra të këqija dhe e harron Krijuesin; më tutje i ndodh edhe që e vërteta t'i fshihet, ndërsa e pavërteta t'i tregohet, prandaj edhe gabimet i duken se shkëlqejnë, korrektësia dhe e vërteta të paqarta etj. Dhe, meqë njeriu është vëlla i njeriut, pavarësisht nëse i pëlqen ose jo, njëri është i nevojshëm për tjetrin, dhe sigurisht se gabimet e njërit, gjegjësisht pasojat e tij, kalojnë në tërë shoqërinë. Prandaj, për këto arsye i Gjithëfuqishmi thekson, se njëra nga vetitë themelore të besimtarit është t'ia rekomandojnë njëri-tjetrit të vërtetën, duke e vendosur të vërtetën, për të gjykuar sipas drejtësisë. Kjo sepse, puna në fushën e së vërtetës, duke e vendosur të vërtetën për çdo gjë tjetër, është themelore. Puna e parë që duhet bërë në kuadër të së vërtetës është besimi në Zot dhe përkushtimi ndaj Tij. Parimet më të thjeshta të së vërtetës përcaktojnë falënderimin ndaj bamirësit, kur janë pa interes, si dhe një qëndrim human ndaj njerëzve, sepse njerëzit në jetë janë të lidhur në mënyrë shoqërore dhe ndërmjet vete ndihmohen sipas kërkesave të jetës. Kjo, në të vërtetë, është nxitje dhe urdhërim për mirësi, si dhe ndalim nga e keqja.

(الأمر بالمعروف والنهي عن المنكر) - Në zbatimin e këtij principi është shpëtimi i individit, i familjes dhe i tërë shoqërisë. Të udhëzuarit për të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja, në të vërtetë, është reflektim i dashurisë. Kjo është punë për t'i ndaluar të tjerët nga hidhërimi dhe dënimi i Zotit. Kjo punë është shumë më e rëndësishme sesa puna në shpëtimin nga zjarri e uji. Imam Buhariu transmeton prej Xheririt: "*Besnikërinë dhe bindjen time ndaj të Dërguarit të Zotit e shpreha me namaz, zekat dhe me dhënien e këshillave për çdo mysliman.*". Në një tjetër hadith të saktë thuhet: "*Feja, e po ajo është këshillë!*". Duke i përshkruar besimtarët e vërtetë, Zoti, xh.sh., ka thënë: "*Besimtarët dhe besimtare e vërtetë janë*

**miq të njëri-tjetrit. Këshillojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja, e falin namazin, e japin zekatin dhe janë të nënshtruar ndaj Zotit dhe të Dërguarit të tij!” (Kurani).** Gabojnë shumë kur disa mendojnë se liria e njeriut është në pavarësinë nga shoqëria dhe bashkësia, dhe se gabimi i njeriut ngel vetëm pranë tij. Një rezonim i tillë është krejtësisht gabim. Nuk e pranojnë as ndjenja, as arsyeja. Arsyeja e shëndoshë konkludon se liria e individit mbaron aty ku fillon liria e të tjerëve. Islami e pohon një të vërtetë të pamohueshme, se njerëzit përbëjnë një organizëm, një trup, një bashkësi, ashtu që, nëse ndonjë pjesë e atij organizmi nuk e kryen funksionin e vet drejt, i tërë organizmi do të vuajë dhe do t’i ndiejë pasojat. Sipas Buhariut dhe të tjerëve, Muhamedi, a.s., ka thënë: *“Ai që i zbaton urdhrat e Zotit i ngjan një shoqërie që ka hipur në anije. Disa janë vendosur në pjesën e lartë, kurse të tjerët në pjesën e poshtme të anijes. Kur udhëtarëve të pjesës së poshtme të anijes do t’u nevojitet ujë, do të ngjiteshin në pjesën e lartë dhe do të thoshin se, sikur ta shpojme anijen, që të marrim ujë, kështu nuk do t’i dëmtonin ata lart. Ata të pjesës së sipërme, sikur t’i linin që ta bëjnë shpuarjen, do të fundoseshin të gjithë bashkërisht, dhe, po t’i pengonin, do të kishin shpëtuar të gjithë.”*

#### 4. و تَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ

**“...dhe njëri-tjetrit ia rekomandojnë durim.”**

Kjo botë është botë e obligimeve, e dhunës, e dashurisë, e urrejtjes, e singëritetit, e gënjeshtërisë, e pasurimit, e varfërisë, e shëndetit, e sëmundjes, e jetës dhe e vdekjes. Ajo është shtëpia në të cilën askush nuk ka mundur të gëzojë qetësi të plotë; jep me një dorë, e merr me tjetrën, lumturohesh, dhe në të njëjtën kohë të trishton dhe të bën të qash. Ajo është shtëpia e fatkeqësive dhe e sprovave. Sikurse vlerësimi i arit që provohet duke e vënë në zjarr, njëjtë është edhe me vlerën morale të njerëzve që tregohen, sidomos në sprova të ndryshme. Krahës kësaj, ndodh që njeriu të bjerë edhe në dëshpërim, ta kapë frika, të bëhet mendjelehtë para asaj që po i ndodh, ta shqetësojnë ngjarjet rreth tij, të jetë shpirtvogël me rastin e fatkeqësive etj. Duke i marrë parasysht të gjitha këto, është e pashmangshme që njeriu të bëjë durim, qëndrueshmëri dhe ekzistencë, kështu që, në këtë shtëpi do të ketë fatkeqësi, gjithsesi, po gjithashtu edhe ndih-

mesa reciproke, si masë preventive për ta larguar fatkeqësinë para se ajo të ndodhë, ose, së paku të largohet, nëse vetëm se është aty, gjegjësisht të zbutet efekti i saj. Për këtë arsye, i Gjithëfuqishmi besimtarët i ka urdhëruar që njëri-tjetrit t'ia rekomandojnë durimin, sepse durimi është çelësi i shpëtimit. Muhamedi, a.s., ka thënë: *"Zoti e vë në sprovë besimdrejtin, dhe atë e bën vetëm për shkak se me atë do ta nderojë!"*. Më tej ka thënë: *"E çuditshme është çështja e besimdrejtit! Tek ai gjithçka është e mirë, e që ky rast nuk është me jobesimtarin. Nëse ai është nderuar me begati, dhe për këtë e falënderon Zotin, ajo do t'i llogaritet gjithsesi në mirësi, ndërkaq, në qoftë se e zë ndonjë fatkeqësi dhe duron, edhe kjo do t'i llogaritet për vepër e mirë, pra, te mumini gjithçka është e mirë dhe e dobishme!"*. Sipas Ibën Sadit, Pejgamberi, a.s., ka thënë: *"Nëse njeriu arrin ndonjë të mirë, ndonjë sukses, të cilin me punën dhe angazhimin e tij nuk e ka merituar, Zoti do ta vërë në sprovë me ndonjë shqetësim, qoftë në trup, familje ose pasuri, për t'i dhënë më pas durim, në mënyrë që ta meritojë mirësinë e fituar!"*. Duke iu drejtua gruas që i ka qortuar ethet, Pejgamberi, a.s., i kishte thënë: *"Mos i fyej ethet! Ato i fshijnë gjynahe, sikurse që flaka e pastron hekurin nga papastërtia."*

Fatkeqësia, kjo është dhunti për besimdrejtin. Varfëria është pasqyrim i mëshirës së Zotit, kurse sëmundja është falje mëkatesh. Vështirësitë janë dhuratë e Zotit, e fatkeqësia është sprovë.

Me këtë ajet, gjithashtu, urdhërohet rekomandimi i ndërsjellë për durim edhe për kryerjen e obligimeve, për largim nga gjithçka që nuk vlen dhe që është e dëmshme, për ku na fton djalli i mallkuar dhe mundohet të na joshë, si dhe pasionet tona dhe djajtë në formën njerëzore. Këtë lloj të durimit njerëzit nuk duhet kurrësi ta injorojnë.

Në një transmetim është shënuar: "Kur takoheshin dy sahabë, nuk do të ndaheshin deri kur njëri nuk ia lexonte tjetrit suren "El Asër".

Bekimi i Zotit qoftë mbi Muhamedin, a.s., familjen dhe shokët e tij! Falënderimi qoftë për Allahun, Krijuesin e të gjitha botëve!

Marrë nga: "Glasnik", nr. 9-12, Sarajevë 1958.

Përktheu:

**Resul Rexhepi**



Dr. Ejup HAZIRI

## MARRËVESHJA E OMERIT ME BANORËT E JERUSALEMIT (PALESTINËS)

### Abstrakt

Ky punim fokusohet në një marrëveshje historike të lidhur ndërmjet myslimanëve, nën udhëheqjen e kalifit Omer bin Hattabi (r.a.), dhe banorëve të Palestinës. Synimi i tij është të hedhë dritë mbi përmbajtjen dhe vlerat e kësaj marrëveshjeje. Rëndësia e punimit qëndron në konfirmimin se Islami është fe e paqes, se dhuna dhe derdhja e gjakut nuk kanë asnjë lidhje me Islamin dhe se *xhizja* nuk është tregues i shtypjes apo robërimit, por një garanci për jetën, fenë dhe pronat.

**Fjalët kyçe:** *Islami, çlirimi, Omeri, Palestina, marrëveshja, xhizja.*

### Hyrje

Islami depërtoi herët në vendet ku sundimi i takonte perandorisë bizantine, ku pas disa betejave, rajoni i Shamit<sup>1</sup> ra në dorë të myslimanëve në kohën kur udhëheqës ishte Ebu Bekri,<sup>2</sup> dhe u finalizua në kohën e Omerit.<sup>3</sup> Edhe persianët u mposhtën në kohën e Omerit.<sup>4</sup> Më pas pasoi

---

<sup>1</sup> Rajoni i Shamit përfshin katër shtete: Sirinë, Palestinën, Jordaninë dhe Libanin e sotëm.

<sup>2</sup> Ebu Bekri ishte udhëheqësi i parë i myslimanëve, dhe sundimi i tij zgjati vetëm dy vjet e katër muaj. Shih: Amër Halid, *Katër Halifët e drejtë*, Prishtinë 2009 f. 8!; Eduart Thartori, *Islami në kohë trazirash*, Prishtinë 2008, f. 46!

<sup>3</sup> Omer bin Hattabi ishte udhëheqësi i dytë i myslimanëve, sundimi i tij zgjati dhjetë vjet e katër apo gjashtë muaj. Shih: Ekrem Dija' El Umerij, *Asrul Hilafetu-rr-Rrashidetu*, mektebetul abikan, pa vit botimi, vëll. I, f. 78

edhe çlirimi i Palestinës, i Egjiptit, i Xhorxhanit, i Taberistanit, i Azerbejdhanit, i Ermenisë, i Libisë dhe i vendeve të tjera. Shumica e tyre ndodhën në kohën e Omerit, ndërsa në kohën e Othman bin Affanit,<sup>5</sup> pasoi çlirimi i Afrikës veriore dhe i asaj perëndimore, shtrirja edhe më shumë në zonat e lindjes, derisa prekën kufijtë e Kinës. Ndërsa, në kohën e Aliut<sup>6</sup> nuk u bënë çlirime që vlen të theksohen, për shkak të trazirave të brendshme; megjithatë arritën t'i mbrojnë ato vende që i kishin çliruar.

Çlirimet e rajoneve të Shamit u bënë nga dy komandantët e pamposhtur të asaj kohe, të cilët me betejat e tyre të njohura çliruan vend pas vendi, e ata ishin Ebu Ubejde bin Xherrah dhe Halid bin Velidi. Amër bin Asi ishte heroi i Egjiptit, ndërsa Sad bin Ebi Vekasi ishte heroi i anës tjetër, Persisë së dikurshme (Iranit të sotëm). Kështu perandoritë e dikurshme, nga të cilat dridhej e tërë bota, morën fund dhe u shuan përgjithmonë. Në skenë doli një fuqi tjetër, që plejada e ushtarëve të tyre gjatë natës adhuronin, e gjatë ditës luftonin. Kjo plejadë e artë nuk shikonte në numrin e armiqve dhe mjetet luftarake që i kishin armiqtë, por me bindjen më të madhe në Zot shpresonin në triumf, dhe nuk dinin se ç'është dështimi.

Asnjëherë nuk sulmonin ndonjë vend befas, pa paralajmërim, dhe kërkesën për paqe nga kundërshtarët e pranonin menjëherë. Paktet, besëlidhjet dhe marrëveshjet e ndryshme e kanë shoqëruar Islamin gjatë gjithë historisë, dhe bota është dëshmitare e traktateve të bëra. Prandaj, këtu do të sjellim marrëveshjen e Omerit me banorët e Palestinës, ku, ndonëse çliroi Palestinën dhe kishte mundësi të vepronte si të donte, ai u ofroi atyre siguri dhe garanci të plotë për jetën e tyre, si dhe mbrojtje për objektet e tyre fetare. Ai u garantoj lirinë e plotë në kryerjen e ritualeve fetare, pa

<sup>4</sup> Në betejën e Kadisijes, e cila u zhvillua në vitin e 14 hixhrij, në të cilën myslimanët treguan heroizëm të pashoq dhe ngadhënjyen ndaj persianëve. Kjo betejë ishte goditje vdekjeprurëse ndaj persianëve.

<sup>5</sup> Othman bin Affani ishte udhëheqësi i tretë i myslimanëve, dhe sundimi i tij zgjati plot dymbëdhjetë vjet.

<sup>6</sup> Ali bin Ebi Talib ishte udhëheqësi i katërt i myslimanëve, dhe sundimi i tij zgjati katër vjet e nëntë muaj.

asnjë pengesë. Pronat dhe çdo gjë që zotëronin u takonin atyre, duke i dëbuar grabitësit nga ai vend.

### **Çka i parapriu marrëveshjes së Palestinës?**

Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, udhëheqës i myslimanëve do të caktohej Ebu Bekri, i cili u përball me sfida të shumta, qofshin ato brenda Medinës, apo edhe jashtë saj. Megjithatë, shteti islam ishte i fuqishëm dhe kishte shtrirje edhe jashtë Medinës dhe Mekës.

Një ndër sfidat ishte edhe mundësia e një përplasjeje me romakët, të cilët ishin superfuqi e asaj kohe, e që kohë pas kohe luftonin me superfuqinë tjetër të asaj kohe, perandorinë perse.

Ebu Bekri e kishte dërguar Halid bin Seid bin El Asin si komandant për Sham, të cilit i dha detyra që të pozicionohej me ushtrinë e tij në Tejma, në veri të Hixhazit, por mos ta fillonte betejën, përveçse në rastet kur kundërshtarët do ta sulmonin. E rëndësishme ishte vetëm vëmendja dhe vrojtimi ndaj lëvizjeve të romakëve, dhe jo ta çlironin Levantin (Shamin). Mirëpo, ndodhi diçka e keqe me romakët, të cilët mobilizuan disa fise arabe nga Bahra, Kelb, Lahm, Xhedham dhe Gassan për t'i luftuar myslimanët. Ushtria e Halidit ishte e vogël, dhe e kishte të pamundur të luftonte me një perandori të tillë, prandaj pësuan disfatë të rëndë më 4 Muharrem të vitit 13 hixhrij (11 mars 634), sa në mesin e të vrarëve ishte edhe djali i tij. Pjesa e mbetur u kthye në Dhi Merva, për ta pritur vendimin e kalifit Ebu Bekër.

Kur lajmi i disfatës i arriti kalifit Ebu Bekër, ai u shqetësua dhe mbloshi shokët për të shkëmbyer mendime dhe këshilla. Pas konsultimeve, u mor vendimi për zmbropsjen e agresionit dhe luftimin e romakëve, të cilët mund të tundoheshin nga kjo fitore e papritur që kërcënonte sigurinë e shtetit. Ky i fundit sapo kishte filluar të merrte frymë më lirshëm pas përfundimit të luftërave të apostazisë (dezertimit nga feja) dhe pas një lajmi të rëndësishëm për fitoret e njëpasnjëshme në frontin e Irakut nga Halid bin Velidi. Kalifi Ebu Bekër Es Siddik përgatiti katër divizione ushtarake dhe përzgjodhi komandantët e tij më efikasë dhe më me përvojë në luftë dhe betejë. Ai përcaktoi për secilën ushtri misionin që do të përmbushej.

Sa i përket ushtrisë së parë, ajo ishte nën komandën e Ebu Ubejda bin El Xherrah, dhe destinacioni i saj ishte Homs. Kjo ushtri numëronte afërsisht 7000 ushtarë. Ushtria e dytë drejtohej prej Jezid bin Ebi Sufjani, e destinacioni i saj ishte Damasku. Ushtria e tij numëronte 9000 ushtarë. Ushtria e tretë ishte nën komandën e Sherhabil bin Hasenes, dhe destinacioni i saj ishte rajoni i Basrës, ndërsa numri i kësaj ushtrise ishte 7000 ushtarë. Sa i përket ushtrisë së katërt, ajo drejtohej prej Amr bin El Asit, dhe destinacioni i saj ishte Palestina. Numri i ushtrisë së tij ishte gjithashtu 7000 ushtarë, dhe totali i të gjitha ushtrive nuk i kalonte tridhjetë mijë. Ebu Bekri i urdhëroi ata ta ndihmonin njëri-tjetrin dhe, nëse do të mblihdeshin së bashku, komanda e përgjithshme t'i jepej Ebu Ubejdes.

Pas këtyre ndodhën disa beteja të vogla mes myslimanëve dhe ushtrisë bizantine, të cilat përfunduan me fitoren e myslimanëve, gjë që e irrituan tej mase mbretin e romakëve, i cili pastaj mobilizoi një ushtri të madhe. Kur myslimanët i panë përgatitjet e ushtrisë romake, kërkuan prej udhëheqësit të besimtarëve t'u dërgonte përforcime. Ebu Bekri dërgoi përforcime të shumta, duke i shkruar edhe Halid bin Velidi që të drejtohej nga Iraku për në Sham. Derisa Halidi ishte drejtuar për Sham, Ebu Bekri i shkruan Ebu Ubejdes, dhe i thotë se tërë komanda do të jetë nën urdhrat e Halidit.

Të dy ushtritë do të takoheshin në Palestinën e sotme, për afërsisht në rrethinën e qytetit Halil, betejë e cila u njoh me emrin si beteja “Exhnadinë”, që i referohet dy ushtrive, dhe jo ndonjë vendi. Ndonëse beteja ishte e pabarabartë për nga numri i ushtarëve, megjithatë fitorja u takoi myslimanëve.<sup>7</sup> Kjo ishte beteja e parë serioze mes myslimanëve dhe romakëve, ndërsa dy vjet më pas, gjegjësisht në vitin 636, ndodhi beteja e Jermukut, që ishte përfundimtare. Triumfi i ushtrisë myslimane ndaj bizantinëve në luftën e Exhnadinit hapi rrugën e çlirimit të Palestinës.<sup>8</sup> Kësh-

<sup>7</sup> Ushtria romake numëronte nga 100 000 deri në 140 000 ushtarë, përderisa ajo myslimane 30 000 ushtarë. Beteja u bë në vitin 13 hixhrij, gjegjësisht në vitin 634 miladi.

<sup>8</sup> Ibën Xherir Et Taberi, *Te'rihu-t-Taberij*, bot. II, Dar El Kutub El Ilmijetu, Bejrut-Liban, 1408, vëll. II, f. 447; Ibën Kethiri, *El Bidaje ve En Nihaje*, Dar Edh Dhehebijetu, pa vit botimi, vëll. VII, f. 53.

tu myslimanët iu afruan Palestinës, dhe udhëheqësit fetarë të Jerusalemit kërkuar që çelësat e Jerusalemit t'ia dorëzonin udhëheqësit të myslimanëve, Omerit, r.a., i cili erdhi në pushtet pas vdekjes së Ebu Bekrit.

### **Marrëveshja e Jerusalemit (Palestinës)**

Në momentin kur Omeri hyri në Jerusalem, priftërinjtë e qytetit shkuan tek ai për t'ia dhënë çelësat e qytetit.<sup>9</sup> Sapo e vunë re pamjen e Omerit, ata filluan të qajnë, duke thënë se në librat e tyre thuhet se çlirimtari i Jerusalemit do të hynte në këmbë, dhe shërbëtori i tij do të ishte mbi kalin e çlirimtarit, i cili e tërheq atë nga frerët.<sup>10</sup> Shenjë tjetër e lajmeve të mëparshme nga librat e tyre ishin edhe rrobat e tij. Ai duhej të ishte me rroba të vjetra dhe të arnuara. Omeri ishte veshur mu ashtu. Ata qanin teksa e shikonin se si profetësitë e cituara në librat e tyre po realizoheshin me ardhjen e Omerit, dhe ata ishin vetë dëshmitarë të saj.<sup>11</sup>

Pastaj Omeri lidhi traktatin me banorët e Jerusalemit, kurse më pas lidhi një pakt edhe me banorët e Luddit, që jetonin afër Palestinës, si dhe me banorët e Rremilit.<sup>12</sup>

Imam Taberiu regjistron paktin e Omerit, një dokument që i është drejtuar popullit të qytetit të Palestinës, që u çlirua në vitin 15 hixhrij, gjegjësisht 636-637 miladi, në të cilin thuhet:

<sup>9</sup> Sophronius ishte Patriarku i Jeruzalemit nga viti 634 deri në vdekjen e tij. Ai nderohet si shenjtor në Kishën Ortodokse dhe Katolike Lindore. Para se të merrte udhëheqjen e Selisë së Jeruzalemit, ai ishte murg dhe teolog, dhe njëkohësisht kryeprogonist i mësimëve ortodokse në polemikën doktrinale mbi natyrën thelbësore të Jezusit dhe veprimet e tij vullnetare. Ai është gjithashtu i njohur për negociatat që çuan në dorëzimin e Jerusalemit te kalifi mysliman Umer bin Hattab.

<sup>10</sup> Omeri, që kur kishte nisur nga Medina, e kishte bërë të mundur që të ulurit mbi kalë të bëhej me ndërrime me shërbëtorin e tij. Në çdo distancë të barabartë, ata ndërroheshin, dhe ai që ishte poshtë tërhiqte kalin përpara. Kur arritën para dyerve të qytetit të Jerusalemit (Palestinës), radha mbi kalë i kishte rënë shërbëtorit të Omerit, dhe ky i fundit po e tërhiqte kalin. Megjithatë sahabët e tjerë i thanë se ishte koha që të paraqitej ai mbi kalë, si prijës që ishte, Omeri kundërshtoi, sepse nuk ishte radha e tij. (Eduart Thartori, *Islami në kohë trazirash*, f. 61).

<sup>11</sup> Eduart Thartori, *Islami në kohë trazirash*, f. 62.

<sup>12</sup> Ibën Kethiri, *El Bidaje ven Nihaje*, vëll. VII, f. 56.

“Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*Kjo është siguri që shërbëtori i Allahut, Omeri, komandant i besimtarëve, garanton për popullin e Palestinës. Ai u jep atyre një garanci sigurie për vete, pronat dhe kishat e tyre, për të sëmurët dhe të shëndetshmit në këtë qytet, gjithashtu një garanci për të gjitha ritualet që i përkasin fesë së tyre. Kishat e tyre nuk do të banohen me myslimanë, dhe nuk do të shkatërrohen. As ata, as toka në të cilën qëndrojnë, as pronat e tyre, assesi nuk do të dëmtohen. Banorët e Palestinës nuk do të detyrohen me forcë të konvertohen. Ata duhet ta paguajnë taksën, sikurse e paguajnë edhe popujt e qyteteve të tjera, dhe banorët e Palestinës duhet t'i dëbojnë bizantinët dhe grabitësit nga ky qytet... ”.*<sup>13</sup>

Ndërsa, shkresa për banorët e Luddit, ishte kjo:

“Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

*Kjo është siguria që Omeri, prijësi i myslimanëve ua jep banorëve të Luddit dhe kush hyn me ata prej banorëve të Palestinës. Do t'u jap garanci për veten e tyre, pasurinë, kishat e tyre, për të sëmurët dhe ata që janë të shëndoshë, dhe gjithë banorëve. Kishat e tyre nuk do të banohen prej askujt, dhe ato nuk do të rrënohen e as të prishen...a ta nuk do të urrehen për shkak të fesë së tyre; askush nuk do t'u bëjë diçka atyre. Për banorët e Luddit dhe ata që hyjnë me ta prej banorëve të Palestinës duhet të paguhet taksë, ashtu siç paguajnë vendet e tjera të Shamit... ”.*<sup>14</sup>

### Vështrim marrëveshjes së Jerusalem

Marrëveshja e Jerusalemit në kohën e Omerit ishte historike, sepse, krahas dy vendeve të shenjta, Mekës dhe Medinës, u arrit të çlirohej edhe një tjetër vend i shenjtë – Kudsi, kibleja e parë e myslimanëve. Kudsi ka pasur gjithnjë një vend të posaçëm në zemrat e besimtarëve. Xhamia Ak-

<sup>13</sup> Al Tabari, *The History of Al Tabari*, trans. Y.Friedmann, Albany: SUNY Press, 1985, vëll. XII, f. 191.

<sup>14</sup> Ibën Xherir Et-Taberi, *Te'rihut Taberij*, vol.II, f. 449.

sa ishte vendi i peygamberëve dhe pikënisja e miraxhit të të Dërguarit të fundit, Muhamedit a.s. Ky vend dhe rrethinat e tij janë të bekuara nga Allahu i Madhërishëm.

Omeri e arriti marrëveshjen pa derdhur asnjë pikë gjaku. Ai nuk bëri luftë, ndonëse kishte fuqi dhe pushtet. Nuk mbyti mijëra fëmijë, gra apo pleq dhe nuk i shkatërroi shtëpitë e tyre. Nuk dëboi askënd nga banesa e tij, as nuk burgosi kënd. Edhe pse i kishte armiq, ai u ofroi siguri dhe garanci për jetën, familjen, pronën dhe kishat e tyre.

Marrëveshja u nënshkrua mes Omerit dhe autoriteteve të qytetit, ku përcaktoheshin disa kushte dhe të drejta për të krishterët dhe hebrenjtë që jetonin atje.

Në vijim do të flasim më gjerësisht për disa nga pikat e kësaj marrëveshjeje.

### **Marrëveshja fillon me emrin e Allahut**

Kjo marrëveshje apo ky pakt, ashtu si të gjitha të tjerat, fillon me emrin e Allahut, çka nënkupton një shenjtëri të pacenueshme dhe një vlerë sublime. Si e tillë, ajo ka për dëshmitar Krijuesin e njerëzimit, duke garantuar vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e saj, si dhe trajtimin e barabartë të të gjithë banorëve.

Fakti që marrëveshjet në Islam mbështeten te Allahu dhe fillojnë me emrin e Tij-Atë që është Vëzhguesi dhe Llogaritësi i gjithçkaje që ndodhet në zemrat e njerëzve-dëshmon më së miri për pacenueshmërinë e tyre, duke mos lejuar manipulimin apo tradhtinë, pasi janë nisur me emrin e Zotit. Pothuajse të gjitha marrëveshjet, qoftë ato nga jeta e të Dërguarit, periudha e katër kalifëve apo edhe gjatë epokave të mëvonshme, kanë filluar gjithnjë me emrin e Allahut.

Sidoqoftë, edhe kjo marrëveshje është sikurse marrëveshjet e tjera. Ajo nuk ka ndonjë formulim të veçantë<sup>15</sup> nga marrëveshjet e tjera, mirëpo më së shpeshti i përshtaten traditës së formulimit, e që si traditë peygam-

<sup>15</sup> Subhi Mahmesani, *El Kanun vel ilakat Ed Devlije fil Islam*, bot. i II-të, dar El ilm lil Melajine, Bejrut, Liban, 1982, f. 149.

berike ishte që ajo të fillonte me emrin e Allahut (bismilah). Pastaj, përmendja e emrave të palëve kontraktuese në marrëveshje, sikurse veprroi Omeri, është ngjashëm siç vepronte i Dërguari i Allahut në marrëveshjet e tij, si në Paqen e Hudejbijes, kur pas emrit të Allahut kërkoi që në formulim të përmendet emri i tij: Muhamedi i Dërguari i Allahut. Mirëpo Suhejli, që përfaqësonte palën tjetër, e pati kundërshtuar këtë, dhe i Dërguari i Allahut u tërhoq nga vendimi i tij, dhe urdhëroi që të shkruhet siç kërkonte Suhejli,<sup>16</sup> dhe kjo dëshmon se marrëveshja duhet të jetë me pajtimin dhe vullnetin e të dy palëve, dhe mos të jetë në mënyrë të detyruar. Ky shembull sigurisht që tregon se pajtimi i vullnetit është element i rëndësishëm në kontratën e traktateve.

Zakonisht formulimi i marrëveshjeve bëhet konform rrethanave të kohës dhe vendit. I Dërguari i Allahut, varësisht nga rrethanat, kishte kërkuar edhe formulimin e tyre, dhe kjo bëhej për shkak të specifikave të banorëve me të cilët lidhej marrëveshja.

### Siguri për jetën e tyre

Marrëveshja ofronte garanci të plotë për banorët e Palestinës, për banorët vendas, mirëpo jo për grabitësit dhe pushtuesit. Madje, marrëveshja nënvizonte se bizantinët (romakët) dhe grabitësit duhet të dëboheshin nga Palestina, meqë ata nuk kishin asnjë lidhje me atë vend.

Ofrimi i sigurisë që ua bëri Omeri banorëve të Palestinës nuk është për çudi që figuron në fillim të marrëveshjes, dhe mund të themi se është çelësi kyç i marrëveshjes, ngase marrëveshja u bë me qëllim që të kthehet rendi e siguria për ata banorë. Vetë i Dërguari i Allahut në marrëveshjet, paktet dhe traktatet e tij me të tjerët, ofrimin e sigurisë e kishte renditur që në fillim, ngase, nëse marrëveshja nuk ofronte siguri e garanci, atëherë çfarë vlere mund të kishte ajo?! I Dërguari i Allahut, kur bëri marrëveshje (pakt) me fisin e Xhuhejnit, formulimi i asaj marrëveshje ishte kështu:

<sup>16</sup> Ebu Ubejd El Kasim bin Selam, *El Emval*, dar El Fikr, 1395h, f. 210; Ebu Jusuf Jakub bin Ibrahim, *El Haraxh*, El matbeatu selefijetu, 1352 hixhrij, f. 210.

*“Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!  
Jeta dhe prona e fisit të Xhuhejnit do të jenë të sigurta...”*

Ndërsa, kur bëri paktin me Benu Dhamran, mund të themi se kishte një përmbajtje të ngjashme:

*“Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!  
Kjo shkresë është prej Pejgamberit të Allahut, Muhamedit, s.a.v.s., drejtuar Benu Dhamras.*

*Këtij populli i garantohet siguria e jetës dhe e pronës...”<sup>17</sup>.*

I Dërguari i Allahut, jo vetëm përmes këtyre marrëveshjeve, por gjatë gjithë jetës së tij ishte një shembull i shkëlqyeshëm në respektimin e tjetrit dhe ofrimin e sigurisë për të. Ai ishte modeli më i lartë që ka njohur njerëzimi, saqë edhe armiqtë e tij i trajtoi me drejtësi dhe mëshirë, njësoj si miqtë.

Për të mbizotëruar paqja, stabiliteti dhe siguria, një pjesë të jetës së tij ia kushtoi marrëdhënieve me kundërshtarët, duke i thirrur në paqe dhe ndaljen e gjakderdhjes e luftës. Për të siguruar qetësinë dhe stabilitetin në rajon, ai lidhi marrëveshje, traktate dhe armëpushime të ndryshme. Gjithnjë ishte i gatshëm të krijonte marrëdhënie të mira, madje edhe me armiqtë e tij.

Madje, atyre që e keqtrajtuan, e përzunë, e ndoqën dhe e luftuan, u shpalli falje të përgjithshme dhe amnisti të hapur. Ai e konsideronte ofrimin e sigurisë së tyre si një zotim hyjnor dhe një besë që duhej përmbushur: ***“Ata janë që e zbatojnë besën e dhënë Allahut, dhe nuk e thyjnë zotimin.”<sup>18</sup>***

Myslimanët i qëndruan besnikë marrëveshjeve të tyre të kurorëzuara me të tjerët. Ata dhanë shembullin më të lartë në historinë njerëzore, edhe pse shpeshherë u tradhtuan prej të tjerëve. Megjithatë, kjo nuk i detyroi që të marrin po të njëjtin hap, sikurse edhe armiqtë e tyre.

Jo vetëm Omeri, sikur në rastin e kësaj marrëveshjeje, por edhe kalifët e tjerë shkuan po asaj rruge që e kishte skicuar i Dërguari i Allahut,

<sup>17</sup> Tabekat Ibën Sa’d, vol. III, f. 27; Sulltan Ajmed Kureshi, *Letrat e Muhamedit, a.s.*, Logos-A, Shkup, 2005, f. 78.

<sup>18</sup> Kurani, Err Rra’d: 20.

duke lidhur marrëveshje dhe duke hartuar traktate dhe ofruar paqe për sigurinë e secilit, në mënyrë që njerëzimi të jetojë me dinjitet, pa frikë dhe pa shqetësim.

### Garanci për kishat e tyre

Sipas kësaj marrëveshjeje, Omeri u dha atyre siguri të plotë për pronat, kishat e tyre, dhe atyre u ofroi garanci të plotë për të gjitha ritualet që i përkasin fesë së tyre. Kishat e tyre assesi nuk do të dëmtoheshin, dhe as që do të shkatërrohen nga ana e myslimanëve.

Sigurisht kjo nuk ishte ndonjë risi e Omerit, por ishte parim i Islamit, duke i dhënë të drejtë secilit ta mbajë besimin e vet. I Dërguari i Allahut, kur kishte hartuar Kartën e Medinës, kishte përmendur fiset çifute Benu Auf, Benu Nexhxhar dhe Benu Haris, se ata duhet t'i përmbaheshin me vendosmëri fesë së tyre, sikurse myslimanët që duhet t'i përmbaheshin fesë së tyre. Edhe pse i Dërguari i Allahut kishte hapësirë për t'i dëbuar çifutët, ai u ofroi atyre siguri për veten, pronat dhe sinagogat e tyre. Vetëm atëherë kur çifutët e prishën marrëveshjen, tentuan ta eliminonin të Dërguarin e Allahut dhe bënë komplete ndaj myslimanëve, atëherë i Dërguari i Allahut i trajtoi ndryshe.

Rrugën e tij e ndoqën edhe shokët e tij, të cilët në përpikëri i zbatuan mësimet e tij. Shembull konkret janë katër kalifët e drejtë, të cilët lidhën marrëveshje e traktate të ndryshme, dhe thuajse në secilin prej tyre përmendej liria fetare dhe toleranca, sikurse edhe siguria dhe garancia ndaj objekteve të kultit. Edhe në raste të luftës, i Dërguari i Allahut i porosiste shokët e tij që mos të mbysnin fëmijë, gra e pleq, mos të mbysnin njerëz që i ishin përkushtuar besimit të tyre, si dhe as mos t'i shkatërronin objektet e kultit. Po kështu veproji edhe Ebu Bekri, Omeri, e edhe të tjerët.

Meqë jemi te kjo çështje, është në interes të lexuesit të përmendet se pas çlirimit të Damaskut, ndonëse u zhvillua një betejë, u ruajtën katërmëdhjetë kisha, aq sa kishte Damasku në atë kohë. Vetëm ana lindore e kishës së madhe që quhej Juhana pësoi prishje,<sup>19</sup> dhe kjo vërteton se mys-

<sup>19</sup> Ibën Kethiri, *El Bidaje ve En Nihaje*, vol. VII, f. 21.

limanët në ato vende që kanë hyrë nuk i kanë prishur kishat, sinagogat apo vendet e kultit, përkundrazi i kanë ruajtur ashtu siç kanë qenë. Jo vetëm Damasku, por, pothuajse të gjitha vendet që ranë nën sundimin Islam, objektet e kultit të tyre u ruajtën dhe mbetën të paprekshme. Shembull për këtë është rajoni i Shamit, ku kishat bizantine mbetën ashtu siç ishin, dhe po kështu u ruajtën edhe sinagogat e çifutëve nëpër vende të ndryshme. Jo vetëm në Sham, por, pothuajse në tërë ato vende ku Islami depërtoi, si vendet e Anadollit, kishat mbetën dëshmi e gjallë e një tolerance të dëshmuar të myslimanëve, e që, me gjithë betejat e mëdha, nuk dëmtuan objektet fetare të armiqve. E njëjta gjë ndodhi edhe në Andaluzinë e dikurshme, ku ndonëse Islami dominonte atje për tetë shekuj të pandërprerë, kishat e armiqve të tyre mbetën siç ishin. Madje, thuajse çdo marrëveshje që bëhej, nënvizonte që kishat nuk do të shkatërroheshin dhe as që do të digjeshin; si shembull konkret sjellim traktatin mes Abdulaziz bin Musa bin Nasir dhe Theodimir, ku mes të tjerash figuronte edhe praktikimi i fesë, ruajtja e kishave dhe të tjera pika me rëndësi:

“Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Ky traktat është në mes Abdulaziz bin Musa bin Nasir dhe Theodimir, të birit të Ghabdush-it. Mos të dëbohet dhe as të largohet ai nga vendi dhe pushteti; të sigurohet ai dhe kush e pason (ndjek) atë; mos të burgosën ata dhe as mos të robërohen gratë dhe fëmijët e tyre; ata do të kenë të drejtë në praktikimin e fesë së tyre; Kishat e tyre assesi nuk do të digjen; objektet e shenjta të tyre nuk do të uzurpohen; këto nuk do të ndodhin përderisa ata nuk e prishin marrëveshjen...”<sup>20</sup>.

### **Pagesa e xhizjes karshi sigurisë së tyre**

Edhe në këtë marrëveshje të Omerit me banorët e Palestinës, pasqyrohet dhe garantohet jeta e tyre, liria fetare dhe ekonomike..., duke nënvizuar se ata janë të lirë dhe të sigurt. Askush nuk mund ta cenojë integritetin e tyre, dhe vendet e kultit të tyre do të jenë të siguruara; nuk i lejohet as-

<sup>20</sup> Ed. Barbara H. Rosenwein, *the Treaty of Tudmir*, Petersborough, Ont, Broadvieç, 2006, f. 92.

kujt që t'i dëmtojë pronat e tyre, shtëpitë dhe vendet e adhurimit të tyre. Ata kanë liri të plotë fetare, dhe se askush nuk guxon t'i gjykojë ata për faktin se i përkasin një besimi tjetër.

Karshi kësaj sigurie në të gjitha sferat, ai kërkonte një taksë simbolike, duke u bazuar në urdhrin kuranor<sup>21</sup> dhe atë pejgamberik. Kjo taksë, ndryshe nga tatimet feudale në Evropë dhe gjetiu, nuk përbënte një vësh-tirësi ekonomike për jomyslimanët që jetonin nën sundimin mysliman. Tatimi konsiderohet si e drejtë legjitime e shtetit islam, kur kihet para-sysh se të gjithë popujt myslimanë dhe jomyslimanë përfitojnë nga mbrojtja ushtarake e shtetit, sigurohej jeta e tyre fetare, politike dhe eko-nomike. Jomyslimanët paguanin taksën e njohur si *xhizje*, kurse myslim-anët paguanin gjithashtu një taksë të nevojshme dhe obligative të njohur me termin *zekat*. Myslimanët duhej t'i mbronin me çdo kusht jomyslima-nët që e kishin paguar atë taksë, e nëse nuk mund t'i mbronin, atëherë ajo nuk merrej. Atë nuk e paguanin njerëzit e varfër dhe të sëmurët.<sup>22</sup> Pra, kur jomyslimanët e paguanin atë taksë, ishin të mbrojtur, dhe jo si tatimet feudale që, edhe nëse paguheshin, ata që paguanin nuk ishin të mbrojtur domosdoshmërisht.

Krahas pagesës së *xhizjes*, jomyslimanëve u ofrohej siguri nga myslimanët dhe, nëse kjo siguri nuk mund t'u garantohej, atëherë kjo taksë simbolike nuk merrej prej tyre. Një ngjarje domethënëse ilustron më së miri këtë parim.

Kur perandori bizantin formoi një ushtri të madhe për të luftuar myslimanët e Shamit, komandanti mysliman Ebu Ubejde dha udhëzime për rikthimin e *xhizjes* te të gjithë ata prej të cilëve ishte mbledhur më parë. Në udhëzimin e tij shkruhej: *“Pasi jemi informuar se një fuqi e madhe*

<sup>21</sup> Sipas urdhrit kuranor, shih Kuran 9:29. Ndërsa në traditën profetike, ka shumë hadithe që flasin për këtë taksë simbolike, të njohur me emrin *Xhizje*, e cila vjen nga folja *xheza-jexhzi*, që nënkupton shpërblim. Në kontekstin tatimor, kjo kuptohet si një shpërblim për sigurinë e jetës, besimit, vendeve të adhurimit, shtëpive, trashëgimisë dhe gjithçkaje tjetër. Andaj, ata që e paguajnë këtë taksë, do të kenë në këmbim një shpërblim sigurie në të gjitha aspektet.

<sup>22</sup> Shih për më tepër: Ed Dik, *El Muahadat fish-Sheriatil islamijeh vel kanun ed devlij El am*, f. 316-317!

*armike është nisur kundër nesh, po ua kthejmë xhizjen tuaj. Sipas marrëveshjes sonë, kjo pagesë na obligon t'ju mbrojmë, por në kushtet aktuale, duke qenë se nuk mund t'ju ofrojmë këtë mbrojtje, ne ua kthejmë të gjitha paratë që kemi marrë nga ju."*

Në bazë të këtyre udhëzimeve, një sasi e madhe parash u shpërnda nga arka shtetërore. Për këtë arsye, të krishterët i drejtoheshin Zotit me lutje për fatin dhe suksesin e sunduesve myslimanë, duke thënë: *"Zoti ju dërgoftë sërish si sunduesit tanë dhe ju bëftë fitimtarë ndaj bizantinëve. Sikur në vendin tuaj të ishin bizantinët, jo vetëm që nuk do të na kthenin asgjë, por do të na merrnin edhe pjesën e mbetur."*<sup>23</sup>

Historiani i njohur Tomas Arnold, në librin e tij 'Ed Davetu Illel Islam', thotë: "Taksa (xhizja) nuk nënkuptonte degradim apo dënim, mirëpo jomyslimanët që jetonin në vendet islame e jepnin atë në këmbim të një sigurie dhe mbrojtjeje që ua ofronin myslimanët."<sup>24</sup>

### **Nuk do të detyrohen konvertimet me dhunë**

Mes fjalëve që bartte marrëveshja e Palestinës ishte edhe fakti që banorët e Palestinës nuk do të detyroheshin ta ndërronin besimin e tyre. Përkundrazi, ata do të kishin liri të plotë në besimin dhe praktikimin e bindjeve të tyre. Në kohën kur Omeri hyri në Palestinë dhe e bëri këtë marrëveshje, kishte fuqinë e tij, dhe myslimanët ishin ata që udhëhiqnin në ato vende që hynin. Me fjalë të tjera, kishte mundësi të vepronte çfarë të donte, ngase banorët e Palestinës ishin të nënshtruar. Megjithatë, ai shfaqti mëshirë të plotë ndaj tyre dhe i trajtoi me butësi e dashamirësi. Atyre u ofroi siguri për jetën e tyre, për kishat dhe objektet e tjera të besimit, dhe gjithashtu shpërfaqti edhe tolerancën e madhe të Islamit, duke mos u hakmarrë ndaj askujt. Atyre ua dëshmoi se Islami është paqe, dhe se në fe nuk ka dhunë. Prandaj, nuk u bëri presion që ta ndërronin besimin e tyre, ashtu siç vepronin të tjerët kur hynin në një vend dhe e nënsh-

<sup>23</sup> Ebu Jusuf, *El Haraxh*, f. 81; Arnold, *Historia e Përhapjes së Islamit*, Prishtinë, 2004, f. 68.

<sup>24</sup> Tomas Arnold, *Ed Da'vetu Illel Islam*, f. 79-80.

tronin atë; përkundrazi, ai me dokument ua bëri të qartë se ata do të kenë liri të plotë në manifestimin e bindjeve të tyre, dhe assesi nuk do të ketë imponim ndaj tyre.

Myslimanët niseshin nga parimi thelbësor *“Në fe nuk ka dhunë”*,<sup>25</sup> prandaj as që vepronin ndryshe, përkundrazi të nënshtroarve ua lejonin praktikimin e besimeve të tyre dhe kryerjen e ritualeve të feve të tyre. Madje, kjo e drejtë ishte e pranishme pothuajse në çdo traktat që mysli-manët lidhën. Kishat, sinagogat dhe vendet e tjera të adhurimit mbeteshin të pacenuara dhe nuk rrënoheshin. Ndërkohë, xhamitë e Spanjës u shkatërruan tërësisht menjëherë pas rënies së mysli-manëve, ashtu si edhe në vendet tona fqinje pas rënies së Perandorisë Osmane. Askush nuk detyrohej të largohej nga besimi i tij. Islami u paraqitej njerëzve, dhe nëse ata e pranonin me vetëdëshirë, bëheshin mysli-manë; në të kundërtën, mbeteshin në fenë e tyre, por ishin të detyruar të paguanin taksën personale (xhizje). Toleranca islame u dëshmuua më së miri në ato vende ku bashkëjetonin religjione të ndryshme. Banorëve u ofrohej siguri personale dhe kolektive, kushte të mira për jetesë, si dhe mbrojtje për objektet e tyre fetare. Kjo ishte një tolerancë që religjionet e tjera nuk e kishin dëshmuar; përkundrazi, shpeshherë kishin vepruar në mënyrë arrogante dhe brutale. Kjo vihet re në përplasjet e vazhdueshme midis kishave dhe sinagogave, siç ishte rasti i konflikteve mes katolikëve dhe ortodoksëve apo midis bizantinëve dhe persëve. Luftërat mes tyre shpesh shoqëroheshin me shkatërrimin e objekteve të kultit të palës së humbur, madje në shumë raste, të mundurit detyroheshin të ndërronin fenë.

---

<sup>25</sup> Kurani, El Bekareh: 256.

## Përfundim

Marrëveshja e Palestinës, e njohur ndryshe si “Pakti i Omerit”, duke iu referuar kalifit të dytë të myslimanëve, është një dokument shumë i rëndësishëm në historinë e Islamit, i lidhur me periudhën e Omerit, të birit të Hatabit.

Kjo marrëveshje u realizua gjatë çlirimit të Jerusalemit nga ushtria islame. Pas një periudhe të gjatë rrethimi, qyteti u dorëzua pa betejë dhe pa luftë, ndërsa banorët e Jerusalemit pranuan kushtet e ofruara nga kalifi Omer. Marrëveshja u nënshkrua mes Omerit dhe autoriteteve të qytetit, duke përcaktuar kushte dhe të drejta për të krishterët dhe hebrenjtë që jetonin atje.

Disa nga pikat kryesore të marrëveshjes përfshinin:

1. Sigurinë për jetën dhe pasuritë e banorëve: Omeri, r.a., u premtoi se ai dhe ushtarët e tij do të ofronin siguri për jetën dhe pasurinë e banorëve të Jerusalemit, duke i mbrojtur ata nga çdo lloj dhune.
2. Liria e besimit dhe praktika fetare: Të krishterët dhe hebrenjtë kishin të drejtën të vazhdonin të praktikonin besimin e tyre fetar dhe kishin mbrojtje për kishat dhe sinagogat e tyre.
3. Ata do ta paguanin xhizjen: Si pjesë e sistemit të taksave, që ishin të detyruara për popujt jomyslimanë që jetonin nën sundimin islam, ata ishin të detyruar ta paguanin një taksë të quajtur “xhizje”, për të siguruar mbrojtjen dhe lirinë për ta.
4. Respektimi i trashëgimisë fetare: Kjo marrëveshje ndihmoi në ruajtjen e trashëgimisë fetare të qytetit, duke i garantuar të krishterët e Jerusalemit të drejtat e tyre mbi vendet e shenjta të krishterët.

Ky akt është konsideruar si një shembull madhështor i tolerancës fetare dhe i mençurisë politike të kalifit Omer, që llogaritet si një njeri me ndikim të madh në historinë e marrëdhënieve ndërfetare dhe zhvillimin e qytetërimeve që ndodhën në atë periudhë.

---

**Literatura e konsultuar:**

- Al-Tabari, *The History of al-Tabari*, trans. Y.Friedmann, Albany: SUNY Press, 1985.
- Amër Halid, *Katër Kalifët e drejtë*, Prishtinë 2009
- Arnold, *Historia e Përhapjes së Islamit*, Prishtinë, 2004, fq. 68.
- Ebu Ubejd El-Kasim bin Selam, *el-Emval*, dar el-Fikr, 1395.
- Ebu Jusuf Jakub bin Ibrahim, *el-Haraxh*, el-matbeatu selefijetu, 1352h.
- Ed. Barbara H. Rosenwein, *the Treaty of Tudmir*, Petersborough, Ont, Broadvieë, 2006.
- Eduart Thartori, *Islami në kohë trazirash*, Prishtinë 2008
- Ekrem Dija' el-Umerij, *Asërul Hilafetu-rr-Rrashidetu*, mektebetul abikan, pa vit botimi.
- Ibën Xherir Et-Taberi, *Te'rihu-t-Taberij*, bot. i II-te, Dar el-Kutub el-Ilmijetu, Bejrut-Liban, 1408. Ibën Kethir, *El-Bidaje ven-Nihaje*, Dar edh-Dhehebijetu, pa vit botimi.
- Subhi Mahmesani, *El-Kanun vel ilakat ed-Devlijeh fil Islam*, bot. i II-të, dar el-ilm lil Melajine, Bejrut-Liban, 1982.
- Sulltan Ajmed Kureshi, *Letrat e Muhamedit a.s.*, Logos-A, Shkup, 2005.

**Dr. Ejup HAZIRI**

## **THE TREATY OF UMAR WITH THE INHABITANTS OF JERUSALEM (PALESTINE)**

### **Abstract**

This paper focuses on a historical agreement concluded between Muslims, under the leadership of Caliph Umar bin Khattab (ra), and the inhabitants of Palestine. Its aim is to shed light on the content and value of this agreement. The importance of the paper lies in the fact that it confirms that Islam is a religion of peace, that violence and bloodshed have nothing to do with Islam, and that *jizya* is not a symbol of oppression or slavery, but something that grants protection to life, religion, and property.

**Keywords:** *Islam, liberation, Umar, Palestine, agreement, jizya.*



Dr. Nail DRAGA

## **80-vjetori i krimeve të komunistëve në Ulqin HASAN LLUNJI - MYFTIU I ULQINIT VIKTIMË E KOMUNIZMIT (1897-1944)\***

### **Abstrakt**

Organizimi i takimeve përkujtimore kushtuar personave apo ngjarjeve të ndryshme paraqet një moment nderimi dhe vlerësimi, si kudo në botën e qytetëruar. Përkujtimi për hafëz Hasan Lllunjin, me rastin e 80-vjetorit të vrasjes, e vlerësoj si një homazh për të gjithë viktimat shqiptare në Ulqin dhe viset tjera shqiptare në Mal të Zi, të cilët u eliminuan me rastin e vendosjes së pushtetit komunist pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Një takim i tillë është në favor të shpalosjes së vërtetës, e cila u ndalua dekada me radhë në kohën e monizmit, për të njoftuar opinionin e gjerë për mbijetesën e shqiptarëve në Ulqin dhe gjetiu në trojet e tyre në Mal të Zi.

***Fjalët çelës:*** *Ulqin, Hasan Lllunji, myderriz, myfti, Ulqin, komunizmi*

---

\* Fjala e mbajtur me rastin e shënimit të 80-vjetorit të vrasjes së hafëz Hasan Lllunjit, mbajtur në Ulqin, më 9 maj 2024.

Hasan Llunji, i biri i Alushit, myfti dhe myderriz i qytetit, lindi në Ulqin. Ka dy data, vitet 1897 dhe 1900. U rrit dhe u formua në një familje arsimdashëse dhe përparimtare. Në moshën 13-vjeçare kryen hafëzllëkun dhe merr thirrjen hafëz, ndërsa diploma e tij, e lëshuar në vitin 1916/17, dëshmon se ai kreu shkollën dyvjeçare kroate-shqipe të Ulqinit. Më tej dëshironte të vazhdonte shkollimin në medresenë e Sarajevës. Nga të parët e tij trashëgoi një bibliotekë të pasur me literaturë fetare dhe artistike, me alfabet arabo-osman. Pas përfundimit të kualifikimeve shkollore, bëri njohuri solide në lëmin e së drejtës trashëgimore të sheriatit. Në këtë fushë u diplomua dhe u specializua në Shkodër, te Sabri Begu, atëbotë kryemyfti i Shkodrës.

Gjatë shërbimit në vise të ndryshme si mësues i fesë, ofiqar, myderriz dhe myfti, ka qenë pajtues në disa revista që botoheshin në Sarajevë dhe në Shkup, dhe sidomos e çmonte lart revistën “Zani i Naltë” që botohej në Shkodër. Nga ajo revistë informohej për të arriturat e ndryshme në fushëveprimin e tij, sidomos për veprimtarinë e shumë emrave të dëgjuar të kulturës dhe të së kaluarës sonë kombëtare.

Gjatë veprimtarisë dhe shërbimit, hafëz Hasan Llunji ka shërbyer në disa vende nga viti 1918 deri në vitin 1944. Ka shërbyer në Ulqin, në Krajë, në Anë të Malit, në rrethinat e Tivarit dhe të Tuzit. Ai nuk mundi të qëndronte imun ndaj disa dukurive antikombëtare që organizonte pushteti i kohës në Mbretërinë SHS. Kështu, në pranverën e viteve 30-ta, në Ulqin flitej se do të vinin disa anije turke për të marrë familjet ulqinake, të cilat, për shkak të skamjes ekonomike dhe shtypjes nacionale, bëheshin gati për ta lëshuar Ulqinin dhe për të emigruar në Turqi.

Ndaj një veprimi të tillë të strukturave të pushtetit, që kishin si qëllim shpërnguljen e shqiptarëve nga ky qytet, me plot guxim reagoi hafëz Hasan Llunji, duke i bindur bashkëqytetarët e tij të mos e lëshonin Ulqinin. Për shkak të këtij qëndrimi, ai u vu në shënjestër të pushtetit dhe u detyrua që për një kohë ta lëshonte Ulqinin. Ai u vendos në qytetin e Shkodrës, por ka qëndruar edhe në Durrës, ku pati takime edhe me Mujo Ulqinakun.

Ky version është i redaktuar në mënyrë që të ruajë strukturën dhe thelbin e origjinalit, duke përmirësuar rrjedhshmërinë dhe duke korrigjuar disa ndihmesat gramatikore.

### **Tokat shqiptare i bashkohen shtetit amë-Shqipërisë (1941-1944)**

Fillimi i Luftës së Dytë Botërore solli ndryshime edhe në hartën politike të Ballkanit. Kështu, pushtuesit e rinj italianë u angazhuan për të përmirësuar gabimin e mëparshëm, duke ia bashkëngjitur tokat etnike shqiptare nën Mal të Zi shtetit shqiptar të kohës, që nga muaji prill i vitit 1941. Një veprim i tillë ishte një surprizë për shqiptarët, sepse pushtuesit fashistë sollën lirinë dhe të drejtat që ishin mohuar nga koha e mbretërisë së Malit të Zi dhe ajo e ish-Jugosllavisë.

Në rrethana të reja politike dhe shoqërore, nga viti 1941-44, Ulqini ishte bashki dhe nënprefekturë e Shkodrës. Nënprefekt ishte Luigj Lufi, me origjinë nga Mirëdita, i cili kishte mbaruar fakultetin e historisë dhe, përveç gjuhës amtare, dinte edhe tre gjuhë të huaja. Truproja e tij ishte Rrok Shkreli. Zyrat e nënprefekturës ishin afër Ranës, në shtëpinë e Bidin Selitës, ku sot ndodhet pushimorja e pensionistëve. Gjatë kësaj kohe, në Ulqin, për herë të parë, u vendos administrata në gjuhën shqipe, u hap shkolla shqipe “Skënderbe” me arsimtarë vendas, por shumica ishin nga Shkodra, ndërsa drejtori i saj ishte shkodrani Jahja Domnori. Në qytet ka funksionuar gjithashtu gjykata, xhandarmëria dhe ushtria, ku të gjithë ishin shqiptarë. Komandanti i qytetit të Ulqinit ishte Gjon Zefi Ivanaj.

Nuk ka dilemë se ngritja e flamurit kombëtar shqiptar më 14.6.1941 paraqet ditën dhe datën me të shenjtë për popullin shqiptar në krahinën e Ulqinit. Atë ditë u mbloodhën para kishës së Shën Zefit (Mal të Bardhë) rreth 5000 qytetarë, pa dallim feje e krahine.

Ja si e përshkruan këtë moment historik Rrok Shkreli: *“Atë ditë ishte mbledhur popull i madh nga Ulqini, Ana e Malit, Kraja, Shestani.... Erdhën edhe krerët e iu bashkuan popullit, dom Nikollë Tusha, Cafo Begu, dom Ivo Bellashi, hoxhë Lhunja, Lush Paloka, Dedë Gjo Nikë Delija, Selë Lamoja me të birin Elezin, Rexhep Dollari e shumë ulqinakë me ta. Së pari ka mbajtur një fjalim të fuqishëm atdhetari dom Nikolla, pastaj ka*

*folur Cafo Begu e ne fund dom Ivo Bellashi në kroatisht pasi ishte kroat... Pas kësaj kemi kërkuar një shkallë për të hipur në kompanjel të kishës, shkallën e ka sjellë Kolë Lucë Ndoja që asokohe iu binte kambanave të kishës. Flamurin e kishte dom Nikollë Tusha, i cili ia dorëzoi Cafo Beg Ulqinit e ky ia dha Dedë Gjo Nikë Delisë; shkallët i solli dhe i mbështeti fort për mur të kishës Kolë Lucë Ndoja, kurse Dedë Gjoni ma afroi mua shtizën e Flamurit, të cilin e valëvita disa herë në ajër e kjo ndezi zemrat e të pranishmëve, pastaj e vendosa dhe e shtrëngova mirë në kompanjol.*

Me rastin e ngritjes së Flamurit u ndez gazmendi liridashës e atdhetar, ashtu që të gjithë së bashku ia kënduan Flamurit këto vargje:

*O Flamur ti kuq e zi  
po valon një bukuri  
për Shqipni e për liri  
në Kosovë e Çamëri  
me gazmend e hijeshi  
për të shtrejtën këtë liri.*

*More djelt e Traboinit,  
të Shestanit e t' Ulqinit  
banju bashkë e lutni i festë  
për kufinin që u kanë hjekë,  
shkoi kufini ku a kenë motit  
n' Sutorman e n' Qafë t' Kokotit “.*

### **Bashkëpunimi me dom Nikollë Tushën**

Gjatë tërë kësaj kohe, deri në vitin 1944, në Ulqin, edhe pse kanë pasur kërcënime dhe akuza nga qarqe të ndryshme, këta dy figura fetare të nderuara ishin shembuj me sjelljen, komunikimin dhe bashkëpunimin me popullin. Të dy dilnin vazhdimisht së bashku. Ishte kjo një shoqëri dhe tolerancë që nuk ishte në favorin e individëve dhe të qarqeve të ndryshme antishqiptare. Këta dy udhëheqës fetarë, së bashku me disa atdhetarë të tjerë, iu bashkuan Cafo Begut, personalitetit më të njohur në Ulqin dhe më gjerë në hapësirën shqiptare.

## Burgosjet në Ulqin



IMZOT NIKOLL TUSHA (1895 – 1946)

Më 24 nëntor 1944, Ulqinin e vërshuan njësitë lokale partizane. Me hyrjen e tyre, filluan menjëherë ndjekjet, maltretimet, burgimet dhe vrasjet. Një pjesë e veprimtarëve nuk u gjetën në Ulqin, një pjesë arratisen, të frikësuar nga hakmarrjet që tashmë ishin bërë skena të ditës, ndërsa një pjesë mbeti në Ulqin.

Bëhet me dije se pushteti i ri i vendosur në Ulqin, për 24 orë, kishte duar të lira për të arrestuar dhe pushkatuar kënd që ata e llogaritnin si armiq, apo pengesë kundër pushtetit të tyre. Duhet thënë se, me vendosjen e pushtetit të ri në Ulqin, pushteti faktik ishte në duar të OZN-ës/UDB-ës, ndërsa partia LKJ ishte një fasadë formale, andaj edhe pasojat janë të njohura.

Nuk ka dilemë se më të rrezikuar ishin ata që mbetën në Ulqin, ku bënte pjesë edhe hafëz Hasan Llunji. Natën e 26 nëntorit, nga OZNA, ai u arrestua në shtëpinë e tij dhe u dërgua në një burg të improvizuar të tyre në Ulqin. Aty gjeti edhe tre ulqinakë të tjerë, të cilët i kishin burgosur më parë: Hodo beg Bushatin me të birin Ahmetin, noter i Gjykatës së Ulqinit, dhe Rafo Goranën, oficer aviacioni.

## Vrasja e Rafo Goranës

Viktima e parë e pushtetit komunist në Ulqin ishte Rafo Gorana. Ai, në mëngjesin e datës 26 nëntor 1944, në shtëpi u mor nga disa persona, gjoja për një takim në Cetinë, për të festuar fitoren ndaj okupatorëve. Sipas të dhënës së bashkëshortes së tij, në momentin që do të largohej nga shtëpia, ai e përqafton tre herë djalën e vogël, Agimin, i cili ishte dyjavësh, duke nuk e parë më atë. Ky ishte momenti i fundit i ndarjes nga familja,

sepse kriminelët, në vend që të niseshin në drejtim të Cetinës, shkuan në drejtim të Limanit në Ulqin.

Ai u pushkatua në mëngjesin e datës 27 nëntor 1944, mbi Lima, tek Çinari, duke shkuar për në Valdanos. Atje u vra edhe i katërti: Hodo beg Bushati dhe i biri i tij, Ahmeti, i cili ishte noter i Gjykatës së Ulqinit, si dhe Radovan Aleksiqi. Ata u pushkatuan dhe nuk u njoftuan fare familjet e tyre për t'i marrë kuformat dhe për t'i varrosur. Dhe, deri më sot ende nuk dihet asgjë për varrin apo varret e tyre, duke mbetur një enigmë deri në ditët e sotme.



*Rafo Gorana (1916-1944)  
me bashkëshorten Halimen  
Hafëz Hasan Lljunji  
(1897-1944)*

### **Vrasja e Hasan Lljunjit**

Nga ana tjetër, Hasanin e torturojnë mizorisht duke e kërcënuar me pushkatim. Ata kërkonin të fliste për aktivitetin dhe shokët e tij. Ndonëse përkohësisht, hafëz Hasanin e lëshuan, pasi nuk siguruan prova për akuzën që ia ngarkonin, nuk vonoi shumë dhe e burgosën përsëri. Organet e OZN-ës, përmes spiunëve të tyre, përfundimisht realizuan qëllimin e tyre, sepse ata i detyruan të mbledhin nënshkrime nga populli për gjoja krimet që kishte bërë gjatë periudhës 1941-1944. Dhe, në një gjyq të improvizuar në Ulqin, në mbështetje të nënshkrimeve të mbledhura, organet e OZN-ës, gjoja në emër të "gjyqit të popullit," dhanë fjalën e tyre përfundimtare - deportimin e tij në Cetinë, për vazhdimin e hetuesisë.

### Në varr të përbashkët

Mirëpo, më datë 15 dhjetor 1944, katër të burgosurit me duar lidhur: hafëz Hasan Llunji, Memin Resulbegu, punëtor i gjeodezisë, Caf Canka dhe Zyhdi Fici, me rojë të maskuara dhe të armatosur, po përcilleshin gjoja drejt Cetinës, që atje t'u shqiptohej dënimi përfundimtar. Dhe, në drejtim të Tivarit, pranë fshatit Braticë, arritën në një kthesë ku u qe zënë prita, dhe ku sigurisht edhe i pushkatuan të gjithë, për t'i varrosur më pas në një varr të përbashkët. Edhe sot janë mu në atë vend, pa asnjë shenjë dalluese, edhe pse e kanë merituar të zhvarrosen dhe të varrosen me ceremoni të veçantë.



*Hafëz Hasan Llunji (1897-1944)*

Veprimet e tilla të komunistëve dëshmuar se ata kishin hartuar më parë lista për të eliminuar figurat e njohura dhe autoritare në Ulqin, të cilët i trajtonin si armiq të pushtetit dhe si pengesa në realizimin e vendosjes së pushtetit sipas strategjisë së tyre politike. Ishte ky veprim patologjik kundër shqiptarëve, që u dëshmuar me veprime kriminale, ku për 18 ditë pushkatuan 8 qytetarë të Ulqinit pa procedurë gjyqësore.

Në sajë të të dhënave që disponojmë, del qartë se ishte pikërisht pushteti i ri ideologjik, i cili nuk zgjodhi mjete për të eliminuar personat dhe familjet me autoritet në Ulqin. Kemi të bëjmë me një periudhë të manipulimit ideologjik, sepse, sipas demagogjisë së tyre, çdo gjë fillonte me ta, duke eliminuar traditën shoqërore në Ulqin dhe më gjerë.

### **Sigurimi i Shqipërisë bashkëpunon me jugosllavët**

Çështja e bashkëpunimit nga ana e Sigurimit të Shqipërisë me OZN-ën jugosllave dëshmon më së miri angazhimin e përbashkët të tyre për të eliminuar armiqtë ideologjik. Të vetëdijshëm se ishin të rrezikuar nga pushteti i komunistëve, disa individë me autoritet largohen nga Ulqini dhe vendosen në Shqipëri, duke menduar se aty do të gjenin strehim të sigurt.

Kështu, dom Nikollë Tusha u detyrua të largohej nga Ulqini dhe u strehua te kushëriri i tij në fshatin Juban, afër Shkodrës. Mirëpo, as këtu nuk ishte i sigurt, sepse Sigurimi shqiptar zbuloi qëndrimin e tij dhe, pasi e arrestoi, ua dorëzoi jugosllavëve. Ishte ky një rast i jashtëzakonshëm, ku shtetasi shqiptar iu dorëzohet organeve të ndjekjes të një shteti tjetër. Megjithatë, një veprim i tillë nuk është për t'u çuditur, sepse për pushtetarët e rinj, orientimi ideologjik ishte parësor, e jo ai kombëtar. Në mënyrë identike është vepruar edhe me ata kosovarë që patën fatin të shpëtonin gjallë në Masakrën e Tivarit (1 prill 1945), të cilët, pasi u zbuluan në Shqipëri, iu dorëzuan jugosllavëve!

### **Burgosja dhe pushkatimi i Hodo Alibegut**

Ngjashëm kanë vepruar edhe me Hodo Alibegun, të cilin e burgosën në Ndroq, afër Tiranës, në Shqipëri dhe e sollën në burgun e Tivarit, ndërsa më pas të dy i sollën në burgun e Ulqinit. Pas hetuesisë së rëndë, u mbajt gjykimi publikisht në sallën e hotelit “Jadran” të Ulqinit.

Gjyqi i dënoi këta dy patriotë me nga 20 vjet burg të rëndë. Pas shpalljes së dënimit, dom Nikollë Tusha dhe Hodo Alibegu u dërguan për të vuajtur dënimin në burgun e Cetinës. Atje, Nikollë Tusha në burgun Bogdanovkraj pati qëndrim burrëror, por pikërisht për këtë qëndrim ai pushkatohet më 4 nëntor 1946, në Bjellashka Papretina. Se pushteti i kohës kishte planifikuar të eliminonte Hodo Alibegun, dëshmon e dhëna se gjykata rishqyrtoi vendimin e mëparshëm të dënimit me 20 vjet burg, duke e dënuar me pushkatim, i cili u realizua më 17 mars 1948, dhe ende nuk dihet vendvarrimi i tij.

Po ashtu, duhen cekur edhe emrat e të tjerë të pushkatuar: Vasë Filip Mirdita nga Pistulli, Ali Beqir Bajrami nga Krytha, Merush Halil Omeri

nga Krytha, Ali Veli Kalimani nga Kalimani, Lekë Maci Perkolaj, Vukë Pjetër Malaj, Gjon Zef Malaj nga Shestani etj. Ende sot nuk dihet gjë për eshtrat dhe varret e tyre.

### **Mungon ballafaqimi me të shkuarën**

Në rrethana të reja shoqërore, pas dështimit të ideologjisë komuniste, nga viti 1990, është pritur me të drejtë që të punohet në ndriçimin e ngjarjeve dhe personaliteteve, si dhe individëve të ndryshëm të cilët u eliminuan nga pushteti i ri, pas Luftës së Dytë Botërore. Por, ngjarjet nga viti 1944-45, kur u instalua pushteti komunist në Ulqin, ende nuk janë hulumtuar me kompetencë profesionale nga studiues të ndryshëm. Nëse në kohën e sistemit monist trajtimi i temave të tilla kishte pasoja, pas rënies së tij, qëndrimi indiferent ndaj kësaj kohe nuk mund të arsyetohet më me asgjë.

Në lidhje me këtë periudhë kohore, në mjediset e ndryshme në vendet e ish-kampit socialist, janë hapur tema të tilla, duke prezantuar krimet e komunistëve me dokumente të dëshmuara. Por, në këtë aspekt përjashtim bën Mali i Zi, sepse këtu ende hezitojnë të ballafaqohen me të kaluarën, një qëndrim që është në kundërshtim me drejtat qytetare dhe nacionale të qytetarëve, të cilat janë obligime sipas standardeve demokratike evropiane.

### **Dy rezoluta nga Këshilli i Evropës**

Edhe pse në Këshillin e Evropës janë miratuar dy rezoluta kundër krimeve të komunizmit, e para ajo më nr. 1096, nga viti 1996, *“Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”*, dhe e dyta nr. 1481, nga viti 2006, *“Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”*, asnjëra prej tyre nuk është miratuar në Kuvendin e Malit të Zi. Një veprim i tillë refuzues dëshmon mungesën e gatishmërisë së pushtetit aktual për t'u ballafaquar me të shkuarën komuniste, siç kanë vepruar vendet e tjera në Europën Juglindore.

Nuk ka dilemë se një qëndrim i tillë politik tregon në mënyrë transparente se këtu ka mbetur e ngulitur në psikologjinë e tyre sistemi monist,

i cili, për qëllimet ideologjike dhe për pushtet, ka eliminuar individë të ndryshëm, ku as shqiptarët në Ulqin dhe më gjerë në Mal të Zi nuk ishin përjashtim.

### **Heshtja si dobësi jo vetëm qytetare**

Në këtë kontekst, mund të thuhet se është obligim moral dhe profesional nga përfaqësuesit tanë politikë, si përfaqësues në institucionet qeveritare në Mal të Zi, të riaktualizojnë çështjen e zbardhjes së vërtetës për eliminimin e qytetarëve tanë pa gjyqe nga pushteti komunist i kohës. Një veprim i tillë do të eliminonte dilemat dhe spekulimet për temat tabu, të cilat kanë qenë të pranishme për rreth pesë dekada.

Ndërsa heshtja pas dëshmimit të komunizmit tregon dobësi personale dhe familjare, por edhe si qytetarë, ajo nuk arsyetohet më asgjë. Në këtë aspekt, ne duhet të marrim shembuj nga vendet e tjera në rajon, të cilët individët me dosje kriminale i kanë shpallur heronj, ndërsa ne vazhdojmë të heshtim për viktimat e pafajshme të komunizmit, të cilët ende nuk kanë varre apo ndonjë pllakë përkujtimore.

Edhe pse të vonuar, siç është ky takim përkujtimor për hafëz Hasan Llunjin me rastin e 80-vjetorit të vdekjes, është koha për të thënë të vërtetën ndaj viktimave, familjarëve dhe brezave të tashëm dhe të ardhshëm. Andaj, duhet angazhim politik, intelektual dhe guxim qytetar, sepse punët tona nuk na i kryejnë të tjerët.

### **Propozime në nderim të viktimave**

Nga ajo që u tha më lart, në këtë takim përkujtimor është obligim qytetar, moral e familjar për t'u angazhuar me sa vijon:

1. Ndonëse të vonuar, pa hezitim duhet të bëhet rivarrosja e viktimave me të gjitha nderimet, për t'u bartur në një mjedis të ri, si aksion i përbashkët edhe i familjarëve, Bashkësisë Islame dhe pushtetit lokal, ashtu siç veprohet në vendet demokratike;
2. Në nderim të veprimtarisë së tyre shoqërore e kombëtare, një rrugë apo shesh duhet të emërtohen me emrin hafëz Hasan Llunji, dom Nikollë Tusha dhe Rafo Gorana;

3. Duhet kërkuar dosjen e viktimave të vrarë në arkivin e UDB-së, dhe ata të publikohen për opinionin, si dhe;
4. Duke marrë parasysh se viktimat nuk kanë qenë kriminelë, por individë me autoritet familjar dhe shoqëror në Ulqin, të tillët duhet të dekorohen me mirënjohje të veçanta (pas vdekjes) nga pushteti lokal i Ulqinit.

---

**Literatura:**

1. Fahri Buçinca, Cafo Beg Ulqini-jeta dhe verprimtari politike, Art Club, Ulqin, 2009
2. Nail Draga, Likuidimi i udhëheqësve fetarë në Ulqin(1944-1946), Lemba, nr.10, Ulqin, 2006
- 3.Rrok Shkreli, Valët e jetës, Ulqin, 2007
- 4.Dom Nikë Ukgjini, Atdhetari dom Nikollë Noga-Tusha(1895-1946), Jeta Katolike, nr. 25(janar-mars), Neë York, 2002
5. Jetish Kadishani-Iliaz Metaj, Martirë të kombit, Gazeta Rilindja(17-22 mars, 2000)
- 6.Gjokë Dabaj, Shestani II, Tiranë-Prishtinë, 2004

**Dr. Nail DRAGA**

**80th anniversary of the communist crimes in Ulqin  
HASAN LLUNJI - MUFTI OF ULQIN - VICTIM OF  
COMMUNISM (1897-1944)**

**Abstract**

The organization of memorial meetings to commemorate different people or events represents a moment of special recognition and appreciation, as everywhere else in the world. The commemoration of Hafiz Hasan Lljunji, on the occasion of the 80th anniversary of his murder, is considered a tribute to all the Albanian victims in Ulqin and other Albanian areas in Montenegro, who were eliminated when the communist government was established after the end of World War II. Such a meeting helps reveal the truth, which was suppressed for decades during the time of monism, to inform the public opinion about the survival of Albanians in Ulqin and elsewhere in their lands in Montenegro.

**Keywords:** *Ulqin, Hasan Lljunji, muderis, mufti, Ulqin, communism*

Sabine SCHMIDTKE

## RACIONALIZMI TEOLOGJIK NË BOTËN MESJETARE TË ISLAMIT

### **Abstrakt**

Racionalizmi ka qenë një tipar i spikatur i mendimit teologjik mysliman që nga kohërat më të hershme. Mutezilja ishte shkolla më e hershme e teologjisë racionaliste islame, e njohur si Kelam, dhe një nga rrymat më të rëndësishme dhe më me ndikim të mendimit islam. Mutezilinjtë theksuan përparësinë e arsyes dhe vullnetit të lirë (kundrejt paracaktimit) dhe zhvilluan epistemologjinë, ontologjinë dhe psikologjinë.

E dyta për nga rëndësia në përdorimin e racionalizmit ishte lëvizja teologjike e ashtuquajtur Esharijje. Esharizmi mbeti një nga vijat më të spikatura të mendimit deri në fund të shekullit të 16-të. Brenda sferës sunite, së paku, Esharizmi tregoi më shumë sukses dhe gëzoi një jetë më të gjatë se Mutezilizmi. Megjithatë, ashtu si Mutezilizmi, edhe Esharizmi u sfidua vazhdimisht nga kundërshtarët tradicionalistë që refuzonin çdo lloj racionalizmi.

**Fjalët kyçe:** *mendimi racional teologjik mysliman, mutezilizmi, esharizmi, kelam, simbiozë intelektuale*

## HYRJE

### I.

#### Mutezilizmi dhe Esharizmi

Racionalizmi ka qenë një tipar i spikatur i mendimit teologjik mysliman që nga kohërat më të hershme. Pavarësisht nga çështja e diskutueshme e autenticitetit, është ruajtur një korpus i vogël tekstesh në të cilat çështjet doktrinare, të tilla si vullneti i lirë kundrejt determinizmit, janë trajtuar me një model dialogu dilematik. Shfaqja e teknikës dialektike në këto tekste dëshmon për përdorimin e arsyes në formulimin dhe argumentimin e çështjeve doktrinare nga një periudhë më e hershme e këtej (Cook 1980; 1981; van Ess 1975; 1977). Pavarësisht nga fakti se racionalizmi ka pasur kundërshtarët e tij gjatë gjithë historisë islame, ai vazhdoi të ishte një nga shtyllat kryesore të mendimit teologjik mysliman dhe, vetëm si rrjedhim i fundamentalizmit modern islamik, racionalizmi është marginalizuar dhe kërcënuar si kurrë më parë.

Mutezilja ishte “shkolla” më e hershme e teologjisë racionaliste islame, e njohur si *kelam* dhe një nga rrymat më të rëndësishme dhe më me ndikim të mendimit islam. Mutezilinjtë theksuan përparësinë e arsyes dhe vullnetit të lirë (kundrejt paracaktimit) dhe zhvilluan epistemologjinë, ontologjinë dhe psikologjinë, të cilat kanë dhënë një bazë për të shpjeguar natyrën e botës, të Zotit, të njeriut dhe të fenomeneve të fesë, të tilla si shpallja dhe ligji hyjnor. Sipas etikës së tyre, Mutezilinjtë pohojnë se e mira dhe e keqja mund të njihet vetëm përmes arsyes njerëzore. Me epistemologjinë e tyre karakteristike, ata ishin gjithashtu kryesisht përgjegjës për zhvillimin e disiplinës tepër të sofistikuar të metodologjisë ligjore.

Mutezilja i ka fillimet e saj në shekullin e 8-të dhe periudha e saj klasike e zhvillimit ishte nga gjysma e dytë e shekullit të 9-të deri në mes të shekullit të 11-të (të erës sonë). Ndërkohë që gëzoi për pak kohë statusin e një teologjie “zyrtare” nën kalifët abasitë në shekullin e 9-të, lëvizja ishte shkrirë në dy shkolla kryesore në fillim të shekullit të 10-të: shkollën e Bagdadit dhe asaj të BASërës. Figurat dominante të shkollës së BASëras ishin Ebu Ali El Xhubbairi (vdiq më 916) dhe djali i tij Ebu Hashimi (vdiq më 933). Pasuesit e Ebu Hashimit formuar një nënshkollë të

rëndësishëm të njohur si Bahshamijje. Nga anëtarët e ndryshëm të kësaj shkolle, mund të përmendim këta në vijim: dishepulli i Ebu Hashimit, Ebu Ali bin Khalladi (vdiq rreth 961), Ebu Abd Allah El Basri (vdiq më 980) dhe Ebu Ishak bin Ajjashi, që ishin nxënës të Ibën Khalladit. Kryegjykatësi Abd el Xhebbar el Hamadhani (vdiq më 1025) ishte një nxënës i Ebu Abd Allahut dhe Ebu Ishakut dhe një autor shumë prodhimtar. Një nga vetë nxënësit e Abd El Xhebbarit, Abul Husejn El Basri (vdiq më 1044), themeloi atë që duket të ketë qenë shkolla e fundit krijuese e mendimit në mesin e mutezilinjve. Lëvizja gradualisht doli nga favori në Islamin Sunit dhe u shua kryesisht në shekullin e 14-të. Ndikimi i saj, megjithatë, vazhdoi të ndihet në Islamin Shiit ku influenza e saj jetoi nëpër shekuj dhe mund të shihet edhe sot. Përveç kësaj, kërkimet moderne për Mutezilen, nga fillimi i shekullit të 20-të e këtej, sollën një rilindje të nocionit mutezilit të racionalizmit që gjeti shprehjen e tij në të ashtuquajturin “Neo-Mutezile”, një term i paqartë që përcakton fillesat e ndryshme të mendimtarëve bashkëkohorë myslimanë, të cilët u mbështetën mbi trashëgiminë mutezilite për të vërtetuar rëndësinë e racionalizmit në diskursin modern mysliman (Hildebrandt 2007, El Mesudi 2008).

E dyta për nga rëndësia në përdorimin e racionalizmit ishte lëvizja teologjike e ashtuquajtur Esharije, e quajtur kështu sipas themeluesit të saj eponim, Ebul Hasan El Eshari (vdiq më 935), një ish-nxënës i mësuesit mutezilit Ebu Ali El Xhubba’iu. Rreth moshës dyzetvjeçare, Eshariu i braktisi mësimet e Mutezilizmit dhe vendosi që të formulonte sistemin e tij doktrinar. Eshariu dhe pasuesit e tij kishin për qëllim formulimin e një rruge të mesme ndërmjet dy vijave dominuese të kundërta të asaj kohe, Mutezilizmit dhe Islamit tradicionalist (sipas vulës së Hanbelizmit). Nga pikëpamja metodologjike, ata aplikonin racionalizmin në mendimet dhe shkrimet e tyre teologjike, siç ishte karakteristike për Mutezilen duke ruajtur ndërkohë ende përparësinë e shpalljes mbi atë të arsyes. Nga pikëpamja doktrinare, ata mbështetnin nocionin e subjektivizmit etik kundrejt objektivizmit etik të Mutezilizmit dhe shtjelluan nocionin e “fitimit” (*kasb*) të njeriut të veprave të tij, si një mënyrë për të ndërmjetësuar mes nocionit mutezilit të vullnetit të lirë dhe pikëpamjes tradicionaliste të paracaktimit. Mbi këtë bazë, ata zhvilluan doktrinat e tyre teologjike. Ashtu

si është karakteristike për zhvillimin e mendimit teologjik islam, Eshariu adoptoi koncepte të ndryshme në sistemin e tij doktrinar që ishin formuluar nga mendimtarët e mëparshëm (Perler/Rudolph 2000). Për shembull, i pari që u përpoq që të kombinonte metodologjinë racionale të mutezilinjeve me pikëpamjet doktrinare të tradicionalistëve në fakt ka qenë Ibën Kullabi (vdiq më 855?) dhe nocioni i “fitimit” të njeriut të veprave të tij ishte formuluar së pari nga Dirar bin Amri (vdiq më 796). Megjithatë, për shkak të suksesit të mëvonshëm të Esharijjes si një shkollë teologjike, këta paraardhës të mëhershëm shpjet u harruan.


Deri në fund të shekullit të 10-të, Esharizmi e kishte provuar veten si një nga lëvizjet më të përhapura teologjike në tokat qendrore të Islamit, kryesisht në sajë të teologut të shquar dhe gjykatësit malikit, Ebu Bekër El Bakilanit (vdiq më 1013), i cili gëzonte patronazhin i vezirit Bujid El Sahib bin Abbadit (vdiq më 995), siç ka qenë rasti me bashkëkohësin e tij mutezilit Abdul El Xhebbar El Hamadhanin. Gjithashtu, përmes nxënësve të Bakillanit, Ebu Bekër Muhamed bin El Hasan bin Furakut (vdiq më 1015) dhe Ebu Is’hak El Isfarainit (vdiq më 1020), të cilët që të dy kishin mësuar në Rajj dhe Nishapur, Esharizmi u përhap shpejt edhe në Persi, ku u shfaqën disa nga teologët më të shquar esharitë të gjeneratave në vijim. Falë përhapjes së shkollës malikite të ligjit në Afrikën e Veriut, shkrimet teologjike të Bakillanit u bënë gjithashtu të popullarizuara në këtë rajon dhe, pikërisht për këtë, fragmentet e *opus magnum* -it të tij, *Kitab hidajet el mustarshidin*, janë ruajtur në dorëshkrim. Esharizmi ka arritur një kulm të mëtejshëm gjatë periudhës së hershme selxhuke, kur gëzonte mbështetjen zyrtare të vezirit Nizam el Mulkut (vdiq më 1099) dhe ai u bë një komponent qendror brenda planprogramit të rrjetit nizamijje të institucioneve arsimore; teologët kryesorë esharitë të kohës ishin Ebu Bekër Ahmed bin Muhamed El Furaki (vdiq më 1085) dhe Imami i famshëm el Haremejn Ebul Ma’ali el Xhujeni (vdiq më 1085). Siç ishte rasti me Ebul Husejn El Basriun në mesin e mutezilinjeve, Xhujeni ishte i pari që integroi metodat dhe nocionet filozofike në *kelamin* esharit dhe në fakt ka prova se Xhujeni kishte studiuar intensivisht dhe ishte ndikuar thellësisht nga shkrimet e Ebul Husejnit (Madelung 2006). Me Xhujenin faza e hershme e Esharizmit mori fund dhe faza e ardhshme u karakteri-

zua nga integrimi në rritje i filozofisë dhe i logjikës në metodologjinë dhe mendimin teologjik. Kjo fazë u hap nga Ebu Hamid el Gazaliu (vdiq më 1111) dhe në mesin e autorëve të saj më të rëndësishëm janë Muhammed bin Abd El Kerim El Shehrestani (vdiq më 1153) dhe Fekhr El Din El Razi (vdiq më 1209). Në tokat lindore të Islamit, Esharizmi mbeti një nga vijat më të spikatura të mendimit deri në fund të shekullit të 16-të. Brenda sferës sunite së paku, Esharizmi tregoi më shumë sukses dhe gëzoi një jetë më të gjatë se Mutezilizmi, megjithatë, ashtu si Mutezilizmi, edhe Esharizmi u sfidua vazhdimisht nga kundërshtarët tradicionalistë që refuzonin çdo lloj racionalizmi.

Vijat e ndryshme të mendimit racional teologjik mysliman brenda Islamit janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, pasi ato janë formësuar dhe riformësuar në një proces të vazhdueshëm të ndërveprimit të ngushtë në mes të përfaqësuesve të tij përkatës. Kjo vlen edhe për shkollat e tjera teologjike që ishin më pak të shquara në zonat qendrore të botës islame, të tilla si Maturidijje (e quajtur kështu sipas eponimit të saj Ebu Mensur El Maturidi, që vdiq më 944) e cila ishte shumë borxhlie ndaj qëndrimeve tradicionale hanefite dhe mendimit mutezilit po ashtu, por qendra e të cilës ishte në verilindje të Iranit (Transoksania), kështu që ajo ka pasur ndikim relativisht të vogël (me përjashtim të tokave qendrore osmane) (Rudolph 1997; Badeen 2008).

## II.

## Ndërveprimi mes autorëve myslimanë dhe atyre të krishterë ose hebraikë



*Faqja e parë e një dorëshkrimi autograf nga Jemeni, e vëllimit 2 të Kitab El Shamil bi-haka'ik el adilla el aklije ue-usul el masa'il el dinijje prej El Imam El Mu'ajjad bi-lah Jabja bin Hamza (vdiq më 749 / 1348-1349).*

Ajo që është thënë në lidhje me ndërveprimin e ngushtë në mes të vijave të ndryshme të mendimit brenda Islamit vlen njëlloj edhe për marrëdhëniet e Islamit me fetë e tjera që paraqiteshin dukshëm në botën mesjetare të Islamit, përkatësisht Judaizmit dhe Krishterimit. Këtu mund të vërehen fenomene të ngjashme të reciprocitetit. Hebrejntë, të krishterët dhe myslimanët, të shkolluar si dhe të pashkolluar, e kanë pasur arabishten (dhe ndonjëherë persishten) si gjuhën e tyre të përbashkët dhe për këtë arsye, natyrisht, kishin të përbashkët një sfond të ngjashëm kulturor. Shpesh duke lexuar të njëjtat libra dhe duke folur dhe shkruar të gjithë në të njëjtën gjuhë, ata krijuan një përbashkësi unike intelektuale në të cilën shkëmbimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i ideve, teksteve dhe for-

mave të ligjërimit ishte normë dhe jo përjashtim. Kjo karakteristikë e botës mesjetare të Islamit – e cila është përshkruar me vend si një “pllenim i kryqëzuar” (Goodman 1995; 1999; Montgomeri 2007) apo një “efekt vorbule” (Stroumsa 2008) – kërkon që çdo studim i racionalizmit teologjik të mos i pranojë kufijtë fetarë. Perspektiva njëdimensionale që ende mbizotëron në kërkimet moderne duhet të zëvendësohet nga shumëdimensionaliteti i vërtetë.

Ekziston pothuajse një konsensus mes dijetarëve bashkëkohorë se teknika dialektike myslimane e *kelamit* mund të gjurmohet në modelet e ngjashme të dialogut dilematik që kanë qenë karakteristike për polemikat e mëparshme antike kristologjike, veçanërisht në ato që u ndezën në shekullin e gjashtë në Aleksandri dhe, më e rëndësishmja, të shekullit të shtatë në Siri (Cook 1980; Zimmermann 1985; Brock më 1986; Hoyland 1997; Reynolds 2004). Përveç kësaj, teologët myslimanë i përkushtuan shumë mendime dhe energji ekzaminimit kritik dhe përgënjeshtërimit të pikëpamjeve të Krishterimit dhe (në një masë më të vogël) Judaizmit, siç shihet qartë nga traktet e shumta polemizuese të shkruara nga ata kundër këtyre religjioneve. Përderisa pjesa më e madhe e përgënjeshtërimit të Krishterimit nga teologët e hershëm myslimanë ka humbur, ekziston një numër i vogël tekstesh ekzistuese antikrishtere të shekullit të 9-të, që japin një përshtypje të mirë të argumenteve që janë përdorur (Thomas 2004). Shembujt ekzistues të veprave të tilla të shekullit të 10-të janë *Kitab tath-bit dala'il el nubuvva* nga muteziliti Abd El Xhebbâr El Hamadhani (Reynolds 2004) dhe, brenda kampit esharit, *Shifa el ghalil* nga Xhujejni apo *Radd el xhemil li-ilahijjet 'Isa bi-sarih el inxhil* që i atribuohet Gazali-ut dhe vërtet mund të jetë prej tij (El Kaisy Friemuth 2007; Thomas 2007).

Gjithashtu janë ruajtur shumë prej trajtesave të mëhershme në gjuhën arabe në mbrojtje të Krishterimit. Këto janë shkruar nga teologë që përfaqësonin tre grupet kryesore të krishtera në Lindjen e Mesme gjatë shekullit të parë abasit: melkiti Theodore Ebu Kurra (vdiq rreth vitit 830), nestoriani Ammar El Basri (vdiq rreth vitit 845) dhe jakobini Habib bin Khidma Ebu Raita (vdiq rreth vitit 855). Ne dimë nga burimet islame se këta tre teologë të krishterë kanë qenë në dialog me teologët racionalë myslimanë. Përveç kësaj, nga mbrojtjet e tyre përkatëse të atyre doktrina-

ve të krishtera që u bënë fokusi standard i polemikave myslimane-të krishtere – pra, Triniteti, Inkarnimi, Pagëzimi, Eukaristia, nderimi i kryqit dhe drejtimi i kthimit gjatë lutjes – është e qartë se ata i njihnin hollësisht teknikat dhe terminologjitë e *kelam*-it mysliman (Griffith 2002). Duke pasur parasysh mosmarrëveshjet themelore ndërmjet pikëpamjeve teologjike myslimane dhe të krishtera, të tilla si nocionin mysliman të unicitetit hyjnor (*tevhid*), i cili është i papajtueshëm me të kuptuarit e krishterë të trinitës dhe të inkarnimit, ishte e pamundur që teologët e krishterë të mund të adoptonin shumë nga doktrinat e shkollave myslimane. Pranimi më i gjerë i *kelamit* mysliman mund të vërehet në mesin e shkrimtarëve koptike. Përderisa autori i parë i madh koptik që shkroi në gjuhën arabe u shfaq relativisht vonë në personin e Severus (Savirius) bin El Mukaffas (vdiq pas 987), koptët sollën në shekujt e mëvonshëm një korpus të literaturës së krishterë në gjuhën arabe, vëllimi e të cilit e tejkalonte shumë atë që ishte shkruar nga të gjitha komunitetet e tjera arabe të krishtera të marra së bashku (Graf 1947: 294ff; Sidarus 1993). Siç është treguar në detaje për Ebu Shakir bin El Rahibin dhe El Mu'temen bin El Assalin (të dy të shek. të13-të), shkrimtarët koptikë të kësaj epoke ishin influencuar veçanërisht nga shkrimet e teologut esharit Fakhr El Din El Razi (Sidarus 1975; Wadi 1997; Schwarb ).

Judaizmi është treguar shumë më i hapur ndaj nocioneve doktrinare themelore myslimane, të tilla si uniciteti hyjnor, se sa Krishterimi dhe ishte Mutezilizmi në veçanti që u adoptua në shkallë të ndryshme, nga shekulli i 9-të e në vazhdim, nga autorët rabbanitë dhe karaitë, kështu që në fillim të shekullit të 11-të u shfaq një “Mutezile hebraike”. Studiuesit hebraikë edhe hartonin vepra origjinale përgjatë linjave mutezilite, edhe bënë kopje të librave myslimane mutezilite, që shpesh i transkriptonin me karaktere hebraike. Shembuj tipikë të veprave mutezilite origjinale hebraike janë: *El Kitab el muhtavi* e karaitit Jusuf El Basirit (vdiq rreth 1040) dhe më i përmbledhuri i tij *Kitab el temjiz* (Vajda 1985; Sklare 1995; von Abel 2005; Madelung & Schmidtke 2006), *Kitab el ni'ma* e bashkëkohësit e tij më të vjetër Levi ben Jefet (Sklare 2007), apo *Kitab el tevrije* e nxënësit të Basirit, Jeshu'a ben Jehudeh. Influenca e Muteziles e gjeti rrugën e saj në vetë qendrat e jetës fetare dhe intelektuale hebraike

në Lindje. Disa prej krerëve të akademive të lashta rabbanite (Jeshivot) të Sures dhe Pumbeditas (që u zhvendosën në shekullin e 10-të në Bagdad) adoptuan botëkuptimin mutezilit. Njëri prej tyre, Samuel ben Hofni Gao-ni (vdiq më 1013) ishte familjarizuar ngushtë me veprat e Ibën Khalladit dhe e ka njohur personalisht Ebu Abd Allah El Basrin (Sklare 1996). Gjithashtu, ashtu siç ka qenë rasti me shkrimtarët e krishterë, doktrinat dhe terminologjia mutezilite ka siguruar një bazë për diskutimet dhe shkëmbimin e polemikave mes dijetarëve hebraikë dhe myslimanë (Sklare 1999). Në kontrast me këtë, veprat dhe autorët esharitë janë pranuar në mesin e dijetarëve hebraikë në një shkallë dukshëm më të vogël dhe në një mënyrë kryesisht kritike (Sinai 2005).

Mutezilizmi kishte lënë gjithashtu gjurmën e tij edhe në mendimin teologjik të samaritanëve, për shembull tek autori i shekullit të 11-të, Ebul Hasan El Suri. Nuk është e qartë nëse samaritanët (qendrat intelektuale të të cilëve ndërmjet shekullit 9-të dhe 11-të ishin kryesisht Nablusi dhe Damasku) i kishin studiuar shkrimet mutezilite myslimane drejtpërsëdrejti apo nëse ata u njohën me to përmes adaptimeve hebraike të mutezilizmit. Shumica e shkrimeve teologjike samaritane që u hartuan në gjuhën arabe presin ende një analizë të thellë, por një shqyrtim i përciptë i materialit të dorëshkrimeve ekzistuese konfirmon se Ebul Hasan El Suri nuk ka qenë aspak një përjashtim (Wedel 2007).

Ekzistojnë mjaft shembuj të tjerë të procesit të vorbullës intelektuale në botën mesjetare të Islamit përtej kufijve sektarë. Dy të mëposhtmit do të mjaftojnë për të treguar se nevojitet një qasje vërtet shumëdimensionale për t'i kuptuar këto procese. Traktati më i hershëm ekzistues sistematik i *kelamit* kishte autor Daval bin Marvan el Mukammasin, një ish-hebre i cili u konvertua në Krishterim dhe më vonë u rikonvertua në Judaizëm. El Mukammasi ishte një nxënës i teologut jakobit Nonnusi i Nisibisit (vdiq rreth 870) dhe vepra e tij, *'Ishrun mekale*, tregon karakteristikat e *kelamit* mysliman si dhe të doktrinave të krishtera, ndërkohë që këndvështrimi i përgjithshëm i librit është hebraik (Stroumsa 1989; 2007). Shembulli i dytë ka të bëjë me mendimtarin e spikatur hebraik Musa bin Mejmun El Kurtubi ("Maimonides", vdiq më 1204), i cili lexohej shumë në literaturën myslimane dhe pranohej gjerësisht në mesin e lexuesve

myslimanë dhe të krishterë mesjetarë, ashtu siç shihet qartë nga gjurmët e shumta të librit të tij *Udhërrëfyesi i të hutuarve* që ka mbetur në literaturën e mëvonshme myslimane dhe krishtere (Schwarb 2007).

### III.

#### **Kërkimi shkencor mbi teologjinë racionale myslimane**

Në fushën e studimeve islame, kërkimi shkencor mbi teologjinë racionale myslimane është një disiplinë relativisht e re, pasi një masë kritike e burimeve parësore u bë e qasshme vetëm në një stad relativisht të vonë. Veprat mutezilite dukshëm nuk janë kopjuar gjerësisht dhe relativisht pak dorëshkrime kanë mbijetuar. Kështu që, meqë një literaturë e paktë autentike mutezilite ka qenë në dispozicion deri në publikimin e disa teksteve të rëndësishme në 1960, doktrina mutezilite njihej më së shumti nëpërmjet veprave të kundërshtarëve të saj. Megjithatë studimi i mendimit mutezilit bëri përparim të ngadalshëm, por të vazhdueshëm, gjatë gjithë shekullit të 20-të. Për shkak se mendimi mutezilit pothuajse ishte ndaluar nga qendra e botës sunitë rreth fundit të shekullit të 11-të, ai nuk konsiderohej si një pjesë përbërëse e historisë intelektuale islame nga studiuesit e mëparshëm perëndimorë. Duke pasur parasysh qasjen racionaliste të Muteziles ndaj çështjeve teologjike, historianët e mendimit të shekullit të 19-të i konsideronin përgjithësisht Mutezilinjtë si “mendimtarë të lirë” brenda Islamit që ishin influencuar nga mendimi filozofik grek dhe kështu përbënin një anomali brenda historisë intelektuale islame (p.sh. Steiner 1865).

Ky vlerësim, i cili bazohej pothuajse ekskluzivisht mbi hereziografitë e shkruara nga joMutezilinjtë, u provua të ishte i gabuar në fillim të shekullit të 20-të, si rezultat i publikimit të disa teksteve të rëndësishme. Në vitin 1925 studiuesi suedez H.S. Nyberg botoi *Kitab el intisar* të mutezilitit nga Bagdadi Ebu l-Husejn el Khajjatit (vdiq rreth 913), një përgënjeshtrim i traktatit polemik të skeptikut Ibën El Ravandit (vdiq më 860 ose 912?), *Fadihat el mutezile*, i cili nga ana e tij drejtohej kundër librit pro-mutezilit të Xhahizit (vdiq më 868) *Kitab fadilat el mutezile* (Nyberg 1925). Ndonëse vepra e Khajjatit nuk përmban informacione të hollësishme mbi pikëpamjet e mutezilinjve për shkak të karakterit të saj apolo-

gjetik, kjo ishte vepra e parë e shtypur e disponueshme me autor një mutezililit. Me një rëndësi shumë më të madhe për studimin e Mutezilizmit ishte botimi i Hellmut Ritterit i doksografisë së Ebul Hasan El Eshariut, *Mekalat el islamijjin*, botuar në 1929-1930 (Ritter 1929-1930). Kjo vepër ofroi njohuri të besueshme për pikëpamjet e mutezilinjeve, pasi autori kishte qenë fillimisht një pasues i kësaj lëvizjeje dhe ishte familjarizuar me shkrimet mutezilite të kohës së tij.

Hapi tjetër vendimtar në studimin e mendimit mutezililit ndodhi në fillim të viteve 1950-ta, kur u zbuluan një numër dorëshkrimesh në Jemen, gjatë një ekspedite të një grupi të dijetarëve egjiptianë. Këto dorëshkrime përfshinin kryesisht veprat e përfaqësuesve të ndryshëm të Bahshamijjes. Ato përfshinin katërmbëdhjetë nga njëzet vëllimet origjinale të veprës enciklopedike *Kitab el Mughni fi ebvab el tevhid ve-l-‘adl* të Abd El Xhabbar El Hamadhani-t, të cilat më pas u botuan në Egjipt (1961-65). Shkrimet e tjera të pasuesve të Bahshamijjes, që janë gjetur në bibliotekën e Xhamisë së Madhe në San‘a, u botuan gjithashtu gjatë viteve 1960-ta. Midis tyre mund të përmendim *Ta‘lik sharh el usul el khamsa*, një recension i *Sharh el usul el khamsa-s* të Abd El Xhebbarit nga një prej pasuesve të tij, Imami zejdi Manakdim (vdiq më 1034) (Manakdim 1965), si dhe *Kitab al-mexhmu fi l-muhit bi-l-teklif*, një recension i *el Kitab el muhit bi-l-teklif* të Abd El Xhebbarit nga një pasues tjetër i tij, përkatësisht Ibën Mattavejh (Ibën Mattavejh 1965-1999).

Megjithatë, pavarësisht nga këto zbulime të pasura, mbeten boshllëqe të shumta. Nga njëra anë, vetëm pak tekste nga mendimtarët përpara Abd El Xhebbarit u zbuluan në Jemen. E njëjta gjë vlen edhe për grupet rivale ndaj Bahshamijjes, si Ikshidijje, ose shkolla e Bagdadit. Gjithashtu, pjesë mjaft të rëndësishme të veprave të pasuesve të Bahshamijje-s ishin ende të pagjetura. Për shembull, vëllimet 1-3, 10 dhe 18-19 të Mughra-s nuk ishin gjetur dhe as vepra të tjera nga Abd el Xhabbari, të tilla si versioni origjinal i librit *el Kitab el muhit* ose vepra e tij *Sharh keshf el a‘rad*. Për më tepër, zbulimet e viteve 1950-ta sugjeruan se Bahshamijje përbënte shkollën e fundit novatore dhe dinamike brenda Mutezilizmit. Kjo përshtypje u provua të ishte e gabuar vetëm disa dekada më vonë, kur Wilferd Madelungu dhe Martin McDermotti zbuluan dhe botuan fra-

gmentet ekzistuese të *Kitab el mu'tamad fi usul el din*-it të Rukn El Din Mahmud bin Muhammed El Melahimit (vdiq më 1141) dhe më të përmbledhurin e tij *Kitab al-fa'ik fi usul el din* (Ibën El Melahimi 1991; 2007). Ibën El Melahimi ishte një ndjekës i mësimave të Ebul Husejn El Basriut, themeluesit të asaj që duket se ka qenë shkolla e fundit novatore brenda Muteziles. Nga shkrimet e tij është e qartë se qëndrimet e Ebul Husejnit ndryshonin dukshëm nga ato të mësuesit të tij Abd El Xhebbarit dhe se ai kishte formuluar pikëpamje të reja mbi një numër çështjesh qëndrore. Nuk u gjetën në Jemen, megjithatë, ishin shkrime teologjike nga vetë Ebul Husejn El Basriu. E as nuk u zbuluan tekstet bashkëkohëse nga kundërshtarët e Ebu l-Husejnit; këto mund të kishin dhënë dëshmi për debatet e forta që u zhvilluan ndërmjet pasuesve të Bahshamijjes nga njëra anë dhe Ebul Husejnit në anën tjetër. Vetëm nga burimet e mëvonshme ne dimë se armiqësitë ndërmjet dy grupeve duhet të kenë qenë vërtet shumë të forta.

Studimi i Mutezilizmit hebraik filloi një shekull më parë me veprat e Salomo Munkut (1859) dhe Martin Schreinerit (1895). Schreineri dhe Munku, megjithatë, nuk kanë qenë në dijeni të burimeve parësore të gjetura në mesin e materialeve të ndryshme në Geniza, që ishin zbuluar dhe nxjerrë gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 19-të në Kajro nga një numër i dijetarëve dhe mbledhësve të dorëshkrimeve. Trembëdhjetë dorëshkrime mutezilite, që janë gjetur në koleksionin e Abraham Firkovitch-it (të marra nga Geniza, apo magazina e Sinagogës Karaite në Kajro), janë përshkruar në detaje nga Andreij J. Borisovi në një artikull të botuar në 1935. Ndërmjet viteve 1939 dhe 1943, Leon Nemoyi botoi *Kitab el envar ve-l-merakib* nga karaiti Jakub el Kirkisani (kulmoi në fillim të shekullit të 10-të në Bagdad). Vepra të tjera të dalluara në studimin e Mutezilizmit hebraik ishin *Repercussions of the Kalam in Jewish Philosophy* (1979) të Harry A. Wolfsonit dhe veprat e Georges Vajdas mbi Jusuf el Beshirin, veçanërisht botimi i tij i veprës së Beshirit: *El Kitab el muhtavi* mbi bazën e një dorëshkrimi nga koleksioni Kaufmann në Budapest (Vajda 1985). Hagai Ben-Shamai ka studiuar elementet mutezilite në veprat e autorëve të hershëm karaitë të shekullit të 10-të, Jakub el Kirkisanit dhe Jefet ben Elit (Ben-Shamai 1978). Në bazë të përshkrimeve të Borisovit

të dorëshkrimeve mutezilite të Firkovitchit dhe nga disa fragmente në Bibliotekën Britanike, Ben-Shamai për më tepër ishte në gjendje që të nxirrte përfundime të tjera në lidhje me identitetin e disa prej materialeve mutezilite të ruajtura nga karaitët, duke treguar veçanërisht se karaitët e kishin ruajtur versionin origjinal të veprës *el Kitab el muhit* të Abd El Xhebbarit (Ben-Shammai 1974). Sarah Stroumsa ka publikuar *Ishrun me-kale* të Davud bin Mervan el Mukammas (Stroumsa 1989; 2007); dhe David Sklare ka rindërtuar disa nga shkrimet mutezilite të Samuel ben Hofni Gaonit (Sklare 1996) dhe ka shqyrtuar ndikimin e mendimit mutezilit në shkrimet ligjore të Jusuf el Beshirit (Sklare 1995).

Në vitin 2003 u themelua “Grupi i Projektit të Dorëshkrimeve Mutezilite” nga autorë të tashëm, së bashku me David Sklaren, me qëllim që të mblidhnin dhe të identifikonin sa më shumë që të ishte e mundur materiale të dorëshkrimeve mutezilite nga magazinat hebraike, si dhe shiite. Një nga gjetjet e fundit më spektakolare nga anëtarët e grupit janë tre fragmente të gjata të veprës *Kitab tesaffuh el adilla* të Ebul Husejn El Basriut, i cili besohej të ishte plotësisht i humbur (Madelung & Schmidtke 2006a), si dhe fragmente të dy përgënjeshtërimeve të doktrinës së Ebul Husejnit, shkruar nga bashkëkohësi i tij, karaiti Jusuf el Beshiri (Madelung & Schmidtke 2006; 2007). Gjithashtu, janë zbuluar dhe botuar pjesë nga vepra *Mughni* e Abd El Xhebbarit nga volume që nuk janë gjetur në mesin e dorëshkrimeve të Jemenit (Schmidtke 2007; Hamdan & Schmidtke; Schwarb). Për më tepër, një koment anonim mbi veprën *Kitab el tedhkire* të Ibën Mattavajhut, që është ruajtur në një kopje dorëshkrimi me sa duket unike, e strehuar në Bibliotekën Asghar Mehdevi në Teheran, është vënë në dispozicion në një botim faksimileje (Schmidtke 2006). Përveç kësaj, shkrime të shumta mutezilite, që janë konsideruar të humbura, janë gjetur kohët e fundit në Jemen dhe Indi, duke përfshirë kritikën e filozofisë peripatetike të Ibën El Melahimi-t, *Tuhfat el mutekellimin fi l-radd ala l-felasife* (Ensari 2001) që tani është e disponueshme në botimin kritik (bot. H. Ensari & W. Madelung, Teheran 2008).

Ndonëse gjatë viteve të fundit është arritur shumë, shumë materiale tekstuale mutezilite mbeten ende të pazbuluara. Ndër dokumentet që janë gjendur në koleksionet e ndryshme të Genizas, materiali që e ka prejardh-

jen nga Ben Ezra Geniza (Kajro) dhe që në ditët e sotme ruhet kryesisht në koleksionin Taylor-Schechter në Bibliotekën Universitare të Kembrixhit (dhe biblioteka të tjera në Evropë dhe SHBA) është deri më tani ende përgjithësisht i paidentifikuar dhe vetëm i kataloguar në mënyrë rudimentare (Baker & Polliack 2001; Shvitiel & Niessen 2006). Shpresohet se një studim sistematik i të gjitha fragmenteve mutezilit do të bëjë të mundur rindërtimin e më shumë shkrimeve të humbura mutezilit (myslimane dhe hebraike) deri më sot. Si i tillë, ky material Geniza do të plotësojë në mënyrë të konsiderueshme zbulimet ekstensive të materialit Geniza të gjetura në Koleksionin Firkovitch (Shën Petersburg), që gjithashtu deri më tani është hulumtuar vetëm pjesërisht (Schmidtke 2007). Gjithashtu, vetëm gjatë viteve të fundit pasuritë e mëdha të bibliotekave të ndryshme private dhe më të vogla publike të Jemenit janë duke u vënë në dispozicion të komunitetit shkencor. Ndërkohë që disa prej këtyre materialeve janë përdorur për botime të ndryshme nga anëtarët e “Grupit të Projektit të Dorëshkrimeve Mutezilit”, pjesa më e madhe ende pret një studim të hollësishëm. Kjo vlen edhe për zhvillimin e mendimit mutezilit në mesin e zejditëve nga shekulli i 12-të e këtej.

Studimi i aktiviteteve letrare samaritane në arabisht në përgjithësi dhe i mutezilizmit samaritan në veçanti është ende shumë në fillim. I vetmi tekst përkatës i cili është studiuar dhe botuar pjesërisht është *Kitab el tubakh* i autorit të shekullit të 11-të, Ebul Hasan El Surit, që mban qartas konceptin doktrinar mutezilit (Wedel 1987; 2007). Kjo gjendje e mjerueshme e hulumtimit është gjithnjë e më shumë e habitshme pasi kushtet për një hetim sistematik të mendimit teologjik samaritan janë ideale. Një koleksion mikrofilmash që përmban pothuajse të gjithë trashëgiminë ekzistues letrare të samaritanëve të shkruar në gjuhën arabe (duke mos i përfshirë, sidoqoftë, materialet e koleksionit Firkovitch) është në pronësi të bibliotekës së Institutit të Studime Arabe dhe Semite të Freie Universität Berlin (shih <[www.geschkult.fu-berlin.de/e/semiarab/](http://www.geschkult.fu-berlin.de/e/semiarab/)>).

Ndërsa hulumtimet moderne mbi Mutezilen kanë filluar relativisht vonë, hulumtimet mbi Esharizmin kishin filluar tashmë që në shekullin e 19-të, pasi në bibliotekat evropiane janë ruajtur më shumë dorëshkrime të teksteve esharite se sa është rasti me tekstet mutezilit. Në vitin 1876

Wilhelm Spitta botoi monografinë e parë për themeluesin eponim të lëvizjes dhe në vitin 1889 Martin Schreiner botoi studimin e parë të zgjeruar historik për Eshariejen. *Kitab el Irshad* i Xhuvejnit u botua së pari në vitin 1938, në një botim kritik nga Jean D. Luciani, së bashku me një përkthim në frëngjisht. Referime kryesore në shekullin e 20-të kanë qenë publikimet e Richard J. McCarthyt. Në vitin 1953, ai botoi një monografi që përmbante botime kritike dhe përkthime të pjesës më të madhe të shkrimeve ekzistuese esharite dhe në vitin 1957 ai publikoi një botim kritik të *Kitab el temhid* të Bakillanit. Një studim i thellë historik i zhvillimit të shkollës e deri në kohën e Xhuvejnit është bërë nga Michel Allard (Allard 1965), i cili kishte publikuar gjithashtu botimet kritike të dy teksteve të Xhuvejnit, *Shifa' el ghalil* dhe *Luma' fi keua'id ehl el sunne ue-l-xhema'a* (Allard 1968). Përparime të tjera në dekadat e fundit janë bërë nga studimet e shumta të Richard M. Frankut (p.sh., Frank 1994; 2007) dhe Daniel Gimaretit (Gimaret 1985; 1987; 1990). Përveç përpjekjeve nga dijetarët perëndimorë, shumë dijetarë në botën islame kanë kontribuar gjithashtu dukshëm për hulumtimin e kësaj lëvizjeje (p.sh., El Bukhti 2005).

Pavarësisht nga ky progres, mbetet ende shumë për të dëshiruar në shqyrtimin shkencor të Esharijjes, veçanërisht në lidhje me fazën më të hershme të lëvizjes, para Gazaliut. Nga dy teologët më të shquar të asaj periudhe, Bakillani dhe Xhuvejni, ne posedojmë deri më tani vetëm një numër shumë të kufizuar shkrimesh dhe, në të dyja rastet, veprat kryesore respektive – *Hidajet el mustershidin* e Bakillanit dhe *Kitab el Shamil* e Xhuvejnit – janë ruajtur vetëm pjesërisht (për aq sa dihet deri më tani të paktën). Për më tepër, shumë teologë të tjerë të kësaj periudhe, shkrimet e të cilëve përmbajnë informacione mjaft të vlefshme mbi pikëpamjet doktrinare të përfaqësuesve të ndryshëm të fazës më të hershme, mbeten ende të pabotuar dhe të pastudiuar. Se deri në çfarë mase këto tekste mund ta revolucionarizojnë kërkimin mund të mësohet nga vepra *Muxherred mekalat el Eshari* e Ibën Furakut. Ajo u botua në vitin 1987 nga Daniel Gimaret, në bazë të një dorëshkrimi të vetëm ekzistues të ruajtur në Medinë (Gimaret 1987), dhe në bazë të tij ai ishte në gjendje që të shkruante studimin e tij deri më tania të patejkalueshëm mbi mendimin doktrinar të

themeluesit të lëvizjes (Gimaret 1990). Për më tepër, libri *Kitab el irshad* i Xhuvejnit, një përmbledhje e librit të tij më të madh *Kitab el shamil*, shkaktoi një numër komentesh nga disa prej nxënësve dhe pasuesve të tij të mëvonshëm, siç është e qartë, për shembull, nga komenti pjesërisht ekzistues i Ebul Kasim Selman bin Nasir el Nisaburi el Ensarit (vdiq më 1118), *el Ghunya fi l-kelam* (MS III Ahmet 1916). Përndryshe libri kryesisht i humbur i Xhuvejnit *Kitab el shamil* (bot. Klopfer 1959; Neshshar [e të tjerë] 1969; Frank 1981; Umer 1999) shpeshherë përdoret dhe shpesh parafrazohet nga autorët e këtyre komenteve. Ne gjithashtu zotërojmë një dorëshkrim që përmban një përmbledhje të tekstit nga një autor anonim që titullohet *el Kamil fi ikhtisar el shamil* (MS III Ahmet 1322). *Kitab el Shamil* gjithashtu citohet shpesh në *summa*-n teologjike nga një nxënës tjetër i tij, Ebul Hasan Ali el Kija Herrasi (vdiq më 1110), i cili është i ruajtur gjithashtu në dorëshkrim (MS Kajro, Dar El Kutub, 'ilm el kelam 290). Një kërkim i thellë i të gjitha koleksioneve të dorëshkrimeve (arabisht) të kataloguara pa dyshim do të nxirrte në dritë një sasi të konsiderueshme të materialit të ri.

Pothuajse të gjitha shkrimet ekzistuese të gjeneratës së parë të shkrimit *mutekellimun* të krishterë në gjuhën arabe janë botuar dhe shumë janë përkthyer (Bacha 1904; Graf 1910; 1951; Hayek 1977; Lamoreaux 2005) dhe studiuesit modernë, të tillë si Sidney H. Griffith dhe David Thomas, i kanë studiuar ato në detaje.

Po kështu, të gjithë shkrimet e pakta ekzistuese antikristiane nga teologët racionalë myslimanë janë publikuar në botime kritike (di Matteo 1921-22; Finkel 1926; Thomas 2002). Në kontrast me këtë, ende nevojitet të bëhet shumë punë mbi korpusin e madh të shkrimeve koptike të krishtera, një numër i paktë prej të cilave është publikuar deri më tani në botime kritike, e le më të jenë studiuar. Është ky korpus që ende nevojitet të jetë në dispozicion në botimet kritike dhe të studiohet me qëllim që ato të zënë vend brenda vorbullës të historisë intelektuale në botën mesjetare të Islamit.

## Përfundim

Hapi tjetër që duhet të bëhet gjatë hulumtimit është fokusimi mbi racionalizmin teologjik në botën mesjetare të Islamit *përtej e matanë* kufijve sektarë. Shkëmbim i vazhdueshëm dhe reciprok i ideve, teksteve dhe formave të ligjërimit ishte normë në mesin e pasuesve të të tri sekteve monoteiste dhe jo përjashtim. Pavarësisht nga ky realitet historik i pranuar gjerësisht, studiuesit ende zgjedhin zakonisht një qasje njëdimensionale me një fokus (shpesh ekskluziv) mbi autorët myslimanë, hebrenj ose të krishterë dhe shkrimet e tyre përgjatë kufijve të vendosur në mes të tre disiplinave kryesore të akademisë dhe hulumtimit, d.m.th. Studimeve Islame, Studimeve Hebraike dhe Studimit të Krishterimit Lindor. Ky model duhet të zëvendësohet me një ndërdisiplinaritet shumëdimensional që arsyetohet me realitetin historik të periudhave dhe të rajoneve nën shqyrtim. Për më tepër, në një përpjekje të tillë njeriu duhet gjithashtu të synojë që të bëjë lidhjen në mes studiuesve kryesorë të fushës që nuk janë të ndarë vetëm nga kufijtë e vendosur disiplinorë, por edhe nga ata politikë. Duhet të kërkohet një bashkëpunim më i ngushtë midis kërkuesve nga Perëndimi dhe botës islamike në mënyrë që të krijohet një cilësi e re brenda hulumtimit. Historia intelektuale, në mënyrë të veçantë, nuk merr parasysh asnjë kufi kombëtar, fetar, kulturor apo ekonomik dhe simbioza intelektuale shpesh ishte normë dhe jo përjashtim në kohën mesjetare dhe paramoderne; dhe kjo qëndron e vërtetë veçanërisht në një nga zonat më të nxehta të sotme të konfliktit, Lindjen e Mesme.

*Përktheu nga anglishtja*

**Mimoza Sinani**

### Referencat:

- Abd El Xhebbbar El Hamadhani (1961-65): *Kitab al-Mughni fi abvab el tehvid ve-l- 'adl*. Bot. Muhammed Mustafa Hilmi [e të tjerë]. Kajro.
- von Abel, W. (2005): *Jusuf el Beshir, Das Buch der Unterscheidung*. Judäo-arabisch—Deutsch. Übersetzt und eingeleitet. Freiburg.
- Allard, M. (1965): *Le probleme des attributs divins dans la doctrine d'el Eš'ari et de ses premiers grands disciples*. Bejrut.
- Allard, M. (1968): *Textes apologetiques de Guwayni*. Bejrut.
- Ensari, H. (2001): "Kitab-i tazihjeb dar Nakd-i falsafa. Paida shudan-i Kitab-i 'Tuhfat el mutekellimin-i' Malahimi. *Nashr-i danish* 18 iii: 31-32.
- Bacha, C. (1904): *Les œuvres arabes de Théodore Aboucara*. Bejrut.
- Badeen, E. (2008): *Sunnitische Theologie in osmanischer Zeit*. Würzburg.
- Baker, C. & M. Polliack (2001): *Arabic and Judaeo-Arabic Manuscripts in the Cambridge Genizah Collections*. Seritë e arabishtes së vjetër (T-S Ar. Ia-54). Kembrixh.
- Ben-Shammai, H. (1974): "A note on some Karaite copies of Mu'tazilite writings". *Buletini i Shkollës së Studimeve Orientale dhe Afrikane* 37: 295-304.
- Ben-Shammai, H. (1978): *The Doctrines of Religious Thought of Aba Yasuf Ya' qab al-Qirqisant and Yefet ben 'Eli*. Tezë PhD, Jerusalem: Universiteti Hebraik.
- Borisov, A.J. (1935): "Mu'tazilitskie rukopisi Gosudarstvennoj Publicnoj Biblioteki v Leningrade." *Bibliografija Vostoka* 8-9: 69-95.
- Brock, S.P. (1986): "Two Sets of Monothelete Questions to the Maximians." *Orientalia Lovanensia Periodica* 17: 119-40.
- Bukhti, J. (2005): *Uthman al-Salaji ve-medhhebijjetuhu el esh 'arijje. Dirasa li-xhanib min el fikr el kelami bi-l-Maghrib min khilal "el Burhanijje" ve-shuruhiha*. Rabat.
- A Common Rationality. Mutezilism in Islam and Judaism*. Ed. C. Adang, S. Schmidtke, D. Sklare. Würzburg 2007.
- Cook, M. (1980): "The Origins of Kelam." *Bulletin of the School of Oriental and African Studies* 43: 32-43. Cook, M. (1981): *Early Muslim dogma. A source-critical study*. Londër.
- El Kaisy Friemuth, M. (2007): "El Radd El xhemil: el Ghazali's or Pseudo-Ghazali's?" *The Bible in Arab Christianity*. Ed. D. Thomas. Leiden, f. 275-94.

- Van Ess, J. (1975): "The Beginnings of Islamic Theology." *The Cultural Context of Medieval Learning*. Bot. John E. Murdoch dhe Edith Dudley Sylla. Dordrecht/Boston: 87-111.
- Van Ess, J. (1977): *Anfänge muslimischer Theologie*. Beirut.
- Finkel, J. (bot.) (1926): *Thalath rasa 'il li-Ebi Uthman... al-Xhahiz*. Kaj-ro [që përmban *al-Radd 'ala l-nasara*] të el Xhahiz-it.
- Frank, R.M. (1994): *el Ghazali and the Ash'arite school*. Durham.
- Frank, R.M. (2007): *Early Islamic Theology: The Mu'tazilites and al-Ash'ari. Texts and Studies on the Development and History of Kelam*, Vëll. II. Bot. D. Gutas. Ashgate.
- Gimaret, D. (1985): "Un document majeur pour l'histoire du kalam: Le Mu-garrad Mekalat el Aš'ari d'Ibn Furak." *Arabica* 32: 185-218.
- Gimaret, D. (bot.) (1987): Ebu Bekër bin Furak (m. 406/1015): *Mugarrad mekalat el Aš 'ari (Expose de la doctrine d'al-Aš'ari)*. Beirut.
- Gimaret, D. (1990): *La doctrine d'al-Ash'ari*. Paris.
- Goodman, L.E. (1995): "Crosspollinations - philosophically fruitful exchanges between Jewish and Islamic thought." *Medieval Encounters* 1: 323-57.
- Goodman, L.E. (1999): *Jewish and Islamic Philosophy: Crosspollinations in the Classical Age*. Edinburgh.
- Graf, G. (1910): *Die arabischen Schriften des Theodor Abu Qurra*. Paderborn.
- Graf, G. (1947): *Geschichte der christlichen arabischen Literatur*. Zweiter Band: Die Schriftsteller bis zur Mitte des 15. Jahrhunderts. Vatikan.
- Graf, G. (1951): *Die Schriften des Jacobiten Ibn Hidma Aba Ra'ita*. Louvain.
- Griffith, S.H. (2002): *The Beginnings of Christian Theology in Arabic. Muslim-Christian Encounters in the Early Islamic Period*. Ashgate.
- Griffith, S.H. (2008): *The Church in the Shadow of the Mosque: Christians and Muslims in the World of Islam*. Princeton, NJ.
- Hamdan, O. & S. Schmidtke [në shtyp]: "Kadi 'Abd el Xhebbar al-Hamadhani (v. 415/1025) mbi Premtimin dhe Kërcënimin. Botimi i një fragmenti të librit të tij *Kitab al-Mughni fi avbab el tevhid val-'adl* që ruhet në Koleksionin Firkovitch, St. Petersburg (II Firk. Arab. 105, ff. 14-92)." *Mélanges de l'Institut dominicain d'Etudes orientales* 27.
- Hayek, M. (1977): *'Ammar El Basri, théologie et controverses*. Beirut.
- Hildebrandt, T. (2007): *Neo-Mu ' tazilismus? Intention and Kontext im moden arabischen Umgang mit dem rationalistischen Erbe des Islam*. Leiden.

- Hoyland, R.G. (1997): *Seeing Islam As Others Saw It. A Survey and Evaluation of Christian, Jewish and Zoroastrian Writings on Early Islam*. Nju Xhersi.
- Ibën El Melahimi, Rukn al-Din Muhammad bin Mahmud (1991): *Kitab al-Mu'tamad fi usul el din*. Pjesët ekzistuese janë botuar nga Martin McDermott dhe Wilferd Madelung. Londër.
- Ibën El Melahimi, Rukn al-Din Muhammad bin Mahmud (2007): *Kitab el Fa'ik fi usul el din*. Është botuar me një hyrje nga Wilferd Madelung dhe Martin McDermott. Teheran.
- Ibën El Melahimi, Rukn al-Din Muhammad bin Mahmud (2008): *Kitab Tuhfat el mutekellimin fi l-radd 'ala l-felasife*. Është botuar me një hyrje nga Hassan Ansari and Wilferd Madelung. Teheran.
- Ibën Mattavejh (1965; 1981; 1999): *Kitab el Mexhmu' fi l-muhit bi-l-teklif*. Vëll. 1, bot. J.J. Houben, Beirut. Vëll. 2, bot. J. J. Houben dhe D. Gimaret, Bejrut. Vëll. 3, bot. Jan Peters, Bejrut.
- Xhurvejni, Imam el Haremejn (1959?): *el Shamil fi usul el din*. Bot. H. Klopfer. Kajro.
- Xhurvejni, Imam el Haremejn (1969): *el Shamil fi usul el din*. Bot. 'A. S. El Nashshar, F. B. 'Avn dhe S.M. Mukhtar. Aleksandri.
- Xhurvejni, Imam el Haremejn (1981): *el Shamil fi usul el din*. Bot. R. M. Frank. Teheran 1360.
- Xhurvejni, Imam el Haremejn (1999): *el Shamil fi usul el din*. Bot. 'A.A.M.M. 'Umer. Bejrut.
- Keating, S. T. (2005): "Refuting the charge of tehrif: Abu Ra'ita (vdiq rreth 835) dhe vepra e tij "First risale on the Holy Trinity.""*Ideas, Images, and Methods of Portrayal: Insights into Classical Arabic Literature and Islam*. Bot. S. Günther. Leiden, f. 41-57.
- Lamoreaux, J. C. (2005): *Theodore Abu Qurrah*. Provo, Utah.
- Luciani, J. D. (bot./përkth.) (1938): *al-Irshad li-Imam al-Haramayn*. Paris.
- Madelung, W. (2006): "Abul Husejn El Basri's Proof for the Existence of God." *Arabic Theology, Arabic Philosophy. From the Many to the One: Essays in Celebration of Richard M. Frank*. Bot. J. E. Montgomery. Leuven, f. 273-80.
- Madelung, W. & S. Schmidtke (2006): *Rational Theology in Interfaith Communication. Abu l-Husejn ea-Basri's Mutezili Theology among the Karaites in the Fatimid Age*. Leiden.

- Madelung, W. & S. Schmidtke (ed.) (2006a): *Abu l-Husejn el Basi, Tesaffuh el adilla*. Janë futur dhe botuar pjesët ekzistuese. Wiesbaden.
- Madelung, W. & S. Schmidtke (2007): "Yusuf al-Basir's First Refutation (Nakd) of Ebu l-lHusejn El Basti's Theology." *A Common Rationality. Mu'tazilism in Islam and Judaism*, f. 230-96.
- McCarthy, R. J. (1953): *The Theology of al-Ash'ari*. Bejrut.
- McCarthy, R. J. (bot.) (1957): *Kitab el Temhid [nga] Ebu Bekër Muhammed bin El Tajjib el Bakillani*. Beirut. Manakdim, Ebul Husejn Ahmed bin Ebi Hashim (1965): *[Te'lik] Sharh el Usul el khamsa*. Bot. Abd el Kerim Uthman [i atribuohet Abd el Xhebbar-it në faqen e titullit], Kajro 1384.
- Mes'udi, 'Abd el 'Aziz Ka'id (2008): *Ishkalijet el fikr el Zejdi fi l-Jemen el mu'asir. Kira'a fi l-kira'at el sab'li-turath Mu'tezilet el Irak*. Kajro.
- di Matteo, I. (1921-22): "Confutazione contro i Cristiani dello zaydita al-Qasim bin Ibrahim." *Rivista degli Studi Orientali* 9: 301-64.
- Montgomery, J. (2007): "Islamic Crosspollinations." *Islamic Crosspollinations. Interactions in the Medieval Middle East*. Bot. A. Akasoy, P. Pormann, J. Montgomery. Oksford, f. 148-93.
- Munk, S. (1859): *Mélanges de philosophie juive et arabe*. Paris.
- Nemoy, L. (bot.) (1939-43): *Kitab el Envar vel Merakib. Code of Karaite Law by Ja'kub el Kirkisani*. Botuar nga dorëshkrimet në Bibliotekën Shtetërore të Leningradit dhe Muzeut Britanik të Londrës. Nju Jork.
- Nyberg, H. S. (bot.) (1925): *Le livre du triomphe et de la refutation d'ibn er-Rawendi l'heritique, par Abou l-Hosein Abderrahim bin Mohammed bin Osman el Khayyat*. Kajro.
- Perler, Dominique & Ulrich Rudolph (2000): *Occasionalismus. Theorien der Kausalität im arabischislamischen und im europäischen Denken*. Göttingen.
- Reynolds, G. S. (2004): *A Muslim Theologian in the Sectarian Milieu. 'Abd el Xhebbar and the Critique of Christian Origins*. Leiden.
- Ritter, H. (bot.) (1929-30): *Die dogmatischen Lehren der Anhänger des Islam von Abu l-Hasan Ali bin Isma'il el As'ari*. Istanbul.
- Rudolph, U. (1997): *Al-Maturidi und die sunnitische Theologie in Samarkand*. Leiden.
- Schmidtke, S. (2006): *An Anonymous Commentary on Kitab el Tadhkire by Ibën Mattawayh. Facsimile Edition of Mahdavi Codex 514 (Shekulli 6-të/12-të)*. Hyrja dhe indeksset nga S. Schmidtke. Teheran.

- Schmidtke, S. (2007): "Mutezili Manuscripts in the Abraham Firkovitch Collection, St. Petersburg. A Descriptive Catalogue." *A Common Rationality*. Mu 'tezilism in Islam and Judaism, f. 377-462.
- Schreiner, M. (1889): "Zur Geschichte des Ash' arithums." *Actes du 8ieme Congres International des Orientalistes*. Stockholm, f. 79-117.
- Schreiner, M. (1895): "Der Kelam in der jüdischen Literatur." *Bericht über die Lehranstalt für die Wissenschaft des Judenthums in Berlin* 13: 1-67.
- Schwarb, G. (2007): "Die Rezeption Mainonides' in der christlich-arabischen Literatur." *Judaica. Beiträge zum Verstehen des Judentums* 61: 1-46.
- Schwarb, G. [në shtyp]: "Découverte d'un nouveau fragment du Kitab al-mughni fi abwab al-tawhid wa-l- 'adl dukadi 'Abd el Xhebbar al-Hamadani dans une collection karaite de la British Library." *Mélanges de l'Institut d'Etudes Orientales* 27.
- Schwarb, G. [gati për qarkullim]: "The Reception of Fakhr el Din el Razi in the Christian Arabic Literature of the Thirteenth Century: Between Plagiarism and Polemics." *Jerusalem Studies in Arabic and Islam* 35.
- Shivtiel, A. & F. Niessen (2006): *Arabic and Judaeo-Arabic Manuscripts in the Cambridge Genizah Collections: Taylor-Schechter New Series*. Kembrixh.
- Sidarus, A. Y. (1975): *Ibën ar-Rahibs Leben und Werk. Ein koptisch-arabischer Enzyklopädist des 7./113. Jahrhunderts*. Freiburg.
- Sidarus, A. Y. (1993): "Essai sur l'âge d'or de la littérature copte arabe (xxie-xive siècles)." Aktet e Kongresit të Pestë Ndërkombëtar të Studimeve Koptike. Uashington, 12-15 gusht 1992. Vëllimi 2: Gazetat nga seksionet e Pjesës 2. Bot. David. W. Johnson. Rom: 443-462.
- Sinai, N. (2005): *Menschliche oder gottliche Weisheit? Zum Gegensatz von philosophischem und religiösem Lebensideal bei al-Ghazali und Yehuda ha-Levi*. Würzburg.
- Sklare, D. (1995): "Jusuf el Basir: Theological Aspects of his Halakhic Works." *The Jews of Medieval Islam. Community, Society, and Identity*. Bot. D. Frank. Leiden, f. 249-70.
- Sklare, D.E. (1996): *Samuel ben Hofni Gaon and his Cultural World. Texts and Studies*. Leiden.
- Sklare, D. (1999): "Responses to Islamic Polemics by Jewish Mutakallimun in the Tenth Century." *The Majlis. Interreligious Encounters in Medieval Islam*. Bot. H. Lazarus-Yafeh, M.R. Cohen, S. Somekh, S.H. Griffith. Wiesbaden, f. 137-61.

- Sklare, D. (2007): "Levi ben Yefet and his *Kitab al-Ni 'ma*." *A Common Rationality. Mu 'tezilism in Islam and Judaism*, f. 157-216.
- Spitta, W. (1876): *Zur Geschichte des Abu l-Hasan al-Ash 'ari*. Lajpcig.
- Steiner, H. (1865): *Die Mu 'taziliten oder die Freidenker im Islam. Ein Beitrag zur allgemeinen Culturgeschichte*. Lajpcig.
- Stroumsa, S. (1989): Njëzet kapitujt e *Dawud bin Marwan al-Muqammas-it* ('Ishrun Mekale). I botuar, i përkthyer dhe i komentuar. Leiden.
- Stroumsa, S. (2007): "Soul-Searching at the Dawn of Jewish Philosophy: A Hitherto Lost Fragment of al-Muqammas's *Twenty Chapters*." *Genzei Qedem. Genizah Research Annual* 3: 137\*-161\*.
- Stroumsa, S. (2008): "The Muslim Context in Medieval Jewish Philosophy." *The Cambridge History of Jewish Philosophy: From Antiquity through the Seventeenth Century*. Bot. S. Nadler, T. Rudaysky. Kembrixh, f. 39-59.
- Thomas, D. (2002): *Early Muslim Polemic against Christianity. Abu 'isa el Warraq's "Against the Incarnation"*. Kembrixh.
- Thomas, D. (2004): "A Mu 'tazili Response to Christianity: Ebu 'Ali el Jubba'i's Attack on the Trinity and Incarnation." *Studime mbi trashëgiminë arabe të krishterë për nder të At Prof. Dr. Samir Khalil Samir S. I. me rastin e gjashtëdhjetepesëvjetorit të tij*. Bot. R. Ebied, H. Teule. Leuven, f. 279-313.
- Thomas, D. (2007): "The Bible and the Kelam." *The Bible in Arab Christianity*. Bot. D. Thomas. Leiden, f. 175-91.
- Vajda, G. (1985): *El Kitab el Muhtavi de Jusuf el Basir*. Texte, traduction et commentaire par G. Vajda. Edité par D. R. Blumenthal. Leiden.
- Wadi, A. (1997): *Studio introduttivo su al-Mu 'taman bin El 'Assal e la sua Summa dei Principi della Religione*. Jerusalem/Kajro.
- Wedel, G. (1987): *Kitab el Tabbah des Samaritaners Ebul Hasan as-Suri. Kritische Edition undkommentierte Übersetzung des ersten Teils*. Tezë PhD Berlin.
- Wedel, G. (2007): "Mu 'tazilitische Tendenzen im Kitab at-Tabbah des Samaritaners Abu l-Hasan as-Suri." *A Common Rationality. Mu 'tazilism in Islam and Judaism*, f. 349-75.
- Wolfson, H. A. (1979): *Repercussions of the Kalam in Jewish Philosophy*. Kembrixh, Mass.
- Zimmermann, F. W. (1985): "Kalam and the Greeks." *Third International Colloquium on: From Jahiliyya to Islam*. Jerusalem.

Sabine SCHMIDTKE

## THEOLOGICAL RATIONALISM IN THE MEDIEVAL WORLD OF ISLAM

### Abstract

Rationalism has been a salient feature of Muslim theological thought from the earliest times.

The Mu`tazila was the earliest "school" of rationalist Islamic theology, known as *kalam*, and one of the most important and influential currents of Islamic thought. Mu`tazilites stressed the primacy of reason and free will (as opposed to predestination) and developed an epistemology, ontology and psychology.

Second in importance in the use of rationalism was the theological movement of the so-called Ash`ariyya. Ash`arism remained one of the most salient strands of thought until the end of the 16th century. Within the Sunni realm at least, Ash`arism proved more successful and enjoyed a longer life than Mu`tazilism, yet, like Mu`tazilism, Ash`arism was constantly challenged by traditionalist opponents rejecting any kind of rationalism.

**Keywords:** *Rational Muslim theological thought , Mu`tazilism, Ash`arism, kalam, intellectual symbiosis*

Mentor MERXHA

## **NJË JETË NË SHËRBIM TË FESË DHE XHEMATIT HAFËZ SALIH EF. GOGA (1915-2000)**

### **Abstrakt**

Në këtë punim autori ka për synimin ndriçimin e jetës dhe veprës të imamatit, mualimit, hafëzit dhe hoxhës, *Hafëz Salih ef. Gogës* (1915-2000), i cili ka dhënë një kontribut të shquar në shekullin e kaluar në jetën fetare dhe shoqërore në Pejë dhe rrethinë. Jetëshkrimi i Hfz. Salih ef. Gogës nuk është trajtuar më herët në shtypin tonë, sikundër që nuk janë trajtuar as parardhësit e tij të cilët po ashtu kanë qenë hoxhallarë të shquar. Ky punim synon të shërbejë si një nismë e mbarë dhe si një skicë për një punim më të plotë të ndiqirmit të biografisë së këtyre ulemave.

**Fjalët çelës:** *feja islame, shqiptarët, Peja, hafëz, mualim, imam*

### **Hyrje**

Ndriçimi dhe njohja e jetës dhe e veprimtarisë së personaliteteve që kanë lënë gjurmë në vendin ku kanë jetuar e vepruar, përveçse obligim, është edhe privilegj për të gjithë ata që zbardhin dhe regjistrojnë kontributin e tyre. Në këto radhë hyjnë edhe figurat tona fetare, që me kontributet dhe veprimtarinë e tyre ishin shembull për të gjithë ata që i njohën dhe për ata që erdhën pas tyre. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin se populli dhe vendi ynë kaloi nëpër kohë të vështira dhe u përball me shumë sfida, por që prijësit tanë politikë e fetarë u rreshtuan dhe qëndruan drejt kau-

zave të drejta e në interes të vendit, atëherë ndriçimi i jetës dhe i veprës së këtyre personaliteteve vërtet bëhet i domosdoshëm, dhe hy ndër obligimet dhe detyrat tona fetare e kombëtare.

Për këtë arsye, në fund të studimeve të mia në Fakultetin e Studimeve Islame, para drejtuesve të këtij institucioni, paraqita kërkesën që për punimin tim të diplomës në nivelin Bachelor të merrja ndriçimin e jetës dhe të veprimtarisë së njërit prej hoxhallarëve të vendit tonë, të imamit, muallimit, hafëzit dhe personalitetit të shquar, *Hafëz Salih ef. Gogës* (1915-2000) nga Peja. Duke pasur parasysh qëllimet dhe interesimet e Fakultetit të Studimeve Islame për përkrahjen e projekteve me karakter fetar islam dhe në zbardhjen e ngjarjeve dhe personaliteteve tona historike, kërkesa ime u miratua dhe ajo kulmoi me mbrojtjen e kësaj teme të diplomës, për çka i jam shumë mirënjohës menaxhmentit të FSI-së dhe të gjithë atyre që më përkrahën në këtë drejtim.

Dhe, sidomos i jam shumë mirënjohës profesorit dhe mentorit tim, prof. asoc. Dr. Sadik Mehmetit, i cili më mbështeti pa rezervë, më dha kurajë në çdo moment, ishte i hapur dhe bashkëpunues në çdo kohë dhe tregoi shumë durim përballë vështirësive dhe lëshimeve që hasa gjatë këtij punimi. Profesori dhe mentori im, si një pedagog i vërtetë dhe i palodhshëm, më ndihmoi ta përmbyll këtë fazë të studimeve të mia në FSI. Pa ndihmën e tij ky punim nuk do të ishte përfunduar kështu, sikundër që ishte edhe ideja e tij që një version të shkurtuar të këtij punimi ta dërgoja për botim në redaksinë e revistës sonë “Edukata Islame”.

## 1. Jetëshkrimi i Hafëz Salih ef. Gogës

### 1.1. Familja

Hafëz Salih ef. Goga lindi më 1915 në qytetin e Pejës, në Rrafshin e Dukagjinit, në pjesën veri-perëndimore të Republikës së Kosovës.

Familja e Salih efendiut, pra familja Goga, u vendos në Pejë në vitin 1800 dhe ka prejardhje nga rrethi i Shkodrës. Si familje e madhe që ishin, ata u ndanë dhe u vendosën në disa vende. Një pjesë e saj mbeti në Shkodër, një pjesë tjetër në Tiranë, ndërsa gjysma tjetër u shpërnda, me një pjesë në Ulqin të Malit të Zi dhe pjesën më të madhe në Vilajetin e Ko-

sovës, respektivisht në Dukagjin, në Pejë. Familja Goga i takon degës së familjes Bytyqi, e cila është pjesë e fisit Thaçi.

Familja Goga kryesisht kanë jetuar nga bujqësia dhe tregtia, ndërsa rrugëtimi i tyre me misionin e fesë-hoxhallëkut nis prej mulla Emin ef. Gogës<sup>1</sup>, i lindur më 1853, te të cilët si familje ndikuan dajat këta patën fatin që dajat e tyre të ishin më herët pjesë e këtij misioni, prandaj u edukuan në frymën islame prej tyre, siç ishin daja Mulla Ali Efendiu, i cili edhe kishte shërbyer kohë të gjatë në fshatin Shushicë të Istogut.

Familja Goga traditën e tyre fetare dhe misionin e hoxhallëkut më pastaj e kanë vazhduar pa ndërprerje, deri në kohën e sotme.

## 2. Arsimimi

### 2.1. Nxënës në mejtepin e të atit, Mulla Rexhep ef. Gogës

Hafëz Salih Goga mësimet e para i mori në mejtep, prej të ati, Mulla Rexhep ef. Gogës, në fshatin Carrabreg, ku Mulla Rexhepi asokohe ishte imam fshati.<sup>2</sup>

Hafëz Salih Efendiu, krahas mësimëve themelore në mejtep, mësoi edhe leximin dhe hatmen e Kuranit nga mulla Rexhep Goga, i cili njihej si një prej lexuesve më eminentë (*kurra*) të Kuranit. Mbështetur në kujtimet e pasardhësve të Hafëz Salihut, të cilat janë përcjellë brez pas brezi, tregohet se mulla Rexhepi, përpos që ishte *kurra* i Kuranit, ishte mjaft rigoroz në drejtshqiptimin e tij dhe në artikullimin e shkronjave sipas rregullave të *texhvidit*. Sipas dëshmimeve të hafëz Salihut, mulla Rexhepi kishte caktuar një orë të veçantë për mësimin e Kuranit çdo natë pas jacisë për katër djemtë e tij, të cilët të gjithë do të bëheshin hoxhallarë të ardhshëm.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Mulla Emin ef. Goga, i biri i Adem Gogës, i lindur më 1853, ka shërbyer një kohë të gjatë si imam në xhaminë e fshatit Vrellë. Dr. Haki Kosumi, *Bashkësitë Fetare Kosovë*, Instituti i Historisë-Prishtinë, 1988 f. 21.

<sup>2</sup> Harun Shabanaj, *Shekuj Drite në Deçan*, f. 155.

<sup>3</sup> Të dhënat për mësimin në mejtep të hafëz Salihut u morën prej deklaratës së nipit të tij, Enes Gogës nga Peja, dhënë studentit më 7.11.23.

## 2.2. Mësimi për hafëz

Pas mësimeve në mejtep dhe pasi kishte mësuar leximin e Kuranit te i ati, Hafëz Salihu e filloi mësimin e hifzit të Kuranit te hafëzi i njohur i Pejës, Hafëz Zekerija Radoniqi, i njohur si Hafëz Zeqa, i cili në atë kohë ishte imam dhe hatib në xhaminë e njohur si “Hamam Xhamia”. Megjithatë, te ky *muhafëz* ai arriti të përfundonte vetëm gjysmën e parë të Kuranit, ndërsa gjysmën tjetër të hifzit e përfundoi te një tjetër hafëz i njohur i qytetit, Hafëz Sulejman Berisha, i njohur si Hafëz Sylja.

Hafëz Salihu e kishte fituar hifzin e Kuranit edhe me dy shokë të tij, *Hafëz Qamil Avdylin* dhe hafëz *Ramadan Tafajn*<sup>4</sup>, që të tre e përfunduan pothuajse në të njëjtën kohë.

Metodologjia e mëimit të hifzit ishte metodologjia e praktikuar qysh nga medresetë osmane.

Hafëz Salihu hifzin e ka përmbyllur për rreth 18 muaj. Pas përfundimit të hifzit, si të gjithë hafëzët, e ka dëshmuar veten e tyre duke lexuar mukabele<sup>5</sup> gjatë muajit të bekuar Ramazan.



*Hafëz Salih ef. Goga*

<sup>4</sup> Hafëz Ramadan Tafaj ka lindur në vitin 1911, në fshatin Gjurgjevik i Madh, në Klinë. Shkollimin e kreu në Medresenë “Atik” të Pejës, ndërsa hifzin e përfundoi te hafëz Zekerja Radoniqi. Ka shërbyer si imam në fshatin Lybeniq, në Komunën e Pejës. Vdiq në vitin 2005 në Pejë. (Këto të dhëna u morën nga Arkivi i KBI-së në Pejë).

Leximi i mukabeles ishte një traditë e hershme në qytetin e Pejës dhe në xhamitë e saj, ashtu siç ishte e pranishme në xhamitë e mbarë vendit tonë. Hafëz Salihu dhe hafëzët e tjerë tregonin se orari i mukabeles në Pejë ishte si vijon: lexohej një xhuz i Kuranit para namazit të sabahut, një tjetër para namazit të drekës dhe të ikindisë, si dhe një xhuz para namazit të teravisë.<sup>6</sup>

Kur jemi te hifzi, duhet theksuar se qyteti i Pejës kishte një numër të konsideruar të hafëzëve. Pothuajse të gjithë imamët e xhamive ishin hafëzë, siç ishte krijuar një standard se imami detyrimisht duhet të jetë edhe hafëz. Pas vitit 1900 në qytetin e Pejës ishin tre hafëzë, të cilët kanë nxjerrë hafëzë të rinj: hafëz Shaqir Baxhaku, hafëz Zekerja Radoniqi<sup>7</sup> dhe hafëz Sulejman Berisha.

### 2.3. Student në medresenë “Atik” të Pejës

Tashmë u theksua se Hafëz Salih efendiu, pasi mori mësimet bazike dhe elementare prej të atit të tij, Mulla Rexhep efendiut, vendosi të regjistrohej në Medresenë “Atik” në Pejë.

Kështu, që në moshën 13-vjeçare, ai filloi mësimet në këtë medrese, e cila në atë kohë kishte edhe një “Musalaja” – Vendfalje, ku Hafëz Salihu u autorizua nga Myderrizi që të thërriste ezanin për çdo namaz, për shkak se Allahu Fuqplotë e kishte pajisur me një zë të bukur e kumbues. Pas njëfarë kohe, qytetarët esnafë dhe xhematlinjtë e “Hamam Xhamisë”, e cila ndodhej rreth 200 metra larg Medresesë “Atik”, kur dëgjonin çdo ditë ezanin e thirrur nga ky myezin i ri, i kërkuan me mirësi myderrizit që hafëzi të bëhej myezin me pagesë në Hamam Xhami.

<sup>5</sup> Mukabele nënkupton kur hafëzi i Kuranit e lexon Kuranin nga mendja dhe zemra e tij, ndërsa para tij janë të tjerët që me mus'hafë – Kuran të hapur e përcillnin leximin e Kuranit.

<sup>6</sup> Të dhënat për mësimin e hifzit të hafëz Salihut dhe leximin e mukabeles u morën nga deklarata e Enes Gogës nga Peja, dhënë studentit – mentorit më 8.11.2023.

<sup>7</sup> Hafëz Zekerja Radoniqi lindi më 1877–1964. Mësimet e para i mori te babai i tij, ku e përfundoi hifzin, e pastaj e kreu Medresenë “Atik” në Pejë. Harun Shabanaj – Shekuj Drite, Deçan – f. 158, Deçan, 2021.

Tani për hafëzin filloi filloi një epokë e re, ku, krahas mësimave në medrese, vazhdonte edhe detyrën e myezinit në “Hamam Xhami”. Kjo ishte shumë e dobishme për të, pasi aty imam ishte Hafëz Zekerija Radoniqi, tek i cili më vonë Hafëzi filloi mësimin e hifzit.

Në atë kohë, “Hamam Xhamia” dhe territori i saj ishin ndër lagjet më autoritare të qytetit. Fatkeqësisht, pas vitit 1953, shumë familje të respektuara nga kjo lagje u shpërngulën në Turqi.

Detyra e myezinit në këtë xhami e bëri Hafëzin të njohur dhe me famë, ndërkohë që njëherazi përfitonte edhe materialisht si një djalë i ri e i vetëm, pasi familja e tij, që nga viti 1907, ishte vendosur në Carrabreg të Deçanit, ku kryente detyrën e imamet në atë zonë.

### 2.3. Student në Medresenë e Madhe “Atik” të Gjakovës

Hafëz Salihu frymëzohet nga kolegët dhe studentët e Medresesë “Atik” në Pejë, të cilët ishin zhvendosur për studime në Medresenë e Madhe “Atik” të Gjakovës, te myderrizi dhe alimi i njohur Hafëz Fahri ef. Iljazi.<sup>8</sup>

Kur Hafëz Salihu filloi mësimet në Medresenë e Gjakovës, ai tashmë ishte i martuar dhe u zhvendos atje me familjen e tij. Menjëherë pas vendosjes në Gjakovë, tregtarët e njohur të Çarshisë së Madhe iu drejtuan myderrizit Fahri efendiut me kërkesën që Hafëz Salihu të emërohej myezin në Xhaminë e Hadum Agës. Ky emërim ishte një nder dhe përgjegjësi e madhe për të, duke e vendosur atë në një pozitë të rëndësishme në jetën fetare të qytetit. Përveç përfitimit të dijeve nga myderrizi Fahri efendiut, Hafëz Salihu pati mundësinë të mësonte dhe bashkëpunonte edhe me hoxhallarë të njohur të kohës, të cilët ishin të pajisur me ixhazet dhe të përgatitur në shkencat islame.

Hafëz Salihu u kthye nga Medreseja e Gjakovës në Pejë në vitin 1943, së bashku me myderrizin e njohur, Hafëz Muhamed ef. Gashin.<sup>9</sup>

<sup>8</sup> Myderrizi hafëz Fahri Iljazi ka lindur në vitin 1903, ndërsa ka vdekur në vitin 1985, në Gjakovë.

<sup>9</sup> Hafëz Muhamed ef. Gashi lindi në qytetin e Pejës, në vitin 1913 e vdiq më 1999.

Hafëz Salihu kishte përfituar dituri edhe nga shoqërimi me Hasan ef. Dashin<sup>10</sup> dhe Jahja ef. Bakallin.<sup>11</sup>

#### 2.4. Mësuesit - myderrizët e Hafëz Salihut

Mësimet e para i mori te mësuesi i tij i parë, që ishte prindi i tij, Mulla Rexhep ef. Goga 1859-1936. Po ashtu, Sali efendiu mori mësimet edhe te myderrizët e nderuar:

- Myderriz Daut efendi Haxhixhi Islami, i cili ishte prej myderrizëve të medresesë Atik në Pejë.
- Myderriz Hysen Hysni efendiu.
- Hafëz Zekerija efendi Radoniqi, 1877–1964.
- Hafëz Sulejman efendi Berisha, 1908–1976.
- Myderriz Hasan efendi Dashi, 1892–1963.
- Myderriz Jahja efendi Bakalli, 1895–1981.

#### Mulla Rexhep ef. Goga (1859-1936)

Mulla Rexhep Efendi Goga<sup>12</sup> lindi në qytetin e Pejës, në vitin 1859. Mësimet e para i mori te daja i tij, *mulla Aliu*<sup>13</sup>, i cili vinte prej fshatit Carrabreg të Komunës së Deçanit, e i cili kishte shërbyer për një kohë të gjatë si imam në fshatin Shushicë të komunës së Istogut. Shkollimin e përfundoi në Medresenë “Atik” të Pejës, ku mori edhe ixhazetin dhe titullin kurra – ekspert i leximit të Kuranit në shtatë mekame. Në sajë të përgatitjes së tij profesionale dhe aftësive të tij, mulla Rexhep Goga, nga

<sup>10</sup> Myderriz Hasan ef. Dashi lindi në vitin 1895, dhe vdiq më 1963.  
[www.islamgjakova.net](http://www.islamgjakova.net).

<sup>11</sup> Myderriz Jahja ef. Bakalli lindi në vitin 1895 dhe vdiq më 1981.  
[www.islamgjakova.net](http://www.islamgjakova.net).

<sup>12</sup> Dr. Haki Kosumi, Bashkësitë fetare në Kosovë, Instituti i Historisë – Prishtinë, 1988, f. 121.

<sup>13</sup> Mulla Aliu, i biri i mulla Mahmutit dhe vëllai i mulla Mehmetit, të gjithë këta hoxhallarë kanë shërbyer në rajonin e komunës së Istogut. Mulla Aliu kishte shërbyer në fshatin Shushicë, komuna e Istogut.

mexhlisi i ulemave të Pejës u emërua mualim në qytetin e Pejës, në objektin e Kullës së Pashës.

Më pas, Hafëz Salihu u emërua imam në Xhaminë e Carrabregut të Deçanit, ku e filloi detyrën në vitin 1907. Në vitin 1935, ai kërkoi një leje speciale në Shkup për të nisur mësim-besimin dhe shkollën shqipe në fshatin Llukë e Epërme, komuna e Deçanit. Vlen të theksojmë se mulla Rexhepi, së bashku me mulla Jusuf Latën<sup>14</sup> kishin arritur të siguronin leje të veçantë për vijimin e mësim-besimit në gjuhën shqipe. Në atë kohë një leje e tillë merrej në Shkup.

Mulla Rexhep Goga shërbeu në Xhaminë e Carrabregut deri në vdekje, në vitin 1936, ku dhe u varros, po në varrezat e xhamisë ku shërbeu<sup>15</sup>.

### **Hafëz Zekerja ef. Radoniqi (1877-1964)**

Hafëz Zekerjaja<sup>16</sup> i njohur si hafëz Zeqa, lindi në qytetin e Pejës në vitin 1877, dhe vdiq më 1964.

Mësimet para i mori në familjen e tij, pasi ishin një familje me tradita fetare dhe hoxhallarësh, dhe në moshë të hershme të rinisë e mësoi Kur'anin përmendsh, duke fituar titullin hafëz.

Hafëz Zeqa përfundoi Medresenë "Atik" në Pejë. Pas marrjes së ixhazetit, u emërua imam në Xhaminë e Çarshisë në Pejë, respektivisht në Xhaminë e Bajraklisë, ku shërbeu për dekada me radhë. Më pas, u transferua në Hamam Xhami, ku shërbeu si imam për shumë vjet. Rreth moshës së pensionimit, ai u emërua imam në Xhaminë e fshatit Isniq në Komunën e Deçanit. Puna e tij si imam dhe karriera e bujshme u përmbyll në Isniq, ku dha shembull të lartë si edukator dhe prijës fetar.

Hafëz Zeqa e përmbylli jetën e tij në qytetin e Pejës në vitin 1964, ku u varros në varrezat e qytetit, të njohura si Varrezat e Kakariçit. Pas vetes la

<sup>14</sup> Jusuf Lataj lindi në vitin 1875 në fshatin Carrabreg të komunës së Deçanit, ndërsa vdiq në vitin 1953.

<sup>15</sup> Shekuj drite në Deçan, autor Harun Shabanaj, Deçan 2021, f. 155.

<sup>16</sup> Të dhënat për hafëz Zeqën u morën nga deklarata e nipit të tij, avokatit të njohur Mustafë Radoniqi nga Peja, nëntor 2023.

një trashëgimi të pasur, dhe sot pasardhësit e tij vazhdojnë të jetojnë në qytetin e Pejës, duke bartur me krenari trashëgiminë dhe kontributin e tij.<sup>17</sup>

### **Myderriz Haxhi Daut ef. Fuadi, i biri i Haxhi Islamit nga Peja (1875-1957)**

*Haxhi Daut Haxhiislami, një figurë e shquar e shekullit të kaluar, lindi në vitin 1875 në një familje të pasionuar për atdhe dhe fe. Me rrënjë të thella në kulturën e tij, ai u bë myderriz dhe e pasqyroj dijen e fesë islame me pasion dhe përkushtim. Ai shërbeu si imam në fshatin Lybeniq, ndërsa Xhamia e Shuster Mëhallës u bë qendra e tij shpirtërore, ku shërbeu me devotshmëri. Një detaj thelbësor në jetën e tij ishte udhëtimi në Haxhillëk, një udhëtim me deve nga Kosova për të përjetuar një nga momentet më të rëndësishme të jetës së tij fetare. Ky fakt e bën atë të dalluar nga shumë personalitete të kohës. Me vdekjen e tij në vitin 1957, Haxhi Daut Haxhiislami la pas një trashëgimi të pasur fetare dhe kulturore, duke shpërndarë njohuri dhe frymëzim për brezat që vijuan. Historia e tij rrëfen një jetë të përkushtuar për arsimin, fenë dhe përhapjen e vlerave tradicionale në një periudhë të ndjeshme të historisë.*<sup>18</sup>

### **Myderriz Hafëz Fahri efendi Iljazi (1903-1987)**

Myderrizi, hafëz Fahri ef. Iljazi ishte prej hoxhallarëve më të shquar të kohës. Ai vinte nga një familje e njohur gjakovare, nga e cila kanë dalë shumë dijetarë, myftilerë, myderrizë, hafëzë, hoxhallarë, atdhetarë.

Fahri Efendiu lindi në vitin 1903, në Gjakovë, si djali i myderrizit, hafëz Iljaz Efendiut, i cili ishte djali i myderrizit, hafëz Muhamed Efendiut. Ky i fundit ishte njëri ndër pesë djemtë e Yvejs Efendiut, të gjithë hoxhallarë të njohur dhe të nderuar: Muhamed efendiu, Ismail efendiu, Muhamed efendiu, Jahja efendiu dhe Hysein efendiu.

<sup>17</sup> Shekuj Drite në Deçan – Harun Shabanaj, Deçan 2021, f. 158.

<sup>18</sup> Të dhënat janë marrë nga Naim Haxhiislami, i biri i Hakiut, nipi i hafëz Eshref Haxhiislamit, i cili ishte djali i axhës së haxhi Daut Haxhiislamit, më 12.12.23.

Yvejs Efendiu, babai i këtyre pesë hoxhallarëve, ka qenë myderrizi i parë në Medresenë e Madhe të Gjakovës, e cila ishte vatra kryesore edukative, arsimore dhe kulturore, jo vetëm për Gjakovën, por për gjithë Kosovën.

Fahri Efendiu filloi mësimet fillestare në Gjakovë, ku, krahas mësimëve, nën udhëheqjen e babait të tij, hafëz Iljaz Efendiut, mësoi përmendsh Kuranin Fisnik në moshën 11-vjeçare dhe fitoi titullin e nderuar: hafëz.

Ai vazhdoi studimet në Medresenë e Madhe në Gjakovë, pranë babait, deri në vitin 1920, kur ndërroi jetë babai i tij i nderuar. Më pas, Fahri Efendiu vijoi studimet në Medresenën “Mehmed Pasha” në Prizren, pranë Myderrizit të shquar Nusret Efendi Galibit, i cili ishte Myfti i Prizrenit, kryeqytetit shpirtëror dhe historik të shqiptarëve.

Gjatë studimeve në Prizren, Fahri Efendiu ishte një nga studentët më të zgjuar, aq sa në mungesë të myderrizëve, ai i zëvendësonte ata. Pas përfundimit të studimeve me sukses të jashtëzakonshëm, ai mori diplomën dhe titullin e nderuar: myderriz. Ky titull, Fahri Efendi e mbrojti me provim para komisionit të përbërë nga tre myderrizë: myderriz Rexheb Efendi nga Mitrovica, myderriz Ataullah Efendi nga Shkupi dhe myderriz Nusret Efendi Galibi nga Prizreni.

Nga janari i vitit 1930 deri në vitin 1948, kur Medreseja u mbyll nga regjimi komunist, Hafëz Fahri Efendi ka qenë myderriz dhe udhëheqës kryesor në Medresenë e Madhe të Gjakovës. Gjatë 18 viteve të shërbimit të tij, në këtë medrese janë diplomuar 93 studentë nga të gjitha trevat shqiptare, dhe mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

#### **2.4. Shërbimi – imam, vaiz e mualim në xhami të ndryshme**

Hafëz Salih efendiu karrierën e tij në shërbim të fesë, siç e thamë, e filloi si student i ri në Medresenë “Atik” në Pejë, duke shërbyer si myezin në “Hamam Xhami”. Më pas, kur u transferua në Medresenë e Madhe të Gjakovës. Po ashtu në Xhamin e Hadum Agës ka shërbyer si myezin.

Ka shërbyer në fshatin Llukafç të Komunës së Istogut si mualim dhe imam për nëntë vjet, pastaj e ka vazhduar karrierën në Çarshi Xhami në Pejë si myezin dhe imam për tre vjet.

Më pas, në fillim të viteve të 50-Tahafëz Salihu emërohet imam, hatib, vaiz dhe mualim në Xhamin e Sahat Kullës Puhovc në Pejë. Në atë kohë, si shumë xhami të tjera, edhe Xhamia e Puhovcit pas Luftës së Dytë Botërore ishte mbyllur dhe hafëzi, me pëlqimin dhe ndihmën e KBI-së në Pejë e rihapin xhaminë në Pejë. Xhamia e Puhovcit ishte në kushte të mjerueshme, por falë autoritetit dhe organizimit të Hafëzit në fjalë, me ndihmën e Allahut e pastaj të xhematit xhamia, u rihap me kushte minimale për të filluar aktivitetin e saj dhe më kalimin e kohës mori ecurinë normale të çdo xhamie aktive funksionale.

Hafëzi ishte shumë i zellshëm në aktivizimin e mejtepit, ku Xhamia e Sahat Kullës për një kohë të shkurtër arriti të bëhej adresë e fëmijëve të Puhovcit, të lagjes së Gjimnazit, Asllan Qeshmes, dhe pehlivan Mejdani.



*Hafëz Salih efendiu në mesin e nxënësve të mejtepit të tij*



*Foto nga Mejtepi i Xhamisë Sahatkulla, me nxënësit nga lagjet Asllan Qeshme, Pehlivan Mejdani dhe Lagjes së Puhovcit*



Në qytetin e Pejës ishin dy hoxhallarë, respektivisht imamë shumë të dalluar në sferën e mësim-besimit – mejtepit: myderriz Haxhi Muhamed ef. Gashi<sup>19</sup> në Xhamin e Kuqe – Kapeshnicë, e cila xhami ishte përplot me fëmijë, si dhe hafëz Salihu në Xhamin e Puhovcit. Dua të konfirmoj se kudo kishte hoxhallarë të nderuar që vepronin në fushën e mësim-besimit, megjithatë këto dy xhami ishin veçanërisht të padëshiruara nga pushteti komunist, pasi hoxhallarët e tyre shpesh përballeshin me presion dhe probleme nga autoritetet.

Hafëz Salihu, edhe gjatë shërbimit të tij si imam në fshatin Llukafc të Komunës së Istogut, ishte aktiv në fushën e mësim-besimit – mejtepit. Dua të nënvizoj një veprim të shkëlqyer të hafëzit tonë, i cili në Ramazanin e vitit të parë, kur filloi shërbimin si imam në fshatin Llukafc, ishte njohur me banorët e atij lokacioni. Kur mësoi se në atë vendbanim kishte edhe këngëtarë, hafëzi, me mirëkuptim, u ofroi mundësinë t’ua mësonte për rregullat elementare të fesë dhe t’i përgatiste si myezinë për muajin Ramazan. Kështu, tre nga këngëtarët e njohur në atë vend u shndërruan në myezinë të asaj rrethine.

Hafëz Salihu ishte i afërt me xhematin, sikurse ishte mjaft komunikativ dhe gjithmonë i disponuar për të qenë në shërbim të xhematit. Si të gjithë hoxhallarët e nderuar, ai ishte në shërbim të xhematit në raste gëzimi, për shembull, në ceremoni synetie, fejesa, martesë etj. Po ashtu, ishte në shërbim të xhematit edhe në shërbime mortore, në të pame, si dhe ishte i palodhshëm edhe në sferën e pajtimit, kur kishte ngatërresa dhe mosmarrëveshje në shoqërinë tonë.

Hafëz Salihu ishte i rregullt dhe i disiplinuar në raport me xhaminë dhe shërbimin ndaj xhamisë. Gjatë muajit Ramazan, ai ishte i njohur për leximin e bukur të Kuranit, veçanërisht për leximin e mukabeles dhe faljen e namazit të teravisë.

<sup>19</sup> Myderriz Muhamed ef. Gashi lindi në qytetin e Pejës, më 1913, dhe vdiq më 1999. Ishte i njohur me urtësinë dhe njohuritë e thella që kishte haxhi Muhamed ef. Gashi. Revista “Dituria Islame”, Prishtinë, 183-184, f. 77-78.



*Xhamia e Sahat Kullës dhe e mësim-besimit në mejtepin e hafëz Salihut*

Kur jemi te namazi i teravive, hafëz Salihu e kishte zakon që namazin e teravive ta falte me suren “Err Rrahman”. I gjithë xhemati i Pejës, gjatë tërë atyre dekadave, sa ishte imam hafëz në Xhaminë e Puhovcit, ishte familjarizuar me suren “Err Rrahman”.

Hafëz Salihu, përveç se ishte orator dhe i guximshëm, Allahu i kishte dhuruar edhe dhuntinë e zërit të bukur e të fuqishëm. Në atë kohë, ezani thirrej lart në minare pa zërim, derisa erdhi edhe koha moderne e zërimit. Qytetarët dhe banorët e Pejës ngazëlleshin me zërin e bukur të ezanit dhe mekameve të hafëz Salihut.



*Xhamia Puhovcit – Sahat Kullës, aty ku ka shërbyer hafëz Salih ef. Goga*

Hafëz Salihu në namazin e sabahut e thërriste ezanin me mekamin<sup>20</sup> sabah hixhazi, dhe kështu vazhdonte mekamet e njohura.

## 2.5. Shërbimi në institucione administrative të BIK–ut

Hafëz Salihu në vitet e '70-ta, atëbotë kur ishte kryetar Hafëz Beqir ef. Sahara<sup>21</sup>, u autorizua që krahas detyrës së tij si imam në Xhaminë e Sahat Kullës – Puhovcit, ta ushtrojë edhe detyrën e arkëtarit pranë KBI-së në Pejë. Detyrën e arkëtarit e kreu për gjashtë muaj radhazi dhe, kur u krijuan rrethana të reja në qytetin e Pejës, me mirëkuptim e dashamirësi kërkoi nga Myftiu Sahara që ta lironte nga kjo detyrë. Hafëz Salihu nuk kishte dëshirë që, krahas detyrave dhe obligimeve të imamet, të mbanim edhe përgjegjësi të tjera.

<sup>20</sup> Kur jemi te mekamet, mekamet më të njohura janë: sabah, kurdi, sika, hixhazhi, neha-vent, rast dhe bejat. [ar.m.wikipedia.org](http://ar.m.wikipedia.org)

<sup>21</sup> Hafëz Beqir ef. Sahara lindi në Pejë në vitin 1913, kurse vdiq më 1991.



*Foto e realizuar pranë objektit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Pejës,  
viti 1968*

*(Salih efendiu, i pari në rreshtin ulur nga e majta)*

## **2.5. Kontributi në aktivitete kombëtare i Hafëz Salih efendiut**

Sikur të gjithë hoxhallarët e nderuar në vendin tonë, të cilët ishin faktorë të rëndësishëm në arsimimin e popullit dhe zhvillimin e vendit, edhe Hafëz Salihu dha një kontribut të vyer në ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe kundërshtimin e represionit serbo-sllav, si para, ashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe regjimit komunist.

Duke pasur parasysh se Hafëz Salihu lindi pas Luftës së Parë Botërore dhe jetoi gjatë periudhës së pushtetit komunist dhe serb, ai gjithashtu kontribuoi në kauzën e popullit shqiptar.

Një prej kontributeve të tij më të rëndësishme ishte angazhimi në shuarjen e hasmërive dhe ndalimin e gjakmarrjes, fenomen që kishte marrë hov gjatë viteve '70 deri '90, dhe që i shkonte për shtati pushtetit jugo-sllavo-serb.

Hoxhallarët, dhe midis tyre Hafëz Salihu, angazhuan fuqishëm për të shuar çdo lloj hasmërie dhe për të parandaluar vëllavrasjen dhe gjakmarrjen, duke i thirrur qytetarët për falje, pajtim dhe unitet.<sup>22</sup>

## 2.6. Kalimi në botën tjetër

Hafëz Salihu ka jetuar 85 vjet. Në maj të vitit 2000, Hafëz Salihu ka-  
loi në Ahiret. Gjatë gjithë jetës së tij, ai ka jetuar në mirëqenie dhe me  
shëndet të mirë. Megjithatë, një periudhë e veçantë në jetën e tij është ajo  
e luftës së fundit të Kosovës, përkatësisht vitet 1998-1999. \

Pasi nisën bombardimet e NATO-s mbi caqet serbe, Hafëz Salihu, me  
këmbëngulje dhe vendosmëri, e refuzoi të lëshonte shtëpinë e tij në lagj-  
en Karagaq të Pejës. Si rezultat i këtij vendimi të guximshëm, ai qëndroi  
në shtëpinë e tij të ngjuar për 78 ditë, me tetë anëtarë të familjes së tij,  
gjatë gjithë periudhës së bombardimeve nga NATO.

Hafëzi qëndroi me bashkëshorten, dy djemtë, nusët e tyre dhe dy ni-  
pat. Gjatë kësaj periudhe të vështirë, anëtarët e familjes Goga u përballën  
me shumë paqartësi dhe ndiheshin të frikësuar. Dy herë, ushtria serbe  
kishte hyrë në shtëpinë e hoxhës për ta kontrolluar dhe frikësuar.<sup>23</sup>

Një gjë shumë e rëndë e kishte mundur hafëzin. Fjala është për mun-  
gesën e ezanit muhamedan për 78 ditë në minaret e qytetit të Pejës. Hafë-  
zi, në pjesën e mbetur të jetës së tij, sa herë e kujtonte dhe bisedonte rreth  
periudhës së fundit të luftës, nuk i ndalte dot lotët dhe thoshte se për këto  
80 vjet e më shumë, këto 78 ditë ishin ditët më të vështira të jetës sime,  
ngase nuk kam menduar ndonjëherë se në vendin tim, minaret e qytetit  
tim nuk do të thirret ezani për kaq kohë të gjatë.

Hafëz Salihu, me dhimbje dhe lot në sy, përmend edhe një rast po  
ashtu të rëndë të periudhës së luftës, kur forcat paramilitare serbe në Xha-  
minë e lagjes së Karagaqi kishin lëshuar në minare këngë nacionaliste –  
çetnike serbe.

<sup>22</sup> Këto të dhëna u morën prej nipit të hafëz Salihut, Enes Gogës, më 7.12.23, Pejë.

<sup>23</sup> Të dhënat u morën prej nipit të hafëz Salihut, Enis Gogës, i cili kishte fatin të qëndron-  
te me hafëzin i ngjuar 78 ditë gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Hafëz Salihu, tërë jetën e tij, e kishte jetuar me shëndet, i shoqëruar me Kuranin fisnik. Vlen të nënvizohet se hafëzi çdo ditë pas namazit të sabahut ka lexuar 5-6 xhuza të Kuranit dhe kjo ishte praktika e tij standarde gjatë gjithë jetës së tij. Më 4 maj 2000, ia dorëzoi shpirtin e tij Allahut. Gjatë tri ditëve të fundit të jetës së tij, kishte pasur disa shqetësime të vogla, por mbeti gjithmonë me vetëdije dhe fizikisht i qëndrueshëm. Në ditën kur Allahut ia dorëzoi shpirtin, ishte koha e namazit të drekës, dhe ai i kishte kërkuar rejës së tij të merrte abdes për ta falur. Morri abdes, por nuk pati mundësi të falte namazin e drekës, pasi meleku i vdekjes erdhi dhe ia dorëzoi jetën Zotit të tij.

Xhenazen e ka marrë përsipër për ta pastruar, me kërkesën e familjes së hafëzit, hoxha i nderuar, mulla Nexhmedin Hoxhaj<sup>24</sup>. Hafëz Salihu u varros në varrezat e qytetit të Pejës, e në pjesëmarrje për varrim kishte një numër të madh të xhematlinjve dhe qytetarëve nga mbarë Kosova, e në veçanti nga tërë rajoni i Dukagjinit.

---

<sup>24</sup> Nexhmedin Hoxhaj ka lindur më 12.04.1952, në fshatin Uçë të komunës së Istogut. Ky ishte kryetar i Bashkësisë Islame në Pejë gjatë viteve 1991-2011.

---

**Burimet dhe literatura:**

- *Arkivi i Këshillit të Bashkësisë Islame të Pejës, fondi: Dosjet e imamëve.*
- Dr. Haki Kosumi – Bashkësitë Fetare Kosovë, Instituti i Historisë-Prishtinë 1988, f. 21.
- Harun Shabanaj – Shekuj Drite në Deçan, Deçan, 2021.

**Intervista:**

- Intervistë me nipin e hafëz Salih efendiut, Enes ef. Gogën nga Peja, dhënë studentit më datën 7.11.2023.
- Intervistë me Naim HaxhxiIslamin, të birin e Hakiut, nipi i hafëz Eshref Haxhxi Islamit, i cili ishte djali i axhës së Haxhxi Daut Haxhhiislamit, më: 12.12.23.
- Intervistë me të birin e hafëz Salihut, Musa Gogën, më 12.12.23, Pejë.

**faqe interneti:**

- Referuar faqes zyrtare të Komunës së Pejës – [kk.rks-gov.net](http://kk.rks-gov.net).
- [www.islamgjakova.net](http://www.islamgjakova.net)

**Mentor MERXHA**

**A LIFE IN THE SERVICE OF RELIGION AND THE  
JAMAAT - HAFIZ SALIH EF. GOGA (1915-2000)**

**Abstract**

In this paper, the author aims to shed light on the life and work of Hafiz Salih ef. Goga (1915-2000), an imam, mualim, hafiz and hodja, who has made a notable contribution to religious and social life in Peja and its surroundings in the past century. So far, not much attention was paid in our press to the life and work of Hafiz Salih ef. Goga, as well as his predecessors, who were distinguished hodjas as well. This paper aims to serve as an outline for a more detailed work to shed light on the biographies of these scholars.

**Keywords:** *Islamic religion, Albanians, Peja, hafiz, mualim, imam*

Isak N. BILALLI

## **HFZ. AVNI ALIU, INTELEKTUALI QË INFLUENCOI CILËSISHT PROMOVIMIN E VLERAVE FETARE DHE KOMBËTARE NË KOSOVË (1947-2011)**

***“Ikra e bismi rabikel’ledhi halak: - Lexo me emrin e Zotit tënd, i  
Cili krijoi gjithçka...! (El Alak: 1)***

*Pasha Atë që në Duart e Tij është shpirti im, që meriton shumë  
falënderime, vendi i të Cilit qëndron më lart se çdo send tjetër,  
Atë e besoj me tërë qenien time, Atij i kërkoj falje në çdo frymë-  
marrje, të më drejtojë në rrugën e të urtëve, të na ruajë nga hum-  
bja e shkatërrimi, dhe mos të na shpjerë në rrugën e atyre që me  
veprat që kryen u ndëshkuan si popull e si komb!*

### **Shërbimi jetësor i Hfz. Avni Aliut për një edukatë islame atdhetare**

Hafëz Avniu kishte lindur për të qenë, jetoi për t’u mbajtur mend, la pas një fakultet shoqëror e shpirtëror të disiplinuar sipas Sheriatit Islam, pa anashkaluar traditën e bukur kombëtare shqiptare.

Edhe pse i lindur në atë vit që askush nuk do të dëshironte të lindte - Prill 1947 - okupim serb dhe komunist gjithandej, në Tërnoc të Bujanocit, nga një familje me sedër patriotike, një dritë që kurrë nuk do të shuhej vinte në jetë.

Hafëz Avniu – tashmë i ndjerë – njihet nga pjesa dërmuese e popullsisë së Gjilanit dhe Anamoravës si Hafëz i Kuranit, por edhe si pedagog i gjuhës shqipe. Grada e tij kuranore si Hafëz vjen pa u shkëputur fare nga

zinxhiri profetik, një titull që e ka mbrojtur që në moshë të re, dhe që e ka shoqëruar gjatë gjithë jetës së tij. Të arriturat e tij profesionale, me kalimin e viteve, shkëlqyen në çdo aspekt të shoqërisë kosovare.

Dimensioni i shërbesës së tij ka qenë i gjithanshëm, por ne do të përqendrohemi në tri periudha kryesore: e para, kur Kosova ishte nën tutelën e thundrës sllavo-serbe; e dyta, gjatë luftës së UÇK-së dhe në Luginën e Preshevës; dhe e treta, sekreti i tij shpirtëror – një mister që, sa herë e sjellim në kujtesë, askush prej nesh nuk mund ta shpjegojë plotësisht.

Më thjesht, Hafëz Avniu ishte një mbështetës i rrallë dhe i veçantë i çështjes kombëtare dhe fetare, duke u shquar si një personalitet i denjë dhe i palëkundur. Ai njihet si një nga intelektualët e kohës që ka ndikuar në promovimin e vlerave fetare dhe kombëtare në rajonin e Anamoravës dhe më gjerë.

Ai përherë e sillte në vëmendje jetën e Pejgamberit, si dhe mexhllisin në xhami, ku merreshin vendime për çështjet kombëtare. Sipas tij, gjithçka që fillon me përmendjen e emrit të Allahut, ka fitoren e garantuar.

Hafëzi ishte një personalitet që ishte formuar mes librave dhe kabinetesh. Kurani ishte burimi kryesor që e burrëroi atë kombëtarisht, pasi pa atdhe nuk ka fe. Pastaj, libri dhe leximi – ashtu siç Meleku Xhibril i tha Pejgamberit Muhamed tri herë: *“Lexo në emrin e Zotit tënd!”* – ishin thelbësore në formimin e tij. Mejtepi, medreseja dhe xhamia ishin vendet e tij të “xhihadi” intelektual, terreni ku ai mbolli dhe kultivoi diturinë për ngritjen dhe ringritjen intelektuale të shqiptarëve, me qëllim që ata të jectonin të lirë në atdheun e tyre, të lirshëm në praktikimin e fesë dhe të kishin të drejtën e besimit në Zotin e Një dhe të Pashoq, ashtu si në të gjitha vendet e civilizuar të botës.

Për ta kuptuar më drejt dhe më saktë dimensionin e arritjeve të tij, është e logjikshme që vëmendja të përqendrohet te rrugëtimi i tij intelektual, atdhetar dhe fetar.

Pasi përfundoi me sukses për pesë vite Medresenë e Mesme “Alaud-din” në Prishtinë, ku u formua shpirtërisht dhe kuptoi qartë të drejtat dhe detyrat e tij ndaj Zotit dhe njerëzve, Hafëzi vazhdoi studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjakovës, në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Ai diplomoi në vitin 1978, dhe prej aty filloi rrjedha e tij fisnike e shkri-meve me përmbajtje fetare dhe kombëtare.

Në kohën për të cilën flasim, ai ishte ndër intelektualët e rrallë që zotëronte dy fakultete, fliste disa gjuhë të huaja dhe debatonte me finesë. Ai dinte t'i linte kundërshtarët të fitonin për momentin, por në fund fitorja i takonte Hafëz Avniut.

Këtë e dëshmon historiografia e tij profesionale, e cila në shumë aspekte është mbresëlënëse dhe unike në llojin e saj. Kjo e bën që ai të mbetet një personalitet pedant, elokuent në ligjërime – ndoshta ashtu e kishte lindur Zoti.

Në mesin e njerëzve, Hafëz Avniu shquhej për urtësinë, modestinë dhe stilin e tij të komunikimit publik. Ai kurrë nuk preferonte të fliste për veten dhe nuk dëshironte të imponohej në asnjë formë. Këto virtyte e bënë atë një figurë unike dhe të pazëvendësueshme.

Respekti që ai fitoi ishte rezultat i aftësisë së tij për të komunikuar qartë dhe natyrshëm, një dhunti që e kishte të lindur, por që e përsosi përmes studimeve dhe thjeshtësisë së tij.

Një tjetër veçori e tij ishte durimi dhe aftësia për të qenë një dëgjues aktiv – një virtyt që e bëri të jetë një bashkëbisedues me besueshmëri të lartë. Ai dinte t'i dëgjonte me kujdes shqetësimet e komunitetit, duke mbetur gjithmonë i afërt dhe i respektuar.

Shqiptimi i pastër, fjalori i pasur, intonacioni i qetë, urtësia në artikulimin e problematikave dhe ofrimi i zgjidhjeve të realizueshme e bënë Hafëzin një intelektual që njihte thellësisht mendësinë dhe rrethanat e kohës. Ai dinte si të shprehte dhe artikulonte shqetësimet publike me mençuri dhe qartësi.

I ndjeri ishte njeri i idealeve, një thesar i fjalës së shkruar. Përveçse një komunikues i shkëlqyer në të folur, ai ishte po aq i fuqishëm edhe në komunikimin publik të shkruar. Dhuntia e tij në këtë fushë e bëri një ndër nismëtarët e publicistikës islame në rajonin e Anamoravës dhe më gjerë.

Kritika dhe qarqet akademike e kanë cilësuar Hafëzin si një mjeshtër të penës, bazuar në cilësinë dhe numrin e madh të shkrimeve të tij të publikuara. Me të drejtë, ai konsiderohet një nga themelartët e publicistikës islame në Kosovë.

Shkrimet e tij në *Buletinin e Shoqatës së Ulemave*, revistën *Dituria Islame* dhe *Edukata Islame* kanë trajtuar tema dhe shqetësime që lidhen me sfidat me të cilat është përballur kombi dhe feja. Në to, ai gjithmonë ka synuar të analizojë problematikat në thelb.

Për ta ilustruar më së miri stilin e tij eseistik dhe kërkues, kam përzgjedhur një paragraf nga shkrimet e tij, i cili prek kufijtë vetë-shpjegues, përmes mënyrës se si trajton temën dhe si e shtjellon atë në formë thirrjeje apo pyetjeje, që ia drejton vetes dhe komunitetit besimtar:

*“Si ta çlirojmë bashkësinë tonë islame nga të gjitha ngushticat e jetës, që e dezertojnë dhe e shëtisin nëpër rrugët e mjegulluara? Si ta vlerësojmë, pra, bashkësinë e lirë islame dhe si ta ngjeshim kështu të bashkuar, për të marrë kahe progresive?”*

Ky postulat shpalos shpirtin e tij kërkues për gjetjen e një formule që mund të çojë drejt progresit shoqëror, i cili, në thelb, duhet të njohë edukatën fetare si një mjet që e nxit këtë përparim.

Në esencë, shkrimet e tij kanë pasur këtë lloj përsiatjeje, ku ai synonte të ushtronte ndikimin e tij përmes publicistikës në formimin e një edukate islame të pastër, nga e cila çdo familje shqiptare duhej të përfitonte sa më shumë. Duhet theksuar se Hafëzi, në publicistikën islame, nuk ka qenë i kufizuar vetëm në Bashkësinë Islame të Kosovës. Në total, ai ka mbi 150 trajtesa autoriale, përfshirë edhe publicistikën rajonale, duke publikuar periodikisht në revistat islame të kohës, siç janë: *Drita Islame* në Tiranë, *Triumfi Islam* në Shkodër, *Hëna e Re* në Shkup, *Elif* në Podgoricë, *Preporod* dhe *Glasnik* në Sarajevë. Siç vërehet, kontributi i tij publicistik ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e edukatës islame në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Duke folur për kontributin e tij rajonal, është e rëndësishme të përmendet shërbimi i tij jetik në Shqipëri pas viteve '90, menjëherë pas rënies së sistemit komunist. Në atë kohë, bashkë me një grup hoxhallarësh nga Kosova, ai shkoi në ndihmë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, duke ligjëruar besimtarëve kudo ku kërkohesh, si në Tiranë dhe në rrethet e tjera të Shqipërisë.

Edhe pse qëndroi për një kohë jo shumë të gjatë, roli i tij ishte vendimtar për periudhën, pasi shoqëria shqiptare vazhdonte të përballej me

pasojat e ateizmit shtetëror. Në këtë sfond, imamët si Hafëz Avniu luajtën një rol kyç në artikulimin e nevojës për besim dhe në forcimin e identitetit islam.

Hafëzi dha një kontribut të pasur dhe të pastër në diskursin publik, duke u dëshmuar si një intelektual i mirëfilltë me një trashëgimi të pasur. Ai la pas dhjetëra libra të botuar dhe qindra përkthime, të cilat i realizoi krahas shërbimit të tij aktiv si imam dhe publicist.

Përveç talentit të tij si autor me penë të mprehtë, ai u vlerësua lart dhe, me të drejtë, u vendos në krye të redaksive dhe platformave publicistike islame. Ai shërbeu si bashkëdrejtues, redaktor dhe anëtar i disa redaksive, duke dhënë një kontribut të çmuar në themelimin dhe zhvillimin e revistave islame në Kosovë. Me përvojën dhe dijet e tij të gjera, ai u dallua si një profesionist dhe një njeri me bagazh të pasur shkencor.

Gjithashtu, nuk duhet lënë anash bashkautorësia e tij në vepra të ndryshme monografike, të realizuara me kolegë e autorë të tjerë, siç janë: *Të rinjtë dhe narkomania* dhe *Myderriz - Haki Efendiu (1914-1948): një jetë për fe e atdhe*. Titujt e këtyre botimeve dëshmojnë shqetësimin e tij të vazhdueshëm për rininë, për fenomenet që shkatërrojnë shoqërinë, për rolin e fesë dhe për detyrimet ndaj atdheut, të cilat, sipas tij, duhej të adresoheshin vazhdimisht.

Fusha ku ai shkëlqeu gjatë gjithë karrierës së tij ishte linguistika, në të cilën ishte një nga studiuesit më të rrallë dhe më dobiprurës. Ai njihet si një nga përkthyesit më të mirë të serbokroatishtes dhe boshnjakishtes në nivel kombëtar dhe, për këtë arsye, të gjitha përkthimet e ulemave domosdoshmërisht kalonin përmes redaktimit të tij.

Gjithashtu, edhe përkthimet e vështira nga arabishtja kalonin përmes ustait, i cili, përveçse zotëronte gjuhësinë, njihte fare mirë nuancat e fjalëve dhe gjetjen e ekuivalentëve të duhur nga gjuha burimore në shqip dhe anasjelltas.

Duke parë trashëgiminë e tij të shkruar, mund të thuhet me siguri se Hafëzi asnjëherë nuk është ndjerë i përmbushur në detyrat që i kishte caktuar vetes. *Njeriu vdes, vepra jo; të punosh e të veprosh në dobi të kombit tënd dhe fesë tënde është si të hapësh një llogari rrjedhëse bankare me Allahun e Madhëruar.*

Në takime në xhami, në familje apo në sebepe, ai fillimisht u tregonte njerëzve për detyrimet tona ndaj Allahut, e më pas kthente kryefjalën te detyrat ndaj kombit dhe mënyra se si duhet të trajtojmë njëri-tjetrin. Kjo qasje ishte pjesë e filozofisë së tij jetësore dhe e shprehte shpesh, si në ligjëratat e tij, ashtu edhe në forume shkencore, ku kërkohej opinioni i tij. Ai këtë e ka bërë në të gjitha etapat kohore ku ka shërbyer.

Në një nga periudhat më të vështira të rrugëtimit të Kosovës për liri, Hafëzi u gjend në pozita drejtuese të Bashkësisë Islame në Gjilan, duke shërbyer si kryetar i saj për tre mandate. Këtë detyrë e ka kryer me besnikëri, përgjegjësi dhe elokuencë.

Lidershipi i tij është karakterizuar nga zgjuarsia në reagime dhe vendime që kanë sjellë rezultate afatgjata, duke e përfaqësuar institucionin me dinjitet dhe koherencë. Ai e kishte këtë dhunti nga Zoti, si stina e qetë që sjell bereqetin e saj. Me maturinë e tij, ai ka ditur të marrë vendime të rëndësishme për mbrojtjen e interesit kombëtar, sidomos gjatë periudhës së paraluftës dhe luftës, kur janë koordinuar të gjitha aktivitetet politike, kulturore dhe humanitare me strukturat udhëheqëse të kohës.

Në disa raste, Hafëz Avniu ndoshta ka rrezikuar edhe jetën e tij, duke qenë i vetëdijshëm se pushteti i kohës e shihte si armik. Por, në atë periudhë kur atdheu kishte nevojë për njerëz guximtarë, ai nuk kurseu asgjë, duke vënë në dispozicion të gjithë arsenalin e tij intelektual dhe njerëzor në shërbim të kauzës për liri dhe thirrjes për besim në Perëndinë.

Me të njëjtin përkushtim, Hafëzi vazhdoi të ushtrojë ndikimin e tij edhe pas luftës, për më shumë se një dekadë, duke mos ndalur asnjë ditë të vetme shërbimin ndaj popullit të tij. Në këtë periudhë, ndonëse me sfida të tjera, ai u angazhua në konsolidimin dhe rivendosjen e funksionalitetit të Bashkësisë Islame, duke vënë në dispozicion përvojën e tij të gjerë si imam dhe si drejtues në terren.

Do të ishte e mangët të mos përmendej një nga tiparet më të shquara të tij: aftësia për të përfaqësuar me dinjitet dhe për të ndërtuar brenda institucionit një rregull të konsoliduar administrativ e funksional.

Kjo aftësi reflektohej në marrëdhëniet ndërinstitutionale dhe bashkëpunimet me partnerët ndërkombëtarë, duke i dhënë Bashkësisë Islame një

vlerë dhe konsideratë të lartë. Ai ishte një lider i urtë dhe i mençur, që zotëronte një aftësi të rafinuar për komunikim.

Para së gjithash, Hafëz Avni Aliu ishte një diplomat i lindur, me aftësi të shkëlqyera komunikuese, vlerësim që e kanë shprehur hapur edhe përfaqësues të korit diplomatik dhe organizatave ndërkombëtare që kanë pasur mundësinë të bashkëpunojnë me të.

Gjej momentin për t'ua sjellë lexuesve dëshminë e shqiptaro-amerikanit R. Gurra, që flet lidhur me njohjen e tij me Hafëzin, në një rast jo të zakonshëm pas futjes së KFOR-it amerikan, në vitin 1999. *“Në fshatin Miresh gjuhet me predhë artilerie nga serbët e fshatit Ranilug në një autobus plot me shqiptarë që vinin nga Kamenica. Shkojnë në vendngjarje menjëherë forcat speciale të ushtrisë amerikane – tregon Gurra – por për fat, predha kishte përshkuar xhamat e autobusit pa shpërthyer fare. Megjithatë, drejtuesi i automjetit humbi kontrollin, duke përfunduar në një kanal. Fatmirësisht, asnjë pasagjer nuk ishte plagosur, edhe pse automjeti kishte shpërthyer në flakë.*

*Vjen një person i moshuar, me një mjekër të bardhë shumë fine dhe, pasi përshëndet, pyet nëse duhet ndihmë apo jo. Koloneli Dean Hoffman e pyet:*

*– Çfarë pune bëni?*

*– Unë jam imam – tha ai. – Quhem Avni Aliu, banoj në Gjilan.*

*Mënyra se si ai u prezantua ishte shumë dinjitoze dhe gatishmëria për të trajtuar situatën në mënyrë civile dhe njerëzore ndikoi që koloneli Hoffman të kërkonte të fliste pak mënjatë me Hafëzin. Për të mos e zgjatur, - dëfton Z. Gurra – pasi Hafëzi ushtron ndikimin e tij në zbutjen e tensioneve, koloneli Dean Hoffman kthehet dhe iu drejtohet të gjithëve:*

*– Tre veta si ky i duhen Kosovës!”*

Pra, diplomacia e tij nuk ishte për të impresionuar të tjerët, por ishte e shtrirë në linja afatgjata, me qëllim ndërtimin e raporteve koherente dhe të qëndrueshme për të paraqitur shqiptarët myslimanë si të denjë për vendin e tyre dhe si një shoqëri e lirë, me besim në Zot dhe në atdhe.

Në gjuhën e artit e të letërsisë, ai kishte të veshur një petk që i përshatej shumë, me një pe që i shkonte gëzofit të tij. Zoti ka thënë në Kur'an: *Ne asnjëherë nuk e lëmë një vend pa drejtues.*

Ky detaj më sjell në kujtesë jetën dhe veprën e Imam Vehbi Ismailit (*rahmet pastë*), me origjinë nga Shkodra, por që kishte emigruar në Detroit të Amerikës qysh para viteve 1940. Përveçse ishte një imam i klasit të lartë, ai ishte edhe një shkrimtar shumë elokuent, i cili jetën e tij e përmbylli mbi libra, në xhaminë e Detroitit. Me plot gojën mund të themi që edhe Hafëz Avniu ishte një personalitet i përmasave të tilla, si një nga përfaqësuesit më elitarë të institucionit që përfaqësonte, duke e justifikuar në çdo dimension çallmën e imamet që e mbajti me krenari deri sa ndërroi jetë.

Në krijimtarinë e tij intelektuale, fetare dhe kombëtare, qartësisht dallohet devocioni për promovimin e një edukate më të çiltër islame, e cila nuk mund të arrihet pa e dashur dhe pa i shërbyer atdheut për aq kohë sa nevojitej ky shërbim.

Hafëz Avni Aliu i përkiste mendësisë dhe vështirimit fetar-politik që kishin hoxhallarët intelektualë e patriotë, të cilët kundërshtuan fuqishëm sistemin shfarosës komunist ndaj shqiptarëve. Në mesin e tyre ishin Mulla Idriz Gjilani, Haki Efendia e të tjerë, të cilët regjimi serb i vrau dhe i zhdukuri për shkak të bindjeve të tyre të palëkundura kombëtare.

Hafëz Avniu ishte një profesor, si shumë patriotë të tjerë, por edhe një hoxhë si shumë ulema që i shërbyen fesë dhe vatanit pa kërkuar asgjë në këmbim. Madje, kontributi i tij i është dukur i paktë në sytë e tij. Veprimtaria e tij mund të krahasohet vetëm me kontributin e dhënë nga hoxhallarët rilindës të kohës dhe ata që patën fatin të flijohen për dheun mëmë.

Pa dyshim, veprimtaria e tij do të kujtohet gjithmonë si pishtar i publicistikës islame, që la gjurmë të pashlyera në diskursin publik. Po ashtu, si një intelektual dhe imam i pashoq, ai ndikoi për shumë dekada në avancimin fetar dhe kombëtar të shoqërisë në Kosovë.

Allahun e Madhëruar e lus që hoxhën tonë, imamin, alimin tonë, mësuesin dhe profesorin tonë, që na mori përdore e na mësoi si të ecim, si të flasim dhe sa ta duam familjen dhe kombin tonë, ta ketë mëshiruar me Xhenetin Firdevs, inshallah.

## **IV. REFLEKSIONE**



Prof. Dr. Hysen MATOSHI

## HARMONIA FETARE TE SHQIPTARËT

Njëra ndër vlerat e padiskutueshme të kombit tonë është edhe modeli shqiptar i bashkëjetesës në harmoni fetare, i mirëkuptimit dhe i dialogut të vazhdueshëm ndërmjet feve. Harmonia ndërfaqetare, respekti mes pjesëtarëve të të njëjtit komb, mirëpo me fe të ndryshme, i ka shquar shqiptarët përgjatë gjithë historisë, duke u bërë një fenomen interesant për kombet e tjera. Nuk duhet harruar se ndër luftërat më të përgjakshme janë pikërisht ato që kombet i kanë zhvilluar brenda strukturës vetjake, pra me vetveten, e ku në krye të herës shquhen konfliktet apo luftërat fetare. Pavarësisht trandjeve historike, përplasjeve deri edhe perandorake në këto hapësira, shqiptarët kanë mbetur të papërfshirë aktivisht në këto luftëra, dhe e kanë ruajtur e kultivuar si vlerë mbi të gjitha vlerat identitare dimensionin e përbashkët etnik. Në këtë vështrim timin dhe përgjithësisht në shkrimet e mia mbi këtë temë, pra të bashkëjetesës sonë fetare në kontekstin etnik a kombëtar, e kam shmangur qëllimshëm togfjalëshin “tolerancë fetare”, që, si atëbotë ashtu edhe sot, ka një përdorim të dendur. Toleranca ka domethënien e durimit të dikujt, e lëshimit për dikujt, të përmbajtjes etj. Në të vërtetë, në kontekstin e domethënies së terminologjisë fetare nuk është se dikush e toleron dikë, e duron dikë, i lëshon për dikujt, ose përkulet a përmbahet fetarisht para dikujt. Askush nuk ka nevojë ta durojë tjetrin. Secili e ka të drejtën e ekzistimit të tij në formatin që e ka perceptuar fetarisht, ose në ndonjë aspekt tjetër identitar. Prandaj, konsideroj se vlerësimi i tjetrit, i të drejtës së tij besimore, i bashkëjetesës pa asnjë imponim të pikëpamjeve dhe të koncepteve fetare, i bashkëveprimit për interesa e qëllime të përbashkëta e përtejfaqetare – këta mund të jenë komponentët që e përbëjnë mirëkuptimin dhe bashkëjetesën harmonike fetare, e cila

mund të realizohet nëpërmjet komunikimit dhe dialogut të mirëfilltë e të vazhdueshëm ndërjetar. Asgjë nuk ishte më e rëndësishme se sa bashkimi në rrethanat dramatike kur shqiptarëve po u cenoheshin të drejtat dhe liritë themelore kombëtare, sociale, politike, ekonomike, arsimore, kulturore, identitare, fetare, pronësore, duke përfshirë edhe të drejtën elementare të jetës. Shqiptarët ditën të bashkohen në rrethana specifike të rrezikut nga zhbërja e tyre të plotë, duke mos rënë në kurthet e mashtrimeve gllabëruese të fqinjëve ballkanikë. Projektet më antishqiptare, sikundër ishte ai i Ivo Andriqit, zhbërjen e suksesshme të shqiptarëve nga trojet e tyre e shihnin nëpërmjet nxitjes së një lufte fetare vëllavrasëse ndërmjet vetë shqiptarëve. Fatmirësisht, ky projekt, ndonëse u mbështet me të gjithë mekanizmat shtetërorë e të tjerë të Serbisë a Jugosllavisë, dështoi në saje të vetëdijes së elitave fetare shqiptare të të gjitha feve pa dallim, të cilat shmangën çfarëdolloj mosdurimi që do të shpinte në një rrugë të pafund të tragjedisë kombëtare.

Madje, edhe vetë krijimi i institucioneve të shtetit shqiptar ishte bërë nëpërmjet një përfaqësimi të të gjitha komuniteteve fetare në Këshillin e Naltë të Regjencës, si organi kolegjial qeverisës, në të cilin do të ndiheshin të barabartë të përfaqësuar të gjithë qytetarët e vendit, pavarësisht se cilës prej feve i takonin. Do thënë se kishte në mesin e anëtarëve të këtij këshilli edhe udhëheqës dhe prijës të lartë fetarë. Kjo formulë u dëshmuar si e suksesshme dhe u bë një praktikë e identifikimit të interesit të përbashkët dhe më madhor e që ishte krijimi i shtetit shqiptar. Pra, që në fillimet e organizimit kombëtar të shqiptarëve prijësit fetarë u panë si potenciali më i besueshëm dhe më frytdhënës për të formuar një strukturë të qëndrueshme shtetërore. Nacionalizmi si ideologji, që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këtej, nuk kishte të bënte me asnjë lloj kundërshtimi me parimet fetare e në këtë kontekst as me ato islame. Islami nuk e kundërshton as etninë dhe as kombin. Dijetarë të shquar të formatit të Hafiz Ali Korçës, janë shprehur për një bashkëveprim të komponentëve kombëtarë me ata fetarë, për dashurinë ndaj atdheut dhe ndaj fesë, ngase këto dashuri nuk përjashtojnë njëra tjetrën; përkundrazi, siç e thekson Hafiz Aliu në vargjet vijuese:

Çdo njeri që s'don Atdhenë  
 Ka shkelur nderin e fenë  
 S'ka njohur as Perëndinë  
 Bota kafshë le ta dinë.<sup>1</sup>

Kjo gjuhë, mbase jodiplomatike e jopoetike e tij, është rrjedhojë e kundërshtimit të vendosur e të rreptë të pikëpamjeve të çoroditura, sipas të cilave një atdhetar është antifetar dhe një fetar nuk çan kokën për atdheun. Në raste të tjera po ky autor, dijetar dhe filozof i shquar, e shpjegon me gjuhë figurative artistike marrëdhënien e pashkëputshme ndërmjet atdheut dhe fesë:

Dini e vatani dy binjakë janë  
 Që të dy një rrënjë dhe një burim kanë.  
 Ç'derd ka për atdhenë kush ka flakur fenë,  
 Për ditë vagaboni e ndërrojnë kiblenë.  
 Nasjonalist jam, por fetar si duhet  
 Le të thotë bota ashtu si t'u thuhet.  
 Nasjonalisti përse turp të ketë-  
 Tek të thotë e dua me shpirt fenë e vetë?  
 Më fetar i saktë çkrihet për atdhenë  
 Të pa feshmit spara ja kënda xhen-nenë (!)  
 Atdheu kuti është feja xhevahiri  
 Rron në kutit brënda e ruhet floriri.  
 Për të mbrojtur nderin na duhet kutija  
 Po s'pate kutinë shkon feja, inxhija.  
 Nasjonalistët qi duan atdhenë  
 Turp i madh të thonë: (nuk e duam fenë).  
 Nasjonalista janë gjithë fetarët,  
 Ndofta kjo disave u vjen pak e tharët.  
 Nasjonalistin kur e stolis feja  
 Dhe një fish më tepër i shkëlqen ideja.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Hafiz Ali Korça, vëllimi 2 – Shtat ëndrrat e Shqipërisë, botoi ALSAR, Tiranë, 2019, f. 118.

<sup>2</sup> Hafiz Ali Korça, Myslimanizma dhe nasjonalizma, "Zani i Naltë", revista fetare merret edhe me filosofi, moral, literaturë kombtare, sociologji, viti I, nr. 4, kallnuer 1923, f.

I gjithë ky reagim i Hafiz Ali Korçës vjen në një kontekst të kundërvënies së ashpër, nga qarqe të caktuara, të përbërësve identitarë, fetarë e kombëtarë dhe të nxitjes së polemikave të panevojshme rreth tyre, prandaj tonet polemizuese të vargjeve të tij dalin në pah që në fillimet e këtij krijimi poetik nëpërmjet këtyre vargjeve:

Mua nga ca njerës më vjen mjaft pështirë  
nasijonalizmën se gjykojnë mirë.  
Nasijonalistët qenka shqiptarë  
fetarët nuk qenkan as pak atdhetarë!  
Të tjerët përkundra çështjen e gjykojnë  
Nasijonalistët pa fe i shikojnë!<sup>3</sup>

Fundja, duke qenë një intelektual i angazhuar për prosperitet shoqëror, Hafiz Ali Korça del kundër ideologjive ekstremiste komuniste që atëbotë po lëshonin rrënjë në Shqipëri dhe përgjithësisht në Ballkan e në botë. Pikërisht për këtë aspekt ai shkroi dhe e botoi një vepër me rëndësi të titulluar “Bolshevizna a shkatërrim i njerëzimit”, në të cilën nëpërmjet shembujve dhe dëshmive të gjalla për rrezikun nga mbizotërimi i ideologjisë komuniste, që, në planin e përgjithshëm, jo vetëm atë fetar, i kano-sej një shoqërie të shpëlarë nga vlerat morale. Këtë vepër e quan një shërbim kombëtar dhe fetar ndaj atdheut, sepse pikërisht në këtë drejtim po rrezikohej vendi i tij. Gati njëzet vjet para se të ndodhte fatkeqësia më e madhe shqiptare, sikundër ishte ajo e periudhës komuniste, ky dijetar i madh e tërhiqte vërejtjen e rrezikut që vinte prej saj. Jo që bashkëkohësit e tij nuk mësuan gjë, por edhe sot pakkush di mbi këtë kontribut që e dha Hafiz Ali Korça në mbrojtje të identitetit kombëtar shqiptar dhe të identitetit fetar të vëllezërve të tij. Madje jo vetëm kaq, ngase me një solidarësi të rrallë e gati të pashembullt e sheh, tepër i shqetësuar, si shkatërrimin e

---

107; gjithashtu edhe në Hafiz Ali Korça, vëllimi 12 – Publicistikë dhe shkrime të tjera, botoi ALSAR, Tiranë, 2019, f. 13.

<sup>3</sup> Hafiz Ali Korça, po aty.

kishave ashtu edhe të xhamive; tragjedi për të ishte vrasja e prijësve fetarë, pavarësisht nëse ishin të proveniencës islame apo krishtere:

Xhami e kisha s'lan' i rrënuan,  
Me kësi punësh djajt i shënuan,  
Priftinjt e hoxhët si kec i ngrinë,  
Inteligjentët në dhet i shtrinë.<sup>4</sup>

Gati e pamundur që të gjesh në përmasa ballkanike një vepër të kështillë që e denoncon dhunën mbi popullin (sikurse po ndodhte atëbotë në Bashkimin Sovjetik) në vendin e të cilit ishte instaluar njëra ndër format më radikale të komunizmit, pra bolshevizmi rus, që po atakonte gjithçka që kishte të bënte me fenë dhe inteligjencien e atij vendi. Më tej ky dijetar sjell shembuj të panumërt të cenimit të rëndë të jetës së përgjithshme shoqërore e kombëtare që po e sillte ideologjia komuniste, duke rrezikuar, në rend të parë, lirinë e besimit, familjen, pronën private pa të cilën nuk mund të mendohet liria e pjesëtarit të akëcilës shoqëri etj. Të gjitha këto ide, pikëpamje dhe përfundime logjike shkencore Hafiz Aliu, dijetari ynë mendjelartë, i shfaq në formate të ndryshme shkrimi, duke filluar nga shkrimi poetik-letrar, për të vijuar me publicistikën brilante polemizuese dhe për të përfunduar jo rrallë edhe me konstatime të qëndrueshme shkencore. Vizioni i tij, por edhe i një pjese tjetër të elitës fetare-intelektuale të kohës, në këtë drejtim, është i qartë. Gati dy dekada para se në Shqipëri (por edhe në Jugosllavi ku kryesisht shtrihej pjesa më e madhe e viseve shqiptare të mbetura jashtë shtetit amë) ta merrte pushtetin lëvizja komuniste, ky urtak, i cili përfaqëson shëmbëlltyrën e modelit të simbiozës fetare-atdhetare, thërriste për kujdes, paralajmëronte dhe ndërgjegjësonte (me aq sa mundte) bashkëkombësit e tij. Fatkeqësisht ndërgjegjësimi do të vinte vetëm pas një gjysmë shekulli errësire komuniste, e cila ndër pos-

<sup>4</sup> Hafiz Ali Korça, Bolshevizma a çkatërimi i njerëzimit, Shtypshkronja "Mbrothësia", Tiranë, 1925, f. 35; cituar sipas botimit të kompletit të veprave Hafiz Ali Korça, vëllimi i 9-të – Bolshevizma, botoi LOGOS A, Shkup, Prishtinë, Tiranë dhe ribotimit të po këtij kompleti nga ALSAR, Tiranë, 2019.

tulatet e saj kryesore pati luftën kundër indoktrinimit fetar, ngase feja nuk ishte shpëtimi shpirtëror i njeriut, përkundrazi, sipas saj, feja ishte “opiumi i popullit” dhe “mjerimi e injoranca e tij”.

Jo një herë është thënë se nuk ka liri të mirëfilltë fetare pa e pasur të përkufizuar atdheun kombëtar, se gardhi i fesë është atdheu, ndërsa feja, besimi në një Zot, është fryma dhe frymëzimi i secilit individ besimtar për të ruajtur paprekshmërinë e atdheut, gardhin, a kufirin e tij. Sa e sa kombe kanë dhënë prova të padiskutueshme të ndërveprimit të këtyre faktorëve, të cilët pa njëri-tjetrin asnjëherë nuk mund ta bënë atë që janë në gjendje ta bëjnë bashkë. Pikëpamje të ngjashme me këto që theksuam më lart manifestonte edhe kleriku Gjergj Fishta, për të cilin binomi fe e atdhe ishte po ashtu i pandashëm. Ky fakt buron nga një ndërgjegjësim rilindës, sipas të cilit vetëm bashkimi i tërë potencialeve të kombit do të mund t’i përballonte stuhitë, të cilat që nga dekada e tetë e shekullit XIX kishin filluar ta zhbënin nga harta gjeografike e Ballkanit njërin ndër popujt më të lashtë e me vijimësi të padiskutueshme autoktonie që nga lashësia e deri në bashkëkohësi.

Shembujt e ndërveprimit të pjesëtarëve të feve të ndryshme të shqiptarët nuk shfaqen vetëm në kohë tronditjesh historike. Kështu, bie fjala, njëri ndër shembujt e solidarësisë vëllazërore shqiptare, pavarësisht identitetit të ndryshëm fetar, është shënuar me rastin e vdekjes së Haxhi Vehbi Dibrës, më 1937, në varrimin e të cilit fjalim mbajti ish-kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Visarion Xhuvani, madje duke qenë edhe në kundërshtim me rregullat e tij fetare. Megjithatë, vdekja e Haxhi Vehbi Dibrës për të ishte një humbje e madhe e njeriut dhe e personalitetit, i cili e kryesoi Kuvendin e Vlorës, i cili e bëri Shqipërinë të pavarur me nënshkrimin dhe aktivitetin e tij si njeriu i dytë i nomenklaturës së asokohshme politike shqiptare, menjëherë pas Ismail Qemalit; ngase, veç kësaj, kishte vdekur prijësi fetar islam, i cili myslimanët dhe të krishterët i quante vëllazër nga kombi, prandaj Visarion Xhuvani do të mbante një fjalim antologjik, nëpërmjet të cilit do të shpërfaqte tërë vlerësimet e larta për një personalitet të shquar kombëtar:

*“Haxhi Vehbiun e kam njoftun si një nga të parët Kryetarë Shpirtnuer, aj që i pari që u dha dorën të Krishterëve tue u thanë se e ndjekim,*

*po besimin, që na kanë lanë trashigim të parët, porse kudo, në jetën t'onë, jemi vllazën të pandarshëm. Unë sod po e thyej pengesën e mos marrjeve pjesë, nga ana jonë, në ceremoninë të tilla: na jemi vllazën. Myslimanizmi Shqiptar duhet të jetë krenar që pati në gjirin e vet burra si i ndjeri: uroj nga zemra që të vazhdoj të ketë të tillë. Aj po ju len juve, shokë të Klerit Mysliman, idealin e tij që po forcohet dita ditës: Haxhi Vehbia është nga ata që i pjell rrallë koha, Aj tashti prehet i sigurt se misioni i tij atdhetaro-fetar qindron ndër duer të mira si të juejat.”<sup>5</sup>.*

Qartësisht në këtë ligjërim dominojnë vlerësimi dhe nderimi për një personalitet të rëndësishëm që nuk është i fesë së folësit. Nuk është thjesht fjala për një kurtuazi rasti dhe as për një raport harmonie fetare, ngase kjo është shpërfaqje e ndërgjegjes së lartë kombëtare, të cilën Haxhi Vehbiu e kishte mbjellë që nga Kuvendi i Pavarësisë në Vlorë dhe e kishte kultivuar tërë jetën, si një model qëndrimi që po jepte frytet në mesin e të gjithë shqiptarëve. Më tej, i pari i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Visarion Xhuvani, do ta përshkruante me këto fjalë të zgjedhura personalitetin e pashëmbllyeshëm të Haxhi Vehbi Dibrës, si kryetar i Komunitetit Mysliman dhe si shqiptar i rrallë:

*“Kur, ecte, kur bisedonte, kur qëndronte në mest të miqëve dhe misafirve i bante të gjithë pa ndryshim feje ta duan e ta respektojnë; nuk bëni kurrë dimagogji as reklame, por vetëm detyrën e tij Fetaro- Kombëtare si një Muhamedan i mirë..., vetëm si një Shqiptarë i mirë, por edhe si një fillosof i zoti i punëve shoqnore, n’as një tallas nuk u përul dhe për as një mik nuk u kursye, dhe n’as një politikë nuk u trazue... jo se ishte miku i jonë personal, por pse ishte edhe një njeri i tillë, edhe neve e pamë t’arsyeshme me mos u kërsoje por me kuxue dhe me çqetsue pak këtë mbëledhje të hirëshme me fjalë tona, në këtë vend shumë të ndershmë ku prehen eshtnat e të dashtunve t’onë vllazër në kombësi, sa do që për të parën herë ndofta jo vetëm në Shqipni por ndofta edhe në të gjithë botën, për të pa-*

<sup>5</sup> Flet Im-Zot Vissarioni, Disa pjesë nga fjala e Im-Zot Vissarionit, ish-Kryetar i Kishës Autoqefale Ortodokse të Shqipnis, “Zani i Naltë”, revistë fetare, Organ’ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, nr. 4, prill 1937, f. 109 – 110.

*rën herë flet një Kryepriest Kristijan Orthodox në varrin e një Kryehoxhe Muhamedan Mysliman.*

*Nuk ka trashigim më të çmueshëm se karakteri i këti burri për bir e bij të tij që i lë mbrapa njerz të meritueshëm.”<sup>6</sup>*

Krahas drejtuesve të lartë fetarë në mesin e shqiptarëve ka pasur dijetarë, të cilët i kanë kushtuar vëmendje raportit të kultivuar harmonik ndërmjet kombit dhe fesë. Ata kanë shkruar gjerësisht për këtë fenomen shoqëror dhe e kanë argumentuar në planin doktrinar, teorik dhe sidomos atë praktik bashkëjetesën ndërmjet feve të ndryshme pa e cenuar strukturën unike kombëtare dhe për këtë klimë të koekzistencës sociale kanë kontribuar, duke thirrur për mirëkuptim dhe bashkëpunim me qëllim të një bashkëveprimi të këtyre komponentëve të rëndësishëm identitarë. I tillë ishte edhe Beqir Haçi, i cili me shkrimin “Feja dhe kombësija” bëhet njëra ndër mendjet orientuese për ndërveprimin e fesë dhe kombit, duke shmangur shumë nga mashtrimet dhe keqkuptimet që mbillnin qarqe të caktuara përçarëse me propagandën e tyre destruktive: *“Të shumtë janë propagandistët, kudo e më çdo anë, që predikojnë mos-harmoninë midis feve, mos-pajtimin midis kombeve dhe mos-marrëveshjen midis feve dhe kombësive, aty edhe mbrënda për mbrënda një kombi, duke hedhë në vëllavrasje vëllezërit e një mëme, të një gjaku, të një kombi e të një atdheu.”<sup>7</sup>*

Ndonëse, sikurse u dëshmuar, nuk ka pasur një përplasje brendashqiptare të karakterit fetar, ndërveprimi fetar në jetën shoqërore, nuk e ka ndjekur gjithmonë të njëjtën linjë, ngase ka pasur periudha në të cilat elitat tona fetare ose kanë qenë të anashkaluara si subjekte të rëndësishme të shoqërisë, dhe këtu kam parasysh periudhën e komunizmit, kur kishte një klimë ideologjike me premisa të qarta të favorizimit të afetarizmit dhe të ateizmit, ose në raste të tjera këto elita nuk e kanë treguar zotësinë e mja-

<sup>6</sup> Flet Im-Zot Vissarioni, Disa pjesë nga fjala e Im-Zot Vissarionit, ish-Kryetar i Kishës Autoqefale Orthodoxe të Shqipërisë, “Zani i Naltë”, revistë fetare, Organ’ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, nr. 4, prill 1937, f. 111.

<sup>7</sup> Beqir Haçi, Feja dhe kombësija, “Njeriu”, revistë e përmujshme shpirtërore kulturore, viti II, nr. 11 (23), qershtor 1944, Tiranë f. 1.

ftueshme që të bëhen përcaktuese të dimensionit shpirtëror të shoqërisë dhe specifikisht të komuniteteve që përfaqësojnë. Kjo e fundit ka ngjarë më shumë në Shqipërinë politike edhe si rrjedhojë e rrënimit pothuajse të plotë të strukturës elitare të të gjitha feve gjatë periudhës së komunizmit, gjë që u pasua me përfshirjen e personaliteteve nga elita fetare të kombeve të tjera. Megjithatë, në periudhat më kritike për fatet e kombit, ose të një pjese të tij, elitat tona fetare kanë luajtur rol të rëndësishëm, duke u bërë pjesë e një të ardhmeje më të mirë, e lirisë dhe e pavarësisë.

Njëri ndër shembujt frymëzues të ndërveprimit të bashkësive fetare të Kosovës është shënuar në periudhën e aparteidit, kur mungonte edhe shpresa më elementare për një jetë normale. Secili mund të kujtojë përpjekjet e myftiut Rexhep Boja dhe të argjipeshkvit të Kosovës Nikë Prela për një ndërveprim korrekt të bashkësive fetare të Kosovës në të mirë të mirëkuptimit dhe të përpjekjeve të përbashkëta për lirinë e vendit dhe përparimin e kombit. Kjo qasje e përbashkët e krerëve fetarë bëri që shqiptarët e Kosovës të homogjenizohen në parimin e kombësisë, ngaqë mbi këtë bazë edhe ishin rrezikuar, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare.

Duke qenë struktura fetare më e madhe dhe me përfaqësim të gjerë në territorin e Kosovës, edhe sot Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës, në krye me Myftiun Naim ef. Tërnavë, jep në vijimësi kontributin kryesor për krijimin e një klime të respektit, të mirëkuptimit, të harmonisë fetare dhe të bashkëveprimit për një shoqëri të bazuar në vlerat e besimit në një Zot, në vlerat e lirisë e të ndërtimit të një shoqërie humane dhe prosperuese në të gjitha drejtimet.

Fundja, në sajë të filozofisë së bashkëveprimit, bota e përparuar i vlerëson në vijimësi shqiptarët e Kosovës si një popullatë me nivel të lartë emancipues në planin fetar, si një popullatë që e zhvillon identitetin e saj besimor pa e konceptuar si pengesë identitetin e tjetrit.



Besnik JAHA

## **FAKTORI *GJUHË* NË HISTORINË E KULTURËS LETRARE SHQIPTARE**

Shkrimi i historisë së letërsisë shqipe, apo periodizimi i saj dhe emërtimi i periudhave, është një proces analitik dhe interpretues, i cili synon ndarjen e zhvillimeve letrare në etapa të veçanta, gjithmonë të ndërthura me kontekste të caktuara sociale, kulturore dhe politike. Në këtë proces gjithsesi se luajnë rol një varg faktorësh, nga të cilët bëjnë pjesë:

- faktorët e brendshëm, dhe;
- faktorët e jashtëm.

### **Faktorët i brendshëm**

Faktorët e brendshëm janë më thelbësorë për ta kuptuar ndarjen dhe vazhdimësitë e historive të letërsisë. Pra, roli dhe ndikimi i këtyre faktorëve, duke përfshirë lëvizjet estetike, zhvillimet tematike dhe teknikat narrative të autorëve shqiptarë, ka qenë esencial në periodizimin që kanë bërë shumica e historianëve të historive të letërsisë shqipe.

Si faktorë të brendshëm për periodizimin e letërsisë shqipe mund të konsiderohen:

- faktori estetik;
- faktori i stilit letrar;
- faktori tematik;
- faktori gjuhësor-gramatikor;
- faktori i shkollave letrare dhe;
- faktori eksperimental.

*Faktori estetik* është një nga faktorët kryesorë të brendshëm në periodizimin e letërsisë shqipe. Kalimi nga tradita folklorike drejt formave më komplekse, si poezia lëvrimtare, proza dhe dramatika, në letërsinë shqipe shënon edhe ndryshim të brendshëm të etapave në historinë letrare. Dhe, ky ndryshim gjithsesi se është vërejtur në planin estetik.

*Faktori i stilit letrar* është ndër faktorët më të përafërt me faktorin estetik, dhe është vërejtur sidomos te ndryshimi i periudhave. Për shembull, rrjedha nga romantizmi drejt paramodernizmit e realizmit, apo zhvillimi i modernizmit dhe postmodernizmit në letërsinë shqipe, që erdhën për shkak të ndikimit të stilit letrar dhe estetikës së kohës.

*Faktori tematik* ka të bëjë me ndryshimet tematike. Sepse, tematika që mbizotëron në vepra të ndryshme shpesh pasqyron etapat historike dhe kulturore. Disa shembuj të dallueshëm nga letërsia shqipe janë, për shembull: periudha e Rilindjes Kombëtare, ku tematika patriotike dhe edukative është në qendër të trajtimit; tema e luftës dhe e periudhës së tranzicionit në letërsinë e pas Luftës së Dytë Botërore; pastaj trajtimi i temave të identitetit, globalizimit dhe individit në letërsinë bashkëkohore (kjo thuhet fare pak e përfshirë në historitë aktuale të letërsisë shqipe); etj.

*Faktori gjuhësor-gramatikor* ka të bëjë me faktorin e zhvillimit të gjuhës si gramatikë, po edhe të gjuhës letrare. Zhvillimi i gjuhës shqipe ka qenë një faktor i rëndësishëm për ndarjet historike të letërsisë shqipe. Kujtojmë se shumë nga historitë e letërsisë shqipe i rendisin edhe dokumentet e vjetra të shkrimit shqip në periudhë të veçantë (Gaetano Petrota - *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, Namik Ressuli - *Shkrimtarët shqiptarë I*), apo duke e përfshirë edhe zhvillimin e gjuhës brenda vetë periudhës së emërtuar si *Letërsia e vjetër shqiptare* (Justin Rrota, Eqrem Çabej - *Shkrimtarët e vjetër*, Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Qosja, Sabri Hamiti - *Letërsia filobiblike* etj.). Krijimi i normës letrare dhe standardizimi i gjuhës shqipe në vitin 1972, në Kongresin Drejtshkrimor të Gjuhës Shqipe, sigurisht se ka ndikuar ndjeshëm edhe në format dhe strukturat e shkrimeve. Figura si Konstandin Kistoforidhi, Naim Frashëri, Mithat Frashëri, Faik Konica, Fan Noli, me krijimin e neologjizmave dhe formave të reja gramatikore, apo edhe autorë të mëvonshëm si Ernest Koliqi, Mit-

rush Kuteli, Ismail Kadare etj., me eksperimentimet gjuhësore e gramatike, kanë kontribuar shumë në ndryshimin e ndjeshmërisë estetike dhe letrare përmes zhvillimit të vetë gjuhës shqipe.

*Faktori i shkollave letrare* ka të bëjë me lidhjen që kanë pasur autorë të ndryshëm me shkollat letrare. Grumbullimi i autorëve të ndryshëm rreth shkollave ose rrymave të caktuara letrare është një kriter që shpeshherë ka shërbyer për shënimin e kufijve kohorë. Shembuj të vërejtur në letërsinë shqipe janë ndikimi nga “shkollat” e diasporës gjatë romantizmit (Italia-Kalabria, Bukureshti, Stambolli, Kajro), pra, ndikimi i tyre në krijimin e vjershave patriotike, apo grupi i autorëve të çerekshekullit të parë të shekullit XX, që solli shenja të “shkollave” moderne, apo edhe grupi i autorëve që pas Luftës së Dytë Botërore, që solli ndikimin e modelit të shkollave letrare socialiste.

*Faktori eksperimental* ka të bëjë me eksperimentimin në forma dhe gjini letrare. Ky faktor është vënë re pak në formulimet e historive të letërsisë shqipe, pasi te ne zakonisht historitë e letërsisë shqipe kanë përfunduar të jenë histori të periudhave apo të poetikave letrare. Dhe kështu, autorët që eksperimentuan me forma dhe gjini letrare, e që shënojnë fillimin e etapave të reja, te ne nuk janë identifikuar e dalluar, duke mbetur kështu gjithmonë pjesë e periudhave a epokave letrare. Krijimi i romanit si gjini e mirëfilltë, ose zhvillimi i eseistikës dhe i publicistikës, apo fillimi i kritikës (këtu bën përjashtim identifikimi i Konicës), janë ndër faktorët kryesorë që do të duhej të ishin faktorë për periodizim të historisë së letërsisë.

Faktorët e brendshëm janë elementë me shumë ndikim, dhe luajnë një rol kryesor në shpjegimin e ndryshimeve të ndërmjetme dhe në zhvillimet afatgjata të kulturës letrare të një shoqërie. Këta faktorë që i trajtuam më sipër, po edhe të tjerë që nuk i kemi marrë në diskutim, ndihmojnë në kuptimin e proceseve të ndryshimit dhe të zhvillimit të një kulture letrare, pastaj në identifikimin e karakteristikave unike të periudhave specifike të asaj kulture, si dhe në veçimin e ndikimit që autorët dhe veprat e tyre mund të kenë pasur në zhvillimin letrar të një letërsie të caktuar.

Faktorët e brendshëm të periodizimit të historisë së letërsisë shqipe janë element themelor për kuptimin e zhvillimeve letrare të letërsisë shqi-

pe. Këta faktorë jo vetëm që ndihmojnë në krijimin e një narrative koherente, por gjithashtu ndikojnë edhe në pasqyrimin e kompleksitetit dhe të koloritit të letërsisë shqipe në periudha të ndryshme historike.

### Faktorët e jashtëm

Shkrimi i historisë i letërsisë, në rastin tonë të letërsisë shqipe, është i ndikuar jo vetëm nga faktorët e brendshëm, por edhe nga një sërë faktorësh të jashtëm, e që kanë ndikim të madh në ndarjen dhe formësimin e periudhave-etapave dhe zhvillimeve letrare. Faktorët e jashtëm, sikurse janë ndikimet politike, shoqërore dhe kulturore, kanë luajtur një rol thelbësor në strukturimin dhe periodizimin e çdo historie të letërsisë shqipe. Në fakt, më shumë sesa faktorët e brendshëm, faktorët e jashtëm ndoshta ishin më vendimmarrës në periodizimin e historisë së letërsisë shqipe. Ndikimi më i madh i tyre është vërejtur në ndryshimet dhe transformimet letrare që ka pasur letërsia shqipe, ndërkaq si faktorë të tillë mund të jenë:

- faktori politik;
- faktori historik;
- faktori i huaj kulturor dhe estetik;
- faktori diasporë;
- faktori i ndryshimeve sociale;
- faktori teknologjik;
- faktori global etj.

*Faktori politik* ka të bëjë me proceset politike dhe ngjarjet politike si faktor që ndikojnë në prodhimet letrare. Për shembull, në letërsinë shqipe ka pasur ndikim të madh politika si faktor për akëcilat ndarje të periudhave në historitë e letërsisë. Si më të njohura janë periudha e Perandorisë Osmane, ajo e Pavarësisë, ajo e para dhe e pas Luftës së Dytë Botërore etj. Për shembull, do të ishte mirë të vërehej roli i Perandorisë Osmane në letërsinë e hershme shqipe dhe në (për)kufizimet e vendosura mbi shkrimin në gjuhën shqipe, e që nuk mund të konsiderohet i pavënëre, megjithëse fare pak i përfillur në historitë e letërsisë shqipe. Në këtë faktor bënë pjesë edhe roli i Rilindjes Kombëtare në zhvillimin e letërsisë, si një mjet për ngritjen e vetëdijes kombëtare, apo edhe periudha politike ko-

muniste dhe ndikimi i censurës shtetërore në formësimin e letërsisë socialiste.

*Faktori historik* është gati i njëjtë me atë politik, megjithëse këtu kemi të bëjmë me aspektin e ndryshimeve në periudha më të mëdha. Për shembull, periudha e Motit të Madh, e njohur si periudha e Skënderbeut, për krijimet popullore letrare, pastaj romantizmi në Evropë dhe kontakti i romantikëve shqiptarë me kulturën e huaj, që ka ndikuar si faktor për ndryshimet kulturore historike në letërsinë shqipe. Duke e parë ç’i mungonte kulturës shqipe, romantikët e plotësuan çdo boshllëk, dhe kështu ndikimi nga jashtë u bë pjesë e kultivimit edhe e periodizimit të historisë së letërsisë sonë kombëtare. Gjithashtu, faktori historik, në raport me rolin e Perandorisë Osmane në letërsinë e hershme shqipe, nuk është përfillur në historitë e letërsisë shqipe, duke lënë kështu edhe modele shumë me rëndësi për t’i parë si histori ose katalogime mesjetare të letërsisë së asaj kohe në arealin gjeografik ballkanas. E kështu, për shembull, mund të konsiderohet vepra e Ashik Çelebiut, *Meşairü’ş-şuara*<sup>1</sup>.

*Faktori i huaj kulturor dhe estetik* ka të bëjë ndikimet nga kontaktet e huaja, e që kanë qenë faktorë në format dhe temat e letërsisë shqipe. Shembull tipik për këtë faktor është edhe koncepti i qarqeve, i identifikuar fillimisht prej Mithat Frashërit nga kultura letrare franceze (i vërejtur në shkrimet e tij në revistën “Diturija”), ndërsa më vonë i dispozituar prej Eqrem Çabejt në konceptin e qarqeve. Pra, faktori i huaj kulturor dhe estetik do ta identifikonte këtë fenomen. Gjithashtu ky faktor do të merrej edhe me ndikimin e romantizmit dhe iluminizmit evropian në shekullin XIX në letërsinë shqipe, apo ndikimin e modernizmit i importuar nga traditat letrare të Europës Perëndimore (në histori të letërsisë shqipe i identi-

---

<sup>1</sup> Vepra *Meşairü’ş-şuara* (Ndjenjat e poetëve), është vepra kryesore e Ashik Çelebiut. Kjo vepër është një lloj fjalori bibliografik i poetëve dhe poezive më të njohura të poetëve të përmendur, të periudhës së tij dhe të mëhershëm (*tezkiye*). Kjo vepër u botua në vitin 1568 dhe është një burim i shkëlqyer jo vetëm për jetën dhe veprën e poetëve më të njohur të asaj periudhe, shqiptarë, osmanë, boshnjakë etj, që kanë jetuar në gjeografinë e sotme shqiptare, por edhe për jetën shoqërore dhe zakonet e studiuesve të asaj kohe. Nga një shfletim që ia kemi bërë kësaj vepre, kemi vërejtur me qindra poetë shqiptarë të qyteteve si Prishtina, Prizreni e Shkupi.

fikuar si faktor vetëm prej Rexhep Qosjes, në periodizimet dhe emërtimin e periudhave që bënë). Po ashtu ky faktor identifikon edhe, për shembull, ndikimin e letërsisë ruse dhe të asaj të Evropës Lindore gjatë periudhave të ndryshme; asaj orientale gjatë Perandorisë Osmane dhe më vonë mes identiteteve islame, ndërsa asaj ruse gjatë periudhës komuniste.

*Faktori diasporë* ka të bëjmë me ndikimin e migrimit dhe të diasporës në kulturën e historisë së letërsisë. Dihet se lëvizjet demografike dhe grupimi i diasporës shqiptare nëpër qendra të ndryshme gjithandej nëpër botë gjithnjë ka qenë burim i pasur për zhvillimin e kulturës dhe të letërsisë shqipe. Në fakt, vepra e parë romantike shqipe shkruhet në diasporë (*Këngët e Milosaos, bir i sundimtarit të Shkodrës* – 1836), drama e parë po ashtu (*Emira* - 1885, e Anton Santorit), e njësoj edhe romani, eseja etj. Autorët shqiptarë që jetuan jashtë vendit sollën perspektiva të reja, si dhe ndikime nga traditat letrare të huaja. Kjo është veçanërisht e dukshme te shkrimet e autorëve të Rilindjes Kombëtare që jetuan në kolonitë shqiptare të Evropës (Itali, Rumani, Greqi, e Stamboll), po edhe te ata të diasporës përtej evropiane (në ShBA, Egjipt, Libi, Siri etj.). Ky faktor është i rëndësishëm edhe për identifikimin e kontributit të autorëve bashkëkohorë që jetojnë në diasporë, gjithandej nëpër botë. Për shembull, ky faktor do të identifikonte rolin e shoqatave shqiptare në diasporë për promovimin e kulturës letrare, sikurse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo, për shembull, autorin kosovar Xhevdet Bajraj, që ka jetuar dhe vdekur në Meksikë.

*Faktori i ndryshimeve sociale* ka të bëjë me zhvillimin dhe ndryshimin social të një shoqërie, e që ka ndikuar në botimin, promovimin dhe leximin e veprave letrare. Në këtë plan mund të përmendet ndikimi i shtypshkronjave në periudhën e Rilindjes Kombëtare, apo i shtëpive të mëdha botuese, sikurse Rilindja më vonë, në përhapjen e letërsisë shqipe.

*Faktori teknologjik* ka të bëjë me zhvillimin teknologjik dhe të internetit, apo të botës digjitale dhe virtuale. Zhvillimi teknologjik dhe ndikimi i këtij zhvillimi në ndryshimin e shoqërisë ka ndikuar edhe në botën e kulturës e letërsisë. Për shembull, përhapja e internetit dhe e teknologjive të varura nga interneti, socialmedies dhe virtuallibrit e audiolibrit, duhet konsideruar si një faktor me rëndësi në ndryshimin e formave të

krijimtarisë letrare dhe të interkomunikimit të letërsisë me lexuesin, po gjithsesi një faktor me rëndësi tashmë edhe në periodizim dhe përpilim të historive të letërsisë<sup>2</sup>.

*Faktori global* ka të bëjë me ndërthurjet që ka sjellë globalizmi mes letërsisë dhe kulturave të vogla dhe atyre më të mëdha. Ky faktor merret edhe me identifikimin e zhvillimit të letërsisë bashkëkohore me tema universale, njohjen e autorëve shqiptarë nëpër botë, si dhe vetë promovimin e letërsisë shqipe nëpër panaire të rëndësishme të botës. Në historitë e gjertanishme të letërsisë shqipe ky faktor nuk është marrë fare parasysh, ndërsa, sidomos letërsia bashkëkohore shqipe përbën një burim që nuk duhet shpërfillur në këtë kontekst.

Faktorët e jashtëm kanë një rëndësi të madhe në përpilimin e historive të letërsisë, pasi jo vetëm që i pasqyrojnë ndikimet e huaja, por gjithashtu i identifikojnë dhe i vlerësojnë edhe dinamikat dhe proceset e ndryshimit brenda letërsisë.

Disa nga efektet kryesore që këta faktorë mund t'i identifikojnë janë edhe zgjerimi ose shtimi i një larmie elementesh, aktiviteteve apo opsionesh brendapërbrenda vetë letërsisë shqipe, siç mund të jenë elementet tematike dhe ato të formave, pastaj ngritja e letërsisë shqipe në kontekste më të gjera kulturore, apo edhe nxitja e dialogut mes kulturës kombëtare dhe asaj globale, etj.

Faktorët e jashtëm janë thelbësorë për ta kuptuar rëndësinë e periodizimit të historisë së letërsisë shqipe dhe vetë historinë e letërsisë. Këta faktorë pasqyrojnë ndërthurjet mes traditave kombëtare dhe ndikimeve të jashtme, duke ndihmuar në krijimin e një versioni sa më të pasur të zhvillimit letrar. Në fakt, të një historie sa më të plotë të letërsisë.

---

<sup>2</sup> Në lidhje me ndikimin e teknologjisë në ndërrimin-ndryshimin e kulturës sonë tradicionale dhe rikonceptimin e një kulture të re, një modeli të ri teknokulturor, për më shumë lexo Alan Kirby, *Digimodernism*, Continuum, New York-United States of America, 2009!

### Faktori gjuhë

Më herët, te faktorët e brendshëm, kemi folur për *faktorin gjuhësor-gramatikor*, i cili faktor ka të bëjë me zhvillimin e *gjuhës* si gramatikë, po edhe të *gjuhës* letrare. Këtu nuk do të flasim për zhvillimin e *gjuhës* shqipe si një faktor për ndarjet historike të letërsisë shqipe. Këtu do të flasim për faktorin *gjuhë në kohë*, si kriter për periodizim.

Faktori *gjuhë* në periodizimin e historisë së letërsisë shqipe është një element mjaft kompleks. Në periudha të ndryshme historike, rëndësia e *gjuhës* për ta konsideruar një autor pjesë të një kulture ka ndryshuar në varësi të kontekstit politik, kulturor dhe ideologjik.

Megjithatë, duhet kuptuar se gjatë Mesjetës, *gjuha* nuk ka qenë faktori kryesor për kategorizimin e kulturave kombëtare. Kjo sepse në atë kohë, identitetet kombëtare nuk ishin ende të formuara në mënyrën që i njohim sot, dhe kategorizimi i kulturave bazohej më shumë në përkatësinë fetare, politike-perandorake apo shoqërore, sesa në *gjuhë*.

Si arsye kryesore pse *gjuha* nuk ishte faktor përcaktues në Mesjetë është dominimi i *gjuhëve* universale: për evropianët latine e greke, për myslimanët arabe e osmane, e kështu me radhë. Shqiptarët, si një nyjë mes këtyre dy kulturave të mëdha, patjetër se të ndikuar nga të dy kulturat, *gjuhën* e tyre në atë kohë sigurisht se nuk e konsideruan të rëndësishme për përdorim përtejditor. Në fakt, *gjuha* shqipe në atë kohë edhe konsiderohej *gjuhë e vulgut-vulgare*, e pazhvilluar, *gjuhë* e fshatit, *gjuhë* e popullit të zakonshëm, dhe si e tillë nuk përfillej për përdorim institucional-administrativ a letrar-akademik. Në këtë periudhë *gjuha* shqipe, si-kurse edhe shumë *gjuhë* të tjera të rangut apo të statusit të saj në atë kohë, kishin mbetur nën hijen e *gjuhëve* të mëdha, *gjuhëve* të pushtetit, *gjuhëve* që përdoreshin në shkencë dhe në administratë.

Prandaj, të shkruash në *gjuhën* shqipe në atë kohë ishte e palogjikshme edhe prej vetë shqiptarëve, edhe pse herë-herë ndonjë fjalë nëpër tekstet e shkruara mund ta kishin përdorur<sup>3</sup>. Kjo për faktin se edhe analfa-

<sup>3</sup> Kur themi se mund ta kishin përdorur ndonjë fjalë, kemi për qëllim sidomos disa *sufiksa* e *paraqfalë* që i kemi vënë re nëpër disa faksimile në *gjuhën* osmane (*fermanë* e *kronika*), në të cilat kemi parë fjalët *nër*, në kuptimin *ndër-nën* para emrave të vendeve, siç rëndom përdorej dikur, e vende-vende edhe sot, kur tregohet për një rajon dhe jo vetëm: “Ndër Dukagjin”, “Ndër vete”, “Ndër ju” etj.

betizmi ishte në një shkallë shumë të madhe; nuk kishte kush të ta lexonte shkrimin tënd. Kështu që, shkrimi në latinisht, greqisht e osmanisht ishte shkrim në *gjuhët* e modës, të ndikimit e të shkencës. Prandaj, secili prej autorëve që shkroi, e zgjodhi njërën nga këto *gjuhë*, ashtu që teksti i tij të arrinte te lexuesi dhe të përfitte nga masa.

Pastaj, në Mesjetë feja kishte ndikim të madh në shoqëri, dhe *gjuhët* që përdorehin për komunikim edhe në rituale ishin latinishtja e osmanishtja apo arabishtja. Kështu që, autorët që shkruanin në këto *gjuhë* konsideroheshin pjesë e një kulture më të gjerë, pavarësisht origjinës së tyre etnike. Për shembull, Mesihi Prishtinaliu e Marin Barleti, që për kohëzgjatje ndajnë vitin e njëjtë të vdekjes (1512). I pari ka lindur në Prishtinë (1470), ndërsa ka vdekur në Stamboll, ndërsa i dyti ka lindur në Shkodër (1450), ndërsa ka vdekur në Padovë. Që të dy këta autorë kanë shkruar në *gjuhë* të huaja, i pari në osmanisht e arabisht, i dyti në latinisht, pavarësisht se veprat e tyre kanë pasur tema të kulturës shqiptare. Pra, pavarësisht *gjuhës* veprat e këtyre figurave janë pjesë e kulturës shqiptare, për shkak të përmbajtjes dhe kontekstit historik që trajtojnë, po edhe identifikimit të përkatësisë nacionale të autorëve.

Pastaj, në Mesjetë identiteti fetar ndarjet kryesore kulturore dhe shoqërore bazoheshin në fe dhe strukturë sundimtare (perandori). Për shembull, një individ konsiderohej pjesë e një komuniteti të caktuar në bazë të fesë (mysliman, katolik, ortodoks) ose përkatësisë ndaj një perandorie apo mbretërie, pavarësisht *gjuhës* që fliste (romak ose osmani, për shkak të Sulltanatit). Në këtë kontekst, edhe nëse shumë grupe nacionale ishin pjesë e perandorive, qoftë romake apo islame, populli mund të flisnin *gjuhë vulgare*, por vetëm për komunikim të përditshëm, ndërsa për përdornin zyrtar, fetar ose akademik ishin *gjuhët* si latinishtja, osmanishtja ose greqishtja.

Në aspekt të letërsisë shqipe, në fazat e hershme të historisë së letërsisë shqipe *gjuha* nuk ishte domosdoshmërisht kriteri kryesor për përcaktimin e një vepre si pjesë të trashëgimisë letrare shqiptare. Më shumë ndikonte tema, sesa *gjuha*. Kjo është e kuptueshme për shkak të disa faktorëve, e sidomos funksionit praktik; në mungesë të një standardi të për-

bashkët të shqipes, shumë autorë preferonin të shkruanin në *gjuhët* që i kuptonin më mirë lexuesit e tyre, në osmanisht dhe në latinisht.

Vetëm në periudhën e Rilindjes Kombëtare, në shekullin XIX, *gjuha* filloi të shihej si një element kyç i identitetit kombëtar, i kulturës letrare kombëtare. Letërsia në këtë periudhë jo vetëm që i shërbente nevojës për ndërtimin e identitetit kombëtar, por edhe e vuri shqipen në qendër të këtij projekti, dhe kështu *gjuha* tani u bë faktor themelor në kategorizimin e kulturës kombëtare, me këtë rast edhe letrare.

Në periudhat më të vona *gjuha* është bërë një kriter gjithnjë e më i rëndësishëm për kategorizimin e një vepre si pjesë të një letërsie. Dhe kështu, shumë shkrime e vepra të shkruara prej shqiptarëve në *gjuhët* si italisht, frëngjisht a turqisht, kanë nisur të konsiderohen edhe si pjesë të kulturës së përgjithshme të atyre vendeve, nganjëherë më shumë sesa të kulturës shqiptare. Në këtë kontekst një “përrjashtim” më i theksuar vërehet sidomos tek autorët që kanë shkruar në gjuhën turke, siç kanë qenë, për shembull, poetët e njohur Kemal Aruçi (nga Shkupi) dhe Mehmet Akif Ersoy (me prejardhje nga Istogu), e që pavarësisht se kanë shkruar për shqiptarët, vepra e tyre letrare asnjëherë nuk është konsideruar pjesë e kulturës letrare shqipe. Megjithatë, siç mund ta vëreni, shkrimet në *gjuhët* mesjetare, osmanisht e latinisht nuk kanë një kriter të njëjtë, sepse *gjuha* në atë kohë kishte një statut apo një kategorizim krejt tjetër.

Siç mund të vërejmë gjer këtu, edhe pse për shqiptarët *gjuha* bëhet si kategori thelbësore gjatë shekullit XIX, kur *gjuha* shqipe u promovua si shtyllë e kombësisë shqiptare, njësoj nuk u pa për kulturën letrare të para shekullit XIX. Sepse faktori *gjuhë* ka kaluar nga një element dytësor në një komponent kyç në periodizimin dhe klasifikimin e historisë së letërsisë, në rastin tonë edhe shqiptare. Kështu që, për ta pasur një histori të letërsisë dhe të kulturës shqipe sa më të plotë, faktori *gjuhë* nuk duhet parë me të njëjtën relevancë në çdo kohë-periudhë.

Kjo perspektivë pasqyron një ndryshim të rëndësishëm edhe në mënyrën se si shqiptarët duhet ta kuptojnë dhe ta ruajnë identitetin e tyre kulturor dhe kombëtar nëpërmjet letërsisë. Pra, ende është e çuditshme përse një varg autorësh shqiptarë që kanë shkruar në *gjuhën* osmane, ose në ndonjë gjuhë tjetër të kohës së Mesjetës, nuk bëjnë pjesë mes autorëve

shqiptarë në historitë e letërsisë shqipe, as si identitete individuale, as si autorë brenda modeleve letrare, po edhe as si autorë në ndonjë periudhë<sup>4</sup>. Pa një vlerësim të këtillë të faktorit *gjuhë*, në kuptimin që e shpjeguem më sipër, kultura shqiptare gjithmonë do ta ketë të paplotë historinë e letërsisë së saj.

<sup>4</sup> Si autorë të periudhave mund të identifikohen shumë emra. Për shembull, mund të bëhet një ndarje në autorë të *divaneve*, mes të cilëve, mund të renditeshin (po i shkruajmë siç janë të regjistruar në gjuhën turke, transliteruar nga osmanishtja, me vitin e vdekjes ose të lindjes në hixhrij dhe miladi; që të gjithë shqiptarë): İşkodralı Râcî (vdek. 1130/1717-18), Akçahisarlı Hâtemî (vdek. 1224/1809-10), Akçahisarlı Şaban Hulûsî (1189/1775-76-1249/1833-34), Bâlî (1320/1902-3'te dođ.), Çâker (1205/1790-91-1274/1857-58), Hasan Hakkî Paşa (1826-27-1882-83), Hikmetî İşkodra Akçahisarlı (vdek. 1240/1824-25), İşkodralı Ahmedî (vdek. 1150/1737-38), İşkodralı Âsaf Mehmet Paşa (1172/1758-9-1222/1807-8), İşkodralı Halilî (vdek. 1223/1808-9), İşkodralı Hamdî (1210/1795-6-1277/1861), İşkodralı Hulusî (vdek. 1307/1889-90), İşkodralı Hüseyinî (vdek. 1737-38), Peklinli Cafer Sâdık Paşa (vdek. 1250/1834-35), Tevfik (vdek. 1260/1844), Tiranlı Hâdim (vdek. 1220/1805-6), Tiranlı Halimî (1208/1793-94-1270/1854), Tiranlı Rıza Bey (1248/1832-33), Tiranli Ziver (vdek. 1294/1877), Zihnî, İsmail Zihnî Efendi İşkodralı (1250/1834-35-1304/1886-87) etj. Apo, mund të përmenden edhe autorë të mëhershëm, sikurse ata të shekullit XV-XVII (ca edhe të fundit të shekullit XIV), që krijuan letërsi në gjuhën osmane, sikurse ishin, për shembull: Lutfi Pashai (Sadrazam, Damad-Dhëndëri Padishahut, i lindur në Vlorë, në vitin 1488, ndër-sa ka vdekur në vitin 1564), Ashik Çelebiu (që lindi në vitin 1520, në Prizren, ndërsa vdiq në Shkup, në vitin 1572, dhe ishte një figurë multidimensionale e kohës; jurist, poet, teolog, historian, filozof, poliglot etj. Në kryeveprën e tij, *tez-kiren*-një lloj bibliografie e poetëve dhe poezive më të njohura, *Meşairü's-şuara-Ndjenjat e poetëve*, mendohet se ka përmendur 427 autorë), Jahja bej Dukagjini-Dukaginzade *Yahja bej* (1498-1582, i njohur edhe si Taslicali Yahya Bey), Suzi Çelebiu (i vdekur në vitin 1524), Mesihi (Isa) Prishtinaliu (që ka lindur në Prishtinë, në vitin 1470, ndërsa ka vdekur në Stamboll, në vitin 1512; shkroi disa vepra, nga të cilat një divan në dialektin rumelian të osmanishtes (versioni i të folmes së osmanishtes prej shqiptarëve), që mbe-ti i pabotuar, një vepër me titull *Murabba'-i bahâr-Kënga e pranverës*, dhe një tjetër me titull "*Shehr-engiz*", dhe ishte i njohur si një ndër poetët më të njohur të kohës), Ni-hâni, Nacak Fâzil (që vdiq në vitin 1519), Dukaginzade, Mustafa Sun'i Bey, Sancak Beyi (poet gjatë sundimit të Sulltan Muradit III, që sundoi nga viti 1574, deri në vitin 1595), Dukaginzade Ahmed/Sultanzade, *Dukaginzade/Sultanzade Ahmed Bey* B. Damad-Dhëndër i Mehmed Pashës (i vdekur në vitin 1552), Ibrahim Shahidi Dede (nga Mugla, i cili në vitin 1514 kishte përpiluar një fjalor me mijëra fjalë, të titulluar "*Tyh-fei Shahidi*" - "Dhurata e Shahidit"), Hizri Elbasanliu (Shehji shqiptar që ka shkruar *tez-kire*, sikurse Ashik Çelebiu), Mevlana Mustafa Shemimiu (nga Prizreni, që vdiq pas vitit 1600), Dervish Elbasanliu (që vdiq në vitin 1645) etj.



Mr. Besim MEHMETI

## **PAQJA GLOBALE DHE ISLAMOFOBIA (FRIKA NGA ISLAMI)**

### **Hyrje**

Operacionet e tmerrshme terroriste të kryera në emër të Islamit, veçanërisht pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, kanë ngjallur polemika të mëdha në botën islame dhe në Perëndim. Shumica dërmuese e myslimanëve e mohojnë lidhjen e fesë së tyre me këto ngjarje dhe e refuzojnë këtë fenomen. Po ashtu, edhe qëndrimet dhe deklaratat e shumicës së politikanëve, mendimtarëve dhe klerikëve të shquar perëndimorë janë të drejta kundrejt Islamit dhe myslimanëve. Sidoqoftë, lidhja e terrorizmit dhe vrasjes me mësimet e Islamit dhe ligjin e tij, si dhe konsiderimi i vlerave të jetës shoqërore islame si të papajtueshme me jomyslimanët, janë ide që po bëhen gjithnjë e më popullore në shoqëritë perëndimore. Këto ide po teorizohen nga mendimtarë, ekspertë strategjikë, aktorë politikë, institucione mediatike dhe artistë, etj.

Rreziku i kësaj situatë është se ajo çon në një rreth vicioz dhe të zbrazët. Rritja e frikës dhe frikësimit ndaj Islamit dhe myslimanëve në shoqëritë perëndimore nxit, në nivelin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në nivelin e marrëdhënieve me pakicat myslimane, pozitat dhe miratimin e politikave të jashtme ose të brendshme që dobësojnë besimin midis dy palëve.

Kjo inkurajon përhapjen e diskursit antiperëndimor në shoqëritë myslimane, i cili ushqehet nga dallimet fetare dhe kujtesa e trashëgimisë koloniale perëndimore.

E qartë është bërë tashmë qëndrimi negativ dhe nxitës kundër Islamit dhe vlerave dhe kulturës së myslimanëve ka marrë përmasa të mëdha në shoqëritë perëndimore, veçanërisht ato ku myslimanët kanë një prani të dukshme. Ky qëndrim është shndërruar në një kartë zgjedhore të suksesshme dhe, në disa raste, në një investim fitimprurës. Pavarësisht faktit që myslimanët në Perëndim jetojnë në vende ku nuk ka diskriminim – teorisht dhe ligjërisht – në bazë të fesë ose racës dhe ku të gjithë janë të barabartë në shtetësi dhe prezumim pafajësie, ata vazhdojnë të detyrohen të deklarojnë vazhdimisht se feja dhe shoqëria e tyre nuk kanë lidhje me akuza për ekstremizëm, dhunë dhe terrorizëm.

Prandaj, angazhimi i dijetarëve, studiuesve dhe mendimtarëve islamë për të promovuar paqen dhe mbështetur misionet dhe iniciativat paqësore nuk ka pushuar kurrë dhe nuk do të ndalet. Me gjithë sfidat e shumta dhe rrethanat gjeopolitike, si dhe ngjarjet e papritura që shoqëritë e ndryshme i kanë kaluar – duke shfrytëzuar pikat e diversitetit dhe nxitur urrejtje ndaj atyre që janë, mendojnë dhe besojnë ndryshe – myslimanët vazhdojnë dhe përpiqen që gjithmonë të udhëzohen nga parimet e Islamit, i cili fton dhe nxit paqen, njohjen dhe bashkëjetesën.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا

***“O ju njerëz, Ne vërtet ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete!”<sup>1</sup>***

Marrja parasysh e kontekstit global vjen si pasojë e seriozitetit dhe përhapjes së fenomenit të frikës nga Islami, dhe ritmit të përshpejtuar të akuzave të drejtuara kundër Islamit dhe myslimanëve, veçanërisht në dritën e rritjes së frikës ndaj myslimanëve në Perëndim. Kjo ndikon në dobësimin e besimit mes pakicave myslimane dhe komuniteteve të tyre, duke kontribuar në përhapjen e mendimit antiperëndimor të bazuar në ndarjet fetare. Fenomeni në rritje i "islamofobisë" shton iluzionin se Islami është armiqësor ndaj paqes, duke kërkuar konfrontim, ndaj është e nevojshme të hulumtohet, rrënjohet dhe paraqitet vizioni i Islamit për paqen.

<sup>1</sup> El Huxhurat 13

Për këtë arsye, forumi për promovimin e paqes në Abu Dhabi 2017 zgjodhi temën “Paqja globale dhe Islamofobia (Frika nga Islami)” si mundësi për të përmbledhur idetë, duke ofruar analiza shkencore dhe shqyrtuar në mënyrë objektive rrënjët dhe shkaqet e frikës së ndërsjellë midis myslimanëve dhe të tjerëve.

Kjo ngjarje globale mbledhi mbi 700 dijetarë, studiues dhe mendimtarë nga të gjitha anët e botës, dhe pata nderin dhe kënaqësinë që, në shoqërim me Myftiun e Kosovës, Naim ef. Tërnavë, të marrë pjesë në diskutimet dhe seancat që u zhvilluan për tri ditë radhazi. Duke e vlerësuar si shumë domethënëse për rrethanat dhe diskutimet që u zhvilluan në diskursin e sotëm shoqëror në vendin tonë dhe mes kombit tonë, e pash të arsyeshme që të paraqes në mënyrë përmbledhëse zhvillimet e kësaj konference globale.

Në këtë vëllim janë përfshirë zërat *Viset shqiptare në Kamus al-a'lâm*, përkthyer nga Zyber Bakiu, *Personalitetet shqiptare në Kamus al-a'lâm*, përkthyer nga Mehdi Polisi, që më parë ishin botuar edhe si botime të veçanta, dhe tani janë shtuar zërat që japin njohuri për Perandorinë Osmane të asaj kohe, për disa qytete dhe treva të saj, si dhe për një varg figurash politike e fetare, të përkthyera prej Metin Izetit.

Në kohën kur vepronte Samiu, pra në çerekun e fundit të shek. XIX, Fuqitë e Mëdha bënë planet e tyre për ndarjen e sferave të ndikimit. Ndërkaq, shtetet e reja ballkanike planifikonin të përfitonin nga tokat shqiptare. Këto momente paraqitnin rrezik për ekzistencën e kombit shqiptar, pasi ai nuk pranohej as nga Fuqitë e Mëdha, as nga shtetet ballkanike, e fatkeqësisht as qëndrimi i Portës së Lartë nuk ishte i qartë.

Shërbimin e drejtpërdrejtë çështjes kombëtare, Samiu ia ka bërë në publicistikën turke me polemikat rreth çështjeve politike, sidomos kundër pretendimeve greke, por edhe sllave, të mbështetura nga politika evropiane, dhe këto polemika shfaqin zgjuarsinë dhe pjekurinë

politike të Samiut. Me artikujt e shumtë për veprimtarinë atdhetare shqiptare, ai u paraqit madje edhe si zëdhënës i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ngjarjet e bujshme që kishin të bënin me shqiptarët dhe trojet shqiptare, Sami Frashëri i regjistroi dhe i komentoi në shtypin turk, gjithnjë duke u përpjekur që gjërat t'i shpjegonte shtruar me argumente, duke iu kundërvënë shumë gazetave për shkrimet antishqiptare që botoheshin në faqet e tyre. Me shkrimet e tij, Samiu lexuesve u ofronte njohuritë e duhura dhe objektive se kush janë shqiptarët, për çka angazhohen dhe çka kërkojnë ata, ngase në atë kohë në shtypin turk manipulohej me kërkesat e shqiptarëve, duke i paraqitur ata si armiq të Islamit dhe të Perandorisë. Në këto shkrime në shtypin turk, Samiu vihej drejtpërdrejt në mbrojtje të tërësisë territoriale të Shqipërisë, në mbrojtje të lëvizjes ideologjike, politike e ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, pra në mbrojtje të çështjes shqiptare. Për këto mund të lexojmë në vëllimin e pestë, që i kushtohet publicistikës së Sami Frashërit, ku përfshihen një sërë shkrimesh nga gazeta *Tercuman-i Shark* (Zëdhënësi i Lindjes), *Sabah* (Mëngjesi), *Tercuman-i Hakikat* (Zëdhënësi i së Vërtetës) dhe nga revista *Hafta* (Java), të përkthyera nga Kristaq Prif-

ti, Abdulla Hamit, Vexhi Buharaja e Vasfi Samimi. Por sigurisht, që kishte edhe shumë gazeta dhe revista në të cilat kishte shkruar Sami Frashëri dhe për tematikat e tjera, si: letrare, gjuhësore e kulturore, që do të ishte mirë të mblidheshin e të përktheheshin në gjuhën shqipe. Edhe pse në këtë vëllim kemi disa shkrime nga revista *Hafta*, mungon pjesa më e madhe e shkrimeve pikërisht të tematikës letrare, gjuhësore e kulturore.

Në Perandorinë Osmane të shekullit XIX, në krahasim me Evropën Perëndimore, kishte ngecje në të gjitha fushat e shkencës. Interesi i intelektualëve ishte i madh për përhapjen e shkencave moderne, të cilat vështirë depërtonin në shoqërinë tradicionale turke. Në këtë drejtim, rol të madh ka luajtur edhe dijetari dhe mendimtari i madh shqiptar Sami Frashëri, i cili u angazhua për popullarizimin e dijeve të shkencave natyrore e shoqërore për tema të patrajuara më parë. Për këtë qëllim, botuesi Mihran, me iniciativë të Samiut, e themeloi Bibliotekën e xhepit, ku u botuan 32 libra me tema të ndryshme enciklopedike, prej të cilëve njëmbëdhjetë janë shkruar nga Sami Frashëri. Ato janë: *Fjalët e urta* dhe *Anekdotat*, të cilat janë përfshirë në Vëllimin II, si dhe *Gjuha*, *Mitologjitë*, *Njeriu*, *Përsëri njeriu*, *Toka*, *Qielli*,

*Gratë*, *Qytetërimi islam*, *E kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e kombeve islame*, *Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit*, të cilat përfshihen në Vëllimin VI. Këto vepra mbështeten në të arriturat e atëherëshme të shkencës, që për shoqërinë turke ishin të panjohura.

Samiu në të gjitha veprat e tij është përpjekur për zgjimin e masës së popullit dhe besonte se, me zgjimin dhe ndriçimin e masës së popullit me njohuritë e zbulimeve të reja, do të dobësohej edhe baza e regjimit totalitar, absolut të Perandorisë Osmane mbi kombet e shtypura, ndër të cilët ishte edhe ai shqiptar.

Nga veprat e serisë së xhepit, më gjerësisht do t'i prezantojmë dy prej tyre: *Gratë* dhe *Gjuha*. Vepra *Kadınlar* (Gratë), të cilën Samiu e shkruan për ta luftuar gjendjen e vështirë të gruas myslimane, duke kërkuar arsimimin dhe inkuadrimin e saj në të gjitha porët e shoqërisë, dhe vlerëson se arsimimi dhe edukimi i grave siguron të ardhmen e shoqërisë njerëzore. Ai thotë se: *Rëndësia e grave është shumë më e madhe pasi ato edukojnë shoqërinë njerëzore*, dhe se arsyeja që Samiu ta shkruaj këtë vepër ka qenë ajo se për çështjet e grave, për përmirësimin e gjendjes së grave në vendet islame, në gjuhët arabe, perse e turke, nuk është shkruar asgjë. Poro-

sitë e Samiut në këtë vepër janë: gruaja është baza e shoqërisë njerëzore, shtylla e moralit publik, nyja e një lidhjeje të shenjtë e familjes, e cila e nxjerr njeriun nga errësira dhe e zbut; ajo është një lulishte e njerëzimit.”<sup>1</sup>

Vepra *Gjuha (Lisan)*, 1886, i përket shkencës së gjuhësisë dhe konsiderohet vepra e parë në fushën e studimeve gjuhësore në Turqi. Këtu, Samiu, pasi flet për turqish-ten, ai flet rreth asaj se ç’është gjuha, për tipat kryesorë të gjuhëve dhe afritë e tyre, pastaj flet për familjet dhe grupet kryesore të gjuhëve në botë.<sup>2</sup> Ai jep mendimet e

dijetarëve të lashtë dhe të vonshëm mbi gjuhën, pastaj flet për gjuhësinë dhe shpjegon përparimin e shpejtë të kësaj shkence.

Dhe, vëllimi VII i kësaj serie të veprave të Sami Frashërit paraqet bibliografinë, e cila, siç shihet, është një bibliografi e pasur, si e veprave të botuara të Samiut, ashtu edhe e shkrimeve për Samiun, edhe në gjuhën shqipe, edhe në atë turke, por mbase larg për të qenë e shteruar. Pjesën e dytë të këtij vëllimi e përbëjnë kumtesat e ndryshme të studiuesve që kishin për qëllim të hedhin dritë mbi veprimtarinë intelektuale, kulturore e shoqërore të tij.

Bibliografia e Sami Frashërit është figura më e madhe intelektuale në shekullin XIX në Perandorinë Osmane. Ky dijetar i madh, me prejardhje shqiptare, krijoi në të gjitha fushat e dijes dhe të kulturës, duke kontribuar dukshëm për emancipimin shoqëror, sidomos të popullit turk, në gjuhën e të cilit u shkruan pjesa më e madhe e veprave të tij.

publicistika e Samiut që jepet në vëllimin e pestë ne sa për informim të shënojmë se ky shkrim i Samiut është përkthyer në shqip. Shih: Abdulla Hamiti, *Sami Frashëri për origjinën dhe ndarjen e gjuhëve*, në **Edukata islame**, nr. 77, Prishtinë, 2005, f. 165-191.

<sup>1</sup> Për pikëpamjet e Samiut për trajtimin e gruas në Islam dhe për pozitën e gruas në familje e shoqëri më gjerësisht shih: Abdullah Hamiti, *Sami Frashëri për rolin dhe pozitën e gruas në familje e në shoqëri*, në: “Dituria Islame”, nr. 72/1995, f. 27-31; dhe: *Sami Frashëri për të drejtat e gruas në Islam*, në: “Dituria Islame”, nr. 73/1995, f. 26-31;

<sup>2</sup> Samiu pesë vjet para se ta shkruante veprën “Gjuha” në revistën “Hafta”, të cilën e nxori në vitin 1881 në gjashtë vazhdimë me (nr. 1 f. 11-14; nr. 2, f. 29-31; nr. 4, f. 40-62; nr. 5, f. 76-78; nr. 7, f. 109-11 dhe nr. 8, f. 12-126) botoi një studim të gjatë me titull “*Lisan-larin Insabi ve Taksimati*” (Prejardhja dhe degët e gjuhëve), i cili si duket ka lidhje të drejtpërdrejtë me librin e tij “*Lisan*” (Gjuha). Meqenëse ky artikull i Samiut nuk është përfshirë te

Jeta e këtij eruditi në Stamboll filloi me shkrime dhe përmbyllet me shkrime. Këto shkrime të Sami Frashërit, që përbëjnë një opus të gjerë të veprave të cilat shtrihen nga ato të publicistikës, të shkencave të ndryshme gjuhësore, letrare, fetare e të tjera, vazhdimisht zgjuan interesimin e studiuesve turq, shqiptarë dhe jo vetëm. Ato fatmirësisht sot i gjejmë të botuara në versionin më të kompletuar në gjuhën shqipe. Falë shtëpisë botuese “Logos -A” nga Shkupi, e cila meritoi përgëzime dhe falënderime për këtë punë

kolosale për kulturën turke dhe atë shqiptare.

Dhe këtu po e mbylлим me kaq këtë fjalë tonën, me këtë recension ku prezantuam veprat e Sami Frashërit, ideologut të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, dijetarit, enciklopedistit, shkrimtarit dhe publicistit me personalitet poliedrik si veprimtar që nderoi si kulturën turke ashtu edhe atë shqiptare.

**Prof. Dr. Abdulla Hamiti**


Departamenti i Orientalistikës  
Fakulteti i Filologjisë - Prishtinë

# PËRMBYSJA E NARRATIVËS HISTORIKE SERBE PËR KOSOVËN E PERIU DHËS OSMANE

(Sadik Mehmeti dhe Hatixhe Ahmedi: *Popullsia e Kazasë së  
Prizrenit sipas defterëve të vitit 1833*  
(Prizreni, Suhareka, Rahoveci, Malisheva, Drenasi).  
Botoi: Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2024)

Libri i Sadik Mehmetit dhe Hatixhe Ahmedit, *Popullsia e Kazasë së Prizrenit sipas defterëve të vitit 1833*, botuar nga Instituti Albanologjik në Prishtinë, është një studim historik i veçantë dhe shumë origjinal mbi historinë e Kosovës në periudhën osmane. Ky libër nuk është thjesht një analizë historike, por një kontribut i çmuar në studimin e historisë së Kosovës gjatë periudhës osmane.

Autorët, Mehmeti dhe Ahmedi, kanë sjellë edhe më parë kontribute të rëndësishme për historinë e Kosovës gjatë periudhës osmane, duke paraqitur dokumente dhe burime të panjohura nga arkivat e pasura të Stambollit. Kontributet e tyre bashkautoriale për të dhënat demografike të Kosovës kanë sfiduar dhe përmbysur narrativen historike serbe për Kosovën, duke u mbështetur në burime autentike nga arkivi i



Stambollit, konkretisht në defterët osmanë të vitit 1833. Këta defterë janë një nga burimet kryesore për studimin e historisë së Perandorisë Osmane dhe mbulojnë një periudhë të gjatë, duke filluar nga themelimi i perandorisë deri në shpërbërjen e saj. Përveç kësaj, defterët e vitit 1833 janë dëshmi të proceseve të ndryshme historike, si ndarja administrative, luftërat dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Kjo është periudha kur në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane fillojnë të shfaqen lëvizjet kombëtare dhe tendencat për krijimin e shteteve homogjene kombëtare. Në këtë kontekst, duhet pranuar se shqiptarët u paraqitën të vonuar në ndërtimin e identitetit të tyre kombëtar. Gjatë shekullit XIX, për shkak të interesave shtetërore dhe hegjemoniste, historiografia serbe ka krijuar një narrativë që sugjeron se popullata shumicë e Kosovës ishte serbe dhe ortodokse. Mohimi i pranisë së shqiptarëve në Kosovë ka shërbyer si një mjet për të legjitimuar pretendimet hegjemoniste të shtetit serb mbi Kosovën, e cila, siç vërtetohet nga ky studim, ka qenë pjesë organike e Arnautllëkut osman, me një shumicë absolute shqiptare. Ky studim sfidon këtë model të propagandës serbe duke sjellë dëshmi dhe dokumente autentike nga Arkivi i Stambollit.

Periudha që mbulon ky studim është fillimi i shekullit XIX, kur Kosova ndodhej nën Perandorinë Osmane, një periudhë që shënonte fillimin e një serë reformash, të cilat synonin forcimin e pushtetit të centralizuar osman dhe krijimin e një aparati burokratik sipas modeleve evropiane. Këto reforma, të njohura më vonë si Tanzimat, kishin për qëllim modernizimin dhe konsolidimin e themeleve sociale dhe politike të perandorisë. Ndër të tjera, këto reforma përfshinin edhe shkatërrimin e trupës ushtarake të jeniçerëve, njësisë elitare të këmbësorisë, nga Sulltan Mahmuti II, më 1826. Ky proces u shoqërua me ngritjen e ushtrisë së re, dhe për këtë arsye ishte i nevojshëm regjistrimi i popullsisë, një iniciativë që filloi pas Luftës Ruso-Osmane (1828-1829) dhe që u realizua në vitin 1830.

Regjistrimi i popullsisë kishte për qëllim evidentimin e resurseve demografike dhe ndryshimeve të ndodhura gjatë shekujve të dominimit osman, si dhe për regjistrimin e meshkujve të aftë për shërbim ushtarak dhe mbledhjen e taksave, të cilat ishin tepër të nevojshme për përballimin e lëvizjeve kombëtare që shpërthyen në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane. Gjatë kësaj periudhe, edhe shqiptarët filluan të organizoheshin në lëvizje për forci-

min e Rilindjes Kombëtare, një lëvizje që vepronte kryesisht nga jashtë për emancipimin kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve, të cilët po ndjenin rrezikun nga ambiciet hegjemoniste të shteteve ballkanike përballë dobësisë evidente të shtetit Osman. Në aspektin administrativ, Kosova, në fillim të shekullit të 19-të, ishte pjesë e Ejaletit të Rumelisë, me qendër në Manastir, ndërsa pas Tanzimatit, territori i Kosovës u përfshi në Sanxhakun e Dukagjinit. Në gjysmën e parë të shekullit 19, siç vërejnë autorët e këtij studimi, Mehmeti dhe Ahmedi, Kosova shtrinte një hapësirë gjeografike që përputhej me provincën ilire të Dardanisë, me kryeqendër Shkupin, dhe shtrihej në veri nga Jeni Pazar dhe kufiri me Serbinë, në verilindje dhe lindje nga Nishi, Prokupla, Krushumlija, Leskovci, Vranja dhe Kumanova, ndërsa në jug nga Shkupi. Edhe pse këto ndryshime administrative kishin për qëllim shmangien e homogenitetit etnik dhe fetar për të parandaluar organizimin e lëvizjeve osmane, ato e bënë të vështirë njohjen e strukturës etnike dhe fetare brenda ndarjeve administrative të shtetit osman.

Sadik Mehmeti dhe Hatixhe Ahmedi në studimin e tyre, *Popullsia e Kazasë së Prizrenit sipas defterëve të vitit 1833*, vërejnë se

shumë pak studiues kanë marrë për-sipër të punojnë me materialet e pluhuruara të arkivave për të shkruar ndonjë studim të detajuar. Siç thekson shkencëtari i njohur turk, Kemal Hikmet Karpat, në veprën e tij "Popullsia Osmane 1830-1914" (Londër, 1984), shumica e studiuesve shmangin punën me këto dokumente të vjetra. Arkivat e Stambollit dhe Ankarasë përmbajnë shumë materiale, por studimet për popullsinë kanë qenë të pakta. Për sa i përket Kosovës, studimet për historinë dhe demografinë osmane janë edhe më të rralla për shkak të numrit të vogël të studiuesve që dinë gjuhën e vjetër turko-osmane.

Ky studim, i bazuar në defterët e regjistrimit të popullsisë myslimane, krishtere dhe kipte të vitit 1833, është shumë i rëndësishëm për studimin e historisë osmane të Kosovës. Përdorimi i këtyre burimeve ndihmon në përcaktimin e strukturës demografike të Kosovës në dekadën e katërt të shekullit të 19-të. Deri më tani, përveç disa informacioneve të pjesshme, të trajtuara në punime të ndryshme ose në artikuj të udhëpërshkruesve osmanë dhe evropianë, si dhe të dhënave të konsujve austro-hungarezë, nuk ka pasur studime të thelluara dhe gjithëpërfshirëse për këtë periudhë.

Ky studim analizon në detaje tre defterët osmanë të regjistrimit të

popullsisë së Kazasë së Prizrenit, përfshirë Suharekën, Rahovecin, Malishevën dhe Drenasin të hartuar në vitin 1833. Defterët ofrojnë të dhëna të vlefshme për organizimin administrativ të rajonit dhe mundësinë për të kuptuar më mirë përbërjen etnike dhe fetare të popullsisë. Sipas autorëve, defterët e regjistrimeve të popullsisë në Arkivin e Stambollit përmbajnë informacion të rëndësishëm që lidhet me periudhën e qeverisjes së Sanxhakut të Prizrenit, të drejtuar nga Mahmut Pasha Rrotulla, dhe me lëvizjet e rezistencës të pashallarëve shqiptarë kundër reformave osmane.

Në këtë libër, autorët analizojnë edhe përbërjen etnike të popullsisë, duke konfirmuar se shumica e popullsisë në rajonet e Kosovës ishte shqiptare, kryesisht myslimane, dhe se pesha numerike e popullsisë ortodokse, përkatësisht sllave, ishte minimale, nga 10 deri në 15%. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të kuptuar praninë e shqiptarëve në trojet e tyre historike si popullsi autoktone. Pjesë të tjera të studimit ndihmojnë në pasqyrimin e strukturës gjinore të popullsisë, që ishte kryesisht mashkullore dhe përdorej për të planifikuar potencialin ushtarak të rajonit.

Libri *"Popullsia e Kazasë së Prizrenit sipas defterëve të vitit 1833"* i autorëve Sadik Mehmeti

dhe Hatixhe Ahmedi, paraqet një studim të thelluar mbi regjistrin e popullsisë të kazasë së Prizrenit, bazuar në dokumentet historike të vitit 1833. Ky libër është një përpjekje serioze për të pasqyruar situatën demografike dhe shoqërore të një zone të rëndësishme të Kosovës, duke ofruar një pasqyrë të detajuar mbi strukturën e popullsisë, organizimin administrativ dhe zhvillimin e fshatrave të Prizrenit, Suharekës, Rehovecit, Malishevës dhe Drenasit. Mbi bazën e defterëve origjinal të shtetit Osman bashkautorët e librit kanë ndihmuar në rikonstruksionin e asaj periudhe dhe të kuptuarit e jetës së përditshme të popullatës, duke analizuar të dhënat mbi numrin e familjeve, ndarjet etnike dhe fetare, si dhe kushteve socio-ekonomike të kohës. Kjo punë është e rëndësishme për studiuesit e historisë dhe etnologjisë, pasi ndihmon në ndriçimin e ndryshimeve që ndodhën në këtë rajon gjatë periudhës osmane, dhe pasqyron jetën dhe zhvillimin e komunitetit shqiptar në një periudhë të caktuar.

Autorët, duke përdorur shënime shtesë për terma të ndryshëm osmanë japin detaje të hollësishme, të cilat i ndihmojnë studiuesve dhe përgjithësi lexuesit të gjerë të kenë një pasqyrë për ambientin e shoqërisë osmane si dhe mënyrën e operimit të administratës osmane në atë

periudhë. Si i tillë, ky studim na ndihmon në kuptimin e rrjedhave historike të Kosovës dhe lidhjeve të saj me sistemin e shtetit Osman. Puna është e pasur me të dhëna të reja dhe është një kontribut i rëndësishëm për historiografinë dhe studimet albanologjike. Ky studim i Mehmetit dhe Ahmedit është një kontribut origjinal mbi historinë e Kosovës osmane, duke ofruar një

pasqyrë të qartë dhe të dokumentuar të popullsisë dhe ngjarjeve të rëndësishme të kohës, që shkrijnë më mirë kontekstin historik dhe etnik të Kosovës gjatë periudhës osmane.

**Dr. Sylë Ukshini**




## NJË NISMË E MBARË QË DUHET VAZHDUAR

(Necdet Yilmaz (përgatiti), *Alimi shqiptar Ali efendi Jakupi (1913 – 1988)* - *Kujtime*, përktheu nga Turqishtja: Behar Kaçeli, “Dituria Islame”, Prishtinë 2024, f. 303).

Në çdo epokë jetësore Allahu, xh.sh. na begatoi me dijetarë që i ndoqën hapat e Pejgamberit, s.a.v.s., gjatë tërë jetës së tyre. Na begatoi me njerëz që me urtësinë dhe dijen e tyre ua kanë ndriçuar mendjet dhe zemrat të tjerëve. Fatkeqësisht, ka shumë dijetarë islamë shqiptarë që nuk njihen në trojet tona, siç është dhe Ali ef. Jakupi, të cilin pak janë ata që e njohin. Fjalët nuk mund ta shprehin admirimin për këtë dijetar, i cili tërë jetën ia kushtoi fesë, mirëpo tepër pak u njoh në mesin e bashkëkombësve të vet.

### Prejardhja e Ali ef. Jakupit

Edhe Ali Jakupi, si shumë hoxhallarë, ka prejardhje nga një familje fetare. Ai lindi në Gjilan, me baba hafëz Hysenin dhe nënë Hyri-shahen. Familja e tij kishte prejardhje nga Shkodra. Gjyshi i tij, Ymer beu, emigroi në Gjilan nga Kolgeci i Shkodrës. Gjyshi i Ali efendiut, haxhi Jakupi, e përfundoi medresenë e Nishit, ndërsa babai dhe xhaxhai i tij studiuan në medresenë “Fatih” në Stamboll. Edhe



gjyshja e Aliut ishte besimtare e devotshme. Në kohën e sulltan Abdulhamitit, dy djemtë e saj morën pjesë në një luftë në Greqi. Kur banorët e Gjilanit e këshilluan ta ç’regjistronte njërin prej tyre, ajo lutej çdo natë që Allahu t’i pranonte si shëhidë, për t’u bërë nënë shehidësh.

### Shkollimi i Ali Jakupit

Ali Jakupi e përfundoi arsimin fillor në shkollën serbe të Gjilanit, ndërsa mësimet e Kuranit i mori prej të atit. Gjatë viteve 1924-1927

studioi në medresenë e Gjilanit, ku pati mësues mulla Kadri efendiun, myderriz Abdurrahmanin dhe Hasan ef. Faikun.

Në vitin 1927 studimet i vazhdoi në Shkup, në medresenë “Medah”, ku mësoi prej Ataullah efendiut dhe Sejfedin efendiut. Pas kthimit, në Gjilan e përfundoi shkollën e mesme shtetërore (1928-1929). Në vitin 1931 e kaloi provimin pranues në “Mektebi Nuvab” në Sarajevë, mirëpo pas vdekjes së babait (1932) u detyrua t’i ndërpriste studimet.

Në vitin 1936 u regjistrua në universitetin “Az’har” në Egjipt, ku mësoi te personalitete si Mustafa Sabriu, Zahid Kevseriu dhe Yozgath Ihsani. Në atë kohë në Kajro studionin edhe figura si Hysen Latifi, Muharrem Tahsini, Hysen Hoxha, Feti Meka, Tefik Isalmi, Vehbi Ismaili dhe Sulejman Gavoçi.<sup>1</sup>

### **Ali efendi në Egjipt**

Ali efendi Jakupi arriti të studiojë në Egjipt, edhe pse me shumë vështirësi, dhe arriti të kishte një formim fetar dhe një kulturë të larmishme. Me një fjalë, ishte një intelektual i mirëformuar. Ai u formua prej dijetarëve si Mustafa Sabri efe-

ndiu dhe Hasan El Benani, si dhe shumë e shumë dijetarë të tjerë. Ai punoi si nënpunës në Biblotekën Qendrore të Universitetit të Kajros, për dhjet vjet me rradhë, ku aty iu dha rasti të lexonte aq sa ai donte.

Më i dashuri për Ali Jakupin ishte Mustafa Sabriu, me të cilin e kishin edhe një lidhje të veçantë bashkëpunimi. Mustafa Sabriu ishte gjithmonë i pari në debate, e Ali Jakupi s’bindej aq kollaj. Madje, një herë Egjiptin e kishte vizituar mbreti Zogu I, dhe ai dëshironte të takohet me Mustafa Sabriun. Ky i fundit e ftoi dhe Ali Jakupin, e ai mendonte se nuk ishte kompetent për këtë takim, prandaj nuk pranoi të marrë pjesë. E, Mustafa Sabriu iu kthye: “Eh, shqiptar kokëfort ti!”<sup>2</sup>.

### **Më shumë për librin**

Libri “Alimi shqiptar Ali Jakupi” i autorit Dr. Necdet Yılmaz, përkthyer prej Behar Kaçelit, ofron një pasqyrë të thellë dhe tërheqëse të jetës dhe veprimtarisë së njërës prej dijetarëve më të shquar të botës islame.

Ali ef. Jakupi ka lënë një trashëgimi të pasur, duke kombinuar njohuritë teologjike me një angazhim të thellë në shërbim të besim-

<sup>1</sup> <https://shkodrar.wordpress.com/2009/04/16/ali-efendi-jakupi1913-1988/>

<sup>2</sup> Shih Librin “Alimi shqiptar Ali Jakupi” f. 26!

tarëve dhe studentëve. Ky libër është një përpjekje për ta pasqyruar jetën e tij të mbushur me sfida, mësimet dhe refleksime të paçmueshme që ndihmuan në formimin e shumë gjeneratave të reja të dijetarëve dhe besimtarëve.

Libri ka plot ngjarje të veçanta, sikurse, për shembull edhe ajo nga vitet 1938-1939, kur Ali Jakupi shkoi si vaiz në Gynylxhine dhe mbante ligjërata në xhami. Pasuri mi i dijes ishte një përpjekje e vazhdueshme për të, siç tregon historia e tij me një të ri në Bejrut, i cili e mashtroi për të marrë një shumë parash, një ngjarje që pasqyron natyrën e tij të besimit dhe të mirësisë. Ndërsa përjeton një pasiguri të thellë, Ali ef. Jakupi mëson t'i përballojë sfidat me mençuri dhe qetësi, duke u ngushëlluar prej Mustafa Sabriut dhe duke përvetësuar një nga mësimet e tij të rëndësishme, atë se besimi në caktimin e Allahut është më i rëndësishëm se çdo dyshim.

Pjesa tjetër e librit ndriçon periudhën kur Ali Jakupi punoi në Ankara si përkthyes, por u detyrua të punonte edhe në një fabrikë si llogaritar, për të mbijetuar, një periudhë kur, pavarësisht kushteve të vështira, ai vazhdoi me përkushtim mësimin e studentëve dhe ligjëratat në xhami. Ai i kushtoi kohë për të shpjeguar tefsir dhe librin "Ihja

Ulumu Din" të Gazaliut, duke përfituar njohuri të thella që i ndihmuan të mbetej një figurë udhëheqëse dhe autoritare në botën islame. Mësimet e tij, të bazuara në përkushtim dhe thellësi intelektuale, ndikuan fuqishëm në zhvillimin e shumë studentëve, të cilët në të ardhmen e afërt edhe do të bëheshin dijetarë të shquar.

Ali ef. Jakupi ishte një mësues që frymëzonte jo vetëm me dijen, por edhe me sjelljen e tij të dashur dhe mbështetëse. Ai kujdesej jo vetëm për edukimin e studentëve, por edhe për jetën e tyre personale, duke i ndihmuar ata në menaxhimin e sfidave të jetës dhe duke i udhëzuar që gjithmonë të qëndronin të përkushtuar ndaj dijes. Ky pasion e tij për të mësuar dhe për t'i mësuar të tjerët është ndjekur me një kujdes të veçantë, duke ua mundësuar të rinjve të marrin dije që do t'i ndihmonte ta zhvillonin jetën e tyre në mënyrë të denjë.

Për më tepër, lidhjet e ngushta miqësore që Ali ef. Jakupi kishte me shokët dhe kolegët e tij të dijes, janë dëshmi e natyrës së tij të sinqertë dhe të kujdesshme. Kjo është evidentuar edhe në marrëdhëniet e tij me shumë dijetarë të tjerë, si Mustafa Çitlak dhe Shejh Sami Ramazanoglu, si dhe me miq të tjerë që tregojnë se ai ishte një person që gjithmonë e vlerësonte bashkëpunimin.

min dhe solidaritetin ndërmjet dijetarëve dhe shokëve të tij.

Në përmbyllje të këtij shkrimi për veprën kushtuar dijetarit Ali ef. Jakupi, librin “Alimi shqiptar Ali Jakupi”, mund të themi se ky libër është një pasqyrë e thellë dhe ndriçuese për jetën dhe veprën e një njeriu të shquar, i cili e ka dhënë gjithë jetën për përhapjen e dijes dhe fesë, si dhe përkujdesjen ndaj

shoqërisë. Ky libër është një thesar i vërtetë për ata që duan të mësojnë nga eksperiencat dhe mësimet e tij të paharrueshme, krahas faktit se mund të mësojnë edhe shumë gjëra nga dijet e përgjithshme që kishte eruditi ynë, Ali ef. Jakupi.

**Kanita Hyseni**

# PËRMBAJTJA

|                                                                                                                          |     |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| <b>I. EDITORIAL</b> .....                                                                                                | 5   |
| HARMONIA NDËRFETARE – VLERË IDENTIFIKUESE<br>E POPULLIT SHQIPTARË .....                                                  | 7   |
| <b>II. ISLAMISTIKË</b> .....                                                                                             | 11  |
| Dr. Ass. Bahri HOXHA .....                                                                                               | 13  |
| XHENETI DHE XHEHENEMI NË BESIMIN ISLAM .....                                                                             | 13  |
| Prof. Ass. Dr. Valmire BATATINA KRASNIQI .....                                                                           | 29  |
| KONCEPTI DHE RËNDËSIA E AGJËRIMIT<br>GJATË MUAJIT RAMAZAN .....                                                          | 29  |
| Myftiu Naim TËRNAVA .....                                                                                                | 43  |
| FILOZOFË E MENDIMTARË ARGUMENTOJNË<br>BESIMIN NË ZOT (2) .....                                                           | 43  |
| Dr. Sedat ISLAMI.....                                                                                                    | 59  |
| KURANI SIPAS HADITHEVE PEJGAMBERIKE .....                                                                                | 59  |
| Dr. Ajni SINANI.....                                                                                                     | 89  |
| SHERIATI DHE FIKHU (2).....                                                                                              | 89  |
| <b>III. KULTURË / TRASHËGIMI</b> .....                                                                                   | 119 |
| Hafëz Sabit ef. ZAIMI .....                                                                                              | 121 |
| ME SHKAS (HASBIHAL) .....                                                                                                | 121 |
| Vehbi Sylejman GAVOÇI - Albani .....                                                                                     | 131 |
| PËRKTHIM I KUPTIMEVE TË KAPTINËS “EL ASËR” ....                                                                          | 131 |
| Dr. Ejup HAZIRI .....                                                                                                    | 139 |
| MARRËVESHJA E OMERIT ME BANORËT<br>E JERUSALEMIT (PALESTINËS).....                                                       | 139 |
| Dr. Nail DRAGA .....                                                                                                     | 157 |
| 80-vjetori i krimeve të komunistëve në Ulqin<br>HASAN LLUNJI - MYFTIU I ULQINIT<br>VIKTIMË E KOMUNIZMIT (1897-1944)..... | 157 |

|                                                                                                                                 |            |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| Sabine SCHMIDTKE .....                                                                                                          | 169        |
| RACIONALIZMI TEOLOGJIK NË BOTËN MESJETARE<br>TË ISLAMIT .....                                                                   | 169        |
| Mentor MERXHA .....                                                                                                             | 193        |
| NJË JETË NË SHËRBIM TË FESË DHE XHEMATIT<br>HAFËZ SALIH EF. GOGA (1915-2000) .....                                              | 193        |
| Isak N. BILALLI .....                                                                                                           | 213        |
| HFZ. AVNI ALIU, INTELEKTUALI QË INFLUENCOI<br>CILËSISHT PROMOVIMIN E VLERAVE FETARE<br>DHE KOMBËTARE NË KOSOVË (1947-2011)..... | 213        |
| <b>IV. REFLEKSIONE</b> .....                                                                                                    | <b>221</b> |
| Prof. Dr. Hysen MATOSHI .....                                                                                                   | 223        |
| HARMONIA FETARE TE SHQIPTARËT.....                                                                                              | 223        |
| Besnik JAHA .....                                                                                                               | 233        |
| FAKTORI <i>GJUHË</i> NË HISTORINË<br>E KULTURËS LETRARE SHQIPTARE .....                                                         | 233        |
| Mr. Besim MEHMETI.....                                                                                                          | 245        |
| PAQJA GLOBALE DHE ISLAMOFOBIA<br>(FRIKA NGA ISLAMI) .....                                                                       | 245        |
| <b>V. RECENSIONE</b> .....                                                                                                      | <b>277</b> |
| BOTIMI MË I KOMPLETUAR I VEPRAVE<br>TË RASHËRIT NË GJUHËN SHQIPE .....                                                          | 279        |
| PËRMBYSSJA E NARRATIVËS HISTORIKE SERBE<br>PËR KOSOVËN E PERIUDHËS OSMANE.....                                                  | 287        |
| NJË NISMË E MBARË QË DUHET VAZHDUAR.....                                                                                        | 293        |
| PËRMBAJTJA .....                                                                                                                | 297        |